MË E MIRA E BOTËVE



ALDOUS HUXLEY

MË E MIRA E BOTËVE

Aldous Huxley

KAPITULLI I

Një ndërtesë gri dhe hijerëndë vetëm tridhjetë e katër kate. Në hyrjen kryesore mbishkruheshin fjalët: "Qendra e shumimit dhe e kushtëzimit për Londrën qendrore" dhe në emblemë, motoja e Botës Shtet: Komunitet, Identitet, Stabilitet. Dhoma e madhe në katin përdhes shihte nga veriu. E ftohtë gjatë gjithë verës atje pas xhamllëkut, edhe pse një i nxehtë tropikal brenda dhomës; një dritëz e hollë dhe e sertë çau përmes dritares duke kërkuar me etje ndonjë manekin të hekurosur, ndonjë formë të zbehtë mumieje akademike, por hasi vetëm xhamin, metalin, si dhe porcelanin e laboratorit me shkëlqimin e tij të ftohtë. Zymtësia këtu i kthente fjalën zymtisë. Mbështjellat e punëtoreve ishin të bardha, duart e veshura me doreza të ngushta gome ishin ngjyrosur lehtë me ngjyrë mishi. Drita qe e ftohtë, e vdekur, fantazmë. Vetëm nga gypat në ngjyrë të verdhë të mikroskopëve përvidhej njëfarë substance e pasur dhe e gjallë, e cila, shtrirë përgjatë tubave të lustruar si me gjalpë, fashë pas fashe shtrohej ëmbël mbi tavolinat e punës.
"Dhe kjo, - tha drejtori duke hapur portën, - është Dhoma e Fekondimit."
Të kërrusur mbi instrumente, treqind fekondues i qenë futur punës në kohën kur drejtori i Shumimit dhe Kushtëzimit

hyri në dhomë, mes heshtjes që gati thithej si ajër, hutimit, këti monologu mërmëritës e fishkëllyes që dilte nga përqendrim i thellë. Një grup studentësh që sapo kishin hyrë, fare të rinj buzëqumësht e të papërvojë, nervozë, gati për gjynah, ndiqnin bllok shënimesh, ku, sa herë që njeriu i madh hapte gojë, r drejtorin hap pas hapi. Secili prej tyre mbante me vete ni dëshpërim shkarravisnin diçka, pa lënë fjalë të binte në tokë. Ishte një privilegj i madh. Drejtori për Londrën Qendrore përherë do të thoshte diçka të veçantë kur shoqëronte studentët
e tij të rinj nëpër departamentet e ndryshëm.
"Sa për t'ju dhënë një ide të përgjithshme," - u shpjegoi ai. Për shkak se ata duhet patjetër të kishin një ide të përgjithshme nëse donin të mbyllin punimet e veta në mënyrë sa më inteligjente - megjithatë kjo prapë ishte shumë pak nëse dëshira e tyre ishte të bëheshin anëtarë të mirë e të lumtur të shoqërisë. Në veçanti, siç e dinë të gjithë, është kërkesa për virtyt dhe lumturi; ndërsa nga pikëpamja intelektuale, parimet e përgjithshme janë ca djaj të nevojshëm. Nuk janë filozofet por sharrëxhinjtë dhe koleksionistët e pullave të postës ashti i vërtetë i shoqërisë.
"Nesër, - vijoi fjalën duke u buzëqeshur lehtë, por kërcënueshëm, - do t'i futeni punës vendçe. Nuk do të keni më kohë të merreni me gjëra të përgjithshme". Ndërkohë..
Ndërkohë, ishte privilegj. Drejt nga goja e tij, pa rënë një fjalë përtokë, drejt e në bllokun e shënimeve. Djemtë shkarravisnin shpejt si të çmendur.
I gjatë, pak si i hollë, por shtatdrejtë, drejtori shkoi më tutje. Ai kishte një mjekër të gjatë e të madhe, dhëmbët pak të dalë, por kur nuk ishte duke folur, dhëmbët i mbuloheshin shpejt prej një palë buzësh të përdredhura me ngjyrë të kuqe. I ri, i

moshuar? Tridhjetë? Pesëdhjetë? Vështirë ta thuash. Gjithsesi nuk do t'i qëllonte kurrë ta pyeste njeri për moshën; në vitin e stabilitetit, 632 P. F., askush nuk pyet më për moshën.
"Më duhet ta nis që nga fillimi, - tha Drejtori, e studentët më të zellshëm e shkruan me të shpejtë në bllok qëllimin e tij: ta nisim nga fillimi. - Këto, - tregoi ai duke lëkundur duart, – janë inkubatorët. - Dhe, duke hapur një portë të izoluar, u tregoi rafte e rafte një mbi një me provëza të etiketuara. - Furnizimi me vezë për një javë; të mbajtura, - shpjegoi ai, – në temperaturën e gjakut, kurse gameta mashkullore, - dhe ja ku e hapi dhe një portë tjetër, - duhet mbajtur në tridhjetë e pesë gradë, jo në tridhjetë e shtatë gradë. Temperatura standarde e gjakut e sterilizon." Desh me mbështjellje termogjene, jo qengja naivë.
I mbështetur ende pas inkubatorit, ndërsa lapsat rendnin me shpejtësi nëpër faqe, ai u dha një përshkrim të procesit modern të fekondimit; në fillim, sigurisht, foli për përdorimin e kirurgjisë: "Operime të ndërmarra vullnetarisht për të mirën e shoqërisë, pa harruar ama edhe faktin se kjo gjë vjen me një bonus në rrogë, e barabartë me pagesën e gjashtë muajve." - vijoi për pak me disa shpjegime mbi teknikën e konservimit për të mbajtur gjallë vezoren të prerë dhe në zhvillim normal; me tej solli në vëmendje temperaturën e favorshme, kripësinë, veshtullinë; iu referua lëngut në të cilin mbaheshin vezët e arrira e të shkëputura; dhe duke i drejtuar ndjekësit nga tavolinat e punës, u tregoi se si lëngu tërhiqej nga provëzat, se si lihej të rridhte pikë më pikë në pjata të veçanta në mikroskopë të ngrohur që më parë, se si vezët që ndodheshin aty kontrolloheshin për anomali, numëroheshin dhe transferoheshin në depozita poroze; si (tani i mori dhe i

çoi të shihnin me sy operimin) kjo depozitë e ngrohur duhej të zhytej në një përzierje surrogati ku notonin spermatozoide të lira - me një minimum përqendrimi prej njëqind mijë per centimetër kub, këtë e theksoi; dhe se si, pas dhjetë minutash, depozita nxirrej jashtë nga surrogati dhe përmbajtja e saj rishikohej sërish; si të gjitha vezët që kishin mbetur të pafekonduara zhyteshin sërish, e, nëse kërkohej edhe një herë e tretë, bëhej edhe ajo; se si vezoret e fekonduara ktheheshin mbrapsht edhe njëherë tek inkubatorët; ku Alfat, Deltat dhe Ypsilonët nxirreshin jashtë pas vetëm tridhjetë e gjashtë orësh, për t'iu nënshtruar procesit Bokanovski.
"Procesi Bokanovski," - përsëriti drejtori dhe studentët nënvizuan fjalët e tij në blloqet e tyre të vogla.
Një vezë, një embrion, një i rritur - gjendja normale. Por, vezët e Bokanovskit do të na nxjerrin sythe, do të ndahen më dysh. Nga tetëdhjetë deri nëntëdhjetë e gjashtë sythe dhe çdo syth do të rritet për t'u bërë një embrion i përkryer; dhe çdo embrion do të kthehet në një të rritur. Duke krijuar nëntëdhjetë e gjashtë qenie njerëzore aty ku dikur rritej vetëm një e tillë. Progres.
"Në thelb, arriti në përfundim drejtori i madh, Bokanovskifikimi lidhet me një sërë frenimesh të zhvillimit. Ne kontrollojmë rritjen e përgjithshme, dhe paradoksalisht, vezët ndaj edhe reagojnë duke lëshuar sythe."
Reagojnë duke lëshuar sythe. Lapsat kishin punë.
Ai tregoi me gisht mbi një transportues që lëvizte shumë ngadalë, një radhë plot me epruveta po hynte në kutinë metalike, një radhë tjetër po shfaqej duke dalë. Makineria gërhiste lehtë, si mace. Duhen tetë minuta që tubi të dalë matanë, u tha ai. Tetë minuta rrezesh të forta X ishin pak a

shumë aq sa mund të duronte një vezë. Disa vdiqën; të tjerat, më pak të prekshme, u ndanë më dy pjesë; shumica u vunë mënjanë për sythe, nja tetë; të gjitha i kthyen pas në inkubatorë ku sythet nisin të zhvillohen; pastaj, pas dy ditësh, papritmas i ngrijnë akull dhe i kontrollojnë. Dy, katër, tetë sytha në fazën e lulëzimit; dhe duke lulëzuar ngopeshin gati deri në vdekje me alkool. Si pasojë bulëzonin përsëri për të zënë sytha - syth nga sythi i sythit të sythit (frenimet e fundit ishin në përgjithësi fatale) - më në fund liheshin të zhvilloheshin në paqe. Në këtë kohë veza origjinale qe e gatshme të bëhej një gjë prej tetë deri në nëntëdhjetë e gjashtë embrionesh - një përmirësim i jashtëzakonshëm, të biem njëmendje, i jashtëzakonshëm i vetë natyrës. Binjakë identikë - por jo në dyshe të parëndësishme apo treshe, si në kohët e vjetra të gjallëpjelljes, kur një vezë aksidentalisht ndahej më dysh; sot kjo bëhej në duzina, sëra radhë-radhë njëherësh.
"Rezultate, - përsëriti drejtori dhe lëkundi krahët, sikur po hapeshin horizonte të reja. - Rezultate." Por, njëri nga studentët ishte aq qëndronte leverdia.
budalla sa pyeti se ku
"Mor djalë i mirë! - drejtori u soll rrotull në majë të thembrave dhe iu drejtua atij në mënyrë shumë të prerë. - Nuk e sheh? Nuk e sheh? - Ai ngriti duart lart, shprehia e tij qe solemne. - Procesi Bokanovski është një ndër instrumentet më kryesore të stabilitetit shoqëror!"
Instrumentet më kryesore të stabilitetit shoqëror.
Burra e gra standarde, në tufa standarde. I gjithë stafi i një fabrike të vogël me prodhimin e një veze të vetme Bokanovski.
"Nëntëdhjetë e gjashtë binjakë identikë, për të punuar me nëntëdhjetë e gjashtë makineri identike! - Zëri gati po

i dridhej prej entuziazmit. - Ju e dini se ku ndodheni, për herë të parë në histori... - Ai përmendi moton planetare. Komunitet, Identitet, Stabilitet. - Fjalë të mëdha. mund të bokanovskifikonim në pafundësi, zgjidheshin të gjitha problemet."
Do zgjidheshin nga standardet e Gamave, Deltave të pandryshueshëm, Ypsilonëve uniformë. Miliona binjakë identikë. Parimi i prodhimit në seri i përdorur më në fund në biologji.
"Por mjerisht, - tundi për jo kokën drejtori, - ne nuk mund të bokanovskifikojmë pafundësisht..."
Nëntëdhjetë e gjashtë është limiti, kështu duket; shtatëdhjetë e dy, një mesatare e mirë. Nga e njëjta vezore dhe gametat e të njëjtit mashkull, për të arritur të prodhojmë sa më shumë binjakë identikë të jetë e mundur - kjo ishte më e mira që mund të bënin (fatkeqësisht, gjëja e dytë më e mirë). Madje edhe kjo ishte tepër e vështirë.
"Natyrës i duhen tridhjetë vjet që dyqind vezë të arrijnë pjekurinë. Por është detyra jonë të stabilizojmë popullatën, këtu, tani, këtë minutë. Të hedhësh me pikatore binjakët përgjatë një çerek shekulli - kujt i hyn në punë kjo gjë?"
Fare qartë, askujt s'i hyn në punë, por teknika e Podsnapit e ka përshpejtuar jashtëzakonisht procesin e pjekurisë. Ata ia dolën ta bëjnë të sigurt, që të paktën njëqind e pesëdhjetë vetë të një moshe të bëhen brenda dy vitesh. Fekondo dhe bokanovskifiko - me fjalë të tjera, shumohen me shtatëdhjetë e dy, dhe ia del të marrësh përafërsisht njëmbëdhjetë mijë vëllezër e motra në njëqind e pesëdhjetë tufa binjakësh identikë, brenda dy vjetësh, të gjithë një moshë.

"Dhe në raste të jashtëzakonshme mund ta bëjmë një vezore të na prodhojë më shumë se pesëmbëdhjetë mijë individë." Duke bërë me shenjë nga një biond kuqalash në moshë të re, i cili qëlloi të kalojë aty atë çast, ai thirri:
- Zotni Foster! - Kuqalashi i ri iu afrua. - A mund të ma thuash rekordin e një vezoreje të vetme, zotni Foster?
- Gjashtëmbëdhjetë mijë e dymbëdhjetë në këtë qendër, ia ktheu pa mëdyshje zotni Fosteri. Ai fliste shumë shpejt, kënaqej shumë kur përmendte shifrat. – Gjashtëmbëdhjetë mijë e dymbëdhjetë; në njëqind e tetëdhjetë e nëntë grupe identikësh. Por sigurisht që ia kanë ndalë mbanë më mirë,- vijoi ai, – në disa nga qendrat në tropik. Ajo e Singaporit ka prodhuar shpesh mbi gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind; dhe Mombasa e ka kapur që tani kufirin e shtatëmbëdhjetëmijëshes. Por ata kanë favore me të padrejtë. Ju duhet ta shihni me sy se si një vezore zezake reagon ndaj hipofizës! Është thjesht mahnitëse kur je mësuar të punosh përditë me material evropian. E megjithatë, shtoi ai me një të qeshur (por drita e betejës kish ngelur në sytë e tij dhe lëvizja e mjekrës po i ndryshonte), ne kemi ndërmend t'i mundim po na u dha mundësia. Unë po punoj me një vezore Delta Minus këto kohë. Vetëm tetëmbëdhjetëmuajshe. Mbi dymbëdhjetë mijë e shtatëqind fëmijë që tani, si në enë, ashtu edhe në embrion. Dhe ende mbahet e fortë. Do t'i mundim.
- Ja, kjo është fryma që më pëlqen! - thirri drejtori dhe e rrahu zotni Fosterin në shpatull. - Hajde bashkë me ne dhe jepu këtyre djemve shansin të përfitojnë nga dija jote prej eksperti.
Zotni Fosteri buzëqeshi me modesti.
- Me kënaqësi. - Ata u nisën.

Dhoma e Shishezimit ishte plot gjallëri e harmoni prej organizimit të punëve. Thela peritoneumi të freskëta të mbjella, të prera që më parë më masën e duhur, vinin duke hedhur valle mbi ashensorët e vegjël nga Magazina e Organeve në bodrumin e poshtëm. Vezz dhe pastaj, çak! Portat e ashensorit hapeshin; ravijëzuesit të shisheve i mbetej të zgjaste krahun, të merrte një llapë, ta fuste brenda, ta shtronte butë dhe përpara se radha e shisheve të kishte kohë të shkonte shumë larg, në fund të grupit të pafund, prapë vëzz dhe çak! Një thelë tjetër peritoneumi binte nga thellësitë, gati për t'u ngjeshur në një shishe të radhës në këtë procesion që nuk mbaronte kurrë.
Ngjitur me ashensorët qëndronte Matrikulatori. Procesioni vazhdonte; një e nga një vezët ishin transportuar nga epruvetat në enë të gjera; në heshtje shtroja e peritoneumit qe çarë, morula e vënë në vend të vet, solucioni me kripë i hedhur aty... dhe ndërkohë që shishja kish kaluar, e kishin radhën etiketat. Trashëgimia, data e fekondimit, anëtarësimi në grupin Bokanovski – detajet transferoheshin nga epruveta, në shishe. Jo më i paemër, por i emërtuar dhe i identifikuar, procesi marshonte ngadalë; drejt përmes një të çare në mur, ngadalë hynte brenda te Dhoma e Paracaktimit Shoqëror.
- Tetëdhjetë e tetë metra kub skedarë, - tha zotni Fosteri
me endje, ndërkohë që po hynin brenda.
- Të cilat përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, - shtoi drejtori.
- I përditësuar çdo mëngjes.
Dhe i programuar çdo pasdite.
- Kjo është baza mbi të cilën bëhen llogaritë.
- Kaq individë, me këtë e atë cilësi.
- Maksimumi i Normës së Filtrimit për çdo minutë.

Më e mira e botëve
29

Shpenzimet e paparashikueshme të bëra mirë, me
përpikëri.
-Me përpikëri, - përsëriti zotni Fosteri. - Por veç ta dini
sasinë e orëve jashtë orarit që më është dashur të bëj pas tërmetit të fundit në Japoni! - tha ai, vuri buzën në gaz dhe tundi kokën i menduar.
- Paracaktuesit sjellin shifrat te Fekonduesit.
- Të cilët u japin embrionet që ata u kërkojnë.
-Dhe shishet vijnë këtu për t'u paracaktuar deri në detaj. - Pas kësaj, ato çohen poshtë tek Magazinat e Embrioneve. - Ku do të procedojmë më pas edhe ne.
Dhe duke hapur portën, zotni Foster i udhëhoqi poshtë një shkallareje drejt bodrumeve. Temperatura ish prapë tropikale. Ata u futën brenda në një mugëtirë, e cila sa vinte e bëhej më e dendur. Dy dyer dhe një kalim me kthesë të dyfishtë, mbronte qilarin nga çdo infiltrim rastësor i ditës.
- Embrionet janë si film fotografik, - tha zotni Fosteri me shaka, ndërsa po shtynte portën e dytë, - ato mund të durojnë vetëm dritën e kuqe.
Dhe për këtë shkak, studentët u përpoqën të shquajnë sendet brenda errësirës së zjarrtë në të kuqe të thellë, si errësira pas qepallave kur mbyll sytë përballë diellit të pasdites në verë. Përbri radhëve të fryra, kishte rreshta me radhë të pakësuara, rresht pas rreshti, shishet ndrisnin kuqëlime të panumërta; mes kuqëlimeve ndodhej spektri i mjegullt i njerëzve, burra e gra me sy të kuq e të gjitha simptomat e lupusit. Zukama e rrahjeve të makinerive trazonte lehtë ajrin.
—Jepu ca shifra, zotni Foster, - tha drejtori, se qe lodhur duke folur.

Zotni Fosteri qe shumë i lumturuar t'u jepte atyre disa shifra.
Dyqind e njëzet metra e gjatë, dyqind e gjerë, e dhjetë e lartë. Ai tregoi lart. Si pula që pinë ujë, studentët ngritën sytë drejt tavanit të largët.
Tri rreshta me rafte; kati përdhes, galeria e parë, galeria e dytë.
Rrjeti i çeliktë si ai i merimangës ngrihej galeri mbi galeri, tretej tej në të gjitha drejtimet nëpër errësirë. Pranë tyre tri fantazma të kuqe punonin fort duke shkarkuar damixhanat nga një konvejer.
Konvejeri vinte prej Dhomës së Paracaktimit Shoqëror.
Çdo shishe duhej të vendosej në njërin nga pesëmbëdhjetë raftet. Çdo raft, megjithëse nuk shihej gjë hiç, ishte një konvejer që lëvizte me një ritëm prej tridhjetë e tre e një çerek, centimetrash në orë. Dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë ditë me tetë metra në ditë. Dy mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë metra plotësisht. Një qark i qilarit në katin përdhes, një në galerinë e parë, gjysmë në të dytën, dhe në mëngjesin e dyqindegjashtëdhjeteshtatë dritë dielli në Dhomën e Filtrimit. E ashtuquajtura "Ekzistencë e pavarur".
- Por në interval, - përmbylli zotni Fosteri, - ne ia dalim t'u bëjmë shumë gjëra deri këtu, oh, bëjmë goxha punë. - E qeshura e tij përmbante vetëdije dhe triumf.
- Kjo është fryma që më pëlqen, - tha drejtori edhe një herë. - Shëtisim edhe ca. Tregoju gjithçka, zotni Foster. Zotni Fosteri ua tregoi me rregull.
U tregoi për rritjen e embrionit në shtratin e vet të peritoneumit. I bëri ta shijonin surrogatin me të cilin i ushqenin, i cili ishte aq i pasur sa gjaku. I shpjegoi përse duhej të

stimuloheshin me placentë dhe tiroksinë. U tha për ekstraktin e copus luteum. U tregoi për currilat, përmes të cilave i ushqenin në mënyrë automatike çdo dymbëdhjetë metra, nga zero deri tek 2040. Foli për dozat e hipofizës që rriteshin gradualisht me kontroll gjatë nëntëdhjetë e gjashtë metrave të fundit të rrugës së tyre. Përshkroi qarkullimin artificial të mëmës, i instaluar në çdo shishe tek metri 112; u tregoi rezervuarin me surrogatin e gjakut, pompën centrifugale, e cila e mbante lëngun në lëvizje mbi placentë; dhe ngau shpejt përmes mushkërive sintetike dhe filtrit të produktit mbetje. Iu referua tendencës shqetësuese të embrioneve drejt anemisë, deri tek dozat masive me lëng të përqendruar nxjerrë nga stomaku i derrave dhe mëlçinë e fetusit të mëzave të lopëve, e cila kishte arsye përse duhej të merrej si furnizim nga jashtë qendrës.
U tregoi mekanizmin e thjeshtë si pasojë e të cilit, gjatë dy metrave të fundit të tetëmetërshit, të gjithë embrionet shkundeshin që të mësoheshin me lëvizjen. Aludoi për gravitetin e së ashtuquajturës "trauma e filtrimit" dhe numëroi masat që duhesh marrë për të minimizuar pasojat e kësaj goditjeje të rrezikshme, përmes trajnimit të duhur të embrionit brenda në shishe. I tha për testin e seksit, i cili merrte jetë në zonën aty rreth fundit të dyqind metrave. Shpjegoi sistemin e etiketimit një T për meshkujt dhe një rreth për femrat; dhe për ata që ishin të përcaktuar të dilni shterpë, shenjën e pikëpyetjes, me bojë të zezë mbi fushë të bardhë.
—Patjetër, - tha zotni Fosteri, - në shumicën e rasteve pjelloria është thjesht një ngatërresë. Një vezore pjellore në dymbëdhjetë mijë - kjo është më se e mjaftueshme për qëllimet tona. Por, ne duam të kemi përzgjedhje të mira. Dhe, sigurisht, dikush do të dojë të lërë gjithmonë një cak të mjaftueshëm,

sa për siguri. Kështu që lejojmë vetëm tridhjetë për qind të embrioneve femërore të zhvillohen normalisht. Të tjerat marrin një dozë të hormoneve seksuale mashkullore për çdo njëzet e katër metra në pjesën tjetër të rrugës. Rezultati: ato janë të filtruara që në fillim shterpë- strukturalisht janë krejt normale (iu desh ta pranonte se "kanë një prirje të lehtë për t'iu mbirë mjekra"), por patjetër që ishin sterile. Sterile me garanci. Gjë që na sjell ne tek e fundit - vijoi zotni Foster, - jashtë fushës së kopjimit prej skllavi të natyrës, në një botë shumë më interesante, atë të shpikjes së njeriut.
Fërkoi duart. Se, sigurisht, ata nuk kishin si kënaqeshin vetëm me çeljen e embrioneve; edhe një lopë mundet ta bëjë një gjë kaq të lehtë.
- Ne, gjithashtu, mund të paracaktojmë kushtet. I filtrojmë bebet tona si qenie njerëzore të shoqërueshme, Alfat dhe Ypsilonët, si punëtorët e ardhshëm të kanaleve të ujërave të zeza, apo si... - ai për pak sa nuk tha: si Kontrollorët e Botës në të ardhmen, por duke korrigjuar veten vazhdoi: - Drejtorët e Çerdheve të së Ardhmes.
Drejtori i madh e pranoi komplimentin me buzëqeshje. Ata po kalonin metrin 320, në rreshtin II. Një mekanik i ri Beta Minus ishte duke u marrë me një kaçavidë dhe një çelës, me një pompë surrogati gjaku që mbushte shishet. Gumëzhima e motorit elektrik e rritej sa herë që ai lëvizte vidat. Poshtë, më poshtë... Një rrotullim i fundit, një vështrim tek numëratori i rrotullimeve dhe u bë. Ai u ngjit dy shkallë në rreshtin më lart dhe nisi të bëjë të njëjtin proces me pompën e radhës.
—Ulja e numrit të rrotullimeve për minutë, – shpjegoi zotni Fosteri, - bën që surrogati të shkojë me sasi më të vogla. Kështu që kalon përmes mushkërive me intervale më të gjata;

kështu, i japim embrionit më pak oksigjen. Nuk ka si zvogëlimi i oksigjenit për të përftuar një embrion nën nivelin mesatar. - Ai fërkoi sërish duart.
-Por përse duam ta mbajmë embrionin nën nivelin mesatar? - pyeti një student plot mençuri.
-O trap! - i tha drejtori, duke e thyer heshtjen e gjatë. - Nuk e keni menduar se një embrion Ypsilon duhet të ketë një ambient rritjeje Ypsiloni, po aq sa edhe një trashëgimi të tillë? Dukej qartazi se atij nuk i kish shkuar në mend një gjë e tillë. Atë e kaploi hutimi.
- Sa më e ulët kasta, - tha zotni Foster, - aq më i paktë oksigjeni. - Organi i parë që prekej ishte truri. Pas tij skeleti. Në nivelin shtatëdhjetë e dy për qind oksigjen, dilnin xhuxhë. Me më pak se shtatëdhjetë, mostra pa sy.
- Të cilët nuk vlejnë për asgjë, - përfundoi zotni Foster Ndërsa (zëri i tij u bë i besueshëm dhe energjik), nëse ata do të mund të zbulonin një teknikë për të shkurtuar periudhën e pjekurisë, çfarë triumfi, ç'mirësi për shoqërinë!
- Merrni për shembull kalin.
Ata e morën parasysh.
· Piqet seksualisht kur mbush gjashtë; elefanti dhjetë. Ndërsa njeriu trembëdhjetëvjeçar nuk është ende i pjekur, kurse i rritur plotësisht është vetëm rreth të njëzetave. Kështu që sigurisht që ky është fryt i zhvillimit të vonuar të inteligjencës njerëzore.
- Por me Ypsilonët, - tha zotni Fosteri me shumë të drejtë, - ne nuk kemi nevojën e inteligjencës njerëzore.
Kur nuk duhej, nuk u jepej. Por ndërsa mendja tek Ypsilonët ishte e pjekur në moshën dhjetë, trupi nuk ishte i aftë për punë deri tetëmbëdhjetë vjeç. Vite të gjata të humbura të pjekurisë.

Nëse zhvillimi fizik mund të përshpejtohej aq sa të ishte, të themi, sa i lopës, sa shumë i kursehej Komunitetit!
-Pafund! - mërmëritën studentët. Entuziazmi i zotni Fosterit ishte ngjitës.
Ai u bë disi teknik në shpjegime: foli për koordinimin jonormal të endokrinës, e cila është shkaktare që njerëzit të rriteshin kaq ngadalë. Pranoi, për ta shpjeguar, një mutacion embrional. Mos ndoshta efektet e këtij mutacioni embrional kanë mundësi të zhbëhen? Mundet që një embrion i vetëm Ypsilon të kthejë në të kundërt, përmes një teknike të përshtatshme, drejt normalitetit të qenve dhe lopëve? Ky ishte problemi. Dhe ky vetëm problem i zgjidhur që nuk është. Pilkingtoni, në Mobasa, kishte prodhuar individë që ishin të pjekur seksualisht në moshë katërvjeçare, por të rritur plotësisht ishin në moshën gjashtë e gjysmë. Një triumf shkencor, por i pavlerë për shoqërinë. Burra e gra gjashtëvjeçarë që as për punët e Ypsilonëve nuk janë të aftë. Dhe procesi ishte i tipit gjithçka ose hiç; ose nuk arrije të përmirësoje asgjë, ose përndryshe e modifikoje të gjithin. Ata ende përpiqeshin të gjenin kompromisin ideal mes të rriturve te të njëzetat dhe të rriturve gjashtëvjeçarë. Deri tani pa sukses. Zotni Fosteri psherëtiu dhe tundi kokën.
Duke bredhur nëpër mugun e përskuqur, dolën në përafërsi të zonës së Metrit 170, në Radhën 9. Nga kjo pikë e tutje Radha 9 ishte e mbyllur dhe shishet kryenin kalimin nëpër pjesën e fundit të udhëtimit brenda një tuneli, i cili ndërpritej herë këtu e herë atje nga ndarje tre metra të gjera.
- Kushtëzimi i temperaturës, - tha zotni Foster. Tunele të nxehta të alternuara me të ftohtë. Freskia bashkohej me vështirësi me të nxehtin në formën e rrezeve të forta X.

Sapo mbaronin filtrimin, embrionet merrnin një të ftohtë të tmerrshëm. Ata ishin të paracaktuar të emigronin në tropik, të bëheshin minatorë, përpunues të vemjeve të mëndafshit dhe hekurpunues. Më vonë mendjet e tyre do bëheshin të tilla që të duronin ndëshkimin e trupit.
- Ne i kushtëzojmë që të harlisen në vapë. - Përmbylli zotni Foster. - Kolegët tanë atje lart do t'i mësojnë ta dashurojnë vapën.
- Dhe ky, - foli drejtori me pompozitet, - ky është sekreti i lumturisë dhe virtytit, të dashurosh atë që e ke me detyrim. Të gjitha kushtëzimet kanë këtë synim: të bëjnë që njerëzit ta pëlqejnë fatin e pashmangshëm të shoqërisë.
Në një të ndarë mes dy tuneleve, një infermiere, me një shiringë të hollë të gjatë, po shqyrtonte me delikatesë përbërësin xhelatinoz brenda një shisheje që po kalonte para saj. Studentët dhe kallauzët e tyre qëndruan dhe vëzhguan në heshtje për disa minuta.
Epo, ja Lenina, - tha zotni Foster, kur më në fund ajo e nxori shiringën jashtë dhe drejtoi shpinën. Vajza u kthye si me komandë. Gjithkush mund ta shihte se edhe pse me lupus e sy të kuq, ajo kishte një bukuri të rrallë.
Henri! - u kthye nga ai nxitimthi, me buzëqeshjen që i shkëlqente nga sëra e dhëmbëve si korale.
- Mahnitëse, mahnitëse, - murmuriti drejtori dhe pasi i dha dy tri të rrahura në krah mori prej saj si këmbim një buzëqeshje.
-Çfarë po u jep? - e pyeti zotni Fosteri, duke i dhënë një ton shumë profesional zërit.
- Oh, të zakonshmet, sëmundjet e tifos dhe të gjumit.
- Punëtorët e zakonshëm vaksinohen në metrat 150 dhe

kanë velëza. Ne imunizojmë peshqit ndaj sëmundjeve njerëzore që do të kenë në të ardhmen. - Sot pasdite në pesë pa dhjetë në tarracë, tha duke u kthyer nga Lenina, - si zakonisht. - Mahnitëse, - tha drejtori edhe një herë tjetër dhe me një shuplakë të fundit u largua bashkë me të tjerët.
Në Raftin 10, vargje punëtorësh të industrisë kimike po trajtoheshin të kishin tolerancë ndaj plumbit, sodës kaustike, ziftit dhe klorit. Tufa e parë prej dyqind e pesëdhjetë embrionesh për inxhinierë raketash sa po kalonte kufirin e një mijë e njëqind metrave në Seksionin 3. Një mekanizëm special i mbante enët e tyre në rrotullim të pandërprerë.
- Për t'ju përmirësuar ndjesinë e balancës, - shpjegoi zotni Foster. - Të bësh riparime në trupin e raketës jashtë në hapësirë është një punë e bezdisshme. Ne ia zvogëlojmë qarkullimin kur qëndrojnë në këmbë, kështu që ata mbeten prapë shumë të uritur dhe ia dyfishojmë surrogatin kur janë kokëposhtë. Kështu mësohen të lidhin pozicionin kokëposhtë me mirëqenien. Mësohen të kapërdijnë surrogatin kur janë kokëposhtë; në fakt, ata e kuptojnë lumturinë vetëm kur qëndrojnë kokëposhtë. - Dhe tani, - zotni Foster vazhdoj më tej, - do doja t'ju tregoja disa kushte shumë interesante tek Intelektualët Alfa-Plus. Kemi një grup të madh në raftin 5. Kati i Galerisë së Parë, ai thirri dy djem, të cilët nisën të shkojnë poshtë për në katin përdhes. - Ata tani ndodhen diku aty tek 900 metra, - shpjegoi ai. - Nuk mund t'u bësh as një lloj trajtimi të dobishëm intelektual, deri kur fetuset të kenë humbur bishtin. Më ndiqni. Drejtori pa orën.
- Dhjetë minuta të shkojë tre, - vazhdoi ai. - Kam frikë se nuk ka kohë për embrionet e intelektualëve; duhet të shkojmë

lart tek çerdhja, përpara se fëmijët të kenë mbaruar gjumin
e drekës.
Zotni Foster u mërzit.
-Të paktën një vështrim të shpejtë në Dhomën e Filtrimit,
- iu lut ai.
- Epo mirë atëherë, - buzëqeshi drejtori i kënaqur. - Le t'i hedhim një sy.

KAPITULLI II

Zotni Foster mbeti në Dhomën e Filtrimit. Drejtori i madh dhe studentët hynë në ashensorin më të afërt dhe u ngjitën lart deri në katin e pestë.
Mbishkrimi i tabelës lexonte: ÇERDHET E FOSHNJAVE. DHOMAT NEOPAVLLOVIANE TË KUSHTËZIMIT.
Drejtori hapi portën. Ata u ndodhën në një dhomë të madhe të zhveshur, shumë të ndriçuar dhe me diell; i gjithë muri nga jugu kishte vetëm një dritare. Një gjysmë duzine me infermiere të veshura me uniformën e linjtë sipas rregullore, me pantallona e përparëse, me flokët lidhur me mjeshtëri nën kapuçat e bardhë dhe që me nxitim vendosnin një linjë vazosh plot me trëndafila përgjatë dyshemesë. Poçe të mëdha ngjeshur plot me lulëzim. Mijëra petale të hapura në kulmin e lulëzimit e të buta si mëndafsh, si faqe kerubinësh të panumërt, por kerubinë që, nën atë dritë të shndritshme, nuk ishin veç rozë dhe arianë, por edhe kinezë të shndritshëm; po ashtu edhe meksikanë, apoplektik po, ngaqë i kanë fryrë trumbetave qiellore, të zbehtë si vdekja, të zbehtë me bardhësinë e mermerit pas vdekje.
Infermieret shtangën nga prania e Drejtorit të madh kur ai hyri brenda.
"Vendosini librat siç duhet," - u tha ai prerë.

Në heshtje infermieret iu bindën komandës. Mes vazove plot trëndafila, librat qenë vendosur siç duhet - një radhë me vëllime librash për fëmijë - të hapur me merak, me fotografi kafshësh, peshqish a të ndonjë zogu me ngjyra të gëzueshme.
"Tani, sillni fëmijët."
Ata nxituan, dolën dhe u kthyen brenda një minute a dy, secila duke shtyrë një kosh me rrota, thurur me rrjetë teli dhe ndarë në rafte të mbushura plot me bebe, të gjitha njëlloj (nga një grup Bokanovski, kjo ishte fare e qartë) dhe të gjitha (meqenëse ishin Delta) të veshura në uniforma ngjyrë kaki. "Vendosini në dysheme."
Foshnjat u shkarkuan.
"Tani kthejini në mënyrë që të shohin lulet dhe librat." Të kthyera, bebet qëndruan njëherë të heshtura, pastaj nisën të ecnin këmbadoraz drejt atyre grumbujve me ngjyra të ndritura, atyre formave kaq të gëzueshme dhe me shkëlqim mbi faqet e bardha. Ndërsa afroheshin, dielli doli nga pas resë si një eklips i çastit. Trëndafilat flakërinin, sikur të kishin në zemër një pasion të panjohur; u duk sikur një gjë me kuptim vërshoi nga faqet plot ngjyra të librave. Nga radhët e bebeve vërshuan klithma gëzimi, gugatje dhe cicërima kënaqësie. Drejtori fërkoi duart.
"Shkëlqyeshëm! - tha ai. - Ngjan tamam si të ishte bërë me qëllim."
Zvarranikët më të shpejtë tashmë e kishin mbërritur objektivin. Duart e vogla u zgjatën të pasigurta dhe i prekën, i rrokën, i shkulën petalet nga trëndafilat, i shfytyruan, zhubrosën fletët e ndriçuara të librave. Drejtori priti deri kur të gjithë i prekën të gëzuar me duar. Pastaj: "Shihni me kujdes!" - tha ai. Dhe ngriti dorën e dha sinjalin.

Kryeinfermierja, e cila po qëndronte pranë një çelësi kuadri në anën tjetër të dhomës, uli poshtë një levë të vogël. Ndodhi një shpërthim i fuqishëm. Me një tingull që sa vinte e bëhej më i mprehtë, sirena vikati. Zile alarmi u tunden
si të çmendura.
Fëmijët nisën të klithin: fytyrat e tyre u shtrembëruan nga
tmerri.
"Dhe tani, - bërtiti drejtori me të madhe (ngaqë zhurma ishte shurdhuese), - tani do të vazhdojmë të ngacmojmë, duke u dhënë leksionin me një shok të butë elektrik."
Ai lëkundi dorën sërish dhe kryeinfermierja uli leven e dytë. Klithma e bebeve befas ndryshoi tonalitet. Kishte diçka të dëshpëruar, diçka të çmendur në angullimat e mprehta e gulçuese që lëshuan tani. Trupat e tyre të vegjël u drodhën, u ngurtësuan; gjymtyrët iu hodhën përpjetë, sikur t'i kishin të lidhura lart dhe po u tërhiqeshin nga fije të padukshme.
"Ne e kemi mundësinë të elektrizojmë të gjithë rripin e dyshemesë, dha një shpjegim drejtori, - por kjo nuk mjafton." Dhe i bëri me shenjë infermieres.
Shpërthimet reshtën, zilet nuk tringëllinë më, klithma e sirenës ra ton pas toni e u fik derisa u bë heshtje. Trupat që përpëliteshin u qetësuan e ngrinë si gur; dhe ajo që më parë ish dënesa me klithma e maniakëve të vegjël, tani u shpërnda prapë si një ngashërim i zakonshëm frike.
"Lulet dhe librat edhe një herë!"
Infermieret iu binden; por sapo i afruan trëndafilat, librat me imazhe të hareshme me mace, qenushë dhe dele të zeza be-be-ba me ngjyra të forta, foshnjat u tkurrën nga tmerri; vëllimi i tonit të ngashërimeve papritur u rrit.
"Vështroni, - tha drejtori plot triumf, - vështroni."

Librat dhe zhurma e madhe, lulet dhe goditjet elektrike - që tani në mendjen e foshnjës këto çifte ishin të lidhura bashkë; pas dyqind përsëritjeve, me të njëjtin leksion, apo me diçka tjetër të ngjashme, këto do të jenë të lidhura pazgjidhshmërisht. Atë që ka lidhur njeriu nyjë, natyra është e pafuqishme ta prishë. "Ata do të rriten me atë që psikologët dikur e quanin urrejtje 'instinktive' ndaj librave dhe luleve. Reflekse të kushtëzuara në mënyrë të pandryshueshme. Ata kështu do të shpëtojnë për gjithë jetën nga librat dhe botanika." Drejtori u kthye nga infermieret. "Merrini me vete."

Ende duke klithur, bebet kaki u ngarkuan në karroca, u nxorën jashtë nga dhoma ku lanë pas vetes erë të thartuar qumështi dhe një heshtje të mirëpritur nga të gjithë.

Njëri prej studentëve ngriti dorën, e paçka se e kuptonte mjaft mirë arsyen përse nuk duhej të kishte njerëz të kastës së ulët që harxhojnë kot kohën e Komunitetit mbi libra, sepse mund të ekzistonte përherë rreziku që të të lexonin ndonjë gjë e cila ndoshta mund të çkushtëzonte në mënyrë të padëshirueshme reflekset e tyre, e pra, prapëseprapë, ai nuk e kuptonte dhe aq mirë këtë gjënë e luleve. Përse të kalonin nëpër gjithë këto telashe për të bërë psikologjikisht të pamundur që Deltat të pëlqejnë lulet?

Drejtori i madh ia shpjegoi me durim. Që fëmijët të klithin nga tmerri kur shohin me sy një trëndafil, kjo ishte baza e politikave ekonomike. Jo shumë kohë më parë (aty rreth një shekull më parë), Gamat, Deltat, madje edhe Ypsilonët ishin kushtëzuar të pëlqenin lulet - veçanërisht lulet dhe natyrën e virgjër në përgjithësi. Ideja ishte t'i bënin që të shkonin në fshat sa herë që t'u jepej mundësia, duke i detyruar kësisoj që të shpenzonin për transport.

- Dhe a shpenzonin për transport? - pyeti një student.
- Goxha, - ia ktheu drejtori, - por vetëm kaq. Aguliçet dhe peizazhet, vërejti ai, kanë një efekt të rëndë ekonomik: janë falas. Dashuria për natyrën nuk mban fabrikat në punë. U vendos të hiqej dashuria ndaj natyrës, gjithsesi vetëm në klasat e ulëta; të hiqej dashuria për natyrën, por jo pirja për të shpenzuar për transportin. Ngase, sigurisht, ishte thelbësore që ata të shkonin në fshat edhe pse e urrenin. Problemi ishte të gjendej një arsye ekonomike e menduar më mirë, që të përdornin transportin më tepër se sa të ndilleshin thjesht nga aguliçet apo peizazhi. Dhe kjo arsye u gjend menjëherë.
- Ne i kushtëzojmë masat që ta urrejnë fshatin, - tha drejtori. Por njëherësh i kushtëzojmë që t'i duan të gjitha sportet që ushtrohen në kushtet e fshatit. Në të njëjtën kohë, sigurohemi që të gjitha këto sporte të kërkojnë detyrimisht përdorimin e aparateve të sofistikuara. Kështu që ata njëherësh me transportin, konsumojnë artikuj të manifakturës. Ky është edhe shkaku pse ushtrojmë goditjet elektrike.
-E kuptoj,- tha studenti dhe u përhumb, gjithë admirim, në heshtje.
Ra heshtje për një çast; pastaj, drejtori qëroi fytin dhe ia nisi: - Na ishte njëherë, kur Fordi ynë ishte ende në tokë, një djalë i vogël që quhej Ruben Rabinoviç. Rubeni ishte një djalë me prindër polakë. - Drejtori preu fjalën në mes. - Ju e dini se çfarë është polonishtja, besoj?
- Një gjuhë e vdekur.
-Si frëngjishtja dhe gjermanishtja, - shtoi një tjetër student, duke u mburrur për dijen që kish.
- Po "prindi"? - pyeti drejtori i madh.

Ra heshtje, të gjithë rrinin si mbi gjemba. Disa nga djemtë u skuqën. Ata nuk kishin mësuar ende të ndanin një vijë të hollë fare, por shumë të dallueshme mes gjuhës së vrugut dhe shkencës së kulluar. Njëri, më në fund, pati kurajën të çojë dorën.
- Qenia njerëzore ka qenë... - ngurroi ai; gjaku i vërshoi në faqe nga turpi. - Epo, ka qenë gjallëpjellës.
- Tamam ashtu, - miratoi me kokë drejtori.
- Dhe kur bebet e tyre filtroheshin...
- Lindnin, - erdhi korrigjimi.
Epo, ata ishin prindërit... dua të them jo bebet, sigurisht;
të tjerët. - Djaloshi i gjorë u pushtua nga hutimi.
- Shkurt, - e përmblodhi drejtori, - prindërit ishin babai dhe nëna. Vrugu, këtu në fakt ishte shkencë, kjo djemve u ra si rrufeja. Nëna, - përsëriti ai me zë të lartë duke gërmuar brenda shkencës dhe u mbështet pas në karrige... - Këto, - tha me ashpërsi, - janë fakte të pakëndshme, e di. Por fundja, pjesa më e madhe e fakteve historike janë të pakëndshme.
Dhe iu kthye Rubenit të vogël... Rubenit të vogël, në dhomën e të cilit një mbrëmje, prej pakujdesisë, babai dhe nëna (rrufe, rrufe!) i kishin harruar radion ndezur.
("Nuk duhet të harroni kurrë që në kohët e prodhimit gjallëpjellës bruto, fëmijët bëheshin përherë nga prindërit, jo në Qendrat Shtetërore të Kushtëzimit.")
Në kohën kur ky fëmijë ishte në gjumë, u dëgjua befas një program i transmetuar nga Londra; mëngjesin e ardhshëm, për habi (djemtë më të trima guxuan të zbardhin dhëmbët me njëri-tjetrin), Rubeni i vogël u zgjua duke përsëritur fjalë për fjalë një leksion të gjatë nga ky shkrimtar i moçëm ("njëri nga të paktët, veprat e të cilit janë lejuar të vijnë deri tek

ne), Xhorxh Bernard Shou, i cili po fliste, sipas një tradite të vërtetuar më së miri, mbi gjeninë e vet. Për Rubenin e vogël syhapur, që vetëm zgërdhihej, ky leksion, sigurisht, ishte plotësisht i pakuptueshëm, ndaj duke menduar se fëmija i tyre qe çmendur, ata e çuan tek doktori. Ai, për fat, kuptonte anglisht dhe e njohu diskutimin që Shou kishte transmetuar një natë më parë në radio, e kuptoi rëndësinë e asaj që kishte ndodhur dhe i nisi një letër shtypit mjekësor mbi këtë çështje. "Parimi i mësimnxënies në gjendje gjumi, ose hipnopedia, qe zbuluar." Drejtori bëri këtu një goxha ndalesë. U zbulua parimi, por do të duhej të kalonin edhe shumë, shumë vite të tjera, derisa ky parim të vihej në zbatim.

"Rasti i Rubenit të vogël ndodhi vetëm njëzet e tre vjet pasi u hodh në treg i pari Modeli-T i Fordit Tonë. - (Këtu drejtori bëri shenjën e T-së mbi bark dhe të gjithë studentët e ndoqën me nderim këtë procedurë.) - E megjithatë...- studentët shkarravitën me furi. - Hipnopedia, u përdor për herë të parë në vitin 214 pas Fordit. Përse jo më parë? Dy arsye. (a)...."

"Këto eksperimente të hershme, - vijoi drejtori, -qenë në shtegun e gabuar. Mendohej se hipnopedia mund të bëhej një mjet për edukim intelektual..."

(Një djalë i vogël kishte rënë në gjumë mbështetur djathtas; krahu i djathtë i ra dhe dora qe varur e mpirë në anë të shtratit. Përmes një skare të rrumbullakët në qoshen e një kutie një zë i fliste butë.)

"Nili është lumi më i gjatë në Afrikë dhe i dyti për nga gjatësia ndër gjithë lumenjtë e globit. Megjithëse vjen pak më i shkurtër se Misisipi-Misuri, Nili është në krye të lumenjve për shkak të gjatësisë së basenit, i cili shtrihet në 35 gradë gjerësi gjeografike..."

Kur po hanin mëngjes të nesërmen, dikush e pyet:
Tomi, e di ti se kush është lumi më i gjatë në Afrikë? - Tundi kokën ai. - Po a nuk të kujtohet një gjë që fillon kështu: - Nili është...
- Nili... është... lumi... më... i... gjatë... në... Afrikë... dhe ..... dyti... për... nga... gjatësia... ndër... gjithë lumenjtë e globit.. - Fjalët dolën me nxitim. - Megjithëse vjen pak më i shkurtër...
- Po mirë, tani, cili është lumi më i gjatë i Afrikës? Sytë ngrinë nga padija.
- Nuk e di.
- Po Nili pra, Tomi.
- Nili... është... lumi... më... i... gjatë... në... Afrikë... dhe
... i... dyti...
- Atëherë cili lumë është më i gjati, Tom?
Tomi ia plasi të qarës.
- Nuk e di, u ngashërye.
Mjaftoi kjo e qarë, u bëri të qartë drejtori, që hetuesit e asaj kohe të shkurajoheshin. Eksperimentet u braktisën. Nuk u provua më t'u mësohej fëmijëve në gjumë gjatësia e Nilit. Dhe me të drejtë. Nuk mund të mësosh shkencë, kur nuk e di përse bëhet fjalë.
- Ndërkohë, duhej ta kishin nisur që në fillim me edukimin moral, tha drejtori duke i drejtuar për nga porta. Studentët e ndoqën duke shkarravitur në ecje e sipër me dëshpërim, deri lart te ashensori. - Edukimi moral, i cili kurrë, në çfarëdo rrethane, nuk duhet të jetë racional.
"Qetësi, qetësi, - pështpëriti një altoparlant me zë gjëmues, kur ata sa po dilnin nga kati i katërmbëdhjetë. - Qetësi, qetësi!" Goja e trumbetës së altoparlantit përsëriste e palodhur mes

intervalesh në fund të çdo korridori. Studentët, madje edhe vetë drejtori, filluan automatikisht të ecnin majë gishtave. Patjetër, se ishin Alfa; por edhe Alfat vetë i kishin kushtëzuar më së miri. Qetësi, qetësi. I gjithë ajri në katin e katërmbëdhjetë dridhej si urdhër kategorik.
Dyzet e pesë metra ecje majë gishtave dhe mbërritën te një portë, të cilën drejtori e hapi me kujdes. Ata kaluan pragun dhe aty u futën në mugëtirën e një fjetoreje të mbyllur me perde. Tetëdhjetë shtretër fëmijësh qëndronin ngjitur pas murit në një resht. Dëgjohej zëri i lehtë dhe i rregullt i frymëmarrjeve; një mërmërimë e pandërprerë e mekur zërash pëshpëriste në sfond. Kur ata hynë, një infermiere u ngrit në këmbë dhe iu paraqit drejtorit.
- Ç'mësim ka sot pasdite? - pyeti ai.
- Zhvilluam edukatë seksuale për fillestarë në dyzet minutat
e para, - iu përgjigj ajo. - Por tani e kemi ndërruar me Vetëdija për klasën fillore.
Drejtori eci ngadalë e me kujdes pas rreshtit të gjatë të shtretërve të vegjël. Si trëndafila, të qetësuar nga gjumi, tetëdhjetë djem e vajza të vegjël të shtrirë merrnin frymë lehtë. Poshtë çdo jastëku kishte nga një pëshpërimë. Drejtori i madh ndali dhe duke u përkulur mbi njërin prej shtretërve të vegjël, dëgjoi me vëmendje.
- Vetëdija për klasën fillore më thatë? Le ta përsëritim me zë pak më të lartë me altoparlant.
Në fund të dhomës një altoparlant i zhurmshëm dilte dukshëm nga muri. Drejtori shkoi dhe shtypi çelësin.
"... të gjithë janë veshur me të gjelbër, - tha një zë i butë por i dallueshëm, duke nisur fjalinë nga mesi, - fëmijët Delta vishen me ngjyrë kaki. Oh, jo, nuk dua të luaj me fëmijët

Delta. Ypsilonët janë edhe më keq. Janë shumë budallenj, nuk janë të zotë as të shkruajnë e të lexojnë. Përveç kësaj, vishen me të zeza - ngjyra e kafshëve. Sa i kënaqur jam, se jam Beta." Pauzë, pastaj zëri nisi sërish.
"Fëmijët Alfa vishen me ngjyrën gri. Ata punojnë shumë më fort se ne, se ata janë aq të mençur sa të fusin frikën. Jam tmerrësisht shumë i kënaqur që jam Beta, sepse nuk punoj aq fort. E për më tepër, ne jemi shumë më mirë se Gamat dhe Deltat. Gamat janë budallenj. Ata vishen të gjithë me të gjelbër, Deltat vishen me kaki. Oh, jo, jo, nuk dua të luaj me fëmijë Delta. Ypsilonët janë edhe më keq. Ata janë shumë budallenj..."
Drejtori e shtypi përsëri çelësin. Altoparlanti heshti. Vetëm pëshpërima e tij e zbehtë vazhdoi të mërmërisë përfund tetëdhjetë jastëkëve.
"Kjo do t'u përsëritet edhe për dyzet a pesëdhjetë herë të tjera përpara se të zgjohen nga gjumi: përsëri të enjten dhe të shtunën. Njëqind e njëzet e tre herë në javë, për tridhjetë muaj. Pas të cilave ata vazhdojnë leksione më të përparuara." Trëndafila dhe goditje elektrike, kakia e Deltave dhe grahma e drurëve të gomës të lidhura bashkë në mënyrën më të pazgjidhshme, përpara se fëmija të jetë i aftë të flasë. Por kushtëzimi pa fjalë është i papërpunuar dhe i përgjithshëm; nuk mund të rrënjosë ndryshimet më të imëta, nuk mund të ndajë modelet më të ndërlikuara të sjelljes. Për këtë duhet të përdorim fjalët, por ama fjalë pa arsyetim. Shkurt, kjo është hipnopedia.
"Forca më e madhe moralizuese dhe socializuese e të gjitha kohërave."

Studentët e shënuan në blloqet e vogla. Pa u rënë fjala në tokë. Edhe një herë tjetër, drejtori preku çelësin.
"...të mençur sa të kesh frikë, - po thoshte zëri i butë, dhelpëror dhe i palodhur. - Jam vërtet tmerrësisht i kënaqur që jam Beta, sepse..."
Nuk janë tamam si pikat e ujit, megjithëse uji, ç'është e vërteta mund të çajë vrima në granitin më të fortë; këto janë më tepër si pika dylli të lëngshëm, ngjitëse, pika që lidhen bashkë, trupëzohen me vendin ku bien, gjersa në fund bërthama bëhet një popël e vogël ngjyrë alle.
"Përderisa mendja e çdo fëmije është kjo tërësi këshillash, edhe shumësi i këshillave është mendja e fëmijës. Dhe jo vetëm mendja e fëmijës, mendja e të rriturit gjithashtu - për gjithë jetën. Mendja që gjykon, dëshiron dhe vendos - përbëhet nga këto këshilla. Të gjitha këto këshilla, janë këshillat tona! - Drejtori prej triumfit për pak sa nuk bërtiti. - Këshilla nga Shteti. - Ai goditi tavolinën më të afërt. - Prej kësaj rrjedh..."
Një zhurmë e bëri të kthejë kokën.
"Oh, Ford! - tha ai me një tjetër ton, - ç'bëra, zgjova fëmijët!"

KAPITULLI III
51

Jashtë në kopsht ishte ora e lojës. Të zhveshur, nën dritën e ngrohtë të diellit të qershorit, gjashtë apo shtatëqind djem e vajza të vegjël vraponin me klithma çjerrëse nëpër livadhe, apo luanin lojëra me top, ose qëndronin urtë ulur galiç në dyshe - treshe, mes gëmushave të lulëzuara. Trëndafilat ishin në lulëzim, dy bilbila fshehur mes degëve i flisnin njëri-tjetrit, një qyqe gati sa nuk po dilte nga vija melodike mes degëve të blirit. Ajri ish përgjumur nga gumëzhimat e bletëve dhe helikopterëve.
Drejtori dhe studentët e tij qëndruan për pak kohë duke ndjekur një lojë Këlyshi Rrotullues. Njëzet fëmijë ishin mbledhur në formë rrethi përqark një kulle prej çeliku të kromuar. Një top hidhej lart që të ndalonte më pas mbi platformën në majë të kullës, rrokullisej brenda saj, binte mbi një disk që vërtitej me shpejtësi, flakej përmes njërës a tjetrës prej vrimave të panumërta të veshjes së jashtme në formë cilindrike, që më pas të kapej prej tyre.
- Çudi, - tha gjithë frymëzim drejtori ndërsa po largoheshin tutje, - çudi të bën të mendosh se edhe në ditët e vjetra të Fordit Tonë, pjesa më e madhe e lodrave luheshin pa ndonjë

aparat, nuk u duhej më shumë se një ose dy topa dhe disa shkopinj, ndoshta edhe ca rrjeta. Imagjinoni vetë çfarë çmendurie, ishte e lejuar: njerëzit luanin lojëra të ndërlikuara, të cilat nuk ndikonin fare në rritjen e konsumit. Çmenduri! Në kohën tonë, Kontrolluesit nuk miratojnë asnjë lojë, nëse loja nuk ka të paktën në përbërjen e saj aq aparatura sa lojërat më të ndërlikuara, të cilat ekzistojnë deri më sot. - Ai e ndërpreu vetë fjalën.
-Sa të këndshëm! - tha ai duke treguar me gisht.
Në një lëndinë të vogël me bar, mes shkurreve të larta të shqopës së Mesdheut, dy fëmijë, një djalë i vogël rreth të shtatave dhe një vajzë, ndoshta një vit më e madhe, po luanin, shumë rëndë dhe me vëmendjen e përqendruar të një shkencëtari në ethet e zbulimit, një lojë seksuale rudimentare. - Sa bukur, sa bukur! - përsëriti plot ndjenjë drejtori i madh.
-Sa bukur! - pranuan me mirësjellje djemtë. Por buzëqeshja e tyre ishte më shumë sa për t'i bërë qejfin atij. Ata i kishin lënë pas me kohë argëtime të tilla prej kalamajsh, aq sa nuk ishin më të aftë t'i shikonin me sy, pa provuar një grimë përbuzje. Sa bukur? Ishte thjesht një çift kalamajsh që ngacmoheshin seksualisht dhe kaq. Punë kalamajsh.
- Përherë e mendoj... - drejtori po vazhdonte fjalën me të njëjtin ton qaraman, kur u ndërpre nga një ëëëëëëëë e zhurmshme.
Nga një shkurrishtë aty pranë mbiu një infermiere, duke tërhequr nga dora një djalë të vogël që ecte e qante. Pas tij një vajzë e vogël përplaste këmbët gjithë inat.
-Si është puna? - pyeti drejtori.
Infermierja mblodhi supet:

- Asgjë me rëndësi, - iu përgjigj ajo. - Më duket se ky djali i vogël nuk e ka me qejf të marrë pjesë vetë në lojën e zakonshme erotike. E kam vënë re edhe nja dy herë të tjera. Sot e bëri prapë. Sapo nisi loja, ky nisi të qajë...
- Betohem, tha kryeneçja e vogël, - nuk desha t'i bëj
keq. Betohem!
- Sigurisht, e dashur, - i tha infermierja për t'u dukur edhe më bindëse para drejtorit. - Kështu pra, - vazhdoi ajo duke u kthyer nga drejtori, - po e çoj ta vizitojë Asistent Kryekujdestari i Psikologjisë. Të shohim nëse ka diçka që nuk
shkon me të.
Shumë e drejtë, - tha drejtori. - Çoje tek ai. Ti vogëlushe qëndro këtu. e ndërkohë që infermierja iku të dorëzojë qaramanin shtoi: Si të quajnë?
- Poli Trocki.
- Paske alamet emri, - tha drejtori. - Ik tani, me vrap. Shiko mos gjen ndonjë vogëlush tjetër të luani bashkë lojë erotike. Fëmija u turr me vrap dhe u zhduk pas shkurreve.
- Një krijesë kaq e vogël dhe kaq brishtë! - tha drejtori duke nga ajo. Pastaj, kur u kthye nga studentët u tha: - Ajo që do t'u them tani, mund të duket e pabesueshme. Mirëpo, kur nuk je mësuar me historinë, shumë fakte të së shkuarës duken vërtet sikur nuk kanë ndodhur.
Dhe lëshoi mbi ta të vërtetën mahnitëse. Për një periudhë të gjatë kohe përpara Fordit Tonë, madje edhe për disa gjenerata më pas, loja erotike mes fëmijëve shikohej si një gjë anormale (shpërthyen të qeshurat). Dhe jo vetëm anormale, madje shikohej si imorale (mos e pabesueshme!): dhe për këtë shkak kjo gjë ndëshkohej rreptë.
Fytyrat e dëgjuesve shtangën. E pabesueshme. Nuk lejohej

që vogëlushët e shkretë të argëtoheshin duke luajtur me nënveten? Nuk arrinin ta besonin.
- Edhe adoleshentët, tha drejtori i madh, edhe adoleshentet në moshën tuaj....
- Nuk ka mundësi!
Përjashto pakëz autoerotizëm të fshehtë, dhe homoseksualizëm, për të tjerat fare...
- Fare
Në shumicën e rasteve deri kur kalonin të njëzetat. Te njëzetat? - jehuan njëzëri gjithë mosbesim studentët. -Të njëzetat, - u tha drejtori. - Ju thashë se do t'ju dukej e pabesueshme.
Por çfarë ndodhi? - e pyetën ata. - Cilat ishin rezultatet? Rezultatet ishin të tmerrshme. - Një zë i thellë buçiti duke ua ndërprerë dialogun.
Ata vështruan aty rrotull. Në qosh të grupit të vogël qëndronte një i huaj - një burrë me shtat të mesëm, flokëzi, me hundën si grepç, buzë mishtore kuqe, sy shumë zhbirues e të errët. "Të tmerrshme," - përsëriti ai.
Drejtori i madh në atë çast u ul në një nga stolat prej çeliku e gome, të shpërndarë mjaft volitshëm nëpër kopshte; por, sapo vuri re të huajin, ai brofi në këmbë dhe u lëshua t'i dalë përpara me duar e zgjatura, duke i buzëqeshur aq fort sa i dukeshin edhe dhëmballët.
- Kontrollori! Çfarë kënaqësie e papritur! Djem, u hutuat? Ky është Kontrollori; ky është dora vetë, fordisti, Mustafa Mond.
Në katër mijë dhomat e qendrës, katër mijë sahatet elektrike ranë njëherësh për të shënuar orën katër. Gojët e altoparlantëve lëshuan zëra sintetikë.

55
Me e mira e botëve

"Turni kryesor i ditës mbylli orarin. Turni i dytë i ditës merr turnin. Turni kryesor i ditës mbylli orarin..."
Në ashensor, rrugës drejt dhomave të zhveshjes, Henri Foster dhe Nëndrejtori i Paracaktimit i kthyen me nënkuptim shpinën Bernard Marksit të Byrosë së Psikologjisë: hoqën nga vetja namin e keq.
Mërmërima e zbehtë dhe rrapama e makinerisë, përziente ende ajrin e kuqërremtë të Magazinës së Embrioneve. Turnet mund të shkojnë e të vijnë, njëra fytyrë bojë lupus i lë vendin tjetrës; madhërishëm dhe përgjithmonë, konvejerët zvarrisnin përpara ngarkesën me burrat dhe gratë e së ardhmes.
Lenina Kroun shkoi drejt daljes pa mëdyshje.
Fordmadhëria e tij, Mustafa Mondi! Sytë e studentëve që po e përshëndesnin ndërkohë, gati sa nuk i kërcyen jashtë nga zgavrat. Mustafa Mondi! Kontrollori i Përhershëm i Evropës Perëndimore! Njëri nga dhjetë Kontrollorët e Botës. Njëri nga dhjetë... dhe ai vetë qe ulur në stol bashkë me drejtorin e madh dhe kishte ndërmend të qëndronte aty me ta; do të qëndronte, po, po, do të fliste me ta... ai dora vetë. Ishte njëlloj si të fliste me gojë, vetë Fordi.
Dy fëmijë bojëkafe si karavidhe, sikur mbinë nga shkurret aty pranë, ia ngulën për një çast sytë e mëdhenj e të habitur, pastaj u kthyen prapë mes gjetheve të bëjnë qejfet e veta.
"Të gjithëve ju kujtohet, - tha Kontrollori me zërin e tij të fortë e të thellë, ju kujtohet besoj, thënia shumë e bukur dhe frymëzuese e Fordit Tonë: - Historia është dokërr. Historia, - përsëriti me ngadalë ai, - është dokërr."
Ai lëvizi dorën dhe u duk sikur me një fshirëse puplash, fshiu për fare atë pak pluhur; ai pluhur ishte Harapa, ishte

Uri i Shaldes; ishte një rrjetë e thjeshtë merimange, këto ishin Teba dhe Babilonia, Knosi dhe Mikena. Fësht. Fësht - dhe ku është tani Odiseja, ku është Jobi, ku janë Jupiteri, Gothama dhe Krishti? Fesht - dhe ato pikla pisllëku antik të quajtura Athinë e Romë, Jerusalem dhe Mbretëri e Mesme - të gjitha u zhdukën. Fësht - vendi ku qe Italia tani është bosh. Fësht, katedralet; fësht, fësht, mbreti Lir dhe Mendimet e Paskalit Fësht, Pasioni; fësht, Rekuiemi; fësht, Simfonia; fësht...
"Do shkosh në kinema sonte, Henri? - pyeti Asistent Paracaktuesi. - Kam dëgjuar se filmi i ri te Alhambra është i klasit të parë. Ka një skenë dashurie mbi një gëzof ariu; më kanë thënë që është e mrekullueshme. Kanë riprodhuar çdo qime të ariut. Ka efektet ndijore më mahnitëse."
- Prandaj nuk u mësojmë histori. - thoshte Kontrollori. - Por tani ka ardhur koha...
Drejtori e pa me nervozizëm. Kishin dalë thashetheme të çuditshme për libra të vjetër e të ndaluar, fshehur brenda një kasaforte në studion e Kontrollorit. Bibla, poezi - një Ford e di se çfarë!
Mustafa Mondi e kuptoi nga vështrimi dhe qoshet e buzëve të tij të kuqe u përdrodhën me ironi.
-Nuk ka asgjë të keqe, drejtor, - tha ai me një ton të mekur dhe shpotitës - nuk t'i korruptoj studentët. Drejtorin e madh e pushtoi hutimi.
Ata që e ndiejnë veten të përbuzur bëjnë mirë ta shfaqin përbuzjen. Buzëqeshja në fytyrën e Bernard Maksit qe përçmuese. Tamam ashtu, i kishin bërë qimet e ariut një për një! "Do të bëj çmos," - i tha Henri Foster.

Mustafa Mondi u përkul përpara dhe u tundi gishtin. "Vetëm përpiquni që ta kuptoni, - dhe zëri i tij drithërim sa atyre iu ngjethën edhe diafragmat. - Përpiquni të kuptoni si mund të ishte vallë të kishit dalë nga një nënë, gjallëpjellur." Prapë këtë fjalë të vrugut. Por askujt nuk i ra ndërmend të buzëqeshë tani.
"Përpiquni të imagjinoni çdo të thotë "të jetosh në familje." Ata u përpoqën, por domosdo pa më të voglin sukses. "Dhe e dini se çfarë ishte 'shtëpia'?"
Ata tundën kokat, thanë jo.
Nga qilari i kuqërremtë dhe i errët, Lenina Kroun u ngjit lart shtatëmbëdhjetë kate; doli nga ashensori dhe u kthye djathtas, eci nëpër korridorin e gjatë, pastaj sapo hapi portën me mbishkrimin, Dhoma e Zhveshjes së Vajzave, u fut zhyt në një kaos shurdhues krahësh, gjoksesh e të linjtash. Rrëke uji të ngrohtë derdheshin brenda ose gurgullonin jashtë nga njëqind banja. Duke gjëmuar e fishkëllyer, tetëdhjetë makina masazhi vibro-vakumi tundnin dhe thithnin njëkohësisht, mishin e fortë e të pjekur nga dielli, të tetëdhjetë ekzemplarësh të shkëlqyer tip femër. Secila prej tyre fliste me sa zë kish në kokë. Një makinë e muzikës sintetike gugaste një pjesë solo në super-trombë.
"Ç'kemi, Fani," - i tha Lenina gruas së re, e cila e kishte varësen dhe dollapin ngjitur me të.
Fani punonte në Dhomën e Shishezimit, mbiemri i saj qe po ashtu Kroun. Por, meqë dy mijë milionë banorët e planetit kishin vetëm dhjetë mijë emra, kjo rastësi nuk përbënte ndonjë çudi të madhe.
Lenina tërhoqi poshtë zinxhirët - poshtë ato të xhaketës,

teposhtë me të dyja duart njëherësh për pantallonat, teposhtë sërish për të lënë të lira mbathjet. Duke mbajtur ende mbathur këpucët e çorapet, ajo shkoi te banjat.
Shtëpia, shtëpia - ca dhoma të vogla, të mbipopulluara, nënshtruar prej një burri dhe një femër periodikisht shtatzëne, si dhe nga një turmë djemsh e vajzash nga të gjitha moshat. As ajër, as hapësirë; një burg i pasterilizuar; errësirë, sëmundje dhe kutërbim.
(Përjetimet e Kontrollorit ishin kaq të gjalla sa njëri nga djemtë, më i ndjeshëm se të tjerët, u zbeh thjesht nga përshkrimi dhe shkoi në atë pikë sa i erdhën zorrët ne fyt.)
Lenina doli nga banja, thau veten me peshqir, mori në dorë një tub të gjatë elastik të ngulur në mur, drejtoi lëfytin në gjoks, sikur të kish ndarë mendjen të vrasë veten dhe shtypi çelësin. Një shkulm ajri i ngrohtë e spërkati me pudrën-talk më të mirë. Tetë aroma të ndryshme dhe eau-de-Cologne ishin vendosur në një rresht rubinetesh të vegjël mbi lavaman. Ajo hapi të tretin nga e majta, spërkati veten me shafran dhe duke mbajtur në dorë këpucët e çorapet, doli jashtë të shohë, mos ndonjë nga makinat e vibro-vakumit qe e lirë.
Shtëpia ishte një pisllëk sa psikologjik aq dhe fizik. Fizikisht ishte një vrimë miu, një tog plehrash, ndezur nga grindjet e një jete të ngjeshur, të qelbur prej emocioneve. Çfarë intimitetesh mbytëse, ç'marrëdhënie e rrezikshme dhe e çmendur mes anëtarëve të familjes! Si maniake, nëna mbronte fëmijët e saj (fëmijët e saj)... mbronte fëmijët e saj siç mbron macja këlyshët e vet; veç ama kjo ishte një mace që flet, një mace që thoshte pa

reshtur "Bebet e mia, o, bebi im! Bebi im, oh, bebi im, e kam në gji, duart e vogla, ka uri, me agoninë e papërshkrueshme të një kënaqësie! Po fle bebi im, po fle, shiko flluskën e bardhë të qumështit në cep të gojës. Bebi im i vogël po fle..."
"Po,- tha Mustafa Mondi, duke pohuar me kokë, - tamam të ngjethet mishi të bëhet kokërr."
-Me cilin do shkosh sonte? - e pyeti Lenina kur u kthye nga vibro-vakumi; si perlës që i buron nga brenda shkëlqimi, edhe ajo ndriste si trëndafil.
- Me asnjeri.
Lenina ngriti vetullat e habitur.
- Jam ndjerë disi pa qejf kohët e fundit, - u shpjegua Fani. Dr. Uellsi më këshilloi gjithashtu që të bëj një Zëvendësim Shtatzënie.
- E dashur, po ti je vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç. Zëvendësimi i parë i shtatzënisë nuk është i detyrueshëm pa u bërë njëzet e një.
E di, e dashur. Por disa njerëz është mirë ta nisin herët. Dr. Uellsi më tha se brunet me legen të gjerë si unë, duhet ta bëjnë zëvendësimin e parë të shtatzënisë që shtatëmbëdhjetë.
Ajo hapi portën e dollapit të saj personal dhe tregoi me gisht në raftin e sipërm një rresht kutish dhe shishesh të vogla me etiketa.
Shurupi corpus luteum. - Lenina lexoi emrat me zë. - Garancia e freskisë së vezores: të mos përdoret pas I gushtit, 632 pas Fordit. Ekstrakt gjëndre mamare: të merret tri herë në ditë përpara ushqimit, me pak ujë. Placentinë: 5 CC të injektohet në damar çdo tridhjetë ditë... Uau! - Lenina u drodh. - I urrej intravenozet, po ti?

-Po. Por, kur të bëjnë mirë ama... - Fani ishte vajzë tepër e ndjeshme.
Fordi Yne-ose Frojdi Ynë, siç e quante ai veten për arsye ende të panjohura, sa herë fliste për çështjet psikologjike - Frojdi Ynë ishte i pari që paralajmëroi për rreziqet që vinin nga jeta e felliqur familjare. Bota qe e mbushur plot me baballarë prandaj qe edhe plot me mjerim; plot me nëna - prandaj edhe përplot me gjithfarë perversitetesh, nga sadizmi, deri te dëlirësia; plot me vëllezër, motra, daja dhe halla - plot me çmenduri e vetëvrasje.
"E megjithatë, mes egërsirave të Samoas, në disa ishuj të brigjeve të Guinesë së Re..."
Drita e diellit të tropikut derdhej si mjaltë i ngrohtë mbi trupat e zhveshur të fëmijëve që rrokulliseshin si të përdalë mes bisqeve të lulëzuara të shkurreve. Shtëpia quhej edhe njëra prej këtyre njëzet kasolleve me kashtë palmash për çati. Në Trobriand ngjizja e femrës mbahej si vepër e fantazmave të paraardhësve; askush nuk kishte dëgjuar ndonjëherë emrin baba.
"Ekstremet, tha Kontrollori, - puqen. Për një arsye të fortë, se janë krijuar që të puqen."
- Dr. Uellsi thotë se një Zëvendësim i Shtatzënisë tani, do të ma ndryshojë shëndetin për më mirë, për tre apo katër vitet e ardhshëm.
- Epo, shpresoj të ketë të drejtë, - tha Lenina. - Prit pak, Fani, mos do të thuash që për tre muajt e ardhshëm ti nuk duhet të...
- Oh, jo, e dashur. Vetëm një javë apo dy, kaq. Do t'i kaloj

mbrëmjet te Klubi duke luajtur Brixhin Muzikor. Ti ma do
mendja do të dalësh? Lenina pohoi me kokë. Me ke?
- Me Henri Fosterin.
-Prapë?-fytyra e ëmbël e Fanit, gati si hënë, mori shprehinë
e papërshtatshme të një shtangieje të dhembshur mospajtimi. -Mos do të më thuash që po shkon prapë me Henri Fosterin?
Nëna dhe baballarë, vëllezër dhe motra. Po kishte edhe bashkëshortë, bashkëshorte dhe dashnorë. Kishte, gjithashtu, monogami dhe romancë.
"Megjithëse ka mundësi që ju nuk e dini se çfarë janë këto." -tha Mustafa Mondi.
Ata tundën kokat.
Familje, monogami, romancë. Kudo mbyllje në vetvete, kudo kanalizim i ngushtë i impulseve dhe energjisë. "Por çdokush i përket çdokujt," - e përmbylli ai duke cituar një proverb hipnopedik.
Studentët pohuan me kokë, duke rënë dakord prerazi me pohimin, të cilin më shumë se gjashtëdhjetë e dy mijë përsëritje në errësirë ia kishin bërë ta pranonin jo thjesht si të vërtetë, por si aksiomatik, të vetëkuptuar e krejtësisht të padiskutueshëm.
-Në fund të fundit, - e kundërshtoi Lenina, - u bë vetëm katër muaj që shkoj me Henrin.
Vetëm katër muaj! E bukur kjo. Dhe për më tepër, - vijoi Fani duke i drejtuar gishtin si për ta akuzuar, nuk ke pasur njeri tjetër përveç Henrit tërë këto kohë. Ke pasur tjetër? Lenina u skuq flakë; por sytë dhe toni i zërit mbetën shpërfillës.

- Jo, nuk kam pasur asnjë tjetër,- iu përgjigj ajo gati me vrazhdësi. - Dhe fare mirë, nuk e kuptoj përse duhet të kem pasur edhe të tjerë.
-Oho, e bukur kjo, nuk e kupton përse duhet të ketë pasur edhe të tjerë, përsëriti Fani, si të ishte duke folur me një dëgjues të padukshëm pas supit të majtë të Leninës. Pastaj, me një ndryshim të beftë të tonit: - Seriozisht tani,- tha ajo, - unë vërtet mendoj se duhet të bësh kujdes. Është zakon tmerrësisht i keq ta shtysh e ta shtysh kështu vetëm me një burrë. Kur të bëhesh dyzet, a tridhjetë e pesë, nuk do qe edhe aq keq, por në moshën tënde, Lenina! Jo, kështu nuk bën. Dhe ti e di se sa me forcë e kundërshton drejtori çdo gjë të thellë dhe të tejzgjatur. Katër muaj me Henri Foster, pa kaluar me asnjë burrë tjetër - boh, ai do të tërbohej fare po ta merrte vesh...
"Mendoni për ujin nën trysni brenda një tubi. - Ata e menduan. - E shpoj një herë tubin, - tha Kontrollori. - Çfarë currili!"
Ai e shpoi njëzet herë tubin. U bënë njëzet shatërvanë të vegjël.
"Bebi ime. Bebi ime...!"
"Nëna!" Çmenduria është ngjitëse.
"Dashuria ime, je para dhe je vetmja, e shtrenjta ime, e shtrenjta ime..."
Nënë, monogami, romancë. Shatërvani gufoi përpjetë fuqishëm, shkumëzues, shkulm i shfrenuar. Shtysa ka një grykëdalje të vetme. Dashuria ime, bebi im. S'është për t'u habitur që këta paramodernë të shkretë ishin të çmendur, të ligë dhe të mjerë. Bota e tyre nuk i linte t'i merrnin gjërat lehtë, nuk i linte të bëheshin të arsyeshëm, virtuozë e të lumtur. Po

nënat dhe dashnoret, po ndalesat për të cilat ato nuk qenë të kushtëzuara t'u binden, po ngasjet dhe pendimet në vetmi, po sëmundjet dhe vetmia izoluese e pafund, po pasiguritë dhe varfëria ishin të detyruara të pësojnë ndenja të fuqishme. Dhe duke ndjerë plot fuqi (dhe për më tepër, jo vetëm fuqishëm, por në vetmi, në izolim vetjak e pashpresë) si mund të ishin
të qëndrueshme?
"Sigurisht që nuk ka asnjë arsye t'i japësh duart. Gjej ndonjë tjetër përveç atij, herë pas here, dhe kaq. Ai shkon me vajza të tjera, apo jo?"
Lenina ia pranoi fjalën.
- Sigurisht që shkon. Të jesh e sigurt që Henri Fosteri është tamam zotni, i përkryer - përherë korrekt. Pastaj nuk duhet të harrojmë edhe drejtorin. E ke parasysh sa tip i qepur që është... Duke pohuar me kokë:
- Ma futi një shpullë në vithe sot pasdite, - i tha Lenina. - Ja, e sheh! - Fani u ndje fitimtare. - Kjo e tregon vetë qëndrimin e tij. Konservatorizmi është i saktë.
"Stabilitet, - tha Kontrollori, - stabilitet. Nuk ka qytetërim pa stabilitet shoqëror. Nuk ka stabilitet shoqëror pa stabilitet individual." Zëri tij qe si një trumbetë. Duke e dëgjuar, ata u ndien më të rritur, më ngrohtë.
Makina vërtitet, vërtitet dhe duhet të vazhdojë të vërtitet - përgjithmonë. Është vdekje nëse qëndron e ndalur. Dhe një mijë milion gërvishtën koren e tokës. Rrotat nisën të vërtiten. Në njëqind e pesëdhjetë vjet u bënë dy mijë milion. Ndali rrotat dhe në njëqind e pesëdhjetë javë bëhen sërish një mijë milionë; mijëra e mijëra burra dhe gra kanë vdekur nga uria.

Rrotat duhet të ecin me qëndrueshmëri, por nuk mund të lihen pa drejtim. Duhet të ketë njerëz që i drejtojnë, njerëz aq të qëndrueshëm sa rrotat në akset e tyre; njerëz të arsyeshëm, njerëz të bindur, të palëkundur në kënaqësi.
Qarjet: bebi ime, nëna ime, e vetmja, e vetmja dashuri, ofshan: Mëkati im, Zoti im i tmerrshëm; klithin nga dhimbja, përçarten nga ethet, vajtojnë moshën e thyer dhe varfërinë - e si mund t'i drejtonin ata rrotat? Dhe nëse ata nuk i drejtojnë dot rrotat... trupat e një mijë mijë mijë burrave e grave vështirë të varrosen apo të digjen.
"Fundja, zëri i Fanit u bë lajkatues, - nuk ka asgjë të dhimbshme apo të papranueshme të kesh një a dy burra të tjerë mënjanë, përveç Henrit sigurisht. Dhe duhet ta kesh parasysh se e ke për detyrë të jesh pak më e përdalë..."
"Stabilitet, - këmbënguli Kontrollori, - stabilitet. Nevoja parësore dhe përfundimtare. Stabilitet. Këtu nisin të gjitha."
Me një gjest të dorës ai përfshiu kopshtet, ndërtesën e pamasë të Qendrës së Kushtëzimit, fëmijët lakuriq që zvarriteshin vjedhurazi nëpër driza apo vraponin në livadhe.
Lenina tundi kokën. "Në një farë mënyre, - turfulloi ajo - nuk jam ndier shumë e përdalë këto kohët e fundit. Ndodh ndonjëherë që nuk të bëhet të jesh e përdalë. Nuk je ndier ndonjëherë edhe ti kështu, Fan?"
Fani i shprehu simpati e mirëkuptim duke pohuar edhe me kokë.
"Por, njeriu duhet të përpiqet, - i tha ajo prerë, njeriu duhet të luajë lojën. Në fund të fundit, çdokush i përket çdokujt."

"Po, çdokush i përket çdokujt,-përsëriti Lenina me ngadalë parullën, psherëtiu, mbeti në heshtje për një moment, pastaj e kapi Fanin nga dora dhe ia shtrëngoi. - Ke plotësisht të drejtë, Fan, si përherë. Do të përpiqem."

Impulsi i frenuar grafullon, përmbytja është vetëdije, përmbytja është pasion, përmbytja është madje edhe çmenduri: ajo varet nga fuqia e rrjedhës, nga lartësia dhe rezistenca, thellohet në forcën e rrymës, lartësinë dhe fortësinë e barrierës. Rryma e papërmbajtur, rrjedh butë teposhtë kanaleve të përcaktuara e ndalet në një prehje të qetë. (Embrioni është i uritur; çdo ditë, pompa e surrogatit të gjakut vërtitet pandërprerë me tetëqind rrotullimet e saj në minutë. Rënkon foshnja e filtruar, në çast vjen një infermiere me bidonin plot me sekrecione të jashtme. Ndjenja përvidhet në atë interval kohe mes dëshirës dhe përmbushjes. Shkurtojeni atë interval, shkatërrojini gjithë ato barriera të vjetra e të panevojshme.) "Djem fatlumë! - tha Kontrollori. - Nuk është kursyer asnjë lloj sakrifice që t'u bëjmë jetët emocionalisht më të lehta. T'ju ruajmë, për aq sa është e mundur, nga përjetimi i emocioneve." "Fordi brenda në veturën e vet të vogël," murmuriu drejtori
i madh, si për të thënë një gjë absolutisht të mirë. “Gjithçka e kësaj bote është e mirë."

- Lenina Kroun? - tha Henri Foster, duke i bërë jehonë pyetjes së Asistent Paracaktuesit ndërsa po mbërthente zinxhirin e pantallonave. - Oh, ajo është vajzë e shkëlqyer. Pneumatike, një mrekulli. Më bën habi si nuk e ke provuar deri më sot. - S'arrij ta kuptoj as vetë si ka mundësi që nuk e kam provuar,- tha Asistent Paracaktuesi. - Patjetër që do ta provoj.

Në rastin më të parë.
Prej aty ku po qëndronte, në anën e kundërt të zonës së dhomave të zhveshjes, Bernard Marksit ia kapi veshi fjalët e tyre dhe u zbeh.
Dhe të them të vërtetën, - tha Lenina, - ka filluar të më vijë pak si në majë të hundës përditë me Henrin, e me asnjë tjetër.
- Ajo ngriti çorapin e majtë. - E njeh Bernard Marksin? -e pyeti ajo me një ton, nga shkujdesja e tepruar e të cilit dukej qartë se ishte e sforcuar.
Fani u duk sikur nuk e priste këtë.
- Mos më thuaj se...?
- Pse jo? Bernardi është Alfa-Plus. Përveç kësaj, ai më ka kërkuar të shkoj me të në një prej atyre Rezervateve të Egërsirave. Unë përherë kam dashur të shoh me sytë e m'i një Rezervat Egërsirash.
- Po reputacioni i tij?
- Ç'më duhet mua reputacioni i tij?
- Ka fjalë se atij nuk i pëlqen Golfi me Pengesa?
- Fjalë, fjalë, u tall Lenina.
- Pastaj ai e kalon kohën krejt i vetëm... me veten e tij. - Tmerri shquhej qartë në zërin e Fanit.
- Epo, nuk do jetë vetëm kur të jetë me mua. E pastaj, përse njerëzit janë kaq kafshë me të? Mua më duket i lezetshëm. - Ajo buzëqeshi me vete; çfarë droje absurde kishte sjellja e tij! Gati-gati frikë, sikur ajo të ish Kontrollore e Botës dhe ai, një copë Gama-Minus mbikëqyrës makinerish.
Merrni në shqyrtim jetët tuaja, - tha Mustafa Mondi. -

Ai ka ndodhur ndonjërit prej jush të hasë ndonjë pengesë të pakapërcyeshme?"
Përgjigjja e pyetjes ishte vetë heshtja që tha jo.
- A ka qenë ndonjëri prej jush i detyruar të durojë një interval të gjatë kohe midis vetëdijes ndaj dëshirës dhe përmbushjes
së saj?
- Epo, - ia nisi njëri prej djemve, dhe nguroi pak.
- Jepi fol, -i tha drejtori. - Mos e lër fordësinë e tij të presë. -Njëherë m'u desh të pres katër javë derisa një vajzë që
doja, të ma japë.
- Dhe ke ndier emocione të forta prej kësaj?
-Të tmerrshme!
-Të tmerrshme, pikërisht, - tha Kontrollori. - Paraardhësit tanë ishin kaq budallenj dhe dritëshkurtër, sa kur iu erdhën reformatorët e parë dhe ofruan t'i çlironin nga ato emocionet e tmerrshme, ata nuk pranuan të bëheshin fare me ta.
-Flet për të sikur të jetë një copë mishi. -i kërcëlloi dhëmbët Bernardi. - Bëja asaj këtu, bëja atje. Si dele. E degradon si të ishte dele. Ajo më tha vetë se do të përpiqej të më kthejë përgjigje kësaj jave. O Ford, o Ford! - Ai do të kishte dashur të shkonte te ata dhe t'ia rraste një të fortë m'u në fytyrë, fort, edhe prapë e prapë.
- Po, unë vërtet të këshilloj ta provosh, - vazhdonte Henri Foster.
"Merr ektogjenezën. Pficneri dhe Kavaguçi ngritën një teknikë të tërë. Por a ishin të gatshme qeveritë t'i hidhnin një sy? Jo. Kishte një gjë që quhej krishterim. Gratë detyroheshin të vazhdonin të ishin gjallëpjellëse."

-Ai është kaq i shëmtuar, - tha Fani.
-Mua më pëlqen pamja e tij.
- Edhe përveç kësaj, e ka të vogël. - Fani u ngërdhesh; vogëlsia ishte për tmerr, tipike, një tipar i kastës së ulët. - Mua më duket një gjë shumë e lezetshme, - tha Lenina. Eshtë qejf t'ia përkëdhelësh. Më kupton. Si mace.
Fani u trondit.
- Thonë se dikush ka bërë një gabim kur ai ishte ende brenda në shishe. Mendoi se mos ishte Gama dhe i hodhi alkool në surrogatin e gjakut. Prandaj është edhe kaq metë. - Gjepura! - tha Lenina e zemëruar.
"Mësimdhënia në gjumë, në fakt, ishte e ndaluar në Angli. Kishte një gjë që quhej liberalizëm. Parlamenti, nëse e dini se çfarë ka qenë, kaloi një ligj kundër tij. Dokumentet mbijetuan. Fjalime rreth lirisë së individit. Liri për t'u bërë joproduktiv e mjeran. Liri për t'u bërë një copë hu gardhi."
"Por, mik i dashur, ti je më se i mirëpritur, të siguroj unë. Je i mirëpritur. - Henri Fosteri i rrahu krahët Asistent Paracaktuesit. - Çdokush i përket çdokujt, në fund të fundit." Njëqind përsëritje tri net në javë për katër vjet, mendoi Bernard Maksi, se ishte specialist në hipnopedi. Gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind përsëritje përbëjnë një të vërtetë të madhe. Idiotët!
"Apo Sistemi i Kastave. Vazhdimisht propozohej, vazhdimisht rrëzohej. Kishte një gjë që quhej demokraci. Thua se njerëzit janë diçka më shumë se sa psikokimikisht të barabartë."

"Epo, ç'të them... do ta pranoj ftesën e tij."
Bernardi i urrente. I urrente. Por ata ishin dy, të mëdhenj dhe
të fortë.
"Lufta Nëntëvjeçare nisi në vitin 141 pas Fordit."
"Edhe po të ishte e vërtetë puna e alkoolit në surrogatin e gjakut..."
"Fosgen, kloropicrinë, etil jodoacetati, difenil cianarsina, triklormetil, kloroform, sulfat dikloretili. Pa përmendur acidin hidrocianik."
"Është një gjë, që, unë thjesht nuk e besoj," - e mbylli
Lenina.
"Zhurma e një mijë e katërqind aeroplanëve që afrohen të le gojëhapur. Por në Kurfurstendam dhe në Rrethrrotullimin e Tetë, shpërthimi i bombave me antraks si vështirë se ka bërë më shumë zhurmë se një tullumbace kur plas."
"Sepse dua të shoh një rezervat me egërsira."
CH3C6H2(NO3(2+ Hg(CNO)2= epo, çfarë? Një gropë e madhe përdhe, një grumbull me tulla, ca copa mishi dhe mukoze, një këmbë ende me çizme, fluturon në ajër, bie plluq, në mes të barbarozave - nga ato të kuqet; shfaqje e shkëlqyer e asaj vere!

"Ti je rast i pashpresë Lenina, dorëzohem."
"Teknika ruse për të infektuar depozitat e ujit ishte veçanërisht gjeniale."
Kurriz më kurriz, Fani dhe Lenina vazhduan të ndërrohen në heshtje.
"Lufta e Nëntë Viteve, kolapsi i madh ekonomik. U bë një zgjedhje midis Kontrollit të Botës dhe shkatërrimit. Mes stabilitetit dhe..."
"Edhe Fani Kroun është vajzë e lezetshme," - tha asistent Paracaktuesi.
Te çerdhet e fëmijëve, ora e Ndërgjegjësimit Klasor për Fillestarët kishte mbaruar, zërat nga altoparlantët po përshtatnin kërkesat e ardhshme industriale me ofertat. "Dua të fluturoj, - u pëshpëritën zërat, - dua të fluturoj, dua të kem rroba të reja, dua..."
"Liberalizmi, sigurisht, kishte vdekur prej antraksit, por gjithsesi, nuk mund të bëheshin të gjitha duke përdorur forcën."
"Jo aq pneumatike sa Lenina. Oho, as nuk i afrohet!"
"Rrobat e vjetra janë kafshëri, - vijoi e palodhur pëshpëritja.

"Ne rrobat e vjetra përherë i hedhim. Shkatërrimi është më i mirë se arnimi, shkatërrimi është më i mirë se arnimi, shkatërrimi është më i mirë..."
"Qeverisja është çështje mbledhjesh, jo rrahjesh. Qeveriset me tru e prapanica, kurrë me grushte. Është zhvilluar edhe fushata për konsumin, sa për shembull."
"Ja ku jam, u bëra gati, - tha Lenina; por Fani e shtangur nuk i tha një fjalë. - Hajt, pajtohemi e dashur Fani.
"Çdo burrë, grua dhe fëmijë shtrëngohet të konsumojë në sasi të caktuara çdo vit. Në interes të industrisë. I vetmi rezultat..."
"Shkatërrimi është më i mirë se arnimi. Sa më shumë arnime, aq më pak fitime; më shumë arnime..."
"Një nga këto ditë, - tha Fani duke vendosur e ngrysur pikat mbi "i", - do gjesh belanë."
"Vërejtje e ndërgjegjshme në shkallë të stërmadhe. Çmos për konsumin. Kthim në natyrë."
"Unë dua të fluturoj. Unë dua të fluturoj."
"Kthim në kulturë. Po, tamam në kulturë. Nuk ke si konsumon shumë, kur rri ulur e lexon libra."

"Si të dukem?" - e pyeti Lenina. Xhaketa e saj qe bërë prej acetati të gjelbër ngjyrë shishesh; me pellush viskoze të gjelbër te manshetat dhe te jaka.
"Tetëqind praktikantë të thjeshtë u krasitën nga mitralozat në Golders Grin."
"Shkatërrimi është më i mirë se arnimi, Shkatërrimi është më i mirë se arnimi."
Pantallona të shkurtra kadife me vija dhe çorapë të bardhë prej leshi viskoz, të kthyer poshtë gjurit.
"Pastaj erdhi Masakra e famshme e Muzeut Britanik. Dy mijë tifozë të kulturës u helmuan me gaz sulfit dikloretili.
Një kapele hipizmi e gjelbër me të bardhë i bënte Leninës hije mbi sy; këpucët e saj lustrafine kishin ngjyrë të gjelbër më të hapur.
"Në fund, -tha Mustafa Mondi, - Kontrolluesit e kuptuan se forca nuk bënte punë. Metodat më të ngadalta, por tërësisht më të sigurta të ektogjenezës, paracaktimit neopavlovian dhe hipnopedia..."
Dhe rreth belit, ajo kishte lidhur një gjerdan surrogat në ngjyrë të gjelbër Maroku me pak argjend, të mbushur dëng, (ngase Lenina nuk ishte shterpë) me furnizimin e zakonshëm me kontraceptivë tamam sipas rregullores.

"Zbulimet e Pficnerit dhe Kavaguçit më në fund u vunë
në përdorim. Një propagandë intensive kundër riprodhimit
gjallëpjellës..."
"E përkryer! - thirri Fani me entuziazëm. Ajo nuk i bënte dot ballë shumë gjatë sharmit të Leninës. - Uah çfarë rripi Maltuzian, i përkryer, shumë gjë e bukur!"
"E shoqëruar me një fushatë kundër të kaluarës; me mbylljen e muzeve, hedhjen në erë të monumenteve historike (për fat shumica e tyre qenë shkatërruar gjatë Luftës së Nëntë viteve); me ndalimin e të gjitha librave të botuar përpara vitit 150 pas Fordit."
"Do ta marr se s'bën edhe unë një si ky," - tha Fani. "Ka pasur atëherë ca gjëra që quheshin piramida, për shembull."
"Gjerdani i zi, ai vjetri e kishte ngjyrën origjinale..."
"Dhe një burrë që quhej Shekspir. Ju, sigurisht, nuk keni dëgjuar kurrë për këto."
“Është vërtet për të ardhur keq. Ah, çfarë gjerdani!"
"Të tilla janë përparësitë e një edukimi me të vërtetë shkencor."

"Sa më shumë arnime, aq më pak fitime, sa më shumë arnime, aq më pak..."
"Prezantimi i të parit Model -T të Fordit Tonë..."
"E kam që prej tre muajsh."
"I zgjedhur si data e hyrjes në erën e re."
"Shkatërrimi është më i mirë se arnimi; shkatërrimi është më i mirë..."
"Kishte një gjë, siç e thashë më parë që quhej krishterim." "Shkatërrimi është më i mirë se arnimi."
"Etika dhe filozofia e nënkonsumit..."
"I dashuroj rrobat e reja, i dashuroj rrobat e reja, i dashuroj..."
"Kaq thelbësore në periudha nënprodhimi; por në kohën e mekanizimit dhe stabilizimit të nitrogjenit, ky përnjëmend ishte krim kundër shoqërisë."
"Ma dha Henri Fosteri."
"Të gjithë kryqeve iu prenë majat dhe u bënë T. Kishte ato
kohë edhe një gjë që quhej Zot."
“Është surrogat i vërtetë nga Maroku."

"Kemi Botën-Shtet sot. Dhe ditët përkujtimore të Fordit, Komuniteti Këndon edhe Shërbimet e Solidaritetit."
"Ford, sa i urrej!" - mendonte Bernard Marksi.
"Kishte një gjë që quhej parajsë; por megjithatë ata prapë vazhdonin të pinin sasi të stërmëdha alkooli."
"Si mish, tamam si mish."
"Kish një gjë që quhej shpirt dhe një gjë që quhej pavdekësi."
"Pyete Henrin se ku e gjeti?"
"Ata përdornin morfinë dhe kokainë."
"Dhe ajo që e bën edhe më zi punën, është se ajo e mendon veten prej mishi."
"Dy mijë farmakologë dhe biokimistë u subvencionuan në vitin 178 pas Fordit."
"Ai vërtet që duket i pikëlluar," - tha asistent Paracaktuesi, duke treguar Bernard Marksin me gisht.
"Gjashtë vjet më pas nisi prodhimi për treg. Ilaçi i përkryer." "Hajt ta ndjellim."

"Euforik, narkotik, halucinant, i këndshëm."
"I pikëlluari Marks, i pikëlluar. - Një prekje në sup e bëri të shohë përpjetë. Ishte ai kafsha, Henri Foster. - Ty tani të duhet vetëm një gramë soma."
"Të gjitha përparësitë e krishterimit dhe alkoolit; asnjë nga
të metat."
"Ford, do ta vrisja me qejf! - por vetëm sa i tha: Jo, të faleminderit," dhe ia ktheu pas kutinë me tableta.
"Merr pushim nga realiteti dhe kthehesh pa dhimbje koke dhe mitologji."
"Merre, - këmbënguli Henri Foster, - merre."
"Stabiliteti praktikisht u sigurua."
"Një centimetër kub shëron dhjetë sentimente të pikëlluara," - tha Asistent Paracaktuesi, duke cituar një copëz nga dituria shtëpiake hipnopedike.
"E vetmja gjë që mbeti për t'u pushtuar ishte pleqëria." "Mallkuar qofsh, mallkuar qofsh!" - ulëriu Bernard Marksi. "Fluturo me pras."
"Hormonet e herdheve, transfuzioni i gjakut të ri, kripërat e magnezit..."

"Dhe mos harro se një grimcë është më e mirë se një mallkim." - Dolën të qeshur.
"Të gjitha plagët psikologjike të pleqërisë janë fshirë. Të gjitha bashkë sigurisht..."
"Mos harro ta pyesësh për atë rripin maltuzian," - i tha Fani.
"Bashkë me to dhe të gjitha tiparet mendore karakteristike të pleqve. Karakteret mbeten të pandryshueshëm përgjatë gjithë jetës."
"...dy lojë Golf me Pengesa deri sa të erret. Ika."
"Punë, lojë... në të gjashtëdhjetat fuqitë dhe shijet tona janë ato që kemi pasur kur ishim shtatëmbëdhjetë. Pleqtë, në atë kohë të këqija, e kishin të zakonshme të hiqnin dorë, të dilnin në pension, të ktheheshin nga feja, të harxhonin kohën duke lexuar, duke menduar - duke menduar!"
"Derra te trashë!" - po thoshte me vete Bernard Marksi, teksa ecte përgjatë korridorit për të shkuar te ashensori.
"Tani, - i tillë është progresi - pleqtë punojnë, pleqtë çiftohen, pleqtë nuk kanë kohë, nuk kanë nge për kënaqësi, asnjë minutë të ulen e të mendojnë - ose, nëse rastis që për ndonjë rrethanë fatkeqe një e çarë e tillë në kohë, arrin ta shqyejë substancën solide të vramendjeve të tyre, kanë përherë soman, të shijshmen soma, gjysmë grami për gjysmë pushimi, një gram për fundjavë, dy gramë për një udhëtim në Lindjen

e mrekullueshme, tre për një përjetësi të errët në hënë; e në të kthyer ata e gjejnë veten në anën tjetër të së çarës, të sigurt e me këmbë në tokën e palëkundshme të punës së përditshme dhe vramendjeve, duke rendur me vrap nga ndjesia në ndjesi, nga një vajzë pompuese te një vajzë pneumatike, nga fusha elektromagnetike e golfit, te..."
"Ik tutje, vogëlushe, - bërtiti Drejtori i madh. - Ik tutje, vogëlush! Nuk e shihni se fordësia e tij është i zënë? Ikni e bëni lojën tuaj erotike diku tjetër."
"Të shkretët vogëlushë!" - tha kontrollori.
Ngadalë, madhërisht, me mërmërimën e zbehtë të makinerisë, konvejerët lëvizën përpara, tridhjetë e tre centimetra në orë. Në errësirën e kuqe shkëlqenin rubinë të panumërt.

KAPITULLI IV

PJESA I

Ashensori qe i mbushur plot me burra që kishin dalë nga dhomat e zhveshjes për Alfat, dhe hyrja e Leninës u mirëprit me përkulje koke e me buzëqeshje miqësore. Ajo ishte vajzë me popullaritet dhe, herë me njërin e herë me tjetrin, e kishte bërë thuajse me të gjithë. Janë si shpirt, mendoi ajo, duke u kthyer përshëndetjet. Djem tërheqës! Megjithatë, asaj do t'ia kishte qejfi që veshët e Xhorxh Edzelit të mos ishin aq të mëdhenj (ndoshta atij i patën dhënë një pikë më shumë se ç'i duhej nga sekrecioni paratiroid në metrin 328). Dhe, ngaqë e kishte para Benito Huverin, me doemos u kujtua se ai ishte vërtet tepër leshtor kur ishte zhveshur cullak. Në të kthyer, me sytë pak të trishtuar nga kujtimi i shkurrnajës së zezë të Benitos, ajo pa në një qoshe trupin e vogël e të dobët
dhe fytyrën melankolike të Bernard Marksit.
- Bernard!- dhe iu afrua. - Po të kërkoja. Zëri i saj tringëlliu
i kthjellët mbi gumëzhimën e ashensorit në ngjitje. Të tjerët panë përreth me kureshtje. - Do të doja të flisnim për planin e Nju Meksikos. Me bisht të syrit, ajo e pa Benito Huverin që u mek nga tronditja. Mekja e tij i shtoi inatin. "Çuditet që nuk

po përgjërohem të shkoj prapë me të!" - tha me vete. Pastaj me zë të lartë dhe më ngrohtësisht se kurrë: Thjesht kisha shumë dëshirë të shkonim bashkë në korrik për ndonjë javë, - vijoi ajo. (Gjithsesi, kështu ajo po e provonte publikisht tradhtine ndaj Henrit. Fanit duhej t'i bëhej qejfi, edhe pse ishte thjesht Bernardi.) - Gjithnjë, - Lenina i buzëqeshi atij hirshëm e në mënyrën më domethënëse, nëse ende do që të jem e jotja. Fytyra meite e Bernardit u bë flakë.
-"Po këtë pse dreqin po e bën?" - tha ajo me vete, e tronditur, por njëherësh e prekur nga kjo dhuratë e çuditshme që i bëhej hireve të saj.
- A s'do të ish ndoshta më mirë ta flasim diku tjetër? - iu mor atij goja duke u dukur tmerrësisht në siklet.
"Sikur po i bëj ndonjë hata, - mendoi Lenina. - Nuk do të dukej më i mërzitur se kaq, edhe sikur të kisha bërë ndonjë shaka të pistë, fjala vjen, ta pyesja si ta quajnë mamin, a ndonjë gjë të tillë."
- Doja të thosha se me gjithë këta njerëz rrotull sikur... - atë e mbyti hutimi.
Qeshja e Leninës rrodhi e lirshme dhe krejtësisht pa të keq. -Sa shakaxhi që je! - tha ajo; dhe ajo e mbante përnjëmend për shakaxhi. - Do të më lajmërosh të paktën një javë përpara, apo jo, - shtoi ajo duke i dhënë zërit një ton tjetër. - Ma thotë një mendje se do të marrim raketën Paqësori Blu? Mos niset gjë nga Kulla Kujdesi-T? Apo nga Hampstedi?
Përpara se Bernardi të mund të përgjigjej, ashensori erdhi e u ndal.
"Tarraca!" - thirri një zë i çjerrë.
Ashensoristi qe një krijesë e vogël prej majmuni, veshur me tunikën e zezë të një Ypsilon-Minus, Gjysmë-Debili.

"Tarraca!"
Ai hapi furishëm portat. Magjia e dritës së pasdites e bëri të shtangej dhe të puliste sytë. "Oh, tarraca! - përsëriti ai me zë entuziast. Dukej sikur qe zgjuar befas dhe gëzueshëm nga një dalldi e zymtë që e kishte mpirë. - Tarraca!"
Ai iu zgërdhi pasagjerëve, me një lloj admirimi si e qenit që pret t'i hedhin ndonjë kockë. Duke folur e qeshur së bashku, ata dolën jashtë në dritë. Ashensoristi i ndoqi me sy. "Tarraca?" - tha ai edhe një herë si me të pyetur. Më pas ra një zile dhe nga tavani i ashensorit një altoparlant zëlartë nisi me të butë, por me imponim, të japë urdhra. "Shko poshtë, - thoshte, - shko poshtë. Kati tetëmbëdhjetë. Shko poshtë, shko poshtë. Kati tetëmbëdhjetë. Shko poshtë, shko..."
Ashensoristi përplasi portat, preku një buton dhe në çast u zhyt brenda mugut gumëzhitës të pusit, mugut të dalldisë së tij të zakonshme.
Në tarracë ishte ngrohtë e plot dritë. Pasditja e verës përgjumej nga zukatja e helikopterëve që kalonin; më e thellë, gumëzhima e avionëve-raketë që nxitonin, të padukshëm, përmes qiellit të ndriçuar nëntë a dhjetë kilometra mbi kokë, ngjante si përkëdhelje në ajrin e butë. Bernard Marksi mori frymë thellë. Pa lart në qiell, rrethas në horizontin blu dhe në fund fare u ndal te fytyra e Leninës.
"A nuk është e mrekullueshme!" - zëri iu drodh pakëz. Ajo i buzëqeshi duke i shprehur mirëkuptimin më dashamirës.
"Ditë e përkryer për Golf me Pengesa, - iu përgjigj ajo me entuziazëm. - Tani më duhet të iki me vrap, Bernard. Henri acarohet kur e lë të presë. Më lajmëro përpara për datën."

Dhe duke përshëndetur me dorë, ajo u arratis përmes tarracës së gjerë e të sheshtë në drejtim të hangarëve. Bernardi ndenji duke vështruar vezullimin e çorapeve të bardha, gjunjët e pjekur nga dielli që përkuleshin e drejtoheshin prapë e prapë, dhe rrokullisjen e butë të kadifeve të shkurtra ngjitur mbas trupit, përfund xhaketës ngjyrë shisheje të gjelbër. Fytyra iu vesh me një shprehi dhimbjeje.
"Më duhet ta them që ishte e lezetshme," - foli një zë i lartë dhe i gëzueshëm nga pas tij. Bernardi ndali dhe hodhi sytë përreth. Fytyra trashaluqe dhe kuqaloshe e Benito Huverit po i buzëqeshte - buzëqeshje me përzemërsi të dukshme. Benito njihej për natyrën e tij të mirë. Njerëzit thoshin se ai mund ta çonte gjithë jetën pa zënë kurrë soma me dorë. Smira dhe zemërimi që i bënin njerëzit e tjerë të merrnin ditë pushimi, nuk e ngisnin kurrë atë. Për Beniton, realiteti ishte përherë me diell.
"Pneumatike, madje. Po sa! - Pastaj me një ton tjetër: - Jo për gjë, po, - vazhdoi ai, - ti po më dukesh i zymtë! Të duhet vetëm një gramë soma. - Duke zhytur dorën e djathtë thellë në astarin e xhepit, Benitoja nxori jashtë një shishkë. - Një centimetër kub shëron dhjetë mërzi... Po! Ta them unë!" Bernardi befas i ktheu shpinën dhe iku me nxitim. Benito e ndoqi ngultas me sy.
"Si e ka hallin ky djalë? - mendoi, dhe, duke tundur kokën, e ndau mendjen se ajo historia e alkoolit që i kishin hedhur të shkretit në surrogatin e gjakut duhet të ishte e vërtetë. - I ka prekur trurin, ma do mendja." Ai e hoqi mënjanë shishen e somas dhe nxori jashtë një paketë me çamçakëzë me hormone seksi, futi një në gojë dhe me hapa të ngadaltë u largua drejt hangarëve duke u përtypur.

Henri Foster e kishte nxjerrë me të shtyrë mjetin e tij nga garazhi dhe kur Lenina mbërriti, ai ndërkaq e priste ulur në
kabinë.
"Katër minuta me vonesë," - komentoi ai, teksa ajo iu ul pranë. Ai ndezi motorët dhe i futi marshin helikës. Mjeti kërceu vertikalisht dhe qëndroi pezull në ajër. Henri shtoi shpejtësinë; gumëzhima e helikës u bë nga si e një brumbulli, në atë të një grerëze, nga grerëz në mushkonjë; shpejtësimatësi tregonte se po ngjiteshin me dy kilometra në minutë. Londra poshtë tyre u tret. Pas pak sekondash, ndërtesat e stërmëdha si tavolina nuk ngjanin shumë më ndryshe nga një shtrat kërpudhash gjeometrike të mbira prej gjelbërimit të parqeve dhe kopshteve. Në mes tyre, si një kërcell i hollë dhe i gjatë i një kërpudhe më thatime - Kulla prej betoni e Kujdesit-T ngrihej drejt qiellit si disk i ndritshëm betoni.
Si buste të vagullt atletësh të famshëm, re vigane e topolake shullëheshin në ajrin blu mbi kokat e tyre. Prej njërës syresh, papritur, u shkëput një insekt i vogël bojë alle, që gumëzhinte teksa binte poshtë.
"Ja ku është Raketa e Kuqe, - tha Henri, - e sapoardhur nga Nju Jorku." Duke parë orën: "Shtatë minuta me vonesë, - shtoi dhe tundi kokën. Këto shërbimet e Atlantikut janë vërtet skandal, përherë me vonesë."
Ai hoqi këmbën nga pedali i gazit. Gumëzhima e helikave mbi ta ra një oktavë e gjysmë, u rikthye nga brumbull e grerëz në zukamën e një blete të egër, në zhuzhak, deri sa u bë si ajo e një buburreci. Rendja e makinerisë drejt lartësisë u ngadalësua; një çast më pas ata po rrinin pezull në ajër. Henri shtyu një levë, u dëgjua një kërcitje. Ngadalë në fillim, pastaj shpejt e më shpejt, gjersa kur u krijua një si mjegull rrethore përpara

syve të tyre, helika e bashit nisi të rrotullohet. Era me shpejtësi horizontale fishkëlleu edhe më e mprehtë. Henri i mbante sytë te matësi i xhirove; kur akrepi preku kufirin një mijë e dyqind, ai e nxori helikopterin nga marshi. Mjeti kishte marrë shtytjen e mjaftueshme sa të fluturonte mbi krahët e veta. Lenina pa poshtë, mes këmbëve të saj, nga dritarja e dyshemesë. Po fluturonin mbi zonën pyjore prej gjashtë kilometrash, që ndante Londrën Qendrore nga unaza e parë e periferive që e rrethonin. Gjelbërimi qe i krimbur prej jetës së përtejshme. Pyje kullash centrifugale Bumble-puppy vezullonin mes pemëve. Pranë Sheperd Bushit dy mijë Beta-Minus të përzier në çifte po luanin Rieman-tenis në sipërfaqe. Në radhë dyshe, Pesë Fushat e Ashensorëve ndanin rrugën kryesore nga Noting Hill në Uillesden. Te stadiumi Illing po zhvillohej një shfaqje gjimnastikore e Deltave dhe një kor i komunitetit.
"Çfarë ngjyre e neveritshme është kjo kakia," - vërejti Lenina, duke i dhënë zë paragjykimeve hipnopedike të kastës së saj.
Ndërtesat e Studiove të Hounslou Fili zinin shtatë hektarë e gjysmë. Pranë tyre një ushtri e zezë dhe kaki punëtorësh ishte shumë e zënë me riveshjen me qelq të rrugës Grejt Uest. Njëra prej furrnaltave lëvizëse po zbrazej teksa ata fluturonin përsipër. Guri i shkrirë derdhej në një rrëke verbuese inkandeshente përgjatë gjithë rrugës; cilindrat e asbestit shkonin e vinin; në bisht të një karroce hermetike që mbante ujë, avulli ngrihej
lart në re të bardha.
Në Brenford, fabrika e Korporatës së Televizionit ishte si një qytet i vogël.
"Do jenë duke ndërruar turnet," - tha Lenina.
Si afidë e si milingona, vajzat me të gjelbër të Gamave dhe

Gjysmë-Debilët me të zeza gëlonin rreth hyrjes, ose qëndronin Beta-Minuset ngjyrë mareje shkonin e vinin nëpër turmë. në radhë për të zënë vend në vagonët njëshinësh të transportit. Tarraca e godinës qendrore gjallërohej nga ulja e ngritja e
helikopterëve.
"Te betohem, tha Lenina, - jam e lumtur që nuk jam Gama."
Dhjetë minuta më pas ata ndodheshin në Stouk Poxhis dhe kishin nisur raundin e parë të Golfit me Pengesa.

PJESA 2

Me sytë përdhe shumicën e kohës - edhe kur i ngrinte ndonjëherë drejt ndonjë krijese mike, ai menjëherë dhe vjedhurazi i shmangej vështrimit Bernardi kaloi me ngut përmes tarracës. Dukej si një përndjekur, por nga armiq që nuk donte t'i shihte me sy, që të mos i dukeshin më shumë armiqësorë, dhe kjo e bënte të ndihej më fajtor dhe më dëshpërimisht i vetmuar.
"I tmerrshmi Benito Huver!" E megjithatë, burri kishte pasur qëllime të mira. Çka e bënte të ndihej, në njëfarë mënyre, edhe më keq. Ata që i donin të mirën, silleshin me të njëlloj si ata që i donin të keqen. Madje edhe Lenina po e bënte të vuante. Kujtonte javët e pavendosmërisë së ndrojtur, javë, gjatë të cilave kishte pyetur veten i djegur nga dëshira dhe dëshpërimi se a do të gjente ndonjëherë kurajë ta ftonte të dilnin bashkë. A do të guxonte të përballej me rrezikun e poshtërimit prej refuzimit përbuzës? Oh, ç'ngazëllim sikur ajo t'i thoshte po! Megjithëse ajo tashmë ia kishte thënë, ai

prapëseprapë ndihej i mjerë... i mjerë ngaqë asaj kjo pasdite i qe dukur e përsosur për të luajtur Golf me Pengesa, ngaqë ajo iku me vrap për t'u bashkuar me Henri Fosterin, ngaqë asaj i qe dukur shakaxhi, meqë atij nuk para i pëlqente të fliste për çështje private në publik. Me një fjalë, i mjerë sepse ajo ishte sjellë me të si çdo vajzë angleze e shëndetshme dhe e dëlirë, e aspak në një mënyrë të jashtëzakonshme e anormale.
Ai hapi portën e garazhit dhe thirri një çift Delta-Minusësh që t'i jepnin një dorë për ta nxjerrë mjetin jashtë në tarracë. Hangarët ishin pajisur me staf nga një grup i vetëm Bokanovski, kështu që burrat ishin binjakë identikë, të vegjël, të zinj e të neveritshëm. Bernardi i dha urdhrat me tonin e mprehtë, gati arrogant dhe fyes, të një njeriu që nuk e ndien veten shumë të sigurt në superioritetin e vet. Kontakti me njerëz të kastave më të ulëta për Bernardin ishte përherë një përvojë që e hutonte. Pasi cilido të qe shkaku (dhe thashethemi që sillej rrotull për alkoolin në surrogatin e tij të gjakut mund - duke qenë se aksidente që mund të ndodhnin në jetë - të qe i vërtetë) fiziku i Bernardit me vështirësi arrinte mesataren e Gamave. Qe tetë centimetra më i shkurtër se standardi i gjatësisë së një Alfe dhe ishte i thatë në trup. Përballja me anëtarët e kastave më të ulëta i kujtonte përherë me dhimbje papërshtatshmërinë e tij fizike. "Unë jam unë, që mos qofsha"; vetëdija e tij qe e mprehtë dhe shqetësuese. Për çdo herë që shihte përballë një fytyrë Delta, në vend që ta shihte siç duhej, nga lart poshtë, ndihej i poshtëruar. A do ta trajtonte kjo krijesë me respektin që i përkiste kastës së tij? Kjo pyetje e përndiqte. Jo pa arsye, Ngase Gamat, Deltat dhe Ypsilonët ishin kushtëzuar deri në njëfarë mase, që të lidhnin masën trupore me superioritetin shoqëror. Pa dyshim, njëfarë paragjykimi i lehtë hipnopedik,

i cili favorizonte përmasat, ishte universal. Prej nga vinte edhe përqeshja e grave të cilave ai u propozonte, apo rrengjet e të barabartëve të tij mes burrave. Qesënditë e bënin të ndihej i huaj; dhe ngaqë ndihej i huaj, si i atillë sillej, çka i rriste paragjykimet kundër tij dhe shtonte përbuzjen e armiqësinë e nxitur me tepri nga mangësitë e tij fizike. Kjo gjë ia rriste ndjesinë se ishte i huaj dhe i vetmuar. Frika kronike e të qenit i shpërfillur, e bënte t'u shmangej të barabartëve me të, e bënte të qëndronte në pozitat e atyre që ishin inferiorë ndaj tij, të ndrydhte me vetëdije dinjitetin e vet. Sa hidhur e me sa zili i shikonte njerëzit si Henri Fosteri dhe Benito Huveri! Njerëz të cilëve nuk u binte kurrë t'i ulërinin një Ypsiloni për të zbatuar një urdhër; njerëz që e merrnin pozitën për të mirëqenë; njerëz që lëviznin nëpër sistemin e kastave si peshku në ujë- ndiheshin aq rehat, sa ishin të pandërgjegjshëm si për veten, ashtu edhe për ambientin e privilegjuar e komod në të cilin jetonin.

Ngadalë e pa qejf (kështu iu duk atij), binjakët e shtynë deri në tarracë mjetin mbi rrotat e transportit.

"Nxitoni! - u bërtiti me irritim Bernardi. Njëri prej tyre e pa vrikthi. Mos ishte njëfarë përqeshjeje kafshërore ajo që ai vuri re në sytë e zbrazët ngjyrë gri të tjetrit? - Nxitoni!" bërtiti ai edhe më fort, dhe zëri i mori një gërvimë të shëmtuar. Ai u ngjit në avion dhe një minutë më pas po fluturonte drejt jugut, në drejtim të lumit.

Byroja e Propagandës dhe Kolegji i inxhinierisë emocionale ishin vendosur në një ndërtesë të vetme gjashtëdhjetëkatëshe në Fllit Strit. Në bodrum dhe në katet e poshtme ndodheshin shtypshkronjat dhe zyrat e tre gazetave të mëdha të Londrës -Radio Ora, gazetë për kastën e lartë, gjelbëroshja e zbehtë

Gazeta e Gamave, dhe ajo në letër ngjyrë kaki, ekskluzivisht me fjalë njërrokëshe, Pasqyra e Deltave. Më pas vinin Byroja e Propagandës përmes Televizionit, Filmit me Ndjenja, Zërit Sintetik dhe Muzikës, sipas radhës - plot njëzet e dy kate. Mbi to gjendeshin laboratorët kërkimorë dhe dhomat e izoluara ku Shkruesit e Kolonave Zanore dhe Kompozitorët Sintetikë kryenin punën e tyre aq delikate. Tetëmbëdhjetë katet e sipërme i zinte Kolegji i Inxhinierisë Emocionale.
Bernardi e uli mjetin mbi tarracën e Shtëpisë së Propagandës dhe zbriti.
"Telefonojini zotni Helmholc Uatsonit, - i dha urdhër portierit Gama-Plus, - dhe t'i thoni se zotni Bernard Marksi po e pret në tarracë."
Ai u ul dhe ndezi një cigare.
Helmholc Uatsoni po shkruante kur i erdhi mesazhi. "Thuaji se erdha menjëherë, - tha ai dhe e uli receptorin. Pastaj, duke iu kthyer sekretares: po të lë ty t'i mbyllësh edhe gjërat e mia." - tha ai me të njëjtin ton impersonal dhe zyrtar; dhe, pa vënë re buzëqeshjen e saj gjithë shkëlqim, u çua dhe eci gjallërisht drejt portës.
Ai ishte një burrë i fuqishëm dhe truplidhur, gjoksgjerë, shpatullgjerë, i bëshëm, e megjithatë i shpejtë në lëvizje, elastik dhe i zhdërvjellët. Shtylla e rrumbullakosur që kishte për qafë, i shërbente si mbështetje për një kokë të latuar shumë bukur. Flokët i kish të zinj dhe kaçurrelë, tiparet të gdhendura mirë. Në njëfarë mënyre, mund të quhej i pashëm; siç dukej sekretarja e tij nuk lodhej kurrë duke i përsëritur se ai qe në çdo centimetër një Alfa-Plus i vërtetë. Me profesion ishte lektor në Kolegjin e Inxhinierisë Emocionale (departamenti i shkrimtarisë) dhe mes intervaleve gjatë aktiviteteve edukative,

punonte si Inxhinier Emocional. Ai shkruante vazhdimisht për *Radio Orën*, hartonte skenarë të ndjeshëm dhe kishte një zotësi për slogane dhe rima hipnopedike.
"I zoti, - ky qe gjykimi prej eprorëve. - Ndoshta, (dhe ata
bën vaki që tundin kokat dhe e thonë me gjysmë zëri) – pak si tepër
i zoti."
Po, pak si tepër i zoti dhe kishin të drejtë. Një tepri mendore kish prodhuar te Helmhole Uatsoni efekte shumë të ngjashme me ato të cilat për Bernard Marksin, ishin rezultati i një defekti fizik. Pak kockë e pak muskul e kishin veçuar Bernardin nga të afërmit e tij njerëzorë. Ndjesia e mënjanimit, duke qenë me të gjitha standardet e kohës, një tepri mendore, kur i erdhi radha atij të shquhej, u bë shkak për një ndarje edhe më të thellë. Kjo e kishte bërë Helmholcin pas shumë vuajtjesh të vetëdijshëm, se ja kështu ishte vetvetja, edhe kjo e marrë në veçanti ishte një aftësi e tepërt. Ajo që ndanin bashkë burrat ishte vetëdija se të dy ishin individë. Por, ndërsa Bernardi, fizikisht me cene, kishte vuajtur gjithë jetën nga vetëdija se e mënjanonin, veç kohët e fundit Helmolc Uatsoni, pasi qe ndërgjegjësuar për teprinë e vet mendore, kish kuptuar dallimin mes vetes dhe personave që e rrethonin. Ky kampion i Shkallë-Shkatërruesve, ky dashnor i palodhshëm (flitej se e kishte pasur gjashtëqind e dyzet vajza të ndryshme në më pak se katër vjet), ky anëtar i nderuar i komitetit, ky shok i mirë i vlerësuar nga të gjithë, kish vënë re kohët e fundit se sporti, gratë, aktivitetet komandues, ishin thjesht, sa i përket atij, gjëra të dorës së dytë. Në të vërtetë thellë brenda vetes, atij i interesonte diçka tjetër. Po çfarë? Çfarë?! Ky ishte problemi që e kish sjellë Bernardin të bisedonte me të ose më mirë, meqë ishte vetëm Helmholci ai që fliste, Bernardi kish ardhur të dëgjonte mikun e tij edhe një herë tjetër.

Tre vajza të hijshme të Zërit Sintetik nga Byroja e Propagandës i hapën atij rrugën teksa doli nga ashensori.
Oh, Helmholc i dashur, ejani me ne... do të bëjmë së bashku një piknik të paparë në Eksmur. - Iu ngjitën nga pas duke iu përgjëruar.
Ai tundi kokën, u tha jo dhe çau përmes me të shtyra. - Jo, jo.
- Nuk kemi ftuar asnjë burrë tjetër.
Por Helmholci qëndroi i palëkundur edhe pas këtij premtimi që do ta bënte çdokënd t'i shkonte goja lëng.
- Jo, - përsëriti ai, - kam punë. Dhe vijoi pa mëdyshje në rrugën e tij.
Vajzat e ndoqën këmba-këmbës. Nuk iu ndanë derisa u ngjit në avionin e Bernardit dhe u përplasi portën në fytyrë, që t'i hiqeshin qafe. Jo pa pishman.
Gratë! tha ai në kohën kur mjeti u ngrit në qiell. - Gratë! dhe tundi kokën duke mrrudhur vetullat. E tmerrshme! - Bernardi i dha të drejtë me hipokrizi, porse me shpirt, teksa fliste, ai do donte të kishte po aq shumë vajza nga pas si Hemholci, me aq pak mund. Befas ai u mbërthye nga një nevojë urgjente për t'u mburrur. - Do ta marr Lenina Krounin me vete në Nju Meksiko, - tha me një tonin më të natyrshëm që ai mund të nxirrte.
- Vërtet? tha Helmholci pa pikën e interesit. Pastaj pas një heshtjeje të shkurtër: - Këtë javën e fundit, apo këto dy javë, - vijoi ai, - i kam ndërprerë të gjitha lidhjet me të gjithë shokët dhe vajzat e mia. Nuk e ke idenë se çfarë potereje kanë bërë në kolegj. E megjithatë besoj se ia ka vyer. Efektet ... - nguroi ai. - Epo, janë kaq të çuditshme, krejt të çuditshme. Cenet fizike mund të sjellin një lloj teprie mendore.

Procesi ngjan i pakthyeshëm. Tepria mendore mundet të shkaktojë, për qëllimet e veta, verbëri e shurdhëri të vullnetshme, impotencën artificiale të asketizmit. Pjesa tjetër e fluturimit të shkurtër përfundoi në heshtje. Kur sosën dhe u shtrinë sa gjatë gjerë mbi divanet pneumatike në dhomën e Bernardit, Helmholci ia nisi nga fillimi.
-A ke ndier ndonjëherë? - e pyeti ai me zë fare të ulët. - Se mos ke ndonjë gjë brenda teje që mezi pret që t'i njohësh fatin të dalë? Njëfarë fuqie, të cilën nuk po e përdor... e di si, si gjithë uji që shkon e bie poshtë në ujëvara, në vend që të kalojë nëpër turbina?
- Dhe e hodhi shikimin nga Bernardi duke pritur përgjigje. - Do të thuash gjithë emocionet që mund të ndiejë njeriu sikur gjërat të ishin ndryshe?
Helmholci tundi kokën.
- Jo plotësisht ashtu. Më shkon ndër mend një ndjenjë e çuditshme që më zë ndonjëherë, një ndjesi sikur kam diçka të rëndësishme për të thënë dhe fuqinë ta nxjerr nga goja po ashtu - vetëm se nuk e di se çfarë është e nuk e fus dot fuqinë në përdorim. Nëse do kishte ndonjë mënyrë të ndryshme të shkruari... ose një diçka tjetër mbi të cilën të shkruash... - Ai heshti; pastaj vazhdoi, - më kupton, jam shumë i zoti të shpik fjali... e di si, me nga ato lloj fjalësh që papritur të bëjnë të kërcesh përpjetë, sikur të ngulet një gjilpërë; gjëra që duken kaq të reja e ngacmuese, edhe pse sigurisht janë dukshëm hipnopedike. Por prapë nuk ngjan si e mjaftueshme. Nuk mjafton që fjalitë të jenë vetëm të mira; ajo që t'i realizon me to duhet të jetë po aq e mirë.
- Ato që ke shkruar janë të mira, Helmholc.
- Oho, e thua meqë akoma mbajnë ujë. – Helmholci

mblodhi supet. - Po nuk mbajnë dhe aq. Në njëfarë mënyre, nuk janë aq të rëndësishme. E ndiej se mund të bëj një gjë shumë më të rëndësishme. Po edhe më të gjallë, më të dhunshme. Por çfarë? Si mund të jetë i dhunshëm dikush për gjërat që dikush tjetër pret që ti të shkruash? Fjalët mund të bëhen si rreze X, po t'i përdorësh me vend - ato kalojnë përmes çdo gjëje. I lexon, dhe ato të shpojnë tejpërtej. Kjo është ajo gjë që përpiqem t'u mësoj studentëve - si të shkruajnë tejshpueshëm. E si mundet të të shpojë një artikull mbi Komuniteti Këndon, apo mbi përmirësimin më të fundit të organeve të nuhatjes? Përveç kësaj, a bëhen dot fjalët aq shpuese-sa rrezet më të forta X-kur nis të shkruash për gjëra të tilla? A mund të thuash diçka për asgjënë? Ja mbërrij këtu dhe çdo gjë më tretet. Edhe unë përpiqem e përpiqem...
- Shshsht! - i tha papritur Bernardi dhe ngriti lart gishtin tregues si paralajmërim; të dy bashkë i vunë veshin zhurmës. - Më duket se është dikush tek porta, - pëshpëriti ai.
Helmholci u ngrit dhe kaloi dhomën në majë të gishtave
e me një lëvizje të vetme e të shpejtë e hapi portën me dy kanatet. Sigurisht, nuk kishte njeri.
- Më fal, -tha Bernardi, duke u dukur dhe u ndjerë si rrotë.
- Më duket sikur kam diçka që më ka ngecur mes nervave. Kur njerëzit të fusin në dyshime, fillon edhe vetë të bëhesh dyshues për ta.
Ai fërkoi sytë me dorë, psherëtiu, zëri iu bë ankues. Po justifikohej.
- Ta dish se çfarë kam hequr këto kohë, - i tha gati me lot,
- dhe me ngutjen drejt vetëmëshirimit iu duk sikur papritur
i shpërtheu papritur një burim. - Veç ta dish!

Helmholc Uatsoni e dëgjoi si i zënë në hall. "I shkreti Bernard!" tha me vete. Por në të njëjtën kohë i erdhi turp për mikun e tij. Dëshironte që Bernardi të shfaqte pak më tepër krenari.

KAPITULLI V

PJESA I

Nga ora tetë drita po binte. Altoparlantët e lartë në kullat "Stoke Poges Club House" nisën të buçisnin me një zë tenori gati njerëzor, lajmëronin mbylljen e fushave të golfit. Lenina dhe Henri e lanë lojën përgjysmë dhe u kthyen në klub. Nga vendndodhjet e Trustit të Sekrecioneve të Brendshme dhe të Jashtme dëgjoheshin pëllitjet e mijëra bagëtive, të cilat plotësonin me bazën materiale, hormone dhe qumësht, fabrikën e madhe në “Farnham Rojal".
Një gumëzhimë e pareshtur helikopterësh ngopte muzgun. Çdo dy minuta e gjysmë një zile dhe fishkëllima të zgjatura lajmëronin nisjen e njërit prej trenave të lehtë njëshinësh, të cilët transportonin golfistët e kastës së ulët në rrugën e kthimit nga fushat e lojës në metropol. Lenina dhe Henri u ngjitën në mjetin e tyre dhe u nisën. Në tetëqind metra Henri ngadalësoi rrotullimet dhe ata qëndruan një çast a dy pezull mbi peizazhin që po fashitej. Pyllii aheve të Burnhamit shtrihej si një pellg i madh i errësuar drejt brigjeve të ndriçuara të qiellit të perëndimit. E përskuqur në horizont, pjesa përfundimtare e perëndimit të diellit, kaloi nga portokalli, përpjetë drejt të verdhës e më pas nëpër të gjelbrat e zbehta të ujërave. Nga veriu, përtej përmbi

pemë, Fabrikat e Sekrecioneve të Brendshme dhe të Jashtme lëshonin vezullime me një shkëlqim të ashpër elektrik nga dritaret e njëzetkatësheve. Përfund tyre shtriheshin fushat e Klubit të Golfit - barakat e pafundme të kastave të ulëta, ndërsa në anët matanë murit ndarës - shtëpitë e vogla që ishin të rezervuara për anëtarët e Alfave dhe Betave. Rrugët për te trenat qenë mbuluar nga një ngjyrë e zezë, si mizeri milingonash, prej qarkullimit të kastave të ulëta. Nga poshtë mburojës së xhamit, një tren me dritat ndezur doli në vend të hapur. Duke ndjekur me sy fushat e tyre të juglindjes ata vështruan nga ndërtesat mahnitëse të Krematoriumit të Kalbësirave. Për sigurinë e avionëve që fluturonin gjatë natës, katër oxhaqet e lartë qenë përmbytur nga dritat dhe pajisur me sinjale të kuqe. Ishin pika referimi.
Përse oxhaqet i kanë ato si ballkone përreth? - kërkoi të dinte Lenina.
Përpunimi i fosforit, - ia ktheu Henri me stil telegrafi. -Rrugës, duke u ngjitur nëpër oxhak, gazet kalojnë përmes disa fazash trajtimi. P-205 ndodh që del ndonjëherë jashtë qarkullimit kur digjet dikush në krematori. Tashmë ata e përpunojnë, nëntëdhjetë e tetë për qind të gazit. Më shumë se një kilogram e gjysmë prej trupit të një të rrituri. Duke mbledhur gazin, në rastin më të mirë, bëhen katërqind ton fosfor në një vit, kjo vetëm nga Anglia. - Henri fliste tërë krenari e kënaqësi, duke iu gëzuar me gjithë zemër kësaj arritjeje, sikur të kishte qenë e tija. - Është bukur të mendosh se mund të jesh i vlefshëm për shoqërinë edhe pas vdekjes. Kështu ndihmon bimët të rriten."
Lenina, ndërkohë, i kishte hedhur sytë diku tjetër, ajo po shihte poshtë fare drejt stacionit të trenit.

- Mirë, tha ajo, - ama e kam një dyshim, Alfat dhe Betat, s'ka si të mos rrisin më shumë pemë se ata shpifarakët e vegjël aty poshtë, Gamat, Deltat dhe Ypsilonët.
-Të gjithë njerëzit janë psiko-kimikisht të barabartë, -i tha Henri sikur po perifrazonte. - Përveç kësaj, Ypsilonët kryejnë shërbime të pazëvendësueshme.
"Një Ypsilon..." Leninës befas iu kujtua një rast kur kishte qenë vajzë e vogël shkolle, qe zgjuar në mes të natës dhe kuptoi për herë të parë ç'ishte pështpërima që e përndiqte sa herë që binte në gjumë. Ajo kish parë rrezen e dritës së hënës, radhën e gjatë me shtretërit e bardhë; kish dëgjuar edhe një herë tjetër zërin e butë që thoshte (fjalët kishin mbetur të paharrueshme pas kaq shumë netëve përsëritje): "Të gjithë punojnë për këdo. Ne nuk ia dalim dot, sikur të mungojë qoftë edhe një i vetëm. Edhe Ypsilonët janë të dobishëm. Nuk ia dalim dot pa Ypsilonët. Të gjithë punojnë për këdo. Nuk ia dalim dot sikur të mungojë qoftë edhe një i vetëm..." Leninës iu kujtua tronditja e parë prej frikës dhe habisë; meditimet për gati gjysmë ore pa gjumë; dhe pastaj, nën ndikimin e atyre përsëritjeve të pafundme, mendja iu qetua pak nga pak, efekti shërues, zbutës, me hapa të avashtë, i gjumit...
-Ma do mendja se Ypsilonët nuk e kanë problem përse janë Ypsilonë, tha ajo me zë të lartë.
- Patjetër. E si mund të bëjë vaki diçka e atillë? Ata nuk e dinë se ç'është të jesh ndryshe. Ne po, por ama, edhe ne jemi të kushtëzuar ndryshe. Dhe përveç kësaj, ne nisim me prejardhje të ndryshme.
-Sa mirë që nuk jam Ypsilon, - tha Lenina e bindur. - Edhe po të ishe Ypsilon, - i tha Henri, - kushtëzimi

do të bënte që t'ia dije për faleminderit që nuk ishe Beta apo Alfa.
Ai ndërroi marshin e helikës së përparme dhe u drejtua nga Londra. Pas tyre, në perëndim, e kuqja dhe portokallia ishin gati duke u fshirë; një grup i errët resh qe ngritur në zenit. Nëkohën kur po fluturonin mbi krematorium, avioni shtyu lartnjë shtyllë ajri të ngrohtë që ngrihej nga oxhaqet dhe që ra papritur poshtë, kur trupi i mjetit doli përtej në freski.
- Çfarë mali rus! - qeshi Lenina e kënaqur,
Por toni i Henrit për një moment ra gati-gati në trishtim. -E di se ç'është ai mali rus? - tha ai. - Është qenie njerëzore që, më së fundi, po zhduket për fare. Duke u ngjiturlart si një çurg i ngrohtë gazi. Jam kureshtar të di se kush ish-burrë, grua, Alfa apo Ypsilon... - dhe psherëtiu. Pastaj me njëzë të vendosur e të gëzuar: - Megjithatë, ka një gjë që e dimë me siguri; kushdo që të ketë qenë ai apo ajo, ka qenë i lumtur kur ka qenë gjallë. Sot të gjithë janë të lumtur.
- Po, sot të gjithë janë të lumtur tani, - jehoi zëri i Leninës.
Ata i kishin dëgjuar këto fjalë të përsëritura njëqind e pesëdhjetë herë në natë, për dymbëdhjetë vjet me radhë. Pasi u ulën në tarracën e dyzetkatëshit në Uestminster, ku ndodhej apartamenti i Henrit, zbritën edhe njëherë deri në fund te holli i ngrënies. Atje, në një shoqëri gazmore e të zhurmshme, hëngrën një darkë të mirë. Soma u shërbye bashkë me kafenë. Lenina mori dy tableta gjysmë gramëshe, kurse Henri tri. Në nëntë e njëzet kaluan rrugën dhe hynë në Abacinë Kabareja e Re e Uestminsterit. Ishte një mbrëmje me qiell të mbushur plot re, pa hënë e pa yje.

Por këtë fakt që mund të sillte mërzi, për fat Lenina dhe Henri nuk e vunë re.Reklamat me drita elektrike lart mbi kokat e tyre, me shumë efektivitet, e mbyllnin errësirën me një kufizim plot dritë: "KALVIN STOPES SË BASHKU ME GJASHTËMBËDHJETË SAKSOFONISTET E TIJ." Nga fasada e Abacisë së re, germat gjigante me shkëlqim të ftonin të hyje brenda. "ORGANO E AROMËS DHE NGJYRËS, MË E MIRA NË LONDËR. MUZIKA MË E MIRË SINTETIKE." Ata hynë brenda. Ajri vinte i nxehtë aq sa nuk thithej dot, ngarkuar me aromën qelibarit gri dhe drurit të sandallit. Në kubenë e tavanit të hollit, organoja e ngjyrës kishte pikturuar për këtë rast një perëndim tropikal. Gjashtëmbëdhjetë seksofonistet po luanin një këngë të vjetër shumë të pëlqyer: "Nuk ka Shishe në botë më të dashur se kjo Shishja ime." Katërqind çifte por vallëzonin pesëhapësh mbi dyshemenë e lustruar. Lenina dhe Henri shumë shpejt u bënë çifti katërqind e një. Saksofonët rënkonin si mace melodioze nën dritën e hënës, mjaullitën në regjistra alto dhe tenor, thua se vdekje të vogla po u qëndronin mbi krye. Të pajisur me një larmi të paparë harmonikash, kori drodhi zërin duke e ngritur deri në kulm, fort e më fort - deri sa më në fund, me një lëvizje të dorës dirigjenti e lëshoi notën finale shkatërruese të muzikës eter dhe i shpërtheu gjashtëmbëdhjetë fryrësat e thjeshtë njerëzorë derisa i fiku në fund për fare. Vetëtimë në La maxhor të prerë. Dhe më pas, asgjë veç heshtjes, kudo veç errësirë, vijoi një ulje graduale; një diminuendo që rrëshqiti gradualisht përmes çerektoneve, poshtë e më poshtë, derisa pëshpëriti një akord të zbehtë dominant të zgjatur (ndërsa ritmi pesë të katërtat ende pulsonte ulët), i cili mbushi sekondat e errësirës me një shpresë si ndër ethe. Dhe shpresa e fundit

u plotësua. Pati një lindje të papritur e shpërthyese, të gjashtëmbëdhjetë u lëshuan duke kënduar të gjithë bashkë:

"Shishja ime, vetëm ty përherë të kam dashur! Shishja ime, pse u ndava prej teje?
Qiejt brenda teje janë blu,
Moti është përherë i mirë;
Se,
Nuk ka shishe në botë
Si ti, e dashura shishja ime."

Pesëhapëshi dhe katërqind rrotullime në Abacinë e Uestminsterit, dhe Lenina me Henrin u gjendën në një botë tjetër të ngrohtë, shumëngjyrëshe, pafundësisht miqësore, botën editës së pushimit soma. Sa të sjellshëm, të pashëm, gazmorë e të hirshëm ishin që të gjithë! "Shishja ime, vetëm ty përherë të kam dashur..." por Lenina dhe Henri e kishin atë që donin... ata ishin këtu tani, brenda... brenda e të sigurt në motin më të mirë, qiellin e përjetshëm blu. Dhe pastaj, të kapitur të gjashtëmbëdhjetët i lanë saksofonët, kur aparati i muzikës sintetike po prodhonte shfaqjen më të fundit me Bluz të lehtë maltuzian. Bluz, ata të dy fare mirë mund të ishin embrione binjake që lëkundeshin në valët e oqeanit të surrogatit të gjakut brenda së njëjtës shishe.
"Natën e mirë, miq të dashur! Natën e mirë, miq të dashur!" Altoparlantët e mëdhenj i vishnin urdhrat me mirësjelljen më gjeniale e më muzikale. "Natën e mirë, miq të dashur..."
Të bindur, bashkë me gjithë të tjerët, Lenina dhe Henri lanë pas ndërtesën. Yjet e mërzitshëm kishin bërë goxha

rrugë përmes qiejve. Por, megjithëse ekrani ndarës i tabelës me drita tani deri diku qe shuar, dy të rinjtë përsëri ruajtën me njëri-tjetrin injorancën e lumtur që i takonte kësaj nate.
E gëlltitur gjysmë ore përpara se të mbyllej klubi, doza e dytë e somas kishte ngritur një mur krejt të papërshkrueshëm mes universit aktual dhe mendjes së tyre. Të rregulluar kaluan rrugën; të rregulluar morën ashensorin deri te dhoma e Henrit në katin e njëzet e tetë. E megjithatë, e rregulluar mirë dhe e nxehur me veten për gramin e dytë të somas, Lenina nuk harroi të marrë të gjitha masat kontraceptive të përcaktuara në rregullore. Vite hipnopedie intensive, nga mosha dymbëdhjetë deri shtatëmbëdhjetë, stërvitje maltuziane tri ditë në javë, kishin bërë që ajo t'i merrte masat në mënyrë gati po aq automatike, sa është e pashmangshme të pulisësh qepallat.
"Oh, se m'u kujtua, - i tha ajo kur u doli nga banja, - Fani Kroun do të dijë se ku e ke gjetur gjerdanin e gjelbër të surrogatit maroken, që më dhurove mua."

PJESA 2

Një herë në dy javë, të enjten, Bernardi kishte ditën e Shërbimit të Solidaritetit. Pas një darke të shpejtë te Afroditeu mi (aty ku Helmholci qe zgjedhur së fundmi nën Rregullin numër Dy), ai e la vetëm mikun dhe u ngjit në tarracë, ku mori një taksi; i tha burrit të fluturonte shpejt drejt Komunitetit Këngëtar të Forsobit. Mjeti u ngjit nja dyqind metra lartësi, pastaj ngau nga lindja dhe sapo u kthye, para syve të Bernardit, gjigante dhe e mrekullueshme, u shfaq Këngëtorja. E përmbytur nga

dritat, treqind e njëzet metrat e gurit të bardhë të Karrares reflektonin inkandeshentë si dëbora mbi kodrat Ladgejt; në secilën prej katër qosheve me platforma për helikopterët, përballë natës, shkëlqenin lehtë T-të e mëdha; aty, prej gojëve të njëzet e katër trumbetave të gjera prej ari, gjëmonte një muzikë sintetike solemne.
"Ta hajë dreqi, sa vonë jam," - tha me vete Bernardi sapo i kapi syri njërin cep të Henrit të Madh, sahatit te Këngëtorja. Dhe tamam ashtu, kur ai po paguante taksistin, sahati gjëmoi. "Ford, - kënduan me një zë bas tronditës të Ford, Ford, Ford..." - nëntë herë. gjitha trumbetat e arta. Bernardi ia dha vrapit të kapë ashensorin.
Auditori i madh për ditët përkujtimore të Fordit dhe Këndimet e tjera masive të Komunitetit ishte në fund të ndërtesës. Përmbi të, njëqind për çdo kat, ngriheshin shtatë mijë dhomat që përdornin Grupet e Solidaritetit për netët e shërbimit një herë në dy javë. Bernardi zbriti poshtë në katin njëzet e tre, nxitoi nëpër korridor, ngurroi për një çast jashtë dhomës 3210, pastaj, mori frymë thellë, mblodhi veten, hapi portën dhe u fut brenda.
Falë Fordit, ai nuk ishte i fundit. Tri karrige nga dymbëdhjetë që rrethonin tavolinën e rrumbullakët ishin bosh. U ul si pa rënë në sy në atë karrige që kish më pranë dhe u bëgati që t'i ngryste vetullat atyre që do të vinin me vonesë. "Çfarë po luanit sot pasdite? - i tha një vajzë që sapo iu afrua. - Pengesat apo Elektromagnetiken?"
Bernardi e pa. (Oh, Ford! Ishte Morgana Rotshildi) I skuqur i tha se nuk ka qenë duke luajtur asnjërën prej tyre. Morgana pa e habitur. Ra një heshtje e sikletshme.
Më pas, gjithë mirëkuptim, ajo u largua duke iu

përkushtuar një tipi më sportiv, i cili ishte në të majtë. "Një nisje e mbarë për Shërbimin e Solidaritetit," - mendoi Bernardi i bërë pleh dhe i parashikoi vetes një tjetër dështim në shëlbim. Sikur t'i kishte dhënë vetes pak më shumë kohë të shihte njëherë përreth, në vend që të vërsulej për të kapur karrigen e parë që i doli përpara! Mund të ishte ulur me Fifi Mburravecen, ose me Xhoana Dizelin! Por jo, shkoi u ul ngjitur me Morganen! Morganen! Oh, Ford! Ajo dhe vetullat e zeza - vetullat, më saktë ato gjërat që i puqeshin mbi hundë. Oh Ford! Dhe në të djathtë ishte Klara Frena. Vetë ajo, me vetullat që nuk i puqeshin. Vetëm se ajo ishte vërtet tepër fare pneumatike. Ndërsa Fifi dhe Joana ishin plotësisht në rregull. Të kolme, bionde, jo shumë të hapura... por ja ishte ai gdhëja, Tom Kavaguçi që e zuri karrigen midis tyre.
I fundit që mbërriti ishte Sarojini Engels.
"A nuk je pak vonë? - i tha presidenti i grupit me shumë qetësi. Kujdes, mos të ndodhë më." Sarojini kërkoi falje dhe zuri vendin e saj, mes Xhim Bokanovskit dhe Herbert Bakuninit. Grupi kështu u plotësua dhe qarku i solidaritetit u përkrye, e tashmë nuk kishte asnjë të metë. Burrë, grua, burrë, një unazë e pafund alternimesh në tavolinën e rrumbullakët. Të dymbëdhjetë të gatshëm për t'u bërë një, mezi prisnin të bashkoheshin, të shkrinin, të tresnin dymbëdhjetë identitetet e tyre brenda një qenieje më të madhe.
Presidenti u ngrit në këmbë, bëri një shenjë T, lëshoi muzikë sintetike, la të lira rrahjet e buta e të palodhura të daulleve dhe një kor instrumentesh - si-era dhe super- telat që tërë kumbim përsëritnin e përsëritnin melodinë

e shkurtër dhe prej së cilës nuk shpëtoje dot, të Himnit të Parë të Solidaritetit. Përsëri e përsëri - dhe nuk ishte veshi që e dëgjonte ritmin pulsues, qe barku; kuja dhe tingëllimat e harmonisë që vazhdonte, bezdisnin jo mendjen, por zorrët e përvëluara të mëshirës.
Presidenti bëri një tjetër shenjë T dhe u ul. Shërbesa kishte nisur. Tabletat e caktuara të somas ishin vendosur në qendër të tavolinës. Tasi me akulloren e mirë soma me shije luleshtrydhesh kaloi dorë më dorë bashkë me formulën "unë pi për asgjësimin tim", u kthye në dolli plot dymbëdhjetë herë. Pastaj, për të shoqëruar orkestrën sintetike, Himni i Parë i Solidaritetit u këndua edhe me zë.

"Ford, dymbëdhjetë jemi; oh, bëna një,
Si pikla brenda Lumit Shoqëror;
Oh, na bëj përpara të shkojmë,
Aq shpejt sa Fliveri yt diellor."

Dymbëdhjetë strofa të zjarrta. Dhe pastaj tasi i dashur u kalua edhe një herë tjetër dora-dorës. "Ngre dolli për Qenien më të Lartë," ishte formula këtë radhë. Dhe të gjithë pinë. Muzika vazhdonte e palodhur. Daullet ranë. E qara dhe përplasjet e harmonisë ishin obsesion për zorrët e tretura. U këndua Kënga e Dytë e Solidaritetit.

"Eja, O Qenie më e Lartë, Mik Shoqëror
,Asgjësohemi dymbëdhjetë në një!
Mezi presim të vdesim,
se kur marrim fund Jeta jonë sapo ka nisur."

Edhe dymbëdhjetë stofa. Ndërkohë soma kish nisur t'u bëjë efekt. Sytë ndrisnin, faqet u përskuqën, drita e brendshme e bujarisë universale shpërtheu me lumturi në çdo fytyrë përmes buzëqeshjesh miqësore. Edhe Bernardi vetë e ndjeu veten pak si të tretur. Kur Morgana Rotshildi iu drejtua me një buzëqeshje, ai bëri të gjitha përpjekjet që t'ia kthente. Por vetullat, ajo gjëja dy në një për fat të keq, ishte prapë aty përmbi buzëqeshjen e saj; nuk e shpërfillte dot, nuk mundej sado që u përpoq. Tretja nuk i kishte përparuar shumë. Ndoshta do të kishte përparuar më tepër sikur të ishte ulur mes Fifit dhe Xhoanës... për herë të tretë kupa e dashurisë kaloi edhe një herë përreth. "Ngre dolli për afrimin e Ardhjes së Tij," - tha Morgana Rotshildi, së cilës i ra radha të nisë ciklin rrethor. Zëri i saj ishte i lartë, i mbushur me gëzim. Ajo piu dhe ia kaloi kupën Bernardit. "Unë pi për të afruar Ardhjen e Tij," përsëriti ai me një përpjekje të sinqertë që ta ndiente se Ardhja ishte e pashmangshme; por vetulla vazhdonte t'ia shpifte. Dhe Ardhja, për aq sa i takonte atij, ishte tmerrësisht e largët. Piu dhe ia dorëzoi kupën Klara Frenës. "Edhe një dështim tjetër, tha me vete. - E di mirë, ashtu ka për të qenë." Sidoqoftë u përpoq për ta ruajtur buzëqeshjen.
Kupa e dashurisë e kreu rrotullimin. Duke ngritur dorën lart, presidenti dha sinjalin; kori ia plasi Himnit të Tretë të Solidaritetit.

"Po vjen Qenia më e Lartë, e di!
Gëzohu, e në gëzime vdis!
Tretu me muzikën e daulleve!
Se ti jam unë e unë je ti!"

Ndërsa vargu ia linte vendin vargut, zërat u pushtuan nga një gëzim akoma edhe më i madh. Kjo ndjesi e Ardhjes së pashmangshme ishte si një tension elektrik që u rrinte pezull mbi koka. Presidenti e ndërpreu muzikën me notën finale të strofës përfundimtare, pastaj ra heshtje absolute - heshtja e shtrirjes së pritshmërisë, që dridhej e zvarritej me jetë të mbinatyrshme. Presidenti zgjati dorën; dhe befas një zë, një zë i thellë e i fortë, shumë më muzikor se çdo zë i thjeshtë njerëzor, më i pasur, i ngrohtë, më kumbues, me dashuri të zjarrtë e dhembshuri, i mrekullueshëm, misterioz, një zë i mbinatyrshëm foli prej së larti mbi kryet e tyre. Shumë ngadalë "Oh, Ford, Ford, Ford," - u foli me përulje dhe me një zë në zbritje. Ndjesia e ngrohtësisë rrezatoi tronditëse jashtë, që nga pleksusi diellor deri në skajet më të fundit të trupave të atyre që e dëgjuan; lotët ia mbushën sytë e zemrat, zorrët ngjanin sikur po u lëviznin përbrenda, thua se kishin aty një jetë të pavarur. "Ford! - po treteshin, - Ford!" - kulluan e kulluan. Pastaj në një ton tjetër, befas, papandehur: "Dëgjoni!" trumbetoi zëri. Ata e dëgjuan. Pas një pauze, zhytur në një pëshpërimë, por një pëshpërimë më penetruese se një kujë. "Këmbët e Krijesës më të Lartë." Pëshpërima gati u shua. "Këmbët e Krijesës më të Lartë janë aty te shkallët." Edhe një herë tjetër ra heshtje; dhe pritja, e qetësuar për një çast, u tendos sërish, u bë e nderë, e nderë deri në përlotje. Këmbët e Krijesës më të Lartë - oh, po, ata po i dëgjonin, po i dëgjonin, lehtë duke zbritur shkallët; duke ardhur përherë e më pranë shkallëve të padukshme. Këmbët e Krijesës më të Lartë. Dhe papandehur kulmii përlotjes erdhi. Me sytë e ngrirë, buzët e hapura, Morgana Rotshildi brofi në këmbë.

- E dëgjoj,- qau ajo.
- E dëgjoj, - klithi Sarojin Engels.
- Po, ai po vjen, e dëgjoj. - Fifi Mburravecja dhe Tom Kavaguçi u ngritën njëherësh në këmbë.
Oh, oh, oh! - dëshmoi ardhjen e tij Xhoana krejt e shushatur.
- Ai po vjen! - bërtiti Xhim Bokanovski.
Presidenti u përkul përpara dhe me një të prekur, çliroi gjithë instrumentet dhe veglat frymore të tunxhit në delir, një
ethe ritmike.
Oh, ai po vjen! - klithi Klara Frena. - Auu! - dhe u duk sikur po e thernin në fyt.
Kur ndjeu se erdhi çasti që edhe ai duhej të bënte diçka, Bernardi njëlloj kërceu përpjetë dhe thirri: - "E ndiej, ai po vjen." Por nuk ishte e vërtetë. Ai nuk kish ndier asgjë e, për të askush nuk po vinte. Askush... me gjithë muzikën, me gjithë eksitimin e ngrehur përpjetë. Por edhe ai lëkundi duart, bërtiti bashkë si gjithë të tjerët; dhe kur ata, të tjerët, nisën të hidhen e përdridhen dhe të përplasin këmbët, edhe ai u hodh e u përdrodh njëlloj.
Procesioni i valltarëve u soll rrotull, çdonjëri me duart në belin e valltarit që kishte përpara, rrotull e rrotull, bërtisnin njëzëri, rrihnin këmbët sipas ritmit të muzikës; rrihnin me shuplaka mollaqet që prinin vallëzimin; dymbëdhjetë palë duar që rrihnin si një e vetme; si një e vetme, dymbëdhjetë mollaqe oshtinë nga shuplakat. Dymbëdhjetë si një, dymbëdhjetë si një. "I dëgjoj hapat, e dëgjoj, ai po vjen." Muzika u përshpejtua; më shpejt e më shpejt, edhe më shpejt rrihnin duart sipas ritmit. Dhe pastaj në një bas të madh sintetik buçitën fjalët që lajmëronin, shëlbimi po

afronte, me të edhe konsumimit final i solidaritetit, bërja një e Dymbëdhjetëshes, mishërim i Krijesës më të Lartë. "Orgji-derri," - këndohej ndërsa pam-pamet vazhduan të trokëllijnë si ndër ethe... :

Orgji-derri, Ford e qejf.
Puthi vajzat beja një
, Djem e vajza rrinë në paqe,
Orgji-derri na kënaqe.

"Orgji-derri," valltarët ia morën refrenit liturgjik. "Orgji- derri! Ford e qejf, puthi vajzat..." dhe ndërsa këndonin, dritat me ngadalë nisën të zbehen - të zbehen, e njëherësh të bëhen më të ngrohta, më të pasura, më të kuqëluara, derisa më në fund ata po vallëzonin brenda muzgut të përskuqur të një Magazine Embrionesh. "Orgji-derri..." Në errësirën fatale të gjakngjyrosurve, vallëzuesit vazhduan edhe më, ndoqën e ndoqën të palodhshmin ritëm. "Orgji- derri..." lëkundej, ndahej, binte në shthurje të pjesshme në rrotullamet e kolltukëve, rreth e qark i mbyllur në harqe - tavolina dhe karrige planetare. "Orgji-derri..." Zëri i thellë me butësi gugati; mes mugut bojë alle u duk sikur ndonjë zezak i madh u hodh zhyt mes tufës së vallëzuesve të lodhur.
Ata po rrinin në tarracë; Henri i Madh sapo lajmëroi orën njëmbëdhjetë. Nata ishte e qetë dhe e ngrohtë.
- A nuk ishte mrekullia vetë? - tha Fifi Mburravecja. - A nuk ishte thjesht mrekullia vetë? - ajo pa nga Bernardi me shprehinë e dalldisë, dalldi brenda së cilës nuk kish asnjë shenjë shqetësimi a eksitimi - ngase të jesh i eksituar do të

thotë të jesh i pakënaqur. E saja ishte ekstazë e ngopjes së plotë, jo thjesht një paqe të ngimjes dhe kotësisë, por e jetës së ekuilibruar, të energjisë në prehje e në ekuilibër. Një paqe e pasur dhe e gjallë. Ngase Shërbimi Solidar kishte dhënë, por edhe kishte marrë, kishte zbrazur, por për të rimbushur sërish. Ajo ndihej e plotësuar, e përkryer, ishte prapëseprapë më tepër se thjesht vetvetja. - A nuk ishte thjesht mrekullia vetë? - këmbënguli ajo duke parë fytyrën e Bernardit, me ata sytë e saj të mbinatyrshëm që shkëlqenin.
Po, m'u duk një mrekulli, - e gënjeu ai dhe pa diku larg; pamja e fytyrës së saj të shfytyruar ishte njëherësh akuzë dhe kujtesë ironike e veçantisë së tij. Ai tani ishte po aq i izoluar sa kur nisi shërbimin edhe më i izoluar mendërisht për shkak të zbrazëtisë shpirtërore dhe ngimjes së vdekur. I veçuar dhe i pashëlbyer, në kohën kur të tjerët po shkriheshin me Qenien e Lartë; fillikat edhe në përqafimin e Morganës - edhe më i vetmuar, pa dyshim, edhe më dëshpërimisht vetvetja, se kurrë më parë në jetën e tij. Kishte dalë prej atij muzgu bojë alle dhe kish hyrë brenda një shkëlqimi verbues elektrik, me ndërgjegje deri në cak të agonisë. Ishte përfundimisht një mjeran, e ndoshta (sytë e saj shkëlqyes e akuzonin), ndoshta gjithë fajin e kishte ai vetë. - Mrekullia vetë, përsëriti ai; por e vetmja gjë që i binte ndërmend ishin vetullat e Morganës.

KAPITULLI VI

PJESA I

Allasoj, allasoj, allasoj ishte gjykimi i Leninës për Bernard Marksin. Kaq allasoj, në fakt, sa gjatë javëve që rrodhën më pas, ajo pyeti veten më shumë se një herë, në duhej të ndërronte mendje për pushimet në Nju Meksiko e të shkonte më mirë në Polin e Veriut me Benito Huverin. Problemi ishte se ajo e kishte parë polin e Veriut, kishte qenë atje me Xhorxh Edzelin verën e shkuar dhe për më tepër i qe dukur një vend shumë i zymtë. S'kishe ç'bëje, dhe hoteli dëshpërimisht i dalë mode, pa televizor në dhomën gjumit, pa organo aromash, me muzikën sintetike më kot dhe jo më tepër se njëzet e pesë fusha loje të mbyllura për më shumë se dyqind mysafirë. Jo, e ndau mendjen njëherë e mirë, nuk e shihte dot me sy përsëdyti Polin e Veriut. Përveç kësaj, në Amerikë kish qenë vetëm një herë në jetë. Po edhe atëherë, sa e patakt! Një fundjavë ekonomike në Nju Jork - kishte qenë me Zhan-Zhak Habibullahun, apo me Xhon Bokanovskin? S'i vinte në hatër. Gjithsesi, nuk kish absolutisht pikë rëndësie. Shpresa se do të fluturonte prapë në perëndim, për të qëndruar plot një javë për më

tepër, ishte fort tërheqëse. Mbi të gjitha, do të rrinin tre ditë në Rezervatete Egërsirave. Jo më tepër se gjashtë persona në gjithë Qendrën e kishin vizituar Rezervatin e Egërsirave. Si psikolog Alfa-Plus, Bernardi ishte nga të paktët të njohur të saj që kishte leje për të hyrë aty. Për Leninën, ky ishte një rast i rrallë. Por, i tillë ishte edhe allasojllëku i Bernardit, saqë ajo ishte e ndërdyshur, kishte menduar, madje të rrezikonte prapë Polin me shakaxhiun babaxhan Benito. Kurse Bernardi...

- Alkooli në surrogatin e gjakut, ky ishte shpjegimi që i jepte Fani për sjelljen e tij të çuditshme. Kurse Henri, me të cilin njëherë kur ishin bashkë në shtrat dhe Lenina kish biseduar me ankth për të dashurin e saj të ri, Bernardin, ai e kishte krahasuar këtë të gjorin me një rinoqeront.

- Nuk u mësohen marifete rinoqerontëve, i kishte dhënë ai një shpjegim të shkurtër e të vrullshëm. - Disa burra janë gati-gati rinoqerontë; nuk u përshtaten tamam kushteve natyrore. Të shkretët! Bernardi është një syresh. Fati i tij që është i zoti në punën që bën. Përndryshe drejtorët nuk do ta kishin mbajtur kurrë në atë vend. Megjithatë, - kishte shtuar ai i bindur plotësisht, - mua më duket krejt i padëmshëm. Krejt i padëmshëm, ndoshta, por edhe po aq shqetësues. Kjo mania, njëherë, që ka për të bërë gjërat fshehur. Kjo në praktikë do thotë të mos bësh asgjë hiç. Se çfarë mundet robi të bëjë fshehurazi xhanëm. (Përjashto këtu, patjetër, kur biem në shtrat; veç njeriu nuk ka si të bëjë gjithë kohës vetëm këtë gjë.) Po pra, çfarë? Asgjë hiç. Pasditen e parë që kishin dalë bashkë kish qenë veçanërisht në rregull. Lenina kishte hedhur propozimin të bënin not te Klubi Torkuej jashtë qytetit dhe më pas ta vazhdonin me një darkë në Oksford Union. Por Bernardi mendoi se ai vend mund të ishte shumë i populluar.

Atëherë për një lojë Golfi-elektromagnetik në Shën Andre? Prapë jo: Golfin-elektromagnetik Bernardi e konsideronte
humbje kohe.
-Atëherë për çfarë kemi kohë? - e kishte pyetur Lenina
disi e çuditur.
Siç dukej, për shëtitje në Zonën e Lumit; ngase ai pikërisht këtë kishte propozuar. Të uleshin në majë të Skidauit dhe të ecnin nja dy orë mes shqopave.
Vetëm ne të dy, Lenina.
Bernard, po ne do të jemi vetëm gjithë natën. Bernardi qe skuqur dhe kishte hedhur sytë tutje. - Desha të them vetëm për të folur, - kishte mërmëritur ai. -Për të folur? Për çfarë? - Të ecim, të flasim, kjo dukej një mënyrë shumë e çuditshme për të kaluar pasditen.
Më në fund ajo e kishte bindur, krejtësisht kundër dëshirë së tij, që të fluturonin deri në Amsterdam për të parë gjysmë- çerek-Finalet e Kampionatit të Mundjes për Femra, Peshat e Rënda.
-Në mes të turmës? - ishte ankuar ai, - si zakonisht. Ai qëndroi gjithë turinj tërë pasditen; nuk foli një fjalë me miqtë e Leninës, (dhe ata kishin takuar dhjetra miq te bar-akullore soma mes platformave të mundjes); dhe megjithëse ishte i mërzitur, ai absolutisht refuzoi të merrte gjysmë grami soma, me shije mjedre, që ajo desh t'ia japë mezor.- Më mirë të jem vetvetja, - i thoshte. - I shpifur, kështu si jam, vetvetja. Askush tjetër, sado qejf të jetë.
-Një gram një herë të ruan nga nëntë, i tha Lenina, duke nxjerrë në pah thesarin e dijes së marrë në gjumë. Bernardi ia kishte shtyrë tutje me padurim gotën prej xhami të pathyeshëm.

- Mos e prish qejfin, - i tha ajo. - Mbaje mend, nje
centimeter kub shëron dhjetë ndjenja të trishta.
- Oh, për hir të Fordit, qepe! - bërtiti ai,
Lenina mblodhi supet.
- Një gram është përherë më i mirë se një mallkim, -i dha fund ajo gjithë dinjitet dhe e piu vetë soman me shije mjedre.
Rrugës së kthimit, kur po kalonin Kanalin, Bernardi këmbënguli të shuanin shtytësin, dhe të rrinin pezull tridhjete metra mbi dallgë duke përdorur vetëm helikën e helikopterit. Moti ishte përkeqësuar, era nga jugperëndimi frynte fort, qielli
ishte me re.
- Shiko!- urdhëroi ai.
- Kjo është e tmerrshme, - tha Lenina duke u tërhequr sa më larg nga dritarja. Ajo u tmerrua nga boshllëku i tërbuar i asaj nate, prej shkumës mbi tallazet e ujit të zi poshtë tyre, nga faqja e zbehtë e hënës, sa e drobitur, aq edhe kërcënuese, lart mes reve që nguteshin. - Ndezim radion. Shpejt! - Ajo u zgjat, preku butonin e kanaleve dhe e ktheu kuturu. "... brenda teje, qiejt janë blu, kënduan gjashtëmbëdhjetë zëra drithërues me falceto, moti gjithmonë..."
Pastaj një lemzë dhe heshtja. Bernardi shoi radion. - Dua të shoh detin në paqe, - tha ai. - Njeriu as nuk sheh dot me këtë katrahurë zhurmash...
- Po kjo është e bukur. Dhe unë nuk dua të shoh. - Po dua unë, nguli këmbë ai. - Më bën të ndihem sikur... ngurroi pak duke kërkuar fjalët e duhura, që të shpjegohej sa më mirë, jam më shumë vetvetja, më tepër unë, nëse e kupton ku dua të dal. Më tepër vetja ime, unë, jo kaq tërësisht pjesë e një gjëje tjetër. Jo veç një qelizë në trupin

shoqëror. A nuk të bën edhe ty të ndihesh kështu, Lenina? Por Lenina po qante.
-E tmerrshme, e tmerrshme, - përsëriste pareshtur ajo. -Dhe si mund të flasësh kështu, nuk dëshiron të jesh pjesë e trupit shoqëror? Fundja, gjithkush punon për gjithkënd. Nuk heqim dot asnjeri. Madje as Ypsilonët...
-Po, e di,- i tha Bernardi me ngërdheshje. - Edhe Ypsilonët janë të dobishëm! Edhe unë. Por për dreq do doja kaq
shumë të mos isha!
Lenina u trondit nga blasfemia e tij.
- Bernard! protestoi ajo me një zë që shprehte ankthin mëtë thellë. Si ta nxori goja!
- Si ma nxori? - përsëriti ai fjalët mendueshëm, me një
ton krejt tjetër. Jo, problemi i vërtetë qëndron se: Si ka mundësi që nuk kam mundësi, apo më mirë- se në fund të fundit, e di fare mirë përse nuk kam mundësi - si do të ishte sikur të kisha mundësi, sikur të isha i lirë - jo i skllavëruar nga kushtëzimi.
Bernard, po nxjerr nga goja gjërat më të tmerrshme. - Nuk do doje ti të ishe e lirë, Lenina?
Nuk e kuptoj ç'do të thuash. Unë e lirë jam. E lirë të kënaqem për mrekulli. Të gjithë sot janë të lumtur.
-Po të gjithë sot janë të lumtur, -qeshi ai. - Ne nisim t'ua japim këtë fëmijëve që pesë vjeç. Po a nuk do doje të ishe e lirë dhe e lumtur në një mënyrë krejt tjetër, Lenina? Në mënyrën tënde, për shembull, jo në mënyrën e gjithë të tjerëve.
-Nuk e di se çfarë do të thuash me këtë, - i tha ajo përsëri. Pastaj u kthye nga ai. - Oh, ikim, kthehemi, Bernard, - tha me të lutur. - E urrej kaq shumë këtë vend.
- Nuk të pëlqen të rrish me mua?

- Po, sigurisht, Bernard! Por ky vend është i tmerrshëm. - Unë kujtova se ne këtu do ishim më... më bashkë- vetëm me detin, hënën dhe asgjë tjetër. Bashkë më tepër se mes shoqërisë, më tepër edhe se në dhomat e mia. Po këtë
e kupton?
- Nuk po kuptoj asgjë, - i tha ajo prerë, e vendosur të ruajë të paprekur gjendjen e moskuptimit. - Asgjë. Të paktën, vijoi me një ton tjetër, - merr ca soma kur ke këto ide të llahtarshme. I harron të gjitha. Dhe në vend që të ndihesh i mjerë, do të ndihesh i gëzuar. Aq i gëzuar, - përsëriti fjalët dhe i buzëqeshi, me gjithë dyshimet dhe ankthin e mbledhur në sytë e saj, me çka donte të ish një miklim ftues dhe epshndjellës.
Ai e pa i heshtur, fytyra e tij që nuk reagonte dhe nxintesi varr; e vështroi me vëmendje. Pas disa sekondash sytë e Leninës u zmbrapsën tutje; ajo lëshoi një të qeshur të vogël, u përpoq të mendojë diçka për të thënë, por s'mundi. Heshtja zgjati vetvetiu.
Kur më në fund Bernardi foli, me një zë të ulët e të lodhur: - Mirë pra, - tha ai, - kthehemi.
Dhe duke e ngjeshur këmbën te pedali i gazit e ngjiti mjetin si raketë lart drejt qiellit. Në kuotën një mijë e dyqind metra e ndezi shtytësin. Fluturuan në heshtje për një minutë a dy Pastaj, papritur, Bernardi nisi të qeshë. Epo pak si allasoj, mendoi Lenina; por prapëseprapë e qeshur quhej.
- Ndihesh më mirë? - guxoi të pyeste ajo. Si përgjigje, ai e hoqi njërën dorë nga kontrollet, i hodhi dorën në qafë dhe nisi t'i fërkojë asaj gjinjtë.
- Fordit i qofshim falë, - tha ajo pa zë, - erdhi prapë në
vete.

Gjysmë ore më pas u kthyen në dhomat e tij. Bernardi kapërdiu katër tableta soma njëherësh, ndezi radion dhe televizorin e nisi të zhvishet.
- E, pra, - pyeti Lenina me qesëndi të nesërmen pasdite kur u takuan në tarracë - t'u duk se bëmë qejf dje? Bernardi pohoi me kokë. U ngjitën në avion. Pak shkundje, dhe u ngjitën lart.
Që të gjithë më thonë se jam llahtar e kolme, - tha Lenina duke rrahur pa mendje shalët.
- Llahtar, por sytë e Bernardit shprehën dhimbje. "Si mish" mendoi me vete.
Ajo ngriti kokën lart ta shohë në sy me një lloj shqetësimi. - Ty nuk të dukem tepër e kolme, apo jo?
Ai tundi kokën për të thënë jo. Si mish. Mish sa të duash. - Të dukem llokmë e mirë... - Një po tjetër. - Me të gjitha?
- E përkryer, tha ai me zë. Kurse pa zë: "Ajo kështu e di veten. Nuk i bën përshtypje të jetë thjesht një llokmë mishi." Lenina buzëqeshi e çliruar. Por kënaqësia ishte e parakohshme.
-Megjithatë, vazhdoi ai pas njëfarë pauze, - prapëseprapë, unë do doja ta kishim kaluar ndryshe.
- Ndryshe? Përse, si mund ta kalonim ndryshe?
- Nuk doja të mbyllej kaq thjesht dhe t'ia rrasnim drejt
e në krevat, saktësoi ai.
Lenina ngriu.
-Jo me të parën, jo krevat me takim të parë...
- Po atëherë, çfarë...?
Ai nisi të thotë shumë gjëra pakuptim dhe të rrezikshme. Lenina bëri sa mundi të ndajë veç veshët nga mendja; por hera-

herës ndonjë frazë këmbëngulte dhe bëhej e dëgjueshme."... për të provuar efektin e ndalimit të impulseve," e dëgjoi ajo të thotë. Fjalët e tij sikur prekën një skutë thellë në mendjen e saj. Qejfin e sotëm mos e lër për nesër, i tha ajo me kokëfortësi.
Dyqind përsëritje, dy herë në javë nga ora dy deri në katëre gjysmë, - ky qe komenti i tij. Dokrrat e çmendurisë nuk i pushonin. - Dua të di ç'është pasioni, - e dëgjoi ajo të nxirrte nga goja. - Dua ta ndiej fort një gjë.
- Kur individi ndien, komuniteti shkundet, - deklaroi Lenina.
- Po mirë, pse të mos shkundet pak?
- Bernard?
Por Bernardi qëndroi i patundur.
- Të rriturit intelektualisht gjatë orëve të punës, - vijoi
ai. Foshnjat ndiejnë nevojën për ndjenja dhe dëshira.
- Fordi ynë i ka dashur foshnjat.
Duke mos ia vënë re ndërprerjen, Benardi vazhdoi:
- Kur, papritur, një ditë më ra ndër mend se është e mundur të sillesh përherë si i rritur.
- Nuk e kuptoj. -Toni i Leninës ishte i vendosur.
E di. Prandaj edhe përfunduam në shtrat që atë natë,
si kalamaj, në vend që të silleshim si të rriturit, të prisnim çastin e duhur.
- Por bëmë qejf, - këmbënguli Lenina. - Apo jo?
- Oho, qejf i paparë, u përgjigj ai, por me një zë aq
të përzishëm, me një shprehje aq të mjerë, sa çlirimi që po ndiente Lenina papritur i avulloi. Ndoshta, atij i qe dukur tepër e kolme, vetëm kaq.

Te kam thënë, -i tha Fani kur Lenina erdhi dhe i hapi zemrën. Fajin e ka alkooli që i hodhën në surrogatin e
gjakut.
- E prapë, kishte këmbëngulur Lenina, - njëlloj më pëlqen. Ka duar kaq të bukura. Dhe mënyra si i lëviz shpatullat - shumë tërheqëse... - Më pas psherëtiu. - Ama do doja të mos ishte kaq allasoj.'

PJESA 2

Kur ndali një çast para portës së dhomës së drejtorit, Bernardi mori frymë thellë dhe shkundi shpatullat që të përgatiste veten për përballjen me mospëlqimin dhe mospranimin, ishte krejt i bindur se do t'i gjente brenda. Trokiti dhe hyri. - Drejtor, kam një leje këtu ku duhej që ju të vinit inicialet, tha ai aq serbes sa mundi dhe e la letrën mbi skrivani.
Drejtori i hodhi një vështrim të thartë. Vula e Zyrës së Kontrolluesve të Botës qe në krye të faqes dhe firma e Mustafa Mondit, e plotë, e zezë, në fund të faqes. Çdo gjë e rregullt. Drejtorit nuk i mbeti gjë në dorë veçse t'i shënonte inicialet me laps - dy germa të zbehta e të ndyra përfund emrit Mustafa Mondi - dhe u bë gati t'i kthente letrën mbrapsht pa fjalë, pa hedhur kurrfarë përkufizimesh gjeniale Fordiane, teksa sytë i zunë diçka të shkruar diku nga mesi i lejedaljes.
-Për te Rezervatet e reja meksikane? - tha dhe toni i zërit
e fytyra që ngriti drejt Bernardit shprehën njëfarë trullosjeje tronditëse.

I habitur prej habisë së tjetrit, Bernardi pohoi me kokë. Ra heshtja.
Drejtori u mbështet pas në karrige, vetullngrysur. - Para sa kohësh ka ndodhur...? - tha ai, më tepër sikur po fliste me vete sesa me Bernardin. - Njëzet vjet, më duket... Diku aty te njëzet e pesë... Duhet të kem qenë në moshën tënde... - tundi kokën dhe psherëtiu.
Bernardi u ndie jashtëzakonisht në siklet. Një burrë si drejtori, aq me etiketë, aq i rregullt e i përpiktë, të kryente një tejkalim kaq të rëndë! Me kaq atij i erdhi të fshihte fytyrën, të dilte me vrap nga dhoma. Jo se ai vetë e shihte si të dënueshme kur njerëzit flisnin për të kaluarën e largët, por kjo ishte një prej atyre paragjykimeve hipnopedike, të cilat ai (kujtonte se) i kishte fshirë krejt nga mendja. Ajo që e bëri me turp ishte se kështu e dinte që drejtorit nuk i aprovonte - nuk e aprovonte e megjithatë e tradhtoi veten duke bërë një gjë të ndaluar. Nën ndikimin e cilës shtysë të brendshme? Por me gjithë sikletin, Bernardi e dëgjoi me veshët pipëz.
Kam pasur të njëjtin mendim me ty, - tha drejtori. - Doja të shikoja me sytë e mi njerëzit e egër. Mora një leje për në Nju Meksiko dhe shkova atje për pushimet e verës. Me një vajzë me të cilën e bëja ato kohë. Ajo ishte Beta-Minus dhe më duket se... - (mbylli sytë) - më duket se flokët i kish të verdha. Sidoqoftë, ishte pneumatike, veçanërisht pneumatike; kjo më kujtohet fare mirë. E pra, shkuam atje dhe i pamë egërsirat, kalëruam e bëmë plot gjëra të tjera. Dhe pastaj - ishte dita e fundit para se të iknim - dhe ajo... humbi. Po kalëronim në njërin prej atyre maleve që ngjiten përpjetë dhe, për tmerr, ishte një i nxehtë i shpifur. Pasi hëngrëm drekën u shtrimë për të fjetur. Ose

më saktë, unë fjeta. Ajo duhet të ketë dalë e vetme për të shëtitur. Me pak fjalë, kur u zgjova unë, ajo nuk ishte aty. Stuhia më e frikshme që kisha parë ndonjëherë, edhe pak dhe do të shpërthente... Dhe e shkundi, bubulliu e vetëtiu; kuajt u trembën dhe ikën turravrap; edhe unë u rrëzova kur u përpoqa t'i kap e vrava gjurin, kështu mezi ecja. E megjithatë e kërkova, bërtita. Vazhdova sërish të kërkoja. Po nuk dukej gjëkundi. Pastaj mendova se mos ishte kthyer vetë në shtëpinë e pushimit. Kështu u hoqa zvarrë poshtë nëpër luginë, andej nga kishim ardhur. Gjuri më dhembte llahtar, prandaj e humba toruan se më kishte humbur dhe soma. M'u deshën orë të tëra. Nuk arrita dot në shtëpinë e pushimit veç pas mesnate. Dhe ajo nuk ishte aty; nuk ishte aty, - përsëriti drejtori. Ra heshtja. - E pra, - u kthye aty ku e kishte lënë fjalën, – ditën tjetër e kërkuam sërish, por nuk e gjetëm. Ndoshta është rrëzuar në ndonjë hon; ose e kanë ngrënë luanët e malit. Fordi e di. Gjithsesi, një tmerr. Më kishte mërzitur shumë ato kohë. Shumë më tepër nga ç'duhej, e them këtë me plot gojën. Sepse, në fund të fundit, është një lloj aksidenti që mund t'i ndodhë kujtdo; dhe sigurisht, trupi shoqëror vazhdon edhe pse përbërja e qelizave mund të ndryshojë. Por ky ngushëllim i mësuar në gjumë, siç duket, nuk e kishte efektin e pritur. - Duke tundur kokën, ai i tha: - Ndonjëherë më del në ëndërr, - dhe zëri iu mbyt. - Shoh në ëndërr sikur zgjohem nga gjëmimi i një bubullime dhe shoh se ajo ka ikur; ëndërroj sikur po e kërkoj poshtë pemëve, - tha ai dhe u përhumb në heshtje mes kujtimesh.
- Duhet të kesh kaluar një shok të tmerrshëm, - tha Bernardi gati me zili.

Prej mënyrës si erdhi zëri i tjetrit, drejtori e gjeti veten në faj kur kuptoi se ku gjendej; i hodhi një vështrim të shpejtë Bernardit dhe pasi e kuptoi nga sytë, u skuq e u bë flakë; pa nga ai me dyshim dhe, i prekur në dinjitetin e vet, i tha: - Mos të të shkojë ndër mend se kam pasur ndonjë marrëdhënie të pahijshme me atë vajzë. Asgjë emocionale, asgjë e tejzgjatur. Ishte një gjë krejtësisht normale dhe e shëndetshme. Dhe ia dorëzoi lejen. Megjithëse nuk e di as vetë pse ta lodha kokën me një barcoletë koti si kjo. I xhindosur me veten që kishte zbuluar një sekret kaq diskreditues, ai ia shfryu të gjithë inatin Bernardit. Shikimi në sytë e tij tani ishte thjesht keqdashës. Dhe do të doja ta përdorja këtë rast që m'u dha, zotni Marks, - vijoi ai, - t'ju shpreh se nuk jam fare i kënaqur me raportimet që marr për sjelljen tuaj jashtë orëve të punës. Ju mund të thoni që nuk është punë për mua. Por ja që është. Se dua të mbroj emrin e mirë të Qendrës. Punonjësit e mi duhet të qëndrojnë jashtë e përtej çdo dyshimi, veçanërisht ata të kastave të larta. Alfat janë të paracaktuara të mos ndiejnë ndjenja fëminore si pjesë e sjelljes emocionale. Mirëpo kjo është një arsye më shumë që të përpiqen në mënyrë të veçantë të përshtaten. Është detyra e tyre të jenë foshnjarakë, qoftë edhe kundër prirjes së tyre të natyrshme. Dhe ja pra, zotni Marks, unë ju dhashë me të drejtë një paralajmërim. - Zëri i drejtorit u drodh nga indinjata, e cila tashmë u bë krejt e rreptë dhe jopersonale - ishte mosaprovim i shprehur nga Shoqëria, dora vetë. Nëse dëgjoj edhe një herë për ndonjë shkarje prej standardit të duhur të etiketës fëmijërore, do të kërkoj transferimin tënd në ndonjë Nënqendër, mundësisht në

Islandë. la kalofshi mirë, dhe mori në dorë një laps, lëvizi në karrige e nisi të shkruajë një gjë. "Kjo do t'ia tregojë mirë këtij," - tha me vete. Por e kishte gabim. Bernardi doli nga dhoma i krekosur, i ngazëllyer, duke përplasur portën pas vetes, me mendimin se ai qëndronte i vetëm, i pathyeshëm, kundër rendit të gjërave; i ngazëllyer nga vetëdija dehëse e domethënies dhe rëndësisë që kishte ai vetë, individi Bernard. Edhe vetë mendimi i persekutimit, që i shtiu frikë e drojë, ishte më tepër përtëritës sesa dëshpërues. Ai u ndje aq i fortë sa të përballej me vuajtjet, aq i fortë sa ta duronte edhe Islandën. Dhe ky vetëbesim në forcat e veta ishte edhe më i madh, ngase ai për asnjë çast nuk besoi se me të vërtetë do të përballej me ndonjë gjë. Njerëzit thjesht nuk transferoheshin për gjëra të tilla. Islanda ishte veç një kërcënim. Kërcënim ndër më këndellësit e gjallëruesit. Duke ecur përgjatë korridorit, ai përnjëmend po fishkëllente.
Rrëfimi që i bëri atë natë intervistës me drejtorin ishte heroik. "Dhe në fund, - mbyllej tregimi, - i thashë të shkojë në të Kaluarën e Pafund dhe dola jashtë nga dhoma. Dhe me kaq e mbylla." Ai pa nga Helmhole Uatsoni duke pritur t'i vinte shpërblimi, me përgëzime, dashamirësi, admirim. Por asnjë fjalë nuk doli. Helmholci u ul në heshtje me sytë përdhe.
Atij i pëlqente Bernardi; i qe mirënjohës atij, sepse ishte i vetmi njeri mes të njohurve, me të cilin mund të fliste mbi tema që ishin më të rëndësishmet për të. Paçka kësaj, te Bernardi kishte gjëra që ai urrente. Këto mburrjet, për shembull. Dhe pa harruar shfrimet e një vetmëshirimi të ndyrë, të cilat pasonin duke u alternuar me mburrjet. Dhe

zakonin e tij të mjerë që bëhej trim pasi kishte ndodhur ngjarja, bashkë me mungesën e plotë të gjakftohtësisë gjatë saj.. I urrente këto, por vetëm ngaqë i pëlqente Bernardi. Sekondat kalonin. Helmholci ngeli me sytë të ngulura në dysheme. Papritur Bernardi u skuq në fytyrë dhe i ktheu shpinën.

PJESA 3

Udhëtimi shkoi krejt qetë. Raketa Paqësori Blu, dy minuta e gjysmë më shpejt në Nju Orlins, humbi katër minuta mes një tornadoje në Teksas, por fluturoi në një rrymë të mbarë ajri në gjatësinë gjeografike 95 gradë në perëndim dhe ia doli të ulej në Santa Fe më pak se dyzet sekonda me vonesë. "Dyzet sekonda në gjashtë orë fluturim. Jo edhe aq keq," - pohoi me mençuri Lenina.
Ata fjetën atë natë në Santa Fe. Hoteli ishte i përkryer-i pakrahasueshëm, për shembull, me të tmerrshmin Aurora Bora Palace, ku Lenina kishte vuajtur aq shumë verën e shkuar. Ajër me lagështirë, televizor, masazh vibro-vakumi, radio, solucion i zier kafeine, kontraceptivë të ngrohtë dhe tetë aroma të ndryshme qenë hedhur në çdo dhomë. Impianti i muzikës sintetike po punonte në kohën kur ata hynë në hotel, gjë kjo që nuk linte më shkas për asnjë të metë. Një shënim në ashensor lajmëronte se hoteli kishte gjashtëdhjetë fusha Shkallë-Raketa-Shtypëse, si Golfi me pengesa, ashtu edhe Elektro-magnetiku mund të luheshin në park.
-Po qenka hata fare, - thirri Lenina. - Më vjen të rri këtu

për fare. Gjashtëdhjetë fusha Shkallë-Raketa-Shtypëse...
Te rezervati nuk ka asnjë të këtillë,- e paralajmëroi
Bernardi. - As aroma, as televizor, madje as ujë të ngrohtë. Nëse mendon se nuk e bën dot, rri këtu deri kur të kthehem unë.
Lenina u ofendua shumë:
- Patjetër që e bëj. Thashë qenka hata vetëm ngaqë...
ngaqë progresi është i bukur, apo jo?
- Pesëqind përsëritje një herë në javë, nga ora një deri në pesë, -tha Bernardi i dërrmuar, gati sikur po ia thoshte vetes
të tëra këto.
- Si the?
- Thashë që progresi është i bukur. Prandaj dhe ndoshta është më mirë të mos vish te rezervati, ose eja vetëm nëse ke qejf me të vërtetë.
- Por unë dua.
-Shumë mirë, atëherë, tha Bernardi, dhe ky u duk thuajse si kërcënim.
Leja e tyre kërkonte firmën e Kujdestarit të Rezervatit, në zyrën e të cilit ata u paraqitën sipas rregullave. Mëngjesin e ditës tjetër një Negro Ypsilon-Plus i mori Bernardit kartën dhe fill pas kësaj ata u lejuan të hynin.
Kujdestari qe një biond kokëngjeshur Alfa-minus, i shkurtër, i kuq, fytyrë rrumbullakët, shpatullgjerë, me një zë buçitës, i përshtatur shumë mirë në artikulimin e urtësive hipnopedike. Ai ishte një minierë informacionesh dhe këshillash të mira, krejt të pavend e të pakërkuara nga askush. Hall sa nisi, se pastaj vazhdoi e vazhdoi pa pushim.
... pesëqind e gjashtëdhjetë mijë kilometra katrorë, ndarë në dy Nënrezervate, të mbrojtur nga një gardh prej teli me korrent."

Në këtë çast, pa kurrfarë arsyeje të dukshme, Bernardit iu kujtua se kishte lënë kolonjën hapur në banjo dhe se ajo tani do ish duke u derdhur papushim.
"... të furnizuar me rrymë elektrike prej stacionit hidroelektrik të Kanionit të Madh."
- Do të më kushtojë sa qimet e kokës deri sa të kthehemi, - me sytë e mendjes Bernardi shikonte shigjetën e matësit të aromës që sillej e sillej sikur të ishte një milingonë punëtore. Shpejt, t'i telefonosh Helmholc Uatsonit.
"... më shumë se pesë mijë kilometra gardh me gjashtë mijë volt rrymë elektrike."
- Mos më thuaj,- i tha Lenina me mirësjellje, pa e ditur fare se çfarë kishte thënë deri tani kujdestari, por e mori me mend nga pauza e tij dramatike. Kur kujdestari zuri të ulërasë, ajo pa mendje e kishte marrë gjysmë gramë soma dhe si rezultat tani mund të rrinte pa kurrfarë mendimi në kokë, me sytë e saj të mëdhenj blu ngjitur pas fytyrës së tij, duke e parë si e magjepsur dhe pa i hyrë asnjë fjalë në vesh.
Prekja e telit do të thotë vdekje e menjëhershme. - Lajmëroi plot solemnitet kujdestari. - Nuk ka asnjë shteg shpëtimi për të dalë prej Rezervatit të të Egërve. Fjala "arratisje" ishte tepër domethënëse.
- Mbase, -tha Bernardi me gjysmë zëri, - do ishte më mirë të largoheshim. - Gjilpëra e zezë e vockël po rendte, cimbisëse përgjatë gjithë kohës, duke i ngrënë paratë në xhep.
S'ka arratisje, - u tha kujdestari duke u mbështetur në karrigen e vet; meqë leja ende nuk ishte firmosur, Bernardi nuk kishte ç'të bënte përveç se t'i bindej. - Ata që kanë lindur në rezervat, dhe mbani mend, zonjëz e dashur, - shtoi ai me një të parë skandaloz e gjithë epsh drejt Leninës, duke

nxjerrë ofshamë të patakt, - mbani mend, fëmijët ende lindin, lindin, tamam lindin, sado për të vjellë që mund të duket... (Ai shpresonte se një referencë e tillë do të bënte që Lenina të skuqej; por ajo vetëm sa i buzëqeshi shtirshëm dhe me zgjuarsi i tha: "Mos më thuaj!". I zhgënjyer, kujdestari ia nisi nga fillimi.) - Ata që, e përsëris, janë lindur në rezervate, janë të paracaktuar të vdesin po atje. Te paracaktuar të vdesin... një decilitër kolonjë për çdo minutë. Gjashtë litra në orë. Ndoshta... u përpoq sërish Bernardi, - mos duhet që... Duke u përkulur përpara, drejtori trokiti me gisht mbi tavolinë.

- Ju më pyesni sa njerëz rrojnë në rezervat. Dhe unë po ju them, - gjithë triumf, - se nuk e dimë. Veçse mund ta marrim me mend.

Vërtet!

- Po, zonjëz e dashur.

Gjashtë herë njëzet e katër, jo, duhet të jetë diku tek gjashtë herë tridhjetë e gjashtë. Bernardi qe zbehur dhe po dridhej nga padurimi. Teksa ulëritësi vazhdonte të kumbonte papushim.

"... rreth gjashtëdhjetë mijë indianë dhe metisë... plotësisht të egër... i vizitojnë inspektorët ndonjëherë... përndryshe, nuk kanë asnjë lloj kontakti me botën e qytetëruar... ende i ruajnë veset e tyre të pështira, edhe zakonet... martesa, nëse e dini se ç'do të thotë kjo e dashur; familjet, nuk kanë paracaktim, kanë besime monstruoze... krishterim, totemizëm dhe kult të paraardhësve... gjuhët e zhdukura, si zunji dhe spanjishtja, atapaskanja... pumat, iriqët dhe kafshë të tjera... sëmundje ngjitëse, priftërinj, hardhuca helmuese..."

- Mos më thuaj!

Më në fund i shpëtuan. Bernardi u turr të kapte telefonin. Shpejt e shpejt; por iu deshën plot tri minuta derisa u lidh me Helmhole Uatsonin.
- Tani mund të jemi mes të egërve, - u ankua ai. - Te paaftë!
- Merr një gram, -i propozoi Lenina.
Ai ia refuzoi, duke parapëlqyer më shumë zemërimin e tij. E më në fund, falë Fordit, linja u hap dhe doli Helmholci; Helmholcit, të cilit i shpjegoi se ç'i kishte ndodhur dhe i cili i premtoi se do ta mbyllte rubinetin, madje menjëherë, menjëherë, por që gjeti rast t'i thoshte atë çfarë u kishte thënë drejtori i madh në publik, dje në mbrëmje...
Çfarë? Po kërkon një njeri për të më zëvendësuar? - zëri i Bernardit ishte agonia vetë. - Pra qenka vendosur? E përmendi gjë Islandën? Mos më thuaj që e bëri? Ford! Islandë... - e uli receptorin dhe u kthye nga Lenina. Fytyra e tij ishte e zbehtë, ndërsa gjendja shpirtërore tepër e brengosur. - Ç'ka ngjarë? - pyeti Lenina.
- Ngjarë? - dhe ra i këputur në një karrige. - Më kanë caktuar në Islandë.
Shpesh më parë, ai kishte vrarë mendjen se si do të ishte sikur t'i binte fati e ai t'i nënshtrohej (pa soma, i mbështetur veç në forcat e veta), ndonjë sprove të madhe, ndonjë dhimbjeje, ndonjë persekutimi; ai madje kish oreks për ndonjë brengë të rëndë. Së fundmi, si tek zyra e drejtorit një javë më parë, ai e kishte menduar veten të fortë, të guximshëm, që me stoicizëm do t'i pranonte mundimet pa nxjerrë as edhe një fjalë nga goja. Kërcënimi i drejtorit, në fakt, e kishte ngazëllyer, ia kish bërë zemrën mal. Por, siç ra në të vetëm tani, kjo kishte ndodhur ngaqë kërcënimin

nuk e kish parë me seriozitetin e duhur; nuk e kish besuar kurrsesi që drejtori i madh, kur të vinte puna, do të shkonte deri në atë pikë. Tani që dukej se kërcënimit i erdhi ora të zbatohej, Bernardi u llahtaris. Tashmë nuk kishte ngelur asnjë gjurmë nga stoicizmi imagjinar dhe guximi teorik.
Sa budalla! u xhindos me veten, unë kundër drejtorit, sa e padrejtë nga ana e tij që nuk i kishte dhënë edhe një shans të dytë; e atë shans, që ai tani pa asnjë dyshim, ishte i gatshëm ta merrte.
Pastaj në Islandë, në Islandë... Lenina tundi kokën. "Më the të thashë, më trash, - citoi ajo, marr një gram dhe ja ku jam."
Më në fund ajo ia doli ta bindë që ai të kapërdijë katër tableta soma. Pesë minuta më vonë dhe ja ku rrënjët dhe frutat u hodhën poshtë; lulja e së tashmes çeli gjithë ngjyra. Nga portieri erdhi një mesazh, i cili thoshte se me urdhër të kujdestarit, një truprojë e rezervatit kishte ardhur rrotull me avion për pak kohë, ndërsa tani i priste në tarracën e hotelit për t'i shoqëruar. Ata u ngjitën pa ia bërë fjalën dysh. Një burrë me 8/1 gjak afrikan në deje, veshur me uniformën e gjelbër të Gamave i përshëndeti dhe nisi menjëherë të recitonte që nga fillimi të gjitha pikat e programit të mëngjesit.
Do t'u hidhnin një shikim panoramik dhjetë a dymbëdhjetë fshatrave më të rëndësishëm, pastaj do uleshin në luginën e fshatit Malpais për të ngrënë drekën. Shtëpia e pushimit atje ishte e rehatshme; përveç kësaj, të egrit sipas gjasash po festonin festivalin veror lart në fshatra. Ky ishte vendi më i mirë për të kaluar natën.
Ata zunë vend në avion dhe u nisën. Dhjetë minuta më pas po kalonin kufirin që ndante qytetërimin prej egërsirave.

Larte poshtë, përmes shkretëtirës prej kripe a rëre, përmes pyjeve, thellë mes violës së kanioneve, përmbi shkrepa, maja e sheshime, gardhi i rrjetës së telit marshonte përpara, i papërballueshëm, në linjë të drejtë, simbol gjeometrik i qëllimit fitimtar të njeriut. Dhe në këmbët e tij, ca aty e ca atje, një mozaik prej kockash të bardha; një kërme ende e pakalbur mirë, e errët, mbi një truall të kuqërremtë, shënonte vendin ku ndonjë dre, mëz, puma, iriq a kojotë, apo ndoshta galat nepsqare të tërhequra nga duhma e kalbësirës, kishin plasur veç nga një e prekur e telave; pastaj kishin avulluar prej kësaj prekjeje, si të ndëshkuar prej një drejtësie poetike.

"Nuk nxënë mend kurrë, - thoshte piloti me uniformë të gjelbër duke treguar me gisht skeletet në truallin aty poshtë. - Dhe nuk kanë për të nxënë kurrë, shtoi ai me tallje, thua se në këtë mënyrë kishte arritur një fitore personale mbi kafshët e ngordhura prej rrymës elektrike."

Edhe Bernardi qeshi po njëlloj; pas dy gramëve të somas, shakaja iu duk pa arsye, megjithëse e bukur. Qeshi, dhe pastaj gati menjëherë ra në gjumë e ashtu në gjumë kaloi në fluturim Taosin dhe Tesukuen; Namben dhe Pikurisin, Pohoakuen, Sian dhe Çikitin, Lagunën, Akoman, Pllajën e magjepsur, Zunjin, Sibolan, Oho Kalienten dhe u zgjua më në fund kur makineria po qëndronte në vend. Lenina i mori valixhet dhe rrobat, i futi brenda një shtëpie të vogël katrore, ndërsa hibridi i gjelbër gama po fliste me një indian të ri në një gjuhë të pakuptueshme.

"Malpaisi, - u shpjegoi piloti kur Bernardi zbriti nga avioni, - kjo është shtëpia e pushimit."

"Ka një valle sot pasdite në fshat. Do t'ju çojë ai atje,-

dhe i tregoi me gisht të egrin e zymtë dhe trupvogël. - Besoj se do të çuditeni boll, - e përqeshi ai, - çdo gjë që bëjnë këta është e habitshme. - Menjëherë, sapo mbaroi fjalën, u ngjit në avion dhe ndezi motorët. "Mirupafshim nesër." "Mos harroni, - e tha këtë për të treguar se ishte vend i sigurt, që Lenina të rrinte rehat, - janë plotësisht të zbutur. Nuk ju vjen asnjë e keqe prej tyre. Kanë përvojën e duhur nga bombat me gaz dhe e dinë mirë se e kanë të pamundur të bëjnë ndonjë marifet." Ende duke qeshur, i futi marshin e helikës, saora u ngrit lart dhe iku.

KAPITULLI VII

Pllaja ishte si një anije që kish ndaluar në një ngushticë pluhuri të ngjyrosur në bojë luani. Kanalet si përdridheshin mes brigjeve, zbrisnin rrëpirave nga njëra faqe në tjetrën, dhe mes një brezi të hollë të gjelbër, lumi dhe fusha e tij. Në majën e asaj anijeje prej guri, në qendër të ngushticës dhe me largësi të barabartë midis anëve ndodhej fshati Malpais. Blloqe guri një mbi një, me çdo kat më të vogël se i mëposhtmi, shtëpitë ngriheshin si piramida të përshkallëzuara, kokëprera, deri lart në qiellin blu. Në këmbë të tyre shtrihej një rang rregullt ndërtesash, një kryqëzim muresh; dhe gremina binte dukshëm më tri anë, derisa zbriste e bëhej shesh. Disa kolona tymi ngjiteshin pingul në ajrin e patrazuar prej erës duke u tretur krejt.
“Çudi, – tha Lenina. - Shumë çudi.” Kjo ishte fjala që përdorte zakonisht si ndëshkim. “Nuk më pëlqen këtu. Dhe nuk më pëlqen ky burri." Ajo e tregoi me gisht indianin e caktuar si shoqërues për rrugëtimin deri në fshat. Ndjenja e saj ishte, me sa duket, reciproke; shpina e burrit, i cili ecte përpara tyre, ishte aq armiqësore, sa ajo ndiente përbuzje prej vrazhdësisë që karakterizonte ecjen e tij.
"Mirë kjo, - tha ajo dhe uli zërin, - por edhe qelbet erë." Bernardi as nuk u përpoq ta kundërshtonte, kështu që vazhduan rrugën.

Papritur u duk sikur ajri erdhi në jetë e pulsonte me pulsin e palodhur të lëvizjes së gjakut. Lart, atje në Malpais, po u binin daulleve. Këmbët e tyre e ndoqën ritmin e mistershëm të rrahjes së kësaj zemre; ata e përshpejtuan ritmin. Shtegu i nxori buzë greminës. Anët e anijes së madhe qëndronin lart mbi kullat treqindkëmbëshe që ngriheshin mbi hon.
"Do të doja ta kishim marrë me vete avionin, - tha Lenina duke vështruar lart faqet e shkreta të gurëve. - Nuk ma ka qejfi fare të eci. Lëre pastaj ndihesh kaq i vogël si njeri, kur rri në këmbët e një kodre."
Ata ecën tej për pak kohë nën hijen e anijes, bënë ca dredha, edhe ja ku ishte, në një përroskë të gërryer prej ujit; aty qe ngritur shkalla që do t'i çonte lart. Ata u ngjitën. Ishte një shteg shumë i pjerrët dhe me zigzage nga njëra anë e honit në anën tjetër. Ndonjëherë goditjet e daulleve bëheshin të padëgjueshme, herën tjetër, dukej sikur ato po rrihnin aty në fund të kthesës.
Kur ishin në gjysmë të rrugës, një shqiponjë u fluturoi aq pranë, sa ajri që rrahu me krahë i fryu në fytyrë pak freski. Mbi kreshtën e një guri gjendej shpërndarë një pirg me kocka. E gjitha kjo po u bëhej edhe më e çuditshme, teksa indiani binte erë përherë edhe më të rëndë. Më në fund dolën nga gryka e mugët në dritën e plotë të diellit. Maja e pllajës ishte një kuvertë e sheshtë prej guri.
"Si Kullat e Kujdesit-T, - komentoi Lenina. Por nuk i ra radha ta shijojë këtë zbulim ngushëllues për shumë kohë. Rrahjet e buta të disa hapave i bënë ata të kthehen andej nga vinte zhurma. Të zhveshur lakuriq nga qafa deri tek kërthiza, me trupat e nxirë e të pikturuar me vija të bardha ("si vijat e bardha të fushës së tenisit." tha Lenina pak më vonë.), me

fytyrat e ngjyera në mënyrë jonjerëzore me mballoma të kuqe allë, të zeza dhe okër, dy indianë erdhën me vrap nga shtegu. Flokët e zinj i kishin të thurur me gëzof dhelprash dhe rripa prej fanellate të kuqe. Pelerinat me pupla gjeldeti u valëviteshin mbi supe; diadema të mëdha bërë me pupla zogjsh u shpërthenin krejt pa shije mbi krye. Për çdo hap që bënin u tringëllinin byzylykët dhe varëset e rënda prej argjendi që mbanin në qafë, plot me kocka e rruaza ngjyrë bruz. Ecnin pa thënë asnjë fjalë, rendnin pa bërë zhurmë në mokasinet me lëkurë dreri. Njëri prej tyre mbante në dorë një furçë puplash, tjetri mbante, në të dyja duart, një gjë që prej së largu dukej si një litar me tri- katër pjesë. Njëri prej litarëve u përdrodh jo aq natyrshëm dhe papritmas Lenina kuptoi se ishin gjarpërinj.

Burrat u afruan pranë e më pranë; sytë e tyre të zinj po e shikonin, ama pa dhënë as shenjën më të vogël të njohjes, as më të voglën shenjë që linte të kuptoje se ata e kishin parë dhe ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e saj në atë vend. Gjarpri i ngrehur u përdrodh ca, pastaj u var poshtë me të tjerët. Burrat ikën.

"Nuk më pëlqen, - tha Lenina, - nuk më pëlqen." Asaj i pëlqeu edhe më pak ajo që e priste në hyrje të fshatit, kur kallauzi i la aty dhe hyri brenda të marrë udhëzimet e mëtejshme. Pluhuri, si fillim, pastaj turrat me plehra, qentë, e më vonë mizat. Fytyra iu zhubros prej neverisë. Vuri shaminë përpara hundës.

- Po si ka mundësi që jetojnë kështu? - shpërtheu ajo me një zë indinjate e mosbesimi. (Nuk ishte e mundur.) Bernardi mblodhi supet si filozof.

-Gjithsesi, - tha ai, - këta të paktën për pesë a gjashtëqind vitet e fundit kështu kanë jetuar. Ma do mendja se janë mësuar të jetojnë kështu.

Por pastërtia shkon dora-dorës me Ford fisnikërinë,- këmbënguli ajo.
- Po, dhe qytetërim do të thotë sterilizim, - vijoi Bernardi duke përmendur me një ton ironie, përcaktimin e leksionit të dytë hipnopedik të higjienës elementare. - Po këta njerëz nuk kanë dëgjuar kurrë për Fordin Tonë dhe nuk janë aspak të qytetëruar. Kështu që nuk ka arsye të...
-Oh! - e kapi ajo për krahu. - Shiko!
Një indian gati lakuriq po i ngjitej me ngadalë shkallës nga kati i parë i tarracës së shtëpisë së fqinjëve - shkallare pas shkallareje, me gjithë mundimet që sjell pleqëria. Fytyra i qe zhubrosur prej rrudhave, nxirë, si maskë e vjetër prej xhami vullkanik. Goja pa dhëmbë i qe futur brenda. Në qoshet e buzëve, në secilën anë, mjekra me pak qime të thinjura ndriste si një gjë e bardhë në sfondin e lëkurës së nxirë. Flokët e gjatë e të pakrehur i vareshin poshtë në bukla gri rrotull fytyrës, trupin e kishte të dobësuar deri në kockë, pothuaj pa një fije mish. Ai kapërcente shkallaret shumë me ngadalë, një e nga një; matej gjithnjë pak para se të hidhte këmbën edhe kur i duhej të bënte qoftë edhe një hap.
- Si e ka hallin ai? - pëshpëriti Lenina. Sytë iu çanë më dysh prej tmerrit.
- Është plak, kaq, - iu përgjigj Bernardi, aq i shkujdesur sa mundi. Edhe vetë ishte i befasuar, ama bëri përpjekjen për t'u dukur trim.
- Plak? - përsëriti ajo. - Po edhe drejtori është plak. Shumë njerëz janë pleq, por nuk janë kështu.
- Kjo ndodh ngaqë ne nuk lejojmë që ata të bëhen si ky. Ne i ruajmë nga sëmundjet. I mbajmë sekrecionet e tyre të

brendshme të balancuara artificialisht në ekuilibrat e moshës më rinore. Nuk lejojmë që raporti i magnezit me kalciumin të bjerë nën masën që ka pasur nën moshën tridhjetëvjeçare. U bëjmë transfuzion me gjak të ri. Ua mbajmë metabolizmin përherë të stimuluar. Kështu që, sigurisht që nuk ka mundësi të ngjajnë si ky. Pjesërisht, - vijoi ai, ngaqë shumica vdesin shumë përpara se të mbërrijnë moshën e plakjes, aq sa ka arritur kjo krijesa këtu. Rini deri në gjashtëdhjetë vjeç, dhe pastaj trak! Vjen fundi.
Mirëpo Lenina nuk po e dëgjonte. Ajo po vështronte plakun. Ngadalë, ngadalë, ai zbriti. Këmbët i prekën në tokë. U kthye. Në gropat e zhytura thellë brenda orbitave, sytë e tij ishin ende jashtëzakonisht të shndritshëm. Ata sy e vështruan një çast, që asaj iu duk i gjatë, krejt pa shprehje, pa habi, sikur ajo të mos ishte fare aty. Pastaj, po aq ngadalë, me shpinën e kërrusur, duke u çapitur, plaku u kaloi pranë dhe iku.
E tmerrshme, - psherëtiu Lenina. - E llahtarshme, nuk duhej të kishim ardhur kurrë këtu. Ajo zgjati dorën në xhep të gjente soma - zbuloi si kurrë ndonjëherë që e kishte lënë shishen me hape në shtëpinë e pushimit. Xhepat e Bernardit ishin gjithashtu të boshatisur.
Leninës i ngeli të përballet me tmerret e Malpaisit pa kurrfarë ndihme. Ato u lëshuan grumbull mbi të, rëndë e me të shpejtë. Spektakli i dy grave të reja që po ushqenin me gji fëmijët e tyre e bëri të skuqej aq sa nuk duroi dot më dhe ktheu kokën në anën tjetër. Nuk kishte parë kurrë në jetë gjë më të turpshme. Mirëpo edhe Bernardi po e përkeqësonte gjendjen në të cilën ajo ndodhej. Në vend që t'i shmangej situatës me mirësjellje, vazhdonte të bënte hapur komente mbi këto skena të gjallëpjellësve; skena, të cilat normalisht do të revoltonin

çdokënd. Tani që efekti soma i kishte dalë, ndihej i turpëruar për dobësinë e shfaqur atë mëngjes në hotel, prandaj doli nga vetja që të tregonte veten burrë, të fortë dhe jotradicional.
- Ç'marrëdhënie mrekullisht intime, - tha ai me ton qëllimisht të pacipë. Dhe me çfarë intensiteti gjenerohen ndjenjat këtu! Shpesh e kam menduar, njeriut i mungon përjetë diçka kur nuk ka pasur një nënë. Lenina, ndoshta edhe ty të mungon diçka se nuk je bërë nënë. Përfytyro veten, ulur aty, me beben e vogël...
Bernard! Si guxon? - Parakalimi i një gruaje plakë me oftalmi dhe një lloj sëmundjeje lëkure i tërhoqi vëmendjen dhe ia prishi indinjatën.
- Ikim që këtu, - i tha ajo, - mua nuk po më pëlqen më. Por, në këtë çast, kallauzi u kthye dhe, pasi u bëri shenjë që ta ndjekin, çau i pari rrugën e ngushtë mes shtëpive. U kthyen në një qoshe. Një qen i ngordhur shtrihej mbi një tog mbeturinash; një grua me gushë të varur poi kontrollonte flokët për morra një vajze të vogël. Kallauzi ndali në këmbët e një shkalle, ngriti dorën pingul lart, pastaj e kaloi horizontalisht sikur u bëri diçka me shenjë. Ata, në heshtje bënë atë që u tha ai - iu ngjitën shkallës dhe kaluan mes një porte që ishpuri brenda një dhome të gjatë e të ngushtë, gati në terr të plotë, me erë tymi e vaji gatimi, mes rrobash të stërpërdorurae të palara prej kohësh. Në fund të dhomës ndodhej një portë tjetër, përmes së cilës vinte një fashë drite dhe zhurmë, shumë e fortë dhe fare pranë ishte zhurma e daulleve që binin fort. Ata çanë përmes dhe në fund kur dolën, gjetën veten papritur në një tarracë. Poshtë tyre, i rrethuar nga shtëpitë e fshatit, ndodhej sheshi i mbushur plot me indianë, me mbulesa të

bardha, me pupla në flokë, varëset ngjyrë bruzi dhe lëkura e errët u shkëlqenin mes vapës. Lenina mbuloi prapë hundën me shami. Në hapësirën në qendër të sheshit ngriheshin dy platforma rrethore prej tulle e argjile të ngjeshur - ishin çati, poshtë të cilave dukeshin fare qartë shtrojat e dhomave të nëndheshme; hyrja në qendër të çdo platforme ishte një kapanxhë dhe një shkallë që dilte nga errësira deri lart në dritë. Tingulli i një flauti të nëndheshëm dëgjohej të vinte prej poshtë, e gati sa nuk humbte në këmbënguljen e vazhdueshme e të pamëshirshme të daulleve.

Leninës i pëlqenin daullet. Me sytë mbyllur ajo e la veten në dorë të bubullimës së butë që përsëritej; i la t'ia pushtojnë vetëdijen e saj përherë e më shumë, derisa nuk mbeti më asgjë tjetër në botë, përveç tingullit të thellë që pulsonte. Kjo gjë sigurisht që i kujtoi asaj zhurmat sintetike që bëheshin tek Shërbimet e Solidaritetit, ditëve përkujtimore të Fordit. "Orgji-derri," - pëshpëriti me vete. Këto daulle bien me po të njëjtin ritëm. Papritur shpërtheu fuqishëm një këngë, qindra zëra burrërorë bërtitën fuqishëm njëherësh me një zë të vrazhdë metalik. Pak nota të gjata dhe heshtje; heshtja gjëmuese e daulleve; pastaj vikama, si një hingëllimë
e përdredhur, përgjigja e një gruaje. E prapë daullet; edhe një herë tjetër burrat përsëritën pohimin e thellë të burrërisë prej kafshërie.

E çuditshme, pa dyshim. Vendi ishte i çuditshëm, po ashtu dhe muzika, edhe veshjet, gushat, sëmundjet e lëkurës dhe pleqtë. Veç, performanca në vetvete, nuk dukej se kishte asgjë të çuditshme rreth saj.

- Më kujton Këngët e Komunitetit të kastës së ulët, - i tha ajo Bernardit.

Por kur koha kaloi, asaj iu kujtuan përherë e më pak ato ceremoni. Sepse befas, aty në dhomat e nëndheshme, gëloi një trupë e kobshme me përbindësha. Me maska të neveritshme, ose thjesht me fytyrat e mballosura me bojë, pa asnjë ngjashmëri me njeriun, burrat rrahën me këmbë tokën duke hedhur një lloj valleje të habitshme rreth e rrotull sheshit; rrotullohu e rrotullohu, vazhdonin e këndonin, duke u sjellë në rreth për çdo herë më shpejt; edhe daullet e ndryshuan dhe e përshpejtuan ritmin, brenda në veshët e tyre rrihte një puls, si i njeriut ndër ethe; edhe turma nisi të këndojë bashkë me valltarët dhe zëri u ngrihej përherë e më lart; pastaj, sapo klithi gruaja e parë, nisi edhe një tjetër, e më pas edhe një tjetër, sikur të ishin duke i therur; kur befas udhëheqësi i valltarëve u shkëput prej vargut, vrapoi drejt sëndukut prej druri që ndodhej në një qoshe në fund të sheshit, i ngriti kapakun dhe nxori që aty një çift gjarpërinjsh të zinj. Një britmë e fortë doli nga turma, të gjithë valltarët vrapuan drejt tij me duart të zgjatura përpara. Ai ia hodhi gjarpërinjtë të parëve që mbërritën, zhyti sërish duart të marrë të tjerë. Prapë e prapë, gjarpërinj të zinj, të kaftë dhe me lara - ua värviste atyre. Atëherë vallja nisi prapë, por me një tjetër ritëm. Rrotull e rrotull hodhën valle me gjarpërinjtë, duke u përdredhur si gjarpërushe, me lëkundje ledhatare çonin bashkë gjunjët me belin. Rrotull e rrotull. Pastaj lideri dha shenjë. Njëri pas tjetrit, të gjithë i vërtitën poshtë gjarpërinjtë në mes të sheshit; një plak doli nga nëntoka dhe i spërkati gjarpërinjtë me kokrra misri, një plakë doli nga një kapanxhë tjetër dhe i spërkati gjarpërinjtë me ujë nga një tas i zi. Më pas plaku ngriti dorën dhe papritur, ra një heshtje absolute e përzishme. Daullet ndalën rrahjet. Jetës dukej sikur i kishte ardhur fundi. Plaku

tregoi me gisht nga dy kapanxhat, hyrjet për në botën më të ulët. Dhe ngadalë, e ngritur nga poshtë-lart nga duar të padukshme, ja ku prej njërës kapanxhë doli imazhi i pikturuar i një shqiponje, prej tjetrës, ai i një njeriu lakuriq të gozhduar në një kryq. Duke parë nga turma, ata dukeshin sikur qëndronin varur pa ndihmën e askujt dhe shikonin vallen. Plaku rrahu shuplakat. Një djalë gati lakuriq, me një copë të bardhë prej pambuku përpara vetes, bashkë me një djalosh tjetër rreth tetëmbëdhjetë vjeç që u nda nga turma, dolën para tij me duart e kryqëzuara në gjoks e kokën të përkulur poshtë. Plaku bëri shenjën e kryqit mbi ta dhe u kthye me shpinë. Djaloshi nisi të ecë me ngadalë rreth togut përdredhës të gjarpërinjve. E plotësoi rrotullimin e parë, ishte gati në gjysmën e të dytit kur, nga mesi i valltarëve doli një burrë i gjatë që mbante të veshur maskën e një kojote dhe në dorë kishte një kamxhik lëkure të thurur gërshet. Ai iu afrua. Djaloshi vazhdoi sikur nuk e pa fare tjetrin. Burri-kojotë ngriti kamxhikun; pati një çast të gjatë pritjeje, pastaj aty për aty u dëgjua fishkëllima e kamxhikut dhe zhurma zëthatë e rrahjes në mish. Trupi i djaloshit u drodh; por nuk bëri zë, eci njëlloj, ngadalë, me të njëjtën qetësi. Kojota e goditi sërish edhe një herë; dhe për çdo të rënë si fillim dilte një gulçimë, pas saj një ofshamë që vinte prej turmës. Djaloshi ecte përpara. Dy herë, tri herë, katër herë, i ra rrotull. Gjaku shkonte çurg. Befas Lenina mbuloi fytyrën me duar dhe filloi të qajë. "Oh, ndal, ndaloni!" - u lut ajo. Por kamxhiku vazhdoi të binte pa ia ndarë. Shtatë herë rrotull. Pastaj erdhi një çast e djaloshit iu morën këmbët, prapë pa nxjerrë një fije zë ra përpara vetes me fytyrën përdhe. Plaku u përkul mbi të, e preku në shpinë me një pendë të bardhë e të gjatë; e mbajti një çast pezull, ashtu të përskuqur, pendën, sa

ta shikonin njerëzit, pastaj e shkundi tri herë mbi gjarpërinjtë. Ca pika ranë, pastaj papritur daullet shpërthyen prapë në një panik notash që vërsuleshin turravrap; plasën britma të forta. Valltarët u vërsulën të kapnin gjarpërinjtë për t'u larguar sakaq me vrap nga sheshi. Burra, gra, fëmijë, e gjithë turma u shkoi pas, po me vrap. Një minutë më vonë i gjithë sheshi u zbraz, vetëm djali ngeli, në të njëjtin vend ku ra, krejt i qetë. Tri plaka dolën prej njërës nga shtëpitë e vjetra dhe me pak vështirësi e morën në krahë dhe e ngritën në këmbë. Shqiponja dhe burri në kryq bënë roje për pak kohë mbi fshatin e zbrazët; pastaj, thua se kishin parë mjaft e nuk donin më të shihnin, u zhytën ngadalë në të njëjtat kapanxha prej nga dolën; u zhdukën pa lënë shenjë, hynë brenda në botën e poshtme.

Lenina vazhdonte të dëneste.

"Shumë e tmerrshme! - përsëriste shpesh dhe ngushëllimet e Bernardit nuk kishin asnjë efekt. - Shumë e tmerrshme! Gjaku! ngjethej ajo. - Oh, si nuk e kam një çikë kokërr soma!"

Në dhomën e brendshme dëgjoheshin hapa.

Lenina nuk lëvizi vendit, por qëndroi ulur me duart në fytyrë pa hapur as sytë. Vetëm Bernardi u kthye të shohë andej nga erdhi zhurma.

Nga veshja, i riu që doli në tarracë dukej indian, por flokët etij të lidhur gërshet kishin ngjyrën e kashtës, sytë ngjyrë blu të zbehtë, lëkura e tij e bardhë prej diellit dukej e bronztë.

- Tung, mirëdita, - tha i panjohuri në një anglishte pa gabime, por disi të veçantë. - Ju jeni të qytetëruar, apo jo? Ju keni ardhur nga Vendi Tjetër, jashtë Rezervatit?

-Ç'dreqin... - ia bëri Bernardi i mahitur. -Xhentëlmeni më fatkeq, - I riu psherëtiu, pastaj tundi

kokën. Dhe, duke bërë me shenjë nga njollat e gjakut në qendër të sheshit, i pyeti me një zë që dridhej prej E shikoni atë njollë të mallkuar?
emocioneve,
Më mirë një gram sesa një mallkim, - tha Lenina mekanikisht pa hequr duart nga fytyra. - Do të doja të
kisha soman time!
vazhdoi
- Unë duhet të kisha qenë në vend të tij, fjalën i riu. - Pse nuk më lënë të bëhem kurban? I rashë rrotull dhjetë herë, dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë herë. Palouhtiua nuk shkoi më shumë se shtatë. Prej meje do kishin nxjerrë dy herë më shumë gjak. Unë do ta derdhja gjakun lumë, dhe hapi krahët në shenjë bujarie; pastaj, nga dëshpërimi i la t'i lëvaren prapë poshtë. Po nuk më lanë. Nuk më pëlqejnë nga ngjyra e lëkurës. Përherë kështu ka qenë. Gjithmonë. - Lotët mbetën në sytë e të riut; atij i erdhi turp dhe u kthye në anën tjetër.
Nga habia Lenina e harroi fare se nuk kishte soma. Ajo hoqi duart nga fytyra dhe, për të parën herë, pa të panjohurin.
- Mos po na thua se deshe vetë të të rrahin me kamxhik? - Ende me shpinën kthyer nga ajo, i riu bëri një shenjë pohuese.
- Për të mirën e pueblos, që të vijë shiu dhe të rritet misri. Të kënaqet Pukongu dhe Krishti. Dhe ta shohin të gjithë se unë e duroj dhimbjen pa qarë. Po, – dhe befas zëri i tij mori një disonancë të re; u kthye nga ajo, i dha supeve qëndrimin krenar, ngriti mjekrën lart me mospërfillje dhe tha: - t'u tregoj se jam burrë... Oh! - lëshoi një gulç, heshti, u mek dhe mbeti gojëhapur.

Për herë të parë në jetë ai pa fytyrën e një vajze, faqet e së cilës nuk kishin ngjyrë çokollate, as si lëkurë qeni, flokët i kishte bojë gështenjë, të valëzuar valë-valë; shprehia e fytyrës së saj (e re, mahnitëse!) tregonte mirësi. Lenina po i buzëqeshte atij; sa djalë i pashëm, po mendonte ajo, me trup kaq të bukur. Gjaku ia përvëloi fytyrën të riut; ai uli sytë poshtë, i ngriti për një moment prapë lart, për të parë që ajo po i buzëqeshte sërish; dhe u pushtua nga një ndjenjë aq e fortë, sa iu desh të kthehej në anën tjetër e të bënte kinse po kërkonte me shumë zell diçka në anën tjetër të sheshit. Pyetjet e Bernardit i tërhoqën vëmendjen. Kush? Si? Kur? Prej ku? Duke mbajtur sytë të ngulitur në fytyrën e Bernardit (me kaq pasion po i buzëqeshte Lenina sa ai nuk guxonte ta shihte), i riu u përpoq të shpjegohej. Linda dhe ai - Linda ishte e ëma (fjalët u duk sikur e vunë Leninën në siklet) - ishin të huaj në rezervat. Linda kishte ardhur nga Vendi Tjetër shumë kohë më parë, përpara se ai të lindte; kishte ardhur me një burrë, i cili ishte babai i tij. (Bernadi ngrehu veshët.) Kur ajo, Linda, doli për shëtitje vetëm, në ato malet atje në veri, qe rrëzuar në një rrëpirë dhe kishte vrarë kokën. ("Vazhdo, vazhdo,"- thoshte me vete Bernardi i ngazëllyer.) Disa gjahtarë nga Malpaisi e patën gjetur dhe sjellë në fshat. Sa për burrin që kish qenë babai i tij, Linda nuk e kishte parë kurrë më me sy. Ai quhej Tomakin. (Po, Tomas, ishte emri i parë i drejtorit të madh.) Siç duket ai kishte fluturuar mbrapsht atje tek Vendet e Tjera, i larguar pa të sa njeri i keq, i pasjellshëm dhe çnjerëzor!

- Edhe kështu linda unë në Malpais, - e mbylli ai. - Në Malpais. - Dhe tundi kokën.

Çfarë pisllëku ajo farë shtëpie atje në të dalë të fshatit!

Më e mira e botëve.
145

Një hapësirë me pluhur dhe plehra e ndanin atë prej fshatit. Dy qen të ngordhur urie rrëmonin për turp me hundë në plehrat përpara shtëpisë. Kur hynë brenda, ishte errësirë, qelbej erë dhe mizat gumëzhinin.
- Linda! - thirri i riu.
Nga një dhomë në brendësi, një zë i ngjirur gruaje thirri: - Hyr! Ata pritën. Në dysheme kish tasa me mbeturina gjellësh të mbledhura, ndoshta prej shumë vaktesh.
Porta u hap. Një bionde e trashë lëkurëkuqe doli në prag, aty qëndroi duke parë nga të panjohurit, të cilët ngelën të çmeritur kur panë gojën e saj të hapur. Lenina vuri re me neveri se i mungonin dy dhëmbët e parë. Po edhe ngjyra e të tjerëve që i kishin mbetur... I shkuan të ngjethurat. Ajo ishte edhe më keq se plaku. Aq e trashë. Dhe me gjithë ato rrudha në fytyrë dhe gjithë ato njolla të kuqërremta, hundën plot damarë të kuq, sytë e përgjakur. Pastaj qafa, çfarë qafe!; kurse sharpa që mbante mbi krye - një rreckë e qelbur. Nën tunikën e saj bojëkafe, me prerje si thes, dukeshin gjinjtë e saj të pamasë, barku i fryrë, këllqet. Oh, shumë më keq se plaku, shumë herë më keq! E papritur krijesa lëshoi me nxitim ca fjalë, pastaj u lëshua vrik drejt saj me krahët e zgjatur përpara dhe oh, Ford! Ford! Ishte shumë e shpifur, për një çast do të villte - ajo e ngjeshi pas xhungave që kishte për gjinj dhe nisi ta puthë; Ford! Ta puthë, me jargë, binte erë për tmerr, dukej se nuk kish bërë kurrë banjë, ndaj thjesht qelbej në erë njëlloj me atë gjënë kafshërore që u futej Deltave e Ypsilonëve kur ishin brenda në shishe (jo nuk ishte asgjë e vërtetë nga ato që thuheshin për Bernardin), binte era alkool. Ajo u shqit prej saj aq shpejt sa mundi.

Një fytyrë e përlotur dhe e shtrembëruar qe ajo çka gjeti përballë; krijesa po qante.
- Oh, e dashur, moj e dashur... - rrëkeja e fjalëve rrodhi me dënesë. - Ta dini çfarë kënaqësie, pas gjithë këtyre viteve! Një fytyrë e qytetëruar. Po, dhe rroba të qytetëruara. S'e mendoja kurrë se do të shihja prapë me sy acetat mëndafshi Ajo çoi përkitazi gishtin te mënga e bluzës së Leninës. Thonjte i kishte të nxirë. Dhe këto pantallonat e shkurta kadife viskoze ç'mrekulli! E di çfarë e dashur, unë i kam ende rrobat e mia të vjetra, me ato që erdha këtu, i kam mbyllur në një kuti. Ti tregoj unë pastaj. Po ama acetati më është bërë gjithë vrima. Të shikosh sa i bukur është gjerdani im i bardhë - po sigurisht, ky marokeni yt gjelbërosh është më i bukur. Jo se ai gjerdan më bëri fort punë. - Lotët i rrodhën prapë. - Ma merr mendja se ju tha Xhoni. Sa kam vuajtur dhe nuk kisha një gramë soma. Vetëm një teke meskallë herë-herë, kur ma sillte Popi. Popi është një djalë që kam njohur dikur. Por meskalla të bën të ndihesh keq kur të del dhe pastaj sëmuresh me peyotl; përveç kësaj, tmerri vetë, të nesërmen më vinte turp edhe më shumë. Kisha kaq turp. Vetëm mendoje pak: unë, Beta - me barrë: vër veten në vendin tim. (Leninës i shkuan fërgëllimat vetëm nga fjala.) - Por ju betohem, nuk kisha faj; akoma nuk e di si ndodhi, edhe i kam bërë të gjitha stërvitjet maltusiane - ti e di vetë, sipas numrave, një, dy, tre, katër, gjithmonë, ju betohem; por ja që ndodhi; dhe sigurisht që këtej nuk gjendet Qendra e Abortit. Meqë ra fjala, ende atje poshtë në Chelsea është? - e pyeti ajo. Lenina pohoi me kokë. - Dhe prapë mbulohet me ato dritat çdo të martë dhe të premte? - Lenina pohoi përsëri. - Ajo kulla e bukur prej xhami ngjyrë rozë! Linda e shkretë ngriti lart fytyrën, mbylli sytë dhe solli ndërmend

pamjen e kujtimit të bukur. - Dhe lumi gjatë natës,- psherëtiu ajo. Lot të rëndë çanë përmes qepallave të saj të shtrënguara fort. Dhe fluturimi, kur ktheheshim në mbrëmje nga Stouk Poxhisi. Pastaj një banjë e ngrohtë dhe masazh vibro-vakumi... por lëre. - Ajo mori frymë thellë, tundi kokën, hapi sërish sytë, thithi me hundë një herë a dy, pastaj shfryu qurrat mbi gisht dhe i fshiu në anë të tunikës së vet. - Oh, më falni, - tha si për t'iu përgjigjur grimasës së neverisë që i shpëtoi Leninës. - S'duhet ta kisha bërë këtë. Më falni. Por ç'mund të bëjë njeriu kur këtej vërdallë nuk ka shami hundësh? Nuk e harroj dot sa më bezdiste gjithë ky pluhur. Nuk kishte as edhe një gjë të vetme që të ishte sterile. Unë kisha një të çarë të llahtarshme në kokë kur më sollën këtu ditët e para. S'jua merr mendja se çfarë më vendosën mbi plagë. Pisllëk, veç pisllëk. Civilizimi është sterilizim, -u thosha unë. Dhe nga Streptokoku G tek Banburi T, për të parë një banjë tamam me V. C. - si kalamajve. Por, sigurisht, askush nuk më kuptonte. Si të më kuptonin? Më në fund u mësova dhe unë, ma do mendja. Po megjithatë, si mund të mbash pastërti kur nuk ka ujë të ngrohtë as sa të lagesh pak? Shiko rrobat. Ky lesh prej kafshësh nuk është si acetati. Ky rron e rron pafund. Dhe duhet arnuar kur fillon e griset. Por unë jam Beta; unë kam punuar në Dhomën e Fekondimit; askush nuk më mësoi të bëj ndonjë gjë të tillë. Nuk ishte puna ime kjo. Pastaj, nuk ishte kurrë gjë e mirë të arnoje rrobat. Hidhi tej po patën vrima dhe bli të rejat. 'Sa më shumë arna, aq më pak pasuri.' A nuk është kështu? Arnimi është antishoqëror. Por është krejt ndryshe këtu. Është si të rrosh me të çmendur përreth. Çdo gjë që bëjnë është një çmenduri! - Ajo pa përreth; pa Xhonin dhe Bernardin që po flisnin me duar duke ecur lart e poshtë mbi plehrat

përpara shtëpisë; megjithatë, duke ulur zërin, iu afrua aq
pranë Leninës, e cila ngriu dhe u tkurr, sa kutërbimi në kulm i embrionhelmit i trazoi qimet e faqes. - Për shembull,
- pëshpëriti ajo me zë të ngjirur, - shiko se çfarë e kanë këta njëri-tjetrin. Të çmendur. Po ta them unë, absolutisht çmenduri. Gjithkush i përket gjithkujt, apo jo? Apo jo? - këmbënguli ajo, duke e tundur Leninën nga mënga. Lenina tundi kokën për po, e ktheu mënjanë për të nxjerrë jashtë frymën që mezi po mbante dhe ia doli të thithte sërish frymë relativisht me të pastër. - Epo këtu, – vijoi tjetra, - asnjeri nuk duhet t'i përkasë më shumë se një njeriu. Edhe po ta bësh me njerëz si zakonisht, të gjithë mendojnë se je e ligë dhe antisociale. Të urrejnë e të përbuzin. Njëherë, shumë gra m'u mblodhën dhe bënë skandal, se shumica e burrave të tyre vinin tek unë. Po ç'ka këtu, xhanëm? Dhe m'u vërsulën mua... Ka qenë e tmerrshme. Nuk di as vetë si të ta shpjegoj. Linda mbuloi sytë me duar dhe u drodh. - Gratë këtu janë kaq të mbushura me urrejtje. Të çmendura, të çmendura dhe tejet mizore. Dhe sigurisht që nuk ia kanë idenë stërvitjes maltuziane, shisheve apo filtrimit. Fare nuk marrin vesh nga këto gjëra. Kështu që bëjnë fëmijë gjithë kohës, si qentë. Për të vjellë. Dhe të mendosh se unë... Oh, Ford, Ford! Por gjithsesi Xhoni m'u bë krah. Nuk e di ç'do të kisha bërë pa të. Megjithëse zemërohej shumë sa herë që ndonjë burrë... Që i vogël, madje. Njëherë (por kjo ndodhi kur ishte më i madh në moshë) desh e vrau të shkretin Uaihusiva, apo mos ka qenë Popi? - Vetëm se unë, ndonjëherë e bëja me ta. Nuk ia dola kurrë ta bëj të kuptojë se kështu duhet ta bëjnë gjithë njerëzit e qytetëruar. Por çmenduria, me sa duket, është ngjitëse. Dhe Xhoni ka

mundësi ta ketë marrë nga indianët. Patjetër, se ai rrinte shume me ta. Megjithëse ata tregoheshin kafshë me të, nuk e linin të bënte as gjëra të tjera, të cilat i bëjnë djemtë. Por kjo, në njëfarë mënyre ishte një gjë e mirë, sepse kështu mua m'u bë më e lehtë që ta kushtëzoj nga pak. Megjithatë nuk e keni idenë sa e vështirë ka qenë. Ka kaq shumë gjëra që s'i di njeriu; nuk e kam pasur për detyrë t'i dija. Dua të them se, kur një fëmijë të pyet se si punon helikopteri apo kush e bëri botën - epo më thuaj kush di t'i kthejë përgjigje, kur je thjesht një Beta që përherë ka punuar në Dhomën e Fekondimit? Kush je ti, që të japësh mend?

KAPITULLI VIII

Jashtë, në pluhur dhe mesin e plehrave (ishin bërë katër qen), Bernardi dhe Xhoni shkonin lart e poshtë me ngadalë.
–Është kaq e vështirë për mua që ta përfytyroj, - po thoshte Bernardi, - ta rindërtoj me mend. Thua se jetojmë në planetë të tjerë dhe në shekuj të ndryshëm. Një nënë, dhe gjithë ky pisllëk, zotat, pleqëria, sëmundjet... - tundi kokën. - Është gati e pabesueshme. Dhe nuk kam për ta kuptuar kurrë nëse as ti nuk ma shpjegon dot.
- Të të shpjegoj çfarë?
- Këtë, dhe bëri me shenjë nga fshati. - Atë. - Dhe bëhej fjalë për shtëpinë e vogël jashtë fshatit. – Gjithçka. Gjithë jetën tuaj.
- Po ç'ka këtu për t'u treguar?
- E dua nga fillimi. Aq sa mban mend.
- Aq sa mbaj mend unë? - ngrysi vetullat Xhoni. Ra një heshtje e gjatë.
Ishte shumë vapë. Kishin ngrënë katër tortija dhe misër të ëmbël. Linda tha: "Hajde e shtrihu pak, zemër," dhe ata u shtrinë të dy bashkë në shtratin e madh. "Këndo," - dhe Linda ia këndoi: "Streptokoku G tek Banburi T, që të kesh tamam një V. C". I këndoi edhe "Mirupafshim zemër, shpejt do të filtrohesh." Dhe zëri i saj u shua dhe u shua...

Plasi një zhurmë e fortë dhe ai u zgjua. Një burrë po qëndronte në këmbë para shtratit, qe i madh dhe të shtinte frikën. Ai po i thoshte diçka Lindës, kurse ajo po qeshte. Ajo e ngriti batanijen deri te mjekra, por njeriu e tërhoqi prapë poshtë. Flokët i kishte si dy copa litari të zi dhe rreth krahut mbante një byzylyk të bukur prej argjendi me gurë blu. Atij i pëlqeu byzylyku; ndonëse kishte frikë; fshehu fytyrën pas trupit të Lindës. Linda i hodhi dorën përsipër dhe ai u ndie më i mbrojtur. Me fjalët e tjera, që ai nuk i kuptoi aq mirë, e dëgjoi të thoshte: "Jo me Xhonin këtu." Burri pa herë atë e herë nga Linda dhe tha disa fjalë me zë të butë. Linda i tha jo, por burri u përkul mbi shtrat drejt tij dhe fytyra gjigante qe e llahtarshme; litarët e trashë e të zinj të flokëve prekën mbulesën.
- Jo, i tha Linda prapë, kur ai ndjeu duart e saj ta shtrëngonin më fort. - Jo, jo! - Por burri e mbërtheu Xhonin nga njëri krah, aq sa i dhembi dhe e ngriti lart. Linda nuk e lëshonte nga adora dhe thoshte: - Jo, jo! - Burri i tha shkurt ca fjalë gjithë inat dhe ajo e lëshoi. - Linda, Linda. - Ai ia rrasi me shqelm dhe u përdrodh; por burri e çoi në krahë deri te porta, e nxori jashtë, e la përtokë në dysheme në dhomën tjetër dhe u kthye mbrapsht duke përplasur portën pas vetes. Ai u ngrit në këmbë dhe vrapoi drejt portës. Në majë të gishtërinjve ia doli ta kapë dorezën e drunjtë. E ngriti lart dhe shtyu portën, por nuk u hap. - Linda! - bërtiti ai.
Ajo nuk u përgjigj.
Ai mbante mend një dhomë të madhe, goxha të errët; dhe kishte aty shumë gjëra të stërmëdha prej druri me fije të lidhura përreth, edhe shumë gra pranë tyre - "thurin mbulesat", - i kishte thënë Linda. Ajo i tha atij të zinte një

qoshe si me fëmijët e tjerë, ndërsa vetë shkoi të ndihmojë gratë. Ai luajti gjatë me djemtë e vegjël. Befas, njerëzit filluan të flasin me zë të lartë dhe ai pa disa gra që po shtynin Linden tutje, ajo po qante. Ajo vrapoi më pas te porta dhe ai iu turr nga pas. E pyeti pse u zemëruan ato, ajo i tha: "Theva unë një gje." Pastaj u nxeh edhe ajo. "Nga ta di unë si bëhet kjo endja e tyre prej kafshësh. Kafshët e pyllit." Ai e pyeti se çfarë ishin keto kafshët e pyllit. Kur u kthyen në shtëpi, Popi po i priste tek porta dhe të gjithë bashkë hynë brenda. Ai kish me vete një pagurë të madhe të mbushur plot me një gjë që ngjante si ujë; vetëm se nuk qe ujë, por një gjë që binte erë të keqe, të digite gojën e të bënte të kolliteshe. Linda piu ca, edhe Popi piu; pastaj Linda qeshi shumë e me zë të lartë; dhe pastaj ajo me Popin u ngritën të shkojnë në dhomën tjetër. Kur Popi hyri brenda, Linda ishte në shtrat; ajo ra në gjumë aq shpejt sa ai nuk e zgjoi dot.
Popi vinte shpesh. Ai i tha se gjëja në pagur quhej *meskall*; por Linda tha se duhej të quhej soma; përveç se të bënte të ndiheshe keq të nesërmen. Ai e urrente Popin. I urrente të gjithë të gjithë burrat që vinin e takonin Lindën. Një pasdite, kur ai po luante me fëmijët e tjerë - ishte ftohtë, këtë e mbante mend dhe maleve kishte dëborë - u kthye në shtëpi dhe dëgjoi një sherr që vinte nga dhoma e gjumit. Ishin zëra femrash dhe flisnin fjalë që s'i kuptoi; por e dinte se ishin fjalë shumë të këqija. Pastaj papritur, një kërcitje! Diçka u përmbys; dëgjoi njerëz që lëviznin me vërtik dhe pastaj u dëgjua edhe një kërcitje tjetër dhe zhurma e diçkaje, sikur po godisnin një mushkë, vetëm se jo aq zhurmë e thatë; atë çast Linda klithi. "Jo, mos, jo!" - tha ajo. Ai u fut brenda me vrap. Ishin tre gra me mbuloja të errëta, Linda ishte mbi shtrat. Njëra prej

grave po e mbante nga kyçet e duarve. Një tjetër mbi këmbë që të mos hidhte shqelma. E treta po e rrihte me kamxhik Një herë, dy herë, tri herë; e për çdo herë Linda bërtiste. Ai u var pas thekëve të mbulojës së gruas. "Të lutem, të lutem!" Me dorën që kishte të lirë ai e shtyu tutje. Kamxhiku i ra prapë e prapë, Linda bërtiste. Ai e mbërtheu dorën bojëkafe të gruas me dy të vetat dhe e kafshoi me gjithë shpirt. Ajo klithi me zë, çliroi dorën dhe i dha një të shtyrë aq të fortë, sa e hodhi përdhe. E kur ai qe i shtrirë në dysheme, e fshikulloi tri herë me kamxhik. I dhembi më shumë se çdo gjë që kishte ndjerë ndonjëherë - digjte si zjarri. Kamxhiku fishkëlleu përsëri, fap. Por kësaj radhe qe Linda ajo që bërtiti.
- Linda, pse duan të të bëjnë keq ty? - e pyeti ai atë natë. Ai po qante, sepse vragat e kuqe të kamxhikut mbi shpinë i dhembnin prapë për tmerr. Por po qante edhe se njerëzit ishin kaq kafshë, të padrejtë dhe ai ishte veç një djalë i vogël e nuk u bënte dot asgjë. Linda po qante edhe vetë. Ajo ishte e rritur tamam, por jo aq e fortë sa të luftonte me tri gra. S'ishte as e drejtë. Po pse duan të të bëjnë keq ty, Linda? - Nuk e di. Nga ta di? - Linda mezi dëgjohej, se qe shtrirë përmbys dhe fytyrën e kishte ngjeshur në jastëk. "Ato më thonë se ata burra janë burrat e tyre, - vazhdoi ajo; dhe dukej sikur nuk po fliste fare me të; dukej sikur po fliste me dikë tjetër brenda vetes. Një bisedë e gjatë që ai nuk e kuptonte; dhe në fund fare nisi të qajë me kujën më të madhe që mund të kishte lëshuar ndonjëherë.
- Mos qaj Linda, mos qaj.
Iu ngjit pas trupit. I hodhi krahun rreth qafës.
- Mos, kujdes, supin! Oho! - bërtiti Linda dhe e shtyu tutje me forcë. Koka kumboi kur u përplas pas murit. -

Idiot! i bërtiti ajo, e pastaj, papritur, zuri ta rrahë me shpulla. Pam, pam...
Linda, i bërtiti ai. - Mos më rrih, mami!
Unë nuk jam mamaja jote. Nuk do të jem asnjëherë
mamaja jote.
-Linda, po... Oh! - E ia futi me shpullë në faqe.
- Jam kthyer në një egërsirë, - klithi ajo. - Bëj dhe unë këlyshë si kafshët... po të mos ishe ti, do kisha shkuar tek Inspektori dhe do të arratisesha. Por me bebe jo. Ky do të ishte turpi më i paparë ndonjëherë.
Ai e pa që do ta qëllonte përsëri dhe ngriti duart të mbrohej në fytyrë.
Oh, Linda mos më, mos më!
Egërsirë! - Ajo ia uli duart poshtë dhe fytyra i mbeti e zbuluar.
- Mos, Linda, mos më! - Ai mbylli sytë, priti shpullën e saj.
Por ajo nuk i ra. Pasi kaloi pak, ai i hapi sytë dhe pa se ajo po e vështronte. Ndaj bëri një si buzagaz. Krejt papritur për të, ajo e mbështolli me krahët e saj dhe nisi ta puthë.
Ndonjëherë, për ditë me radhë, Linda nuk ngrihej fare nga shtrati. Rrinte shtrirë nga dëshpërimi. Ose përndryshe pinte nga ajo gjëja që i pati sjellë Popi, qeshte mirë e mirë dhe binte prapë në gjumë. Nganjëherë ishte sëmurë. Shpesh ajo harronte ta lante atë dhe ai nuk kishte asgjë tjetër për të ngrënë përveç tortijave të ftohta. Atij i kujtohej hera e parë kur ajo kishte gjetur ato kafshët e vogla nëpër flokë dhe si i bërtiste e i bërtiste.
Kohët më të lumtura qenë kur ajo i tregonte për Vendin Tjetër. "Dhe atje mund të fluturosh ku të ta ketë qejfi."

"Ku të ta ketë qejfi."- Pastaj ajo i tregonte për muzikën e këndshme që dilte prej një kutie, lojërat e bukura që luanin, gjërat e shijshme që hanin e pinin dhe dritën që vinte kur njeriu shtypte atë gjënë e vogël që rrinte në mur, fotografitë që mund t'i shikoje, prekje e nuhasje, njëlloj siç i shihje, edhe për një kuti tjetër që nxirrte aroma të mira, për shtëpitë bojë rozë, blu, jeshile, për ato bojë argjendi të larta sa malet, edhe se si të gjithë ishin të lumtur e askush nuk dëshpërohej, kur çdokush i përkiste gjithkujt, edhe për kutitë ku mund të shikoje e dëgjoje se çfarë bëhej në anën tjetër të botës, edhe për bebet nëpër shishet e bukura e të pastra - çdo gjë kaq e pastër, asnjë erë të shpifur, asnjë fije pluhur - edhe për njerëzit që nuk mbeteshin kurrë të vetmuar, por duke jetuar të gjithë bashkë të gëzuar e të lumtur, si mbrëmjet e vallëzimit në Malpais, por shumë më të lumtura; dhe për lumturinë që ndieje nga të qenët aty përditë, për çdo ditë... ai e dëgjonte me orë të tëra. Dhe, ndonjëherë, kur ai dhe fëmijët e tjerë ishin shumë të lodhur për të luajtur, një prej pleqve të fshatit u fliste fjalët e tjera, për Transformuesin e Botës, dhe për luftën e gjatë mes Dorës së Majtë e Dorës së Djathtë, mes Lagështirës e Thatësirës; për Auonauilonën, i cili bëri një mjegull të madhe nga të menduarit natën dhe pastaj krijoi të gjithë botën prej kësaj mjegulle; për Nënën Tokë e Atin Qiell; për Ahajutën dhe Marsailemën, binjakët e Luftës dhe Fatit; për Krishtin dhe Pukongun; për Marinë dhe Etsanatlehin, gruan që e rinon përsëri veten; për Gurin e Zi te Laguna dhe për shqiponjën e madhe, Zonjën Tonë të Akomas. Histori të çuditshme, edhe më të mrekullueshme për të, se thuheshin me fjalë të tjera që nuk i kuptonte aq mirë. Kur shtrihej në shtrat, ai mendonte për Parajsën dhe

Londrën, Zonjën Tonë të Akomas, edhe për vargjet sërë- sërë të bebeve kërpë, shishet e pastra; Krishtin që fluturonte lart, Lindën që fluturonte lart dhe për Drejtorin e Madh të Çerdheve të Botës e Auonauilonën.
Shumë burra vinin për ta takuar Lindën. Djemtë nisën t'ia bëjnë atij me gisht. Me ato fjalët e çuditshme që flisnin ata, thoshin se Linda ishte e keqe; ata i ngjitën asaj emra që ai nuk i kuptonte, por e dinte mirë se ishin emra të këqij. Një ditë i kënduan edhe një këngë vetëm për të, e përsëritën dhe e përsëritën. Ai u qëlloi me gurë. Ata ia kthyen; një gur i mprehtë e çau në faqe. Gjaku s'pushonte; ai u mbulua krejt me gjak.
Linda i mësoi të lexojë. Ajo mori një copë qymyri dhe vizatoi në mur figura: një kafshë e ulur, një bebe brenda në shishe; pastaj i shkroi germat. Macja është në qilim. Kalamani në djep. Ai e mësoi shpejt e pa u lodhur. Kur mësoi të shkruajë e të lexojë të gjitha fjalët që ajo shkroi në mur, Linda nxori nga sënduku prej druri pantallonat e shkurtra të kuqe që nuk i vishte kurrë, e prej tyre një libër të vogël e të hollë. Ai e kishte parë edhe më parë, "Kur të rritesh do ta lexosh," - i pati thënë ajo. Epo, ja pra që tani ishte bërë i madh sa duhej. Ishte krenar. "Kam frikë se nuk do të të duket shumë ngazëllues, - tha ajo. Por është e vetmja gjë që kam, - i tha me psherëtimë. - Vetëm t'i shikoje makinat e bukura të leximit që kishim në Londër!" Ai nisi ta lexojë. *Kushtëzimi kimik dhe bakteriologjik i embrionit. Udhëzime praktike për Punëtorët Beta të Magazinës së Embrioneve*. I mori një çerek ore që të lexonte vetëm titullin. Ai e hodhi librin në dysheme. "Libër i shëmtuar, i shëmtuar!" - tha ai dhe nisi të qajë.

Djemtë ende e këndonin atë këngën e tmerrshme për Linden. Ndonjëherë, edhe ata vetë, e përqeshnin pse ishte kaq i leckosur. Kur i griseshin rrobat, Linda nuk dinte si t'i arnojë. Te Vendi Tjetër, i thoshte ajo, njerëzit i hidhnin tej rrobat me vrima dhe vishnin të reja. "Zhele! Zhele! e tallnin djemtë. Por unë di të lexoj,- i thoshte ai vetes, - ata s'dinë. As nuk e dinë fare se çfarë është leximi." Ishte kollaj për të, sa herë që fillonin me tallje, të mendonte për leximin dhe të bënte kinse ata nuk i bënin fare përshtypje. Shkonte te Linda dhe ia kërkonte librin përsëri.
Sa më shumë që djemtë e tregonin me gisht dhe këndonin, aq më shumë lexonte ai. Shumë shpejt ia doli të lexojë fjalët fare mirë. Edhe ato më të gjatat.
- Por çfarë kuptimi kanë? - e pyeti Linden; por ajo edhe kur përpiqej t'ia shpjegonte nuk ia bënte shumë të qartë. Se në përgjithësi ajo nuk dinte fare të kthente përgjigje. - Çfarë janë kimikatet? - e pyeste ai.
- Oho, janë kripëra magnezi dhe alkool që t'i mbajnë Deltat dhe Ypsilonët të vegjël e të prapambetur, edhe karbonat kalciumi për kockat, gjëra të tilla.
Po si bëhen kimikatet, Linda? Nga vijnë? Epo, nuk e di. Ne i marrim ato nga shishet. Dhe kur shishet zbrazen i çojmë te Dyqani i Kimikateve dhe marrim të tjera. Ma ha mendja se i bëjnë ata njerëzit tek Dyqani i Kimikateve. Ose dikush tjetër që ata e çojnë në fabrikë. Nuk
e di. Nuk kam mësuar kurrë kimi. Puna ime e përhershme ishin embrionet.
Kështu shkonte me gjithë gjërat që dëshironte të dinte. Linda dukej se nuk dinte asgjë. Pleqtë e fshatit kishin shumë më tepër përgjigje të sakta.

"Fara e njeriut dhe e gjithë krijesave, fara e diellit dhe fara e tokës, fara e qiellit - Auonauilona i bëri të gjitha prej Mjegullës së Shumimit. Tani, bota ka katër mitra; dhe ai i lëshoi farat thellë brenda mitrës së katërt, më të ulëtës. E gradualisht farat nisën të rriten..."
Një ditë (Xhoni pati llogaritur më vonë se i binte diku pas ditëlindjes së tij të dymbëdhjetë), kur hyri në shtëpi, gjeti të hedhur përdhe në dyshemenë e dhomës së gjumit një libër që nuk e kishte parë kurrë më parë. Qe një libër i trashë dhe ngjante shumë i vjetër. Qoshet e lidhjes ia kishin brejtur minjtë; disa faqe i kishin humbur, disa qenë të zhubrosura. Ai e mori nga toka dhe pa titullin e kopertinës: libri quhej *Vepra e plotë e Uilliam Shekspirit.*
Linda qe shtrirë në shtrat duke pirë me surba nga një kupë atë të shpifurën meskall, që qelbte erë. “E solli Popi," - tha. Zëri i saj qe i trashë dhe i ngjirur sikur të ishte zëri i dikujt tjetër. - Kish mbetur në një prej sëndukëve të Antelope Kivasit. Thuhet se ka qëndruar atje prej qindra vitesh. Ma ha mendja që kjo është e vërtetë, ja shikoje vetë, duket se është i mbushur plot me gjëra pa kuptim. I paqytetëruar. E megjithatë, për ty është mirë se praktikon leximin." Ajo thithi surbën e fundit, e la kupën poshtë në dysheme pranë vetes në anë të shtratit, u kthye mënjanë, e mori lemza edhe dy a tri herë dhe ra në gjumë. Ai e hapi librin ku ia zuri dora.

Jo vetëm, por të jetosh
Në shtrojën e djersës së shtratit të shthurur
Ishterur në prishje, ëmbëltuar dhe duke bërë dashuri
Mbi një thark të ndyrë....

Fjalët e çuditshme u rrokullisën nëpër mendjen e tij; gjëmuan si gjuha e rrufesë; si daullet e valleve të verës, sikur daullet të kishin gojë; si burrat kur këndonin Këngën e Misrit, kaq bukur, kaq bukur, sa të qaje; si Mitsima plak kur u këndon magji puplave të veta, shkopit të gdhendur, copëzave të kockave dhe gurëve - *kiathla tsilu silokue silokue silokue. Kiaisilu silu, tsithl*- por më e mirë se magjia e Mitsimës, sepse kishte kuptim më shumë, sepse i fliste atij; thoshte mrekullisht dhe vetëm gjysmë me kuptim, një magji të tmerrshme shumë të bukur, fliste për Linden; për Linden e shtrirë aty duke gërhitur, ndanë një kupe të zbrazët në anë të shtratit; për Lindën dhe Popin, Lindën dhe Popin.
Ai e urrente Popin përherë e më shumë. *Njeriu ia del të buzëqeshë e të buzëqeshë e prapë të jetë kopuk. I pamëshirshëm, tradhtar, epsharak, kopuk shpirtlig.* C'thoshin vallë ato fjalë? Ai kuptonte vetëm gjysmën. Por magjia e tyre qe e fortë dhe endej nëpër mendjen e tij dhe megjithatë iu bë sikur vërtet nuk e kishte urryer kurrë më parë Popin; nuk e kishte urryer kurrë më parë sepse nuk kishte qenë kurrë i aftë ta thoshte me fjalë se sa shumë e urrente. Por tashmë kishte këto fjalët, këto fjalë si daulle, dhe këngë, dhe magji. Këto fjalë dhe historinë e habitshme nga e cila ishin nxjerrë (ai nuk a ndante dot mendjen për këtë, por ato ama gjithsesi ishin të mrekullueshme, të mrekullueshme) - ato i dhanë arsye për ta urryer Popin; dhe e bënë urrejtjen më të vërtetë; e bënë edhe vetë Popin më të vërtetë.
Një ditë, kur u kthye nga loja, porta e dhomës së brendshme qe hapur dhe i pa të dy shtrirë bashkë në shtrat

duke fjetur - Linda e bardhë dhe Popi i zi, me njërin krah poshtë supeve të saj e tjetrin në gjinj; e me një prej plinteve të flokëve të gjatë në qafën e saj, si një gjarpër i zi që po përpiqej ta mbyste. Paguri i Popit dhe një kupë ishin në dysheme pranë shtratit. Linda gërhiste.
Sikur iu shkul zemra dhe i la një vrimë në gjoks. Ndihej bosh. Bosh dhe akull i ftohtë, iu bë si për të vjellë, iu morën mendtë. U mbështet pas murit për të marrë veten.
Të pamëshirshme, tradhtare, epsharake... si daulle, si burrat kur i këndonin misrit, si magji, fjalët përsëriteshin e përsëriteshin brenda kokës së tij. Nga akull i ftohtë, papritur, u ndje valë i nxehtë. Faqet i dogjën nga vërshimi i gjakut, dhoma gumëzhiu dhe u err përpara syve të tij. Kërcëlliu dhëmbët. "Do ta vras, do ta vras, do ta vras," - përsëriste. E ashtu befas erdhën fjalë të tjera.

Kur ai fle i dehur, apo në inat
Apo zhytur në kënaqësitë e incestit në shtrat...

Magjia ishte në anën e tij, magjia shpjegonte dhe jepte urdhra. Ai u kthye në dhomën e jashtme. "Kur ai fle i dehur..." Thika e mishit qe petë në dysheme, pranë vatrës së zjarrit. Ai e mori në dorë e doli majë gishtave prapë nga porta. "Kur ai fle i dehur, fle i dehur..." E kaloi dhomën me vrik dhe ia nguli - oh, gjaku! - ia nguli prapë, ndërsa Popi përpiqej të zgjohej, e ngriti dorën t'ia ngulë edhe një herë tjetër, por pa veten me kyçin e dorës të mbërthyer, të ngecur lart - oh, oh! - të përdredhur. Nuk lëvizte dot, qe në grackë, dhe sytë e zinj e të vegjël të Popit ngulur përballë syve të tij. Pa tutje. Dy të prera kishte shpatulla e majtë e

Popit. "Oh, shiko, gjak! - filloi të qajë Linda. - Gjak!" Ajo nuk ia kishte dalë kurrë ta durojë pamjen e gjakut, Popi ngriti dorën tjetër - për ta goditur, mendoi ai. Shtangu duke pritur grushtin. Por dora veç sa e kapi për mjekre dhe i drejtoi fytyrën nga Popi që sytë të haseshin prapë ballë për ballë. Për një kohë të gjatë, çaste që zgjatën me orë e me orë të tëra. Dhe papritur - s'e mbajti dot veten -- filloi të qajë. Popi ia plasi gazit. "Ik, - i tha ai me fjalë indianësh. - Ik, Ahajuta im guximtar!" Ai vrapoi drejt dhomës tjetër për të fshehur lotët.
- Ti u bëre pesëmbëdhjetë, - i tha Mitsima me fjalë indianësh.
- Tani mund të të mësoj të punosh baltën. Galiç në anë të lumit, ata punuan së bashku.
-- Para së gjithash, - tha Mitsima, duke marrë një plis argjile të njomë në dorë, do të bëjmë një hënë të vogël. Plaku e shtypi plisin, e bëri si disk, pastaj ia përveshi anët; hëna u bësi një kupë e cekët.
Ngadalë e i pazoti, ai imitoi lëvizjet delikate të plakut. - Një kupë hëne dhe tani një gjarpër. - Mitsima rrokullisi një plis tjetër argjile duke e bërë si një cilindër të gjatë, e përkuli si rreth dhe e ngjeshi buzëve të kupës. - Pastaj edhe një gjarpër tjetër. Edhe një tjetër. Edhe një tjetër. Dora-dorës, Mitsima ngriti anët e tasit; qe i ngushtë, i fryrë, edhe ngushtohej përsëri duke u ngjitur drejt qafës. Mitsima shtypi dhe rrahu, ngjeshi dhe kroi; dhe ja më në fund qëndroi, me formën e enës së zakonshme të ujit për Malpaisin, por ngjyrë e bardhë krem në vend që të ishte e zezë, dhe ende e butë në të prekur. Imitimi i keq i Mitsimës

dhe origjinali i tij qëndruan krah për krah. Duke parë nga të dy tasat, ai nuk e mbajti të qeshurën.
- Ama tjetrin do ta bësh më mirë, - tha ai dhe zuri të
njomte një tjetër plis argjili.
Modelimi, dhënia formë, të parët e gishtave të vet teksa përfitonin shkathtësi dhe fuqi - gjithë këto i dhanë një kënaqësi të jashtëzakonshme. "A, B, C, vitamina D,"- këndonte me vete ndërsa punonte, "Dhjami ndodhet në mëlçi, merluci në det." Edhe Mitsima këndoi me të - një këngë për vrasjen e një ariu. Ata punuan gjithë ditën dhe e gjithë dita qe e mbushur me një lumturi të fortë e rraskapitëse.
Dimrin tjetër, tha plaku Mitsima, - do të të mësoj të bësh harkun e shigjetës.
Ai qëndroi për një kohë të gjatë përpara shtëpisë; ceremonitë në brendësi më në fund kishin mbaruar. Porta u hap dhe ata dolën jashtë. Kothluja erdhi i pari, me dorën e djathtë të zgjatur përpara e pëllëmbën të shtrënguar fort, thua se po mbante aty ndonjë xhevahir të çmuar. Me dorën e mbledhur dhe krahun të zgjatur po njëlloj, atë e ndiqte Kiakimeja. Ata ecën në heshtje, dhe po ashtu të heshtur pas tyre erdhën vëllezër, motra e kushërinj dhe gjithë trupa e pleqve. Ata dolën nga fshati përmes pllajës. Në qoshe të shkrepit ndalën, me fytyrat kthyer nga dielli që po lindte. Kothluja hapi dorën. Në mes të pëllëmbës kishte një pak miell misri të bardhë; ai mori frymë mbi miell, murmuriti ca fjalë, pastaj e hodhi atë dorë me pluhur të bardhë në drejtim të diellit. Kaikimeja bëri të njëjtin gjest. Më pas doli përpara babai i Kiakimes dhe duke mbajtur lart një shkop faljesh të

mbështjellë me pupla, bëri një lutje të gjatë, pastaj e hodhi
shkopin pas miellit të misrit.
- U krye, - tha Matsima me zë të lartë. Tani janë të
martuar.
di të them vetëm kaq, shumë zhurmë për asgjë. Në vendet e - Epo mirë,- tha Linda ndërsa ata po
largoheshin,-unë qytetëruara, kur një djalë do të shkojë me një vajzë, i duhet
vetëm... Po ti Xhon, ku po shkon?
Ai nuk ia vuri veshin thirrjes së saj dhe iku me vrap, me vrap, sa më larg, atje ku të ishte krejt i vetëm.
U krye. Fjalët e plakut Mitsima përsëriteshin pafund në kokën e tij. U krye. U krye... Në heshtje dhe prej shume larg, por me shumë dhimbje, dëshpërim, i pashpresë, ai e dashuronte Kiakimën. Dha tani çdo gjë ishte kryer. Ai qe gjashtëmbëdhjetë vjeç.
Kur hëna të qe e plotë, në Antelope Kiva, sekretet do të thuheshin, sekretet do kryheshin e duheshin mbajtur. Ata do të zbrisnin poshtë brenda në kiva si djem dhe do dilnin burra. Djemtë kishin të gjithë frikë e njëkohësisht mezi e prisnin atë ditë. Më në fund u kishte ardhur dita. Dielli shkoi teposhtë, hëna u ngrit lart. Ai shkoi me të tjerët. Burrat qëndronin të zymtë në hyrjen e kivas; shkalla hynte poshtë në thellësitë e ndriçuara nga e kuqja. Menjëherë, djemtë e parë zbritën poshtë. Befas, një burrë i doli përpara, e mbërtheu nga krahu dhe e nxori nga radha. Ai ia hoqi dorën, u çlirua dhe zuri përsëri vendin e tij në rresht me të tjerët. Kësaj radhe burri e goditi, e kapi për flokësh.
-Jo për ty, flokëbardhë! - i tha. - Nuk është kjo për të birin e buçes, - tha njëri nga burrat e tjerë. Djemtë qeshën. - Ik! - dhe ndërsa ai ende priste në skaj pranë grupit: - Ik! -i

bërtitën burrat për herë të dytë. Një prej tyre u përkul, mori një gur dhe ia hodhi. - Ik, ik, ik!" Nisi një shi prej gurësh. I përgjakur ai iku me vrap, thellë në errësirë. Prej kivas me dritën e përskuqur, vinte zhurma e këngëve. Djali i fundit kishte zbritur poshtë shkallës. Ai mbeti vetëm.

Krejt i vetëm, jashtë fshatit, në shkretinë e zhveshur të pllajës së sheshtë. Guri qe si kockë e kripëzuar prej dritës së hënës. Poshtë në luginë, kojotat po i ulërinin hënës. Të vrarat i dhembnin, të çarat i rridhnin gjak, por ai nuk ngashëreu prej dhimbjes; i ndodhi se ishte krejt vetëm, se e kishin përjashtuar, i vetmuar, në këtë botë skeletesh prej guri e drite hene. Në qoshen e pjerrësirës u ul. Hënën e kishte nga pas; pa poshtë në hijen e errët të pllajës, në hijen e errët të vdekjes. I duhej të bënte veç një hap, një kërcim të vogël... Shtriu dorën nga drita e hënës. Nga të prerat në kyçe, gjaku nuk reshtte së rrjedhuri. Për çdo sekondë, një pikë pikonte, e errët, gati e pangjyrë, mes dritës së vdekur. Pikë, pikë, pikë. Nesër e nesër e nesër... Ai kishte zbuluar Kohën, Vdekjen dhe Zotin.

"Vetëm, përherë vetëm," - thoshte i riu. Fjalët zgjuan një jehonë vajtimi në mendjen e Bernardit. Vetëm, vetëm...

Kështu jam dhe unë, tha ai në një valë mirëbesimi. - Tmerrësisht vetëm.

- Edhe ti? - Xhoni dukej i befasuar. - Mendoja se tek Vendi Tjetër... dua të them Linda përherë thotë se askush nuk mbetet kurrë i vetmuar atje.

Bernardi u skuq prej sikletit.

- Po, shiko, - tha duke mërmëritur, me sytë e kthyer

mënjanë, unë jam pak si ndryshe nga të tjerët, me sa ma ha mendja. Nëse një njeri ndodh që të filtrohet ndryshe... - Po, ja kjo është, - pohoi me kokë i riu. - Nëse dikush rastis të jetë ndryshe nga të tjerët, do të jetë domosdo i vetmuar. Të tjerët do të sillen si egërsira. E di ti se më kanë veçuar nga gjithçka? Kur djemtë e tjerë shkuan të flinin lart në male - e ke parasysh, kur shkon të ëndërrosh cila është kafsha më e shenjtë për ty - nuk më lanë të shkoj me ta; nuk ndajnë me mua asnjë prej sekreteve. I kam bërë të gjitha vetë, prapëseprapë, shtoi ai. - Nuk hëngra asgjë për pesë ditë me radhë dhe shkova lart te ata malet atje. - Tregoi ai me gisht nga malet. Bernardi i buzëqeshi në mënyrë prindërore.
-Dhe ëndërrove ndonjë gjë? - e pyeti. Tjetri pohoi me kokë.
- Por nuk duhet të ta them ty se çfarë. - Dhe heshti për pakëz; pastaj, me një zë të ulët, vazhdoi, - njëherë kam bërë një gjë që asnjë tjetër s'e ka bërë: u ngjita në një shkëmb një ditë vere në mes të ditës, edhe hapa krahët, si Krishti në kryq.
- Po për ç'dreqin e bëre këtë?
- Desha të di se si është të jesh kryqëzuar. I varur aty në mes të diellit...
- Po përse?
- Përse? Po ja... - nguroi ai. - Sepse e ndjeva se ashtu duhej. Derisa e duroi Krishti. Edhe pastaj, nëse dikush ka bërë ndonjë gabim... Përveç kësaj, nuk isha i lumtur; ja kjo ishte një arsye tjetër.
- Më duket një mënyrë e habitshme për të shëruar mërzinë, – tha Bernardi. Por me një mendje të dytë, e pranoi

se kjo e kishte njëfarë kuptimi, në fund të fundit. Më mirë se të marrësh *soma*...
- Më ra të fikët njëherë, - tha i riu. - Rashë përtokë me fytyrë. E shikon këtë shenjën ku u çava? - Dhe ngriti flokun e trashë e të verdhë nga balli. Shenja dukej, e zbehtë dhe e rrudhosur, në tëmthin e djathtë.
Bernardi e pa dhe pastaj, shpejt, me një fërgëllimë të lehtë, i hodhi sytë përtej. Kushtëzimi e kishte bërë atë jo aq të dhembshur, sa të dobësohej menjëherë sa t'i vinte për të vjellë. Shfaqja më e thjeshtë e sëmundjeve apo plagëve ishte jo vetëm e llahtarshme, por edhe e neveritshme e për më tepër e shpifur. Si pluhuri, deformimet apo plakja. U ngut e ndryshoi temën e bisedës.
- A do të doje të vish me ne në Londër? - e pyeti, duke bërë lëvizjen e parë në një fushatë, strategjinë e së cilës ai po e përpunonte në mënyrë të fshehtë, qëkur kishte kuptuar, atje te shtëpia e vogël, se mund të ishte babai i këtij djaloshi të ri. – Të pëlqen të vish me ne? Fytyra e të riut ndriti. - Vërtet e keni?
- Sigurisht, nëse unë arrij të të marr leje, pse jo? - Edhe Linda?
- Epo... - ngurroi ai plot dyshim. Ajo krijesë për të vjellë! Jo, ishte e pamundur. Vetëm nëse, nëse... papritur Bernardit i shkoi ndërmend që çdo gjë e shpifur mund të ishte një aset i jashtëzakonshëm. - Po, sigurisht! - ia palli me zë, duke u përpjekur të ndreqë ngurrimin fillestar me një dashamirësi të tepruar e me përzemërsi të zhurmshme. I riu mori frymë thellë.
- Të mendosh që mund të bëhet e vërtetë - këtë që kam ëndërruar gjithë jetën. Të kujtohet se çfarë thotë Miranda?

- Kush është Miranda?
Por mesa duket i riu nuk e dëgjoi pyetjen e tij.
Çfarë mrekullie! - tha ai; edhe sytë iu mbushën me lot, fytyra iu skuq flakë. Sa krijesa të perëndishme që ka! Sa e përkryer për nga bukuria është raca njerëzore. - Përskuqja papritur u përflak më tepër; ai po mendonte për Leninën, si për një engjëll brenda një viskoze të gjelbër, me gjithë shkëlqimin e rinisë, ushqimin e zgjedhur, të kolmen, buzëqeshjen dashamirëse. Zëri iu ligështua. - O më e mira e botëve, - nisi të thotë, pastaj befas i ndërpreu vetë fjalët; gjaku iu largua nga faqet; u bë i zbehtë meit. - Jeni martuar ju të dy? - e pyeti Bernardin.
- Ne jemi çfarë?
- Martuar. Më kupton... përgjithmonë. Ashtu thonë ata me fjalë indiane përgjithmonë; që nuk prishet më.
- Mos, pasha atë Ford! - Bernardi nuk e mbajti dot të qeshurën.
Edhe Xhoni qeshi, por me një tjetër arsye. Qeshi prej gëzimit të kulluar.
O më e mira botëve,
përsëriti ai. - O më e mira e botëve që mban njerëz të tillë mbi vete. Nisemi që tani.
-Ti ke një mënyrë krejt tënden të të folurit, ndonjëherë, -tha Bernardi, duke kundruar të riun, i hutuar e në mëdyshje. - Edhe, sido që të shkojë, nuk të duket më me vend të durosh edhe ca, derisa ta shohësh me sytë e tu botën
e re?

KAPITULLI IX

Leninës iu duk krejt i merituar, pas kësaj dite çudish dhe tmerresh, një pushim absolut. Sapo u kthyen te shtëpia e pushimit, ajo kapërdiu gjashtë tableta gjysmëgramëshe soma, u shtri në shtrat dhe brenda dhjetë minutave i hipi anijes së ëndrrave. Do të duhej të kalonin të paktën tetëmbëdhjetë orë që ajo të vinte sërish me këmbë në tokë.
Bernardi ndërkohë rrinte shtrirë mendueshëm, me sytë
e hapur në terr. U desh të kalonte mesnata para se ta zinte gjumi. Shumë pasi kishte kaluar mesnata, pagjumësia i kishte dhënë frytet e veta; ai e kishte një plan.
I përpiktë, në dhjetë të mëngjesit të së nesërmes, i njëjti oktoron me rrobën e gjelbër zbriti prej helikopterit. Hemardi po e priste mes agaveve.
- Zonjusha Kroun ka ikur me pushime-soma, - i shpjegoi atij. - Zor se vjen në vete para orës pesë. Kjo na jep neve shtatë orë kohë.
Ai mund të fluturonte për në Santa Fe, të mbaronte gjithë punët e veta dhe të kthehej në Malpais para se ajo të zgjohej.
- A do të jetë e sigurt këtu e vetmuar?
- E sigurt sa helikopterët, e siguroi oktoroni. Ata i hipën makinerisë dhe u nisën menjëherë. Në orën

dhjetë e tridhjetë u ulën në tarracën e Zyrave të Postës në Santa Fe; më dhjetë e tridhjetë e shtatë Bernardi kishte kaluar në Zyrën e Kontrollorit të Botës në Uajtholl; me dhjetë e tridhjetë e nëntë po fliste me sekretaren numer katër të lartfordësisë së tij; më dhjetë e dyzet e katër po përsëriste historinë me sekretaren e parë, dhe më dhjetë e dyzet e shtatë e gjysmë ishte zëri i thellë e rezonant i vetë
Mustafa Mondit që i tingëlloi në veshë.
-Guxova të mendoj, - belbëzoi Bernardi, - se lartfordësia juaj mund të ketë për këtë çështje interes të mjaftueshëm
shkencor...
- Po, më duket me interes të mjaftueshëm shkencor, - tha zëri i thellë. - Silli me vete këta dy individë këtu në
Londër.
-Lartëfordësia juaj është në dijeni se unë kam nevojë për një leje të veçantë...
- Urdhëresat e nevojshme, - tha Mustafa Mondi, - po mbërrijnë te Kujdestarët e Rezervatit gjatë këtyre çasteve. Ju duhet të veproni menjëherë te Zyra e Kujdestarit. Ditën e mirë, zotni Marksi.
Ra heshtja. Bernardi e uli receptorin dhe ia mbathi drejt
tarracës.
- Te Zyra e Kujdestarit, -i tha oktoronit Gama bojëjeshil. Më dhjetë e pesëdhjetë e katër, Bernardi po shtrëngonte dorën me Kujdestarin.
- Gëzohem, zotni Marks, gëzohem. - Zëri i tij ishte i përulur. Sapo na mbërritën urdhëresat speciale...
- E di, - i tha Bernardi me superioritet. - Sapo qeshë duke folur me lartfordësinë e tij në telefon. - Zëri i tij i bezdisur la të nënkuptonte se ishte e zakonshme që ai të

fliste me lartfordësinë e tij çdo ditë të javës. U ul rëndë në një karrige. Nëse mundeni, ju lutem, të merrni gjithë masat e nevojshme, sa më shpejt të jetë e mundur... Sa më shpejt të jetë e mundur..." - e përsëriti ai prerë. Po kënaqej
shumë.
Më njëmbëdhjetë e tre, i kishte të gjitha letrat e nevojshme në xhep.
-Mirupjekshim,- i tha tërë begenisje kujdestarit, i cili e shoqëroi deri te qepenat. - Mirupjekshim.
Ai u kthye në hotel, bëri një banjë, një masazh vibrovakumi, i futi një të rruar elektrolike, dëgjoi lajmet e mëngjesit, pa televizor për rreth gjysmë ore, hëngri ngeshëm drekë, dhe në orën dy e gjysmë fluturoi mbrapsht me oktoronin drejt Malpaisit.
I riu po qëndronte jashtë shtëpisë së pushimit. "Bernard, - thirri ai. Bernard!" - nuk u përgjigj njeri.
Pa bërë zhurmë me mokasinat e veta prej lëkure dreri, ai kërceu shkallët dhe provoi të hapte portën. Ishte e mbyllur. Kishin ikur! Kjo ishte gjëja më e tmerrshme që i kishte ndodhur ndonjëherë. Ajo i kishte kërkuar ta takonte aty, kurse tani paskësh ikur. U ul tek shkallët dhe nisi të qante.
Gjysmë ore më pas i ra ndërmend të shohë brenda dritares. Gjëja e parë që i ra në sy ishte një valixhe e gjelbër me inicialet L. K. të ngjyrosura mbi kapak. Gëzimi iu ndez përbrenda si fishekzjarr. Mori një gur në dorë. Xhami i thyer tringëlliu mbi dysheme. Pas një çasti ishte brenda në dhomë. E hapi valixhen e gjelbër; dhe në çast nuhati parfumet e Leninës dhe mbushi mushkëritë me thelbin e vetë qenies së saj. Zemra i rrahu fort; për një çast sa nuk

i ra të fikët. Pastaj, i përkulur mbi kutinë e vyer, e preku, e ngriti lart kundrejt dritës, e ekzaminoi. Zinxhiri i palës rezervë të pantallonave të shkurtra prej kadifeje viskoze të Leninës në fillim iu duk si enigmë, pastaj, kur e zgjidhi, çfarë çlirimi. Zip, edhe pastaj zap, hap e fap, mbyll; paqu kënaq. Pantoflat e saj të gjelbra qenë gjëja më bukur që i kishte zënë syri. Shpalosi një palë të linjta me zinxhir esa i pa u skuq spec dhe i hoqi mënjanë vetëtimthi; por e puthi një shami duarsh prej acetati të parfumosur dhe një shall të lehtë, të cilin e lidhi rreth qafës. Kur hapi një kuti, prej saj iu derdh një re pluhuri me aromë. Duart i qenë pudrosur me gjënë. Ai i fshiu në gjoks, në shpatulla dhe mbi krahët e vet të zhveshur. Parfum kaq erëmirë! Mbylli sytë; fërkoi faqen pas krahut të vet të pudrosur. Preku lëkurën e lëmuar të faqes, nuhati me flegrat e hundës pluhurin erëmyshk - praninë e saj prej vërteti. "Lenina, - pëshpëriti. - Lenina!" Një zhurmë e bëri të hidhej përpjetë e të sillej si i zënë në faj. I ngjeshi të gjitha hajdutllëqet e veta në valixhe dhe e përplasi kapakun për ta mbyllur; pastaj vuri veshin të dëgjojë, vështroi rrotull. Asnjë shenjë jete, asnjë zhurmë. E megjithatë, ai me siguri që kishte dëgjuar diçka - një si psherëtimë, diçka si kërcitje dërrase. Shkoi majë gishtave te porta, me kujdes të madh e hapi, u gjend para një sheshpushimi të gjerë. Në krahun e kundërt të sheshpushimit ishte një portë tjetër, paksa e hapur. Ai bëri përpara, shtyu portën, futi kokën për të parë. Aty, në një shtrat të ulët me çarçafë të hedhur tutje, veshur me një palë pizhame njëpjesëshe ngjyrë rozë, ishte shtrirë Lenina, në gjumë të thellë; ishte kaq e mrekullueshme mes kaçurrelave të veta; kaq fëminore e prekëse me gishtat e mëdhenj të ngjyer

me bojërozë dhe fytyrën solemne të gjumit; kaq e brishtë me duart e mpira e krahët e këputur prej gjumit, sa atij iu mbushën sytë me lot.
Me një pafundësi masash të kota - asnjë kobure nuk do ta zgjonte dot Leninën nga pushimi-soma, pa ardhur ora e caktuar - ai hyri në dhomë e ra në gjunjë përpara shtratit të saj. la nguli sytë, shtrëngoi duart, buzët i lëvrinë. "Sytë e saj," - murmuriti ai,

"Sytë e saj, floku, faqja, ecja, zëri;
Pagare ligjërata, O! Se dora e saj
Në krahasim me të, gjithë të bardhat blozë janë,
Turpin njëlloj shkuan; kur të mbledhin aq butë,
të ashpër e bëjnë të duket dhe zogun e mjellmës..."

Një mizë zukati rrotull saj; ai e trembi me dorë. "Mizat," - iu kujtua atij,

"Në mrekullinë e bardhë të së dashurës dorë të Xhulietës, të
prehem
E të vjedh bekimin e pavdekshëm prej buzëve të saj,
Të cilat, thjesht të dëlira e të panjolla,
Prapë skuqen, veç kur e mendojnë të puthurën faj."

Shumë ngadalë, me gjestin hezitues të njeriut që zgjatet përpara të ledhatojë një zog ikanak e disi të rrezikshëm, ai zgjati dorën. I mbeti varur e dridhur, një inç larg gishtërinjve të saj; në prag të prekjes. A guxonte ai? Guxonte të përdhosë me duart e tij të padenjë... Jo, nuk guxonte. Zogu ishte shumë i rrezikshëm. Dora u mblodh mbrapsht. Sa e bukur ishte! Sa e bukur!

Pastaj papritur u gjend duke menduar se i mjaftonte ta kapte vetëm një herë fort zinxhirin në qafën e saj, e t'i jepte një të tërhequr të fortë, të fortë e të gjatë... mbylli sytë shtrënguar, tundi kokën me gjestin e një qeni që shkund veshët kur ka dalë nga uji. Mendime të neveritshme! I erdhi turp nga vetja. Të dëlira e të panjolla...
Një zukamë erdhi prej së largu. Një mizë tjetër që përpiqej të vjedhë bekimin e pavdekshëm? Një grerez? Vështroi e nuk pa asgjë. Zukama erdhi dhe u bë përherë e më fortë, duke treguar qartë se ndodhej jashtë dritareve të mbyllura. Avioni! Në panik, ai u pengua me këmbët e veta dhe doli te dhoma tjetër, kërceu jashtë përmes dritares së thyer e, duke rendur nëpër shtegun mes agaveve të larta, mbërriti tamam në kohë të dallojë Bernard Marksin teki zbriste helikopterit.

KAPITULLI X

Akrepat e katër mijë sahateve elektrike, nëpër katër mijë dhomat e Qendrës Blumsbëri shënuan të gjithë dy e njëzet e shtatë minuta. "Kjo koshere e industrisë," siç e kishte me qejf ta quante drejtori, ishte në zukatjen e plotë të punës. Që të gjithë ishin të zënë, gjithkush në lëvizje të rregullt. Në mikroskopë, spermatozoidet, me bishtat e gjatë që i lëviznin furishëm, po zhyteshin me kokë në vezë, dhe, të fekonduara, vezët po zgjeroheshin, ndaheshin, ose nëse ishin të bokanovskifikuara, lulëzonin e shpërndaheshin nëpër popullata të tëra embrionesh të veçanta. Nga Dhoma e Kushtëzimit Social, ashensorët rrapëllinin poshtë e lart drejt bodrumit dhe atje, në errësirën e përskuqur, të ngrohtë si supë mbi jastëkët e peritoneumit, të ngopur paq me surrogat gjaku e hormone, fetuset rriteshin e rriteshin, ose, të helmuara, fishkeshin derisa bëheshin gjysmakë Ypsilona. Me rrapëllimë e zukatje të lehtë raftet lëvizëse zvarriteshin, pa rënë në sy përgjatë javëve dhe epokave përsëritëse, për në Dhomën e Filtrimit, ku bebet e reja, teksa nxirreshin nga shishet, lëshonin britmat e para të tmerrit dhe mahnitjes. Dinamot gërhisnin poshtë në bodrumin e parë, ashensorët shkonin e vinin. Në të njëmbëdhjetë katet e çerdhes ishte koha

e ushqimit. Prej njëmijë e tetëqind shishesh, një mijë e tetëqind foshnja të etiketuara me kujdes po thithnin njëkohësisht dozën e vet me sekrecione të jashtme të pasterizuara. Mbi ta, në shtresat e njëpasnjëshme të fjetoreve, vogëlushet e vogëlushët ende aq të vegjël sa ta kishin të nevojshëm gjumin e pasdites, qenë po aq të zënë sa gjithë të tjerët, megjithëse nuk e dinin, në dëgjimin te pavetëdijshëm të leksioneve hipnopedike mbi higjienën dhe shoqëroren, në vetëdijen ndaj klasës dhe jetën dashurore të foshnjave. Mbi to ishin dhomat e lojës, ku, moti ishte bërë me shi, nëntëqind fëmijë më të rritur po kënaqeshin duke bërë modele me plastelinë, duke luajtur lojën “gjuaj me pantofel" ose lodrat erotike.
Bezz! Bezz! Kosherja gumëzhinte, e zënë me punë, plot hare. Plot gaz ishte kënga e vajzave të vogla mbi epruvetat e veta. Kushtëzuesit fishkëllenin ndërsa punonin dhe te Dhoma e Filtrimit, çfarë barcoletash të hatashme po tregoheshin ndanë shisheve të zbrazura! Por fytyra e drejtorit, ndërsa hynte te Dhoma e Fekondimit me Henri Fosterin, ishte varr, e ngurtësuar me një qëndrim të rreptë.
- Një shembull publik, - po u thoshte ai, - kjo dhomë, sepse përmban më shumë punëtorë të kastës së lartë se çdo qendër tjetër. I thashë të më takojë këtu në dy e gjysmë. - Ai punën e vet e bën shumë mirë, ndërhyri Henri me një zemërgjerësi prej hipokriti.
- E di. Por kjo është një arsye më shumë për t'i mbajtur një qëndrim edhe më të rreptë. Eminenca e tij intelektuale mbart me vete përgjegjësitë morale përkatëse. Sa më të mëdha të jenë talentet e njeriut, aq më të mëdha janë fuqitë e tij për të nxjerrë nga rruga e drejtë. Është më mirë të vuajë një njeri, sesa të korruptohen shumë të tjerë. Merreni këtë rast të zhveshur nga

pasioni, z. Foster, dhe do ta shikoni se asnjë shkelje nuk mund të jetë më e urryer se sa sjellja jokonformiste. Vrasësi vret vetëm një individ - dhe, në fund të fundit ç'është individi? - Me një gjest të vetëm, sikur po fshinte diçka, ai tregoi gjithë raftet me epruveta, mikroskopë dhe inkubatorë.
Ne mund të bëjmë të tjerë me lehtësinë më të madhe -sa të na dojë qejfi. Jokonformisti kërcënon më shumë sesa thjesht jetën e një individi; godet vetë Shoqërinë. Po, vetë Shoqërinë, - përsëriti ai. - Aha, ja ku po vjen ai vetë.
Bernardi hyri në dhomë, duke çarë mes rafteve të fekonduesve, shkoi drejt tyre. Një lustër vetëkënaqësie e vetëbesimi e mbulonte trashë nervozizmin e tij. Zëri me të cilin tha:
-Mirëmëngjesi Drejtor, - ishte në mënyrë absurde shumë i lartë. Për të korrigjuar gabimin, ai tha:
- Më kërkuat të flasim bashkë! - Qesharak fare dhe butë, si angullimë.
- Po, z. Marks, tha drejtori me pompozitet. - Unë ju kërkova të vini këtu. Ju u kthyet nga pushimet mbrëmë, me sa di.
- Po, i ktheu përgjigje Bernardi.
- Pooo, tha drejtori duke zgjatur o-të me gjuhën e nxjerrë jashtë sikur të ishte gjarpër. Pastaj befas, duke ngritur zërin, tha: "Zonja dhe zotërinj," e duke e trumbetuar me të madhe tha prapë: "Zonja dhe zotërinj.".
Kënga e vajzave mbi epruveta, fishkëllimat e mikroskopistëve, papritmas ndalën. Kishte një heshtje të thellë; të gjithë vështruan rreth e rrotull.
- Zonja dhe zotërinj, përsëriti Drejtori, edhe një herë tjetër, më falni që po ju ndërpres në punën tuaj. Një detyrë e vështirë më detyroi. Siguria dhe stabiliteti i Shoqërisë janë

në rrezik. Po, në rrezik, zonja dhe zotërinj. Ky njeri,- duke treguar me gisht dhe duke akuzuar Bernardin, - ky njeri, i cili qëndron këtu përpara meje, ky Alfa-plus, të cilit i është dhënë kaq shumë dhe, për këtë rrjedhojë, prej të cilit pritet edhe po aq shumë, ky kolegu juaj - apo mos më duhet të nxitoj e ta them menjëherë ky ish-kolegu juaj e ka tradhtuar rëndë besimin që i është ngarkuar. Me pikëpamjet e tij heretike mbi sportet dhe soma, me jokonformizmin e tij skandaloz në jetën seksuale, me refuzimin që bën ndaj bindjes karshi mësimeve të Fordit Tonë, edhe me sjelljen jashtë orarit të zyrës si "bebe në shishe"; (këtu, drejtori bëri me duar shenjën e T-së) - ai e vërtetoi se është armiki Shoqërisë, një shkatërrimtar, zonja dhe zotërinj, i të gjithë Rregullit dhe Stabilitetit, një komplotist kundër vetë Qytetërimit. Për këtë arsye, unë propozoj ta shkarkojmë me çnderim nga posti që ka mbajtur në këtë qendër; propozoj që të aplikojmë menjëherë për transferimin e tij në një Nënqendër më të ulët, asisoj që ky ndëshkim t'i shërbejë më së miri interesave të Shoqërisë; dhe sa më larg të jetë e mundur nga çdo qendër e rëndësishme e popullatës. Në Islandë, ai do të ketë shumë pak mundësi t'i drejtojë të tjerët në shembullin e tij antifordian. Drejtori mbajti heshtje për një çast, pastaj duke kryqëzuar krahët u kthye tërë madhështi drejt Bernardit..

- Marks, -i tha, - mund të tregosh ndonjë arsye përse unë nuk duhet të zbatoj gjykimin mbi ty?

- Po, mundem, - iu përgjigj Bernardi me një zë të fortë e të pastër.

Disi i tërhequr, por përsëri aq madhështor, drejtori i tha: - Atëherë na e thuaj.

- Sigurisht. Arsyeja do të vijë vetë këtu. Një moment, - Bernardi vrapoi te dera dhe e hapi më dysh. - Hyr! - dha urdhër, dhe arsyeja hyri dhe u prezantua.
Plasi si një gulç, një mërmërimë habie dhe tmerri; një vajzë e re ulëriu; duke qëndruar në karrige për të parë më mirë, dikush përmbysi dy epruveta plot me spermatozoide. E fryrë, e lëshuar, mes atyre trupave të lidhur e plot rini, atyre fytyrave të pashfytyruara, një lubi e huaj dhe e tmerrshme prej kohëve të mesjetës, Linda, përparoi brenda në dhomë duke buzëqeshur tërë koketëri, buzëqeshjen e vet më të mirë, krejt e dërrmuar dhe e vrarë; duke rrokullisur rulet e saj të trasha, ato që duhej të dhuronin valëzime epshndjellëse, këllqet e saj gjigante, mbi ato ajo sikur po ngatërronte hapat. Berndardi eci përkrah saj.
-Ja ku është, tha ai duke e drejtuar nga drejtori. - Mos kujton se nuk e njoha? - ia ktheu Linda e indinjuar; pastaj, duke u kthyer me fytyrë nga drejtori tha: - Sigurisht që të kam njohur dikur; Tomakin, do të të kisha njohur kudo, edhe mes një mijë vetëve. Por ndoshta ti më ke harruar. Nuk të kujtohem? Nuk të kujtohem, Tomakin? Linda jote. Ajo qëndroi duke e vështruar atë me kokën mënjanë, ende buzagaz, por me një buzëqeshje që erdhi dhe u zhbë, duke parë fytyrën e Drejtorit të bërë gur nga krupa, përherë e më pak vetëbesuese, buzëqeshja iu spërdrodh e pastaj u shua. - Nuk më mban mend, Tomakin? - i tha ajo përsëri dhe zëri iu drodh. Sytë e saj ishin vetë ankthi, agonia. Fytyra e dërrmuar dhe e vrarë u kthye dhe u bë groteske,
prej një grimase pikëllimi të pafund. -Tomakin! - ajo i shtriu krahët drejt tij. Dikush nisi të kukurisë.

-Çfarë do të më thuash, - nisi drejtori fjalën,- me këtë
përbindësh...?
-Tomakin!-ajo u hodh drejt tij, i hodhi krahët në qafë
dhe pushoi kokën në gjoksin e tij.
Plasi një gaz i pafre.
-...me këtë shaka të përbindshme! - bërtiti drejtori. I skuqur në fytyrë, u përpoq të shkulej prej përqafimit të saj. Ajo e dëshpëruar u mbërthye pas tij.
Po unë jam Linda, Linda. - E qeshura e bëri zërin të dukej më i ulët. - Ti më le me barrë, lëshoi ajo klithmën mbi gjithë murmurimat.
Befas ra një heshtje; sytë u sollën vërdallë prej sikletit, pa ditur ku ta hedhin vështrimin. Drejtori papritur u be meit, ngeci dhe u ndrydh me duart e shtrënguara në llërët e saj, duke e vështruar gjithë tmerr.
- Po, më le me barrë. Unë tani jam nënë. - Ajo e flaku tej skandalin si sfidë në drejtim të njerëzve të shtangur që heshtnin; më pas, papritur duke u shkëputur prej tij, krejt e turpëruar, mbuloi fytyrën me duar dhe qau. - Nuk ishte faji im Tomakin... se unë përherë e kam mbajtur të pastër, apo jo? Apo jo? Gjithmonë... nuk e di se si ndodhi... Po ta dish sa e llahtarshme, Tomakin... por, ai për mua u bë një ngushëllim i shtrenjtë. E duke u kthyer nga porta thirri: Xhon! Xhon!
Dhe ai erdhi menjëherë, ngurroi një çast sa kaloi portën, pa rrotull, pastaj butë mbi mokasinat e veta kapërceu lehtë mbi dysheme, mes për mes dhomës dhe ra në gjunjë përballë drejtorit të madh dhe i tha: "Baba!".
Fjala ("babi" nuk ishte aq e pahijshme - me domethënien e diçkaje që është shkëputur nga neveria dhe detyrimi moral

i përkujdesjes prindërore - më tepër se sa thjesht vulgare, njëfarë pisllëku më shumë skatologjik, sesa pornografik); kjo fjalë e fëlliqtë e komike që u lëshua e shtensionoi situatën, që ishte bërë thuajse e papërballueshme. E qeshura shpërtheu, e madhe, gati në histeri, dora-dorës, thua se nuk do të mbaronte kurrë. Babi - dhe ky na ishte drejtori i madh! Babi! O Ford, O Ford! Kjo ishte e madhe. Britmat e gulçet shkuan radhë, përherë e më të gjalla, fytyrat ngjanin sikur do të plasnin nga të qeshurat, lotët shkuan çurg. Gjashtë epruveta të reja u përmbysën. Babi!
Meit, syhapur, drejtori i hodhi atij një vështrim të zjarrtë, nxjerrë nga thellësitë agonisë dhe turpit.
Babi! E qeshura që dha shenja se po shuhej, plasi prapë, tashmë më e fortë se kurrë. Ai vuri duart tek veshët dhe vrapoi jashtë dhomës.

KAPITULLI XI

Pas skenës në Dhomën e Fekondimit, e gjithë kasta e lartë e Londrës sa s'po çmendej për të parë krijesën e lezetshme që i kishte rënë në gjunjë Drejtorit të Çerdheve të Shumimit dhe Kushtëzimit - ose më mirë të thuash ish-drejtorit, për të shkretin burrë, se e dha dorëheqjen menjëherë dhe nuk shkeli më kurrë në qendër - se ajo gjëja e kishte thirrur (shakaja ishte gati shumë e bukur për të qenë e vërtetë) "babi". Linda, përkundrazi, nuk u ngjalli interes; asnjeri nuk kishte dëshirë të shikonte Lindën. Se të thuash që je nënë – kjo e tejkalonte edhe shakanë më mizore; kjo ishte një gjë e turpshme. E për më tepër, ajo nuk ishte egërsirë prej vërteti, ishte rritur e filtruar si një njeri normal, direkt nga shishet, e më pas ishte kushtëzuar si gjithë të tjerët, kështu që nuk mund të kishte edhe ide të vetat, origjinale. E së fundmi – dhe kjo ishte edhe arsyeja më e fortë përse njerëzit nuk donin ta shihnin Lindën e gjorë – paraqitja. E trashë, me rini të humbur: dhëmbë të prishur, lëkurën me njolla dhe me atë trup, (Ford!) - nuk ia hidhje dot sytë pa t'i sjellë zorrët tek goja, po tamam, zorrët tek goja. Kështu që më të mirët e ndanë mendjen të mos e shikonin Lindën. Por edhe Linda, nga ana e vet, nuk kishte ndonjë dëshirë për t'i parë. Kthimi në qytetërim ishte për të kthimi tek *soma*, ishte

mundësia të rrinte shtrirë në shtrat e t'i merrte pushimet me tabletat radhë, pa e vrarë më mendjen kurrë për dhimbjet e kokës apo krizat e të vjellave; për të mos ndier më kurrë ato gjendjet që kalonte pas përdorimit të pejotave, thua se kishe bërë ndonjë gjë antisociale, aq të turpshme sa të mos guxoje dot më të ngrije kokën lart. Soma nuk i shkaktonte asnjë nga këto siklete. Pushimet që ajo sillte qenë të përkryera dhe, nëse mëngjesi i nesërm ishte i pakëndshëm, ishte i tillë jo në vetvete, por po të krahasohej me gëzimet e pushimit të shkuar. Marifeti ishte t'i bëje pushimet të përhershme. E babëzitur, ajo u ankua përherë e më fort për doza përherë e më të mëdha, përherë e më të shpeshta. Doktor Shou në fillim kundërshtoi, pastaj e la të bënte ç'të donte. Ajo merrte njëzet gramë çdo ditë.

"Gjë kjo që do ta shuajë për një muaj a dy, - i rrëfeu doktori Bernardit. Një ditë qendrat e saj të frymëmarrjes do të paralizohen. Pa frymë. Mbaroi. Dhe është gjë e mirë. Po të mund ta rinonim, sigurisht që çdo gjë do të ishte ndryshe. Por ja që s'e bëjmë dot."

Për habi, siç menduan që të gjithë (meqë Linda në pushime- soma u leverdiste atyre që e donin jashtë loje), Xhoni shtroi disa vërejtje.

-Po a nuk po ia shkurtoni jetën duke i dhënë kaq shumë? - Nga njëra anë, po, - pranoi doktori. - Por, në anën tjetër, ne në fakt, po ia zgjasim. -Djaloshi ia nguli sytë krejt i paqartë. Soma mundet të heqë ca vite jetë, vazhdoi doktori. - Por mendo për kohëzgjatjet e pamasa që të jep jashtë kohës. Çdo pushim soma ngjan pak me atë që paraardhësit tanë dikur e quanin përjetësi.

Xhoni nisi të kuptojë.

- Përjetësia në buzët dhe sytë tanë, - murmuriti.

- Çfarë?
- Asgjë.
- Sigurisht, - vazhdoi më tej doktor Shou, - nuk mund t'i lëmë të gjithë njerëzit të kalojnë në përjetësi, kur ata kanë punë të rëndësishme për të bërë. Por, meqë kjo nuk ka ndonjë punë serioze...
-E prapëseprapë, - nguli këmbë Xhoni, - nuk më duket e drejtë.
Doktori ngriti supet.
Epo sigurisht, nëse ty të pëlqen më shumë ta lëmë të ulërijë si e çmendur gjithë kohës...
Më në fund Xhonit iu desh të lëshojë pe. Linda mori *soman* e saj të dashur. Që prej asaj kohe, ajo mbeti në një dhomë të vogël në apartamentin e Bernardit në katin e tridhjetë e shtatë, shtrirë në shtrat, me radion dhe televizorin përherë të ndezur, rubinetin e parfumit që pikonte, tabletat e somas sa të zgjasje dorën - ja aty mbeti; e megjithatë, nuk ishte fare aty; ishte gjithë kohës larg, pafundësisht larg, me pushime; me pushime në një tjetër botë, ku muzika e radios ishte një labirint i zëshëm ngjyrash, shkarje, labirint dredharak, i cili të shpinte (me ç'dredha të bukura e të pashmangshme) në një qendër të ndritur të bindjes absolute; ku imazhet vallëzuese të televizorit interpretonin njëfarë kënge plot zë e ndjenjë, me një shije të papërshkrueshme -ku parfumi që pikonte nga rubineti ishte më shumë se sa aromë ishte diell, ishin një milion saksofone, ishte Popi që bënte dashuri, ama shumë më tepër se kaq, pakrahasimisht më shumë, dhe pa marrë fund kurrë.
-Jo, nuk mund ta rinojmë. Por unë jam shumë i kënaqur, -
e përmbylli doktor Shou, - që pata mundësi të shoh me sy një

shembull plakjeje te një qenie njerëzore. Faleminderit shumë që më thirrët dhe mua. - Dhe i shtrëngoi dorën ngrohtësisht Bernardit.
E pra, të gjithë i ishin qepur Xhonit. E meqë të shihje atë, duhej të kaloje patjetër përmes Bernardit, rojës së akredituar, Bernardi për herë të parë në jetën e tij e gjeti veten të trajtuar jo më thjesht normalisht, por si një person jashtëzakonisht i rëndësishëm. Nuk dolën më fjalë për alkoolin në surrogatin e gjakut, as shpoti për pamjen e tij. Henri Fosteri doli nga vetja për ta bërë prapë shok; Benito Huveri i bëri dhuratë një paketë gjashtëshe çamçakëzash me hormone seksi; Asistent Paracaktuesi e lypi gati si mjeran ftesën për një nga mbrëmjet që organizonte Bernardi në shtëpi. E sa për femrat, Bernardit i mjaftonte veç një shenjë që ta bënte me kë t'i donte qejfi. Bernardi më tha se do ta takoj të egrin të mërkurën tjetër, tha Fani tërë triumf.
- Sa më bëhet qejfi, - i tha Lenina. - Edhe tani duhet ta pranosh se e kishte gabim për Bernardin. A nuk të duket se është shumë i ëmbël?
Fani pohoi me kokë.
- Më duhet të them, shtoi ajo, më ka habitur për mirë.
Shefi i Shishezimit, Drejtori i Paracaktimit, tre Asistente të Përgjithshëm Fekondues, Profesori i Ndjesive në Kolegjin e Inxhinierisë Emocionale, dekani i Shkollës së Këngës së Komunitetit të Uestmisterit, Mbikëqyrësi i Bokanovskfiimit; lista e njerëzve të shquar për Bernardin nuk kishte të sosur.
- E bëra me gjashtë vajza javës që shkoi, - iu rrëfye ai Helmhole Uatsonit. - Një të hënën, dy të martën, dy të premten e një të shtunën. Dhe po të kisha kohën e qejfin,

ishin edhe nja dymbëdhjetë të tjera që mezi prisnin... Helmholci dëgjonte lavdërimet në heshtje mosmiratuese, e me një mërzi të atillë sa Bernardi u ndie i fyer.
- Ke zili, - i tha ai. Hemholci tundi kokën.
Thjesht më trishtove, - i ktheu përgjigjen. Bernardi doli duke shfryrë i pezmatuar. Kurrë, tha me vete, kurrë nuk do t'i fliste më me gojë Helmholcit.
Ditët kaluan. Bernardit i ra suksesi në kokë si vera dhe e pajtoi atë plotësisht (si pajtohet njeriu prej pijes dehëse), me të njëjtën botë në të cilën deri atëherë ai nuk kishte qenë hiç i kënaqur. Për aq kohë sa e pranonin për njeri me rëndësi, gjërat ishin mbarë. Por, pajtuar për shkak të suksesit, ai refuzoi të heqë dorë nga privilegji i kritikës ndaj këtij rendi. Sepse kritika si akt e lartësonte, e bënte ta ndiente veten më të rëndësishëm, ndihej më i madh. Për më tepër, ai vërtet besonte që ky rend kishte plot gjëra për t'u kritikuar. (Njëkohësisht, atij përnjëmend i pëlqeu suksesi dhe mundësia ta bënte me aq vajza sa i desh qejfi.) Përpara atyre që tani, për hir të Egërsirës, i bënin shpurë, Bernardi shpaloste një joortodoksi gërnjare. Dhe e dëgjonin me mirësjellje. Por ama, tundnin kokat past shpinës së tij. "Ky djalosh do ta pësojë shumë keq," flisnin njerëzit, duke profetizuar edhe më me bindje se ata vetë do të siguroheshin personalisht që ky fund të ishte i keq. "Nuk i vjen më egërsirë tjetër ta shpëtojë për së dyti," - flisnin gojët. Ndërkohë, megjithatë, sa ishte aty egërsira e parë, të gjithë ishin të sjellshëm. Dhe ngaqë ata ishin të sjellshëm, Bernardi u ndie si gjigant - një gjigant i fryrë e i bërë kacek, më i lehtë edhe se vetë ajri.
- Më i lehtë se ajri, - tha Bernardi duke shënjuar diku

lart. Si një perlë lart në qiell, lart përpjetë shkëlqente ngjyrë
rozë balloni i Departamentit të Motit.
-... Egërsirës së lartpërmendur, .-kështu thoshin instruksionet e Bernardit, - t'i tregohet jeta e qytetëruar në të gjitha aspektet...
Atij iu ofrua të vështronte nga pika më e lartë e Kullës Drejtuese-T. Mjeshtri i stacionit dhe meteorologu i përhershëm po i shërbenin si ciceronë. Por Bernadi po fliste më shumë se ata. I dehur, ai po sillej sikur, më e pakta, të ishte njëri nga Kontrollorët e Botës, që po u bënte atyre një vizitë. Më i lehtë se ajri.
Raketa e Gjelbër e linjës Bombei u shkëput prej qiellit të lartë dhe u ul. Pasagjerët zbritën poshtë. Tetë binjakë identikë dravidinanë të veshur me kaki, ruajtën tetë daljet, kabinat dhe shkallët.
- Dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë kilometra në orë, - tha Shefi i Stacionit i mahnitur. - Po kjo si ju duket, zotni Egërsira?
Xhonit iu duk shumë gjë e mirë.
- Por, u tha ai, - Ariela i bie botës rreth e qark për dyzet minuta.
"I egri, - shkroi Bernardi në raportin për Mustafa Mondin, - për çudinë tonë, habitet shumë rrallë dhe nuk tregon frikë ndaj shpikjeve të qytetërimit. Kjo pjesërisht ndodh për shkak se, padyshim, ai ka dëgjuar për këto prej fjalëve të Lindës,
n---s së tij.
(Mustafa Mondi ngrysi vetullat. "Mos ky budalla mendon se unë jam aq delikat sa të mos e duroj dot leximin e kësaj fjale të shkruar të plotë?")

"Pjesërisht për shkak të interesimit të tij në atë pjesë që ai e quan "shpirti", për të cilin ai këmbëngul se është një entitet i pavarur nga mjedisi fizik; gjithsesi, për aq sa unë jam përpjekur t'ia bëj të qartë..."
Kontrollori e kapërceu fjalinë pasardhëse dhe ishte gati për të kthyer faqen në kërkim të diçkaje më interesante, konkrete, kur sytë i kapën një sërë fjalish të pazakonta. "... megjithëse më duhet të pranoj," lexoi në letër ai, "se bie në një mendje me të egrin, të cilit i duket fëmijëria e qytetëruar shumë e kollajtë, ose, siç thotë ai me fjalët e veta: jo aq e shtrenjtë sa duhet; dhe unë dua të shfrytëzoj këtë rast për të sjellë në vëmendjen e Lartësisë suaj Fordiane për..."
Zemërimi i Mustafa Mondit ia la thuajse menjëherë vendin buzagazit. Ideja se kjo krijesë po i jepte mësim për rregullin shoqëror atij - atij - kjo ishte groteske. Ky njeri ndoshta është çmendur. "Më duhet t'i jap një mësim të mirë," - tha ai me vete, pastaj mbështeti kokën pas dhe qeshi me të madhe. Për momentin, sido që të vinte puna, nuk do t'i jepte asnjë lloj mësimi.
Ajo ishte një fabrikë e vogël për pjesët ndriçuese të helikopterëve, degë e Korporatës së Pajisjeve Elektrike. Ata u pritën në tarracë, (çfarë efekti magjik kishte letra e rekomandimit e mbledhur tub, e lëshuar prej Kontrollorit, dora vetë!), nga Shefi i Teknikës dhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore. Zbritën të gjithë bashkë shkallët që të fusnin në
fabrikë.
"Çdo proces, - shpjegonte Menaxheri i Elementit Njerëzor,
- çohet përpara për aq sa është e mundur, prej një grupi të vetëm Bokanovski."

Dhe në fakt, tetëdhjetë e tre zezakë Delta, gati pa hunde, punonin në presa. Të pesëdhjetë e gjashtë makinat katërboshtëshe prerëse e kthyese, drejtoheshin prej pesëdhjetë e gjashtë Gamash kuqalashe hundëkërraba. Njëqind e shtatë Ypsilonë të trajtuar kundër nxehtësisë punonin në fonderi Tridhjetë e tre femra Delta, kokëgjata, kuqalashe, beltrasha, të gjitha me dallim brenda 20 milimetrash në gjatësinë e tyre I metër e 69 centimetra, filetonin vida. Në dhomën e montimit, dinamot montoheshin prej dy çifte xhuxhësh Gama-plus. Dy tavolinat e ulëta të punës qenë vendosur përballë, mes tyre zvarritej konvejeri me pjesët e çmontuara; dyzet e shtatë koka bionde përballeshin me dyzet e shtatë bojëkafe; dyzet e shtatë turishtypur përballë dyzet e shtatë nofulldalëve. Mekanizmat e montuar inspektoheshin prej tetëmbëdhjetë kuqalashesh kaçurrele Gama identike, të veshura me jeshile; paketoheshin në arka prej tridhjetë e katër këmbëshkurtërve, mëngjërasheve Delta-Minus dhe ngarkoheshin nëpër kami onë e vagonë që prisnin jashtë, prej gjashtëdhjetë e tre quksash sykaltër, verdhacukë, nga sëra e Ypsilonëve Gjysmëdebilë. "O më e mira e botëve, - nga e keqja që i kishte mbetur ndërmend, i egri përsëriti pa dashje fjalët e Mirandës. - O më e mira e botëve, që mban njerëz të tillë mbi vete."
"Dhe ju siguroj, tha Menaxheri i Burimeve Njerëzore kur po iknin nga fabrika, - ne zor se hasim ndonjë problem me punëtorët tanë. Gjithmonë gjejmë..."
nxirrte
po Por i egri papritur u shkëput prej tyre dhe zorrët pas një shkurreje dafine, thua se toka e fortë ku po shkelte të ishte një helikopter që po binte në një xhep ajri.

"I egri, - shkruante Bernardi, - nuk pranon të marrë soma dhe duket shumë i shqetësuar se Linda, m-e tij, vazhdon të qëndrojë në pushime të përhershme. Është me rëndësi të vërehet se, me gjithë plakjen e m-së e paraqitjen e saj të neveritshme, i egri në mënyrë të vazhdueshme shkon ta shohë dhe duket shumë i lidhur pas saj - një shembull interesant për mënyrën se si paracaktimi i hershëm mund të modifikojë, madje deri në pamundësi për të kundërshtuar impulset natyrale (në këtë rast, impulsi për t'u sprapsur tej prej një objekti të papëlqyeshëm.)"
Në Iton ata zbritën në tarracën e Shkollës së Lartë. Në krahun përkundër oborrit të shkollës, pesëdhjetë e dy katet e Kullave Lupton shkëlqenin gjithë bardhësi nën dritën e diellit. Kolegji në të majtën, e më të djathtë Shkolla e Këngëve të Komunitetit ngrinin të nderuarat kolona prej hekurbetoni e xhami organik. Në qendër të sheshit katërkëndësh, qëndronte statuja e vjetër origjinale prej çeliku të kromuar e Fordit Tonë. Doktor Gafni, rektori, dhe madam Keti, kryezonja, i pritën derisa ata zbritën nga avioni. - Keni shumë binjakë këtu? - e pyeti i egri me shqetësim kurpo nisnin turneun e inspektimit.
-Oh, jo, - ia ktheu rektori. - Itoni është rezervuar vetëm për djem dhe vajza të kastës së lartë. Një vezë, një i rritur, E bën edukimin sigurisht më të vështirë. Por, meqë ata do të thirren në detyrë, do të mbajnë përgjegjësi e do të përballojnë urgjenca, nuk bëhet dot ndryshe, - dhe psherëtiu.
Bernardi, nga ana tjetër, i ishte qepur mirë madam Ketit. -Po të jesh e lirë të hënave, të mërkurave apo të premteve

në mbrëmje, - po i thoshte. E duke treguar me gisht drejt të egrit tha, ai është shumë kureshtar, e ke parasysh – shtoj ai. Tip më vete.
Madam Keti buzëqeshi (edhe buzëqeshjen e paska magjike, mendoi ai); i tha faleminderit, do të ishte një kënaqësi të shkonte në një prej mbrëmjeve që organizonte ai në shtëpi. Rektori i hapi portën.
Pesë minuta te klasa e Alfa-Dopio-Plus mjaftuan që Xhoni të hutohej fare.
-Çfarë është relativiteti i thjeshtë? - i pëshpëriti ai Bernardit Dhe ai u përpoq t'ia shpjegojë, pastaj e mendoi më mirë dhe e këshilloi të shkonin njëherë të shikonin klasat e tjera.
Nga pas portës, në korridorin që të çonte tek klasa e gjeografisë së Beta-minuseve, zëri tringëllues i një sopranoje thërriste "një, dy, tre, katër," edhe pastaj, me nerva të lodhura thirri "edhe një herë nga fillimi".
-Stërvitja maltuziane, - shpjegoi madama. - Shumica e vajzave tona janë shterpë, doemos. Edhe unë, vetë, shterpë jam. - Ajo i buzëqeshi Bernardit. - Por kemi dhe tetëqind të pashterpëzuara, të cilat e kanë të domosdoshme stërvitjen e përditshme.
Te dhoma e gjeografisë së Beta-minuseve, Xhoni mësoi se "një rezervat egërsirash është një vend ku, për shkak të kushteve jo të favorshme klimaterike, gjeologjike, apo varfërimit të burimeve natyrore, nuk ia ka vlejtur të shpenzohej për qytetërim." Një kërcitje, dhoma u ert, papritur, ja ku dolën, në një ekran mbi kokën e mjeshtrit Te penduarit e Akomas, që përuleshin para Zonjës Sonë dhe rënkonin, siç i kishte dëgjuar Xhoni edhe vetë të rënkonin, të rrëfenin mëkatet para Krishtit të kryqëzuar dhe para figures

së shqiponjës së Pukongut. Itonianët e rinj bërtitnin me gëzim. Ende duke rënkuar, të penduarit ngriheshin në këmbë, shqyenin rrobat e sipërme dhe, me kamxhikun plot me nyje, rrihnin trupin, fshikullimë pas fshikullime. E shumëfishuar, e qeshura e mbyti zërin e rënkimeve.
- Po përse po qeshin? - pyeti i egri i shushatur nga dhimbja.
-Përse? - Rektori u kthye nga ai akoma i ngërdheshur. - Përse? Po kjo të shkrin gazit.
Mes muzgut kinematografik, Bernardi rrezikoi me një gjest, të cilin, dikur, edhe në errësirën më të zezë, nuk do kishte pasur guxim ta bënte. I forcuar prej rëndësisë së re që kishte arritur, ai i hodhi madamës krahun rrotull belit. la mbështolli si kulpër shelgu. U bë gati t'i merrte ndonjë puthje a dy, a ndoshta ndonjë të pickuar të ëmbël, kur grilat u hapën përsëri.
- Ndoshta do të ishte më mirë të vazhdonim, - tha madam Keti dhe shkoi drejt portës.
Dhe kjo, tha rektori një moment më pas, - është dhoma e kontrollit hipnopedik.
Qindra bokse me muzikë sintetike, nga një për çdo fjetore ishin vendosur në tre rafte në anët e dhomës; ata me brima në raftin e katërt ishin kolonat zanore në shirita letre, mbi të cilët ishin shtypur leksione hipnopedike të llojeve të ndryshme.
- Vendoset shiriti aty, i shpjegoi Bernardi duke ndërprerë kështu doktor Gafnin, - shtyp këtë çelësin për poshtë...
-Jo atë aty... - e qortoi me bezdi rektori.
Ky tjetri, atëherë. Shiriti shpështillet. Celulat e seleniumit

i transformojnë impulset e dritës në valë zanore dhe... - Dhe ja tek është, - e mbylli doktor Gafni.
- Po Shekspirin a e lexojnë? - e pyeti i egri ndërsa ata po ecnin rrugës për te Laboratorët Biokimikë, matanë
Bibliotekës së shkollës.
- Sigurisht që jo, - tha madama dhe u skuq në fytyrë. - Biblioteka jonë, - tha doktor Gafni, - përmban vetëm libra reference. Nëse të rinjtë kanë nevojë për argëtim, ketë mund ta marrin te kinemaja e ndjesive. Ne nuk i nxisim të plotësojnë dëshirat me dëfrime vetmitare.
Pesë grupe djemsh dhe vajzash, duke kënduar, apo të përqafuar në heshtje, u kaluan përpara në rrugën e ndriçuar.
Sapo janë kthyer, - i shpjegoi doktor Gafni, ndërsa Bernardi, duke bërë pështpërima, la takim me madamën për atë mbrëmje, - nga Krematoriumi i kalbësirave. Kushtëzimi për vdekjen nis që tetëmbëdhjetë muajsh. Çdo fëmijë kalon dy mëngjese në javë tek Spitali për të vdekurit. Lodrat më të mira i mbajmë atje dhe në ditë me vdekje u jepet krem çokollate. Mësohen kështu që ta marrin vdekjen si pjesë te rrugëtimit.
- Si çdo proces tjetër fiziologjik, shtoi madama me profesionalizëm.
Në orën tetë te Savoja. Gjithçka ishte sajdisur.
Rrugës së kthimit drejt Londrës, ndalën te fabrika e Korporatës së Televizorëve në Brentford.
- Të vjen keq të presësh një çast këtu sa të bëj një telefonatë? - e pyeti Bernardi.
I egri priti dhe vështroi përreth. Turni kryesor i ditës sa po linte detyrën. Turmat me punëtorë të kastës së ulët

qenë mbledhur përballë stacionit hekurudhor - shtatë a tetëqind Gama, Delta dhe Ypsilonë, burra e gra, me jo më shumë se një duzinë fytyrash e gjatësish. Për secilin prej atyre me biletë në dorë, punonjësi i hekurudhës jepte një zarf prej letre. Zinxhiri i gjatë i grave dhe burrave lëvizte përpara ngadalë.
Çfarë kanë brenda (duke kujtuar Tregtarin e Venedikut) "ato kutitë"? - kërkoi të dijë i egri sapo iu afrua Bernardi. - Racioni i somas për një ditë, - iu përgjigj Bernardi, pak i turbulluar, se po përtypte një prej atyre gomave me hormone që i solli Benito Huveri. - I marrin pasi kanë mbaruar punën. Katër tableta gjysmëgramëshe. Gjashtë të shtunave.
Ai i hodhi krahun me dashamirësi Xhonit dhe shkuan bashkë drejt helikopterit.
Lenina hyri duke kënduar në dhomat e zhveshjes. - Dukesh e kënaqur shumë sot, - i tha Fani.
- Jam e kënaqur, iu përgjigj ajo. - Zip! Bernardi më bëri një zile gjysmë ore më parë. Zip! Zip! - Dhe i hoqi pantallonat e shkurtra nga këmbët. - I kishte dalë një takim i papritur pune. Zip! Ma kërkoi si nder nëse mund ta shoqëroja të egrin te kinemaja e ndjesive sot pasdite. Më duhet të nxitoj... - Dhe ajo rendi me nxitim drejt banjave. -Ka fat kjo vajzë, - tha me vete Fani duke e parë Leninën t'i zhduket nga sytë.
Nuk kishte pikë zilie në komentin e saj; natyrëbutë Fani thjesht po konstatonte një fakt. Lenina ishte me fat, me fat që kishte ndarë me Bernardin një pjesë të bollshme të famës gjigante të egërsirës, me fat që rrezatonte përmes personit të

saj të papërfillshëm lavdinë e epërme të këtij çasti. A nuk j
kish kërkuar Sekretarja e Shoqatës së Grave të reja fordiane të jepte një leksion mbi përvojat e saj? A nuk e kishin ftuar te Darka Vjetore në Klubin e Afërditave? A nuk kishte dalë ajo tashmë në Lajmet e ndjeshmërisë parë, dëgjuar dhe prekur prej syve e veshëve të miliona njerëzve në planet? E po aq të përgëzueshme kishin qenë edhe kujdeset që ajo kish përfituar nga persona tejet të spikatur. Sekretari i Dytë i Përhershëm pranë Kontrollorit të Botës e kishte ftuar për darkë dhe mëngjes. Ajo kishte kaluar një javë me Shefin e Drejtësisë së Fordit dhe një javë tjetër me Peshkopin e Këngëtarëve të Komunitetit të Kanterburit. Presidenti i Korporatës së Sekrecioneve të Brendshme dhe të Jashtme, ishte përherë në telefon me të; kishte shkuar edhe në Douvill, me Zëvendës Guvernatorin e Bankës së Evropës. - Është e mrekullueshme, sigurisht. Po prapëseprapë, -i ishte rrëfyer ajo Fanit, - më duket sikur po marr diçka të pamerituar. Sepse, sigurisht, gjëja e parë që duan të dinë të gjithë është si është të bësh dashuri me një të egër. Dhe më bie të them se nuk e di. - Ajo tundi kokën e dëshpëruar. - Shumë burra nuk më besojnë, sigurisht. Por kjo është e vërteta. Do doja shumë të mos ishte kështu, shtoi dhe psherëtiu. - Është i bukur llahtar, apo s'të duket ashtu? - Po ai s'të ka qejf ty? - e pyeti Fani.
- Ndonjëherë mendoj se më ka, ndonjëherë jo. Përherë përpiqet të më shmanget; del nga dhoma kur unë hyj brenda; nuk më prek; as nuk më hedh sytë. Por ndonjëherë, kur kthehem vërtik e shoh që sytë i ka të ngulur tek unë, edhe pastaj epo, ti e di se si të shohin burrat kur u pëlqen. Po, Fani e dinte.

- Nuk po e marr vesh, - tha Lenina. Ajo nuk po e merrte vesh; dhe kjo jo vetëm e hutonte, por edhe e kishte mërzitur.
- Ngase, e ke parasysh, Fani, mua më pëlqen.
I pëlqente përherë e më shumë. Epo, tani do të kishte një shans, mendoi, teksa parfumosej pas banje. Flluq, lluq, lluq - një shans prej vërteti. Dhe gëzimi iu derdh në këngë.

"Përqafomë deri sa të më dehësh zemër;
Më puth aq sa të bie në koma;
Përqafomë, zemër, lepurushe tushe;
Dashuria është tamam si soma."

Organo e aromave po luante një tekë bimore plot nur e freski - vallëzonin arpezhet mes trumzës, rozmarinës, borzilokut, mërsinës, taragonit; një sërë modulimesh ndjellëse përmes pikanteve më kyç, që bëheshin të gjitha gati si qelibari; dhe një kthim i zorshëm në dru sandalli, kamfur, cedër e bar i thatë i sapo grirë (me prekje rastësore e të lehta shkel e shko grahmën e mëlçive të bëra pure, çikëzën më të vogël të bajgës së derrit) e kthim pas te aromatiket e thjeshta me të cilat niste pjesa. Shpërthimi i fundit i trumzës u fashit; pati një radhë duartrokitjesh; dritat u shuan. Në makinën e muzikës sintetike fonogrami u çmbështoll sërish. Ishte një trio për hiperviolinë, superviolonçel dhe surrogatoboes që tashmë mbushte ajrin me një kapitje të këndshme. Tridhjetë a dyzet masa - e pastaj, përkundër këtij sfondi muzikor, diçka edhe më shumë sesa thjesht një zë njerëzor nisi të ligjërojë; herë i mbytur, herë zë koke, herë tëhollej si flauti; herë ngarkohej me dëshirën e zjarrtë

të harmonikave, e krejt pa zor kalonte prej regjistrimit të ulët të Gaspard Fosterit në kulmet e toneve muzikore, deri sa mbërrinte notën më të lartë, si e lakuriqit të natës, lart në Do, të cilës (më 1770 në Operën Dukale të Parmës, për habinë më të madhe të Moxartit) Lukrecia Ajugari, e vetmja në historinë e këngëtarëve), dikur i dha atë kuptimin shpues
që mban edhe sot.
Të zhytur në qoshet e veta, Lenina dhe i egri thithnin hundët duke nuhatur aroma dhe dëgjonin. Tani ishte radha e syve dhe lëkurës.
Dritat u fikën; ca germa të zjarrta u ngritën solide, thua se vetëqëndronin mes errësirës. TRI JAVË NË HELIKOPTER NJË FILM ME TË PREKUR, ME SUPER KËNGË, ME TË FOLUR SINTETIKE, ME NGJYRA DHE STEREOSKOPIK ME SHOQËRUES ORGANOSH TË SINKRONIZUAR
AROMASH.
"Mbahu pas këtyre dorëzave metalike në mbështetëset e karriges, - i pëshpëriti Lenina, - se përndryshe nuk merr asgjë nga efektet e filmit me të prekur."
I egri bëri si i thanë.
Por germat e zjarrta ishin zhdukur, ndërkohë; e për dhjetë sekonda ra errësira e plotë; pastaj, papritur, verbuese dhe pakrahasueshmërisht shumë më solide se ç'mund të dukeshin në jetën me mish e me kocka, shumë më reale se realiteti, ja ku ishin para tyre pamjet stereoskopike, mbërthyer në krahët e njëri-tjetrit, një zezak gjigant dhe një femër flokartë e re brakocefalike Beta-Plus.
I egri u tremb. Ç'ndjesi në buzë! Ngriti dorën tek goja; gudulisja u ndërpre; dhe e lëshoi dorën prapë mbi dorëzën metalike; gudulisja nisi prapë. Organo e aromave këtë

radhë shfrynte era myshk të pastër. Duke dhënë shpirt, superpëllumbeshë-kolonë zanore gugati "Oh - ooh!"; dhe duke vibruar vetëm tridhjetë e dy herë në sekondë, një zë bas më i thellë se i afrikanit iu përgjigj: "Aa-aah. Ooh-ah!" - buzët stereoskopike u mbyllën përsëri, edhe një herë tjetër pjesët erogjene të gjashtë mijë spektatorëve në Alhambra u gudulisën me një kënaqësi galvanike thuajse të padurueshme. "Ooh..."
Fabula e filmit ishte krejt e thjeshtë. Pak minuta pas oheve të para, aheve të dyta (pas një dueti të kënduar dhe bërjes dashuri mbi lëkurën e famshme të ariut, ku çdo fije leshi - kish pasur plotësisht të drejtë Asistent Paracaktuesi - ishte e veçanërisht dhe dallueshmërisht e ndjeshme), - zezaku pësoi një aksident me helikopter, u rrëzua me kokë. Bum! Çfarë oshtime që i lëshoi balli kur u godit! Një kor ahuhesh dhe ohuhesh doli prej audiencës.
Përfundimi ishte se goditja ia hodhi gjithë kushtëzimin në erë. Ai zhvilloi një pasion maniak për bionden Beta. Ajo e kundërshtoi. Ai këmbënguli. Pati disa përpjekje, ndjekje, një sulm ndaj një rivali, e më në fund një rrëmbim sensacional personi. Betabjondja u rrëmbye tutje përtej qiejve dhe mbeti atje varur për tre javë në një tête-à-tête me zezakun e çmendur. Më në fund, pas një serie të gjatë aventurash e shumë akrobacive ajrore, tre të rinj të pashëm Alfa ia dolën ta shpëtojnë. Zezakun e mbyllën në një qendër rikushtëzimi për të rritur dhe filmi mbaronte me fund të lumtur e të zbukuruar, me Betan që bëhet dashnorja e tre shpëtimtarëve të vet. Ata bënë një shkëputje një moment, sa për të kënduar në kuartet me shoqërim superorkestral dhe aromë gardenie prej organos së aromave. Pastaj lëkura e ariut doli edhe një

herë të fundit në skenë dhe mes gjëmimit të saksofoneve, puthja përfundimtare stereoskopike u tret nëpër errësitë, gicilimi elektrik vdiq mbi buzë si një flutur nate që dridhet para se të ngordhë, dridhet edhe më tepër prej pafuqisë, e dobët e më në fund e heshtur, aq e heshtur, gjersa nuk lëviz më.
Por për Leninën flutura e natës nuk vdiq krejtësisht. Edhe pasi u ndezën dritat, ndërsa me ngadalë po përziheshin me turmën drejt ashensorëve, fantazma e fluturës ende rrihte krahët mbi buzët e saj, ende gjurmonte rrugë të brishta ankthesh e kënaqësish nëpër gjithë lëkurën e trupit të saj. Faqet i kishte prush. I kapi dorën të egrit dhe e ngjeshi, ashtu të mpirë, mbas vetes. Ai e pa për një moment, i zbehtë, me vuajtje, dëshirë dhe i turpëruar prej epshit të tij. Ai nuk ia vlente, nuk... Sytë e tyre hasën bashkë për një çast. Çfarë thesaresh premtonin sytë e saj! Një shpërblesë për temperamentin prej mbretëreshe. Me ngut hoqi sytë prej saj dhe tërhoqi me forcë dorën e burgosur prej saj. Ishte i tmerruar për dalldi se mos ajo reshtte së qeni diçka për të cilën ai ndihej i pavlerë.
-Nuk mendoj se duhet të shohësh gjëra të tilla, - i tha, duke u përpjekur me ngut të hiqte prej Leninës e për ta spostuar drejt rrethanave çdo faj, për çfarëdo rënieje, të shkuar a të ardhme, të situatës prej nivelit të përsosmërisë. Çfarë gjërash, për shembull, Xhon?
- Si ky filmi i tmerrshëm.
- I tmerrshëm? - Lenina mbeti nga habia. - Po mua m'u
duk shumë i bukur.
- Ishte i ulët, - tha ai me indinjatë,- i poshtër. Ajo tundi kokën.

-Nuk e kuptoj se ç'do të thuash.
Pse ishte ai kaq i çuditshëm? Pse merrte kot e i prishte
gjërat?
Në taksikopter, ai as nuk i ktheu sytë nga ajo. I lidhur pas betimesh të forta që nuk ishin shpallur kurrë, i bindur ndaj ligjesh që kishin pushuar së vepruari prej kohësh, ai bëri mënjanë e iu kthye heshtjes. Ndonjëherë, si tel i tendosur, gati për t'u këputur, tërë trupi i tij dridhej brof.
Taksikopteri u ul në tarracën e apartamentit të Leninës. "Më në fund," tha ajo me ngazëllim teksa zbriste nga mjeti. "Më në fund," megjithëqë ai kish qenë aq i çuditshëm mu atë çast. Duke qëndruar poshtë një llambe, ajo picërroi sytë përpara një pasqyre të vogël tualeti. Më në fund. Po, hunda i shkëlqente pak. Ajo shkundi pudrën e tepërt nga tamponi. Ndërkohë që ai paguante taksistin, i dilte koha. E fshiu pjesën e shkëlqyer me pudër duke menduar: Ky është llahtar i bukur. S'ka përse të ketë turp si Bernardi. E prapëseprapë... Çdo burrë tjetër do ta kishte bërë me kohë. Po ja, sot, më në fund. Fragmenti i fytyrës së vet që dukej në pasqyrën e vogël, papritur i buzëqeshi.
- Natën e mirë, i tha nga pas një zë i mbytur. Lenina u kthye rrotull.
Ai po qëndronte te porta e taksisë, me sytë e palëvizshëm, ngulur diku; siç dukej, s'ia kishte ndarë sytë gjatë gjithë kohës kur ajo po pudroste hundën, priste - po çfarë priste? Apo nguronte, përpiqej t'i mbushte mendjen vetes, dhe gjithë kohës duke menduar e menduar, ajo nuk arrinte dot të përfytyronte se ç'mendime të jashtëzakonshme.
Natën e mirë, - Lenina, i tha ai për së dyti dhe bëri një grimasë të habitshme në përpjekje për të buzëqeshur.

- Por, Xhon... Unë mendova se ti... dua të them, nuk.. Ai e mbylli portën dhe u përkul përpara për t'i thënë diçka shoferit. Taksia fluturoi fishek në ajër.
Duke parë poshtë përmes dritares në dysheme, i egri dalloi fytyrën e shtrembëruar të Lindës, e zbehtë meit prej dritës blu të llambës. Gojën e kishte të hapur, po e thërriste Figura e saj atje tej vrapoi të ikë larg, katërkëndëshi i tarracës që po bëhej përherë e më i vogël, ngjante sikur po binte poshtë në errësirë.
Pesë minuta më pas, ai ishte kthyer në dhomën e tij. Nga vendi i vet sekret, ai nxori vëllimin e brejtur prej minjve, hapi me përkujdesje gati religjioze faqet e zhubrosura dhe nisi të lexojë Otellon. Otello, kujtoi ai, ishte si heroi i filmit Tre javë në helikopter - një zezak.
Duke fshirë sytë, Lenina i ra përmes tarracës për tek ashensori. Rrugës për në katin e njëzeteshtatë, ajo nxori shishen me soma. Një gramë, mendoi, nuk do të mjaftonte; ky i saji ishte pikëllim më tepër se njëgramësh. Por po të merrte dy gramë, kishte rrezik të mos zgjohej të nesërmen në mëngjes. Bëri kompromis dhe në pëllëmbën e majtë të bërë lugë hodhi tri tableta gjysmëgramëshe.

KAPITULLI XII

Bernardit iu desh të bërtasë pas portës së mbyllur, i egri nuk po e hapte.
- Po të presin të gjithë.
- Le të presin, erdhi përtej portës së mbyllur zëri i mekuri Xhonit.
- Por ti e di fare mirë, Xhon (sa e vështirë është të jesh bindës me zërin në kupë të qiellit!), unë u thashë kastile që të takohen me ty.
- Duhej të më kishe pyetur më parë mua, nëse doja unë t'i takoja.
- Po ti përherë i ke takuar, Xhon.
- Ja për këtë arsye nuk dua të vij më.
- Sa për të më bërë qejfin mua, - i tha me lajka Bernardi.
-Nuk vjen ti sa për të më bërë mua qejfin?
- Jo.
- E ke me gjithë mend?
- Po.
- Po si t'ia bëj unë, - rënkoi prej dëshpërimit Bernardi. -Në djall shkofsh! - ulëriu zëri i pezmatuar që brenda. -Sonte do të jetë edhe Kryepeshkopi-këngëtar i Komunitetit Kanterburi.- Bernardi gati sa s'po qante.

-Ai *yaa tákua!* - i egri mund të shprehte vetëm në gjuhën Zunji se si ndihej për Kryepeshkopin këngëtar të Komunitetit Kanteburi. - *Háni!* - shtoi si fjalë të fundit; e pastaj (me çfarë egërsie përçmuese!) - *Son éso tse-ná,*-dhe pështyu përtokë, ashtu siç do të kishte bërë Popi në një rast si ky.

Më në fund, Bernardit iu desh të përvidhet i mpakur drejt dhomave të veta, për të informuar asamblenë që priste me padurim, se i egri nuk do të shfaqej atë mbrëmje. Lajmi u prit me indinjatë. Njerëzit u tërbuan nga ky mashtrim; se u sollën me edukatë ndaj këtij tipi pavlerë që kishte emër të keq dhe opinione heretike. Sa më e lartë pozita e tyre në hierarki, aq më i thellë përçmimi i tyre.

- Të tallet kështu me mua, përsëriste pa pushim Kryepeshkopi-këngëtar, me mua!

E sa për gratë, ato të indinjuara u ndien se kishin shkuar me të nën pretendime të rreme - e kishin ngrënë nga një burrec i gjorë, të cilit i kishin hedhur alkool gabimisht në shishen e vet një krijesë me fizikun e një Gama-minusi. Ky ishte ofendim, dhe ato e thoshin këtë me zë përherë e më të lartë. Kryezonja e Itonit ishte veçanërisht më e rreptë.

Vetëm Lenina nuk tha gjë. E zbehtë, me sytë e saj blu të errësuar prej një melankolie të pazakontë, ajo qëndroi ulur në një qoshe, e shkëputur krejt prej atyre që e rrethonin nga një ndjenjë që s'kishte me ta asgjë të përbashkët. Kish ardhur në festë e mbushur me një ngazëllim të ankthshëm. "Pas pak, - tha me vete, ndërsa hynte në dhomë, - do ta shoh me sy, do flas me të, do ia them (për këtë e kishte ndarë mendjen) - se më pëlqen më shumë se askush tjetër që kam njohur ndonjëherë. E ndoshta edhe ai do t'i thoshte..."

Ç'mund t'i thoshte ai? E gjaku i vërshoi faqeve.
"Pse ishte aq i çuditshëm atë natë, pas filmit me prekje? Sa i habitshëm. E megjithatë jam e sigurt se ai më pëlqen mjaft, jam e sigurt..."
Në këtë moment, Bernardi dha lajmin; i egri nuk do vinte në festë.
Lenina papritur ndjeu t'i kalojnë të gjitha ndjesitë që normalisht provohen në fillim të trajtimit me Surrogatin për Pasionet e Dhunshme - ndjesinë e një zbrazëtie të frikshme, mbajtje të frymës, të përziera. Iu bë sikur i ndali zemra. "Ndoshta kjo ndodh se nuk i pëlqej atij," - tha me vete. Dhe menjëherë kjo mundësi u kthye në siguri të palëkundur: Xhoni s'kishte pranuar të vinte sepse nuk e pëlqente atë. Nuk e pëlqente...
"Është, në fakt, pak si tepër i trashë," - po i thoshte Kryezonja e Itonit drejtorit të Krematoriumit dhe Riciklimit të Fosforit. Dhe kur mendoj se unë madje....
- Po, u dëgjua zëri i Fani Krounit, - është absolutisht e vërtetë puna e alkoolit. Dikush që unë njoh, njihte dikë në magazinën e embrioneve që punonte atje ato kohë. Ajo i tha mikes sime dhe mikja më tha mua...
-Sa keq, sa keq, - tha Henri Fosteri, duke u bërë bashkë me Kryepeshkopin-këngëtar. - Mund të jetë me interes për ju të dini se ish-drejtori ynë erdhi në një pikë sa donte ta transferonte në Islandë.
Shpuar prej çdo fjale të thënë, tullumbacja e tendosur e vetëbesimit të Bernardit kullonte prej një mijë plagësh. I zbehtë, i trallisur, i mjerë dhe i zemëruar, ai iu soll rrotull të ftuarve duke belbëzuar shfajësime jokoherente, për t'i bindur se radhës tjetër i egri do të vinte patjetër, iu lut të

zinin vend për të ngrënë ndonjë sandviç karotene, një fetë pâté me vitaminë A, apo një gotë surrogati shampanje. Per të ngrënë ata hëngrën, por atë e injoruan; pinë dhe ose u bënë edhe më të pasjellshëm me të, ose nisën të flisnin me njëri-tjetrin në mënyrë fyese, sikur ai nuk ishte fare aty.

- Dhe tani, miqtë e mi, - tha Kryepeshkopi-këngëtar i Komunitetit Kanterburi me zërin e tij melodik, me të cilin drejtonte seancat e ceremonive ditët përkujtimore të Fordit Tonë. E tani miq, mendoj se është koha të shkojmë.... - u ngrit në këmbë, e la gotën, shkundi jelekun e kuq të uniformës prej viskoze surrogat nga thërrmijat e një vakti jo të vogël dhe eci drejt portës së daljes.

Bernardi i doli përpara që ta ndalë.

- Ju duhet të shkoni vërtet, Peshkop i Këngës?... Është ende shumë herët. Shpresoja që ju të... Po, ç'nuk kish shpresuar, kur Lenina i tha në mirëbesim se Peshkopi i Këngëtarëve të Komunitetit Kanterburit do ta pranonte ftesën, nëse i dërgohej një e tillë. "Ai është mjaft i dashur, e ke parasysh." Dhe i kishte treguar Bernardit kokën e florinjtë të zinxhirit në formë T-je, të cilën Kryepeshkopi- këngëtar ia kishte dhuruar gjatë një fundjave të kaluar me Leninën në Dioqezën e këngëve. Për të takuar Kryepeshkopin- këngëtar të Kanterburit dhe zotni egërsirën. Bernardi e kishte shpallur triumfin e vet në çdo ftesë. Por i egri kishte vendosur që pikërisht atë mbrëmje, nga të gjitha mbrëmjet e jetës, të mbyllej në dhomën e vet e të bërtiste me zë të lartë: "Háni!" madje edhe (qe me fat që Bernardi nuk e kuptonte gjuhën Zunji) "Sons éso tse-ná!". Ai që duhej të ishte momenti i kurorëzimit për karrierën e Bernardit, u kthye e doli çasti i poshtërimit të tij më të madh.

- Unë shpresova kaq shumë... - përsëriti ai duke belbëzuar, duke parë nga titullari me sy lutës e të hutuar.
Miku im i ri, i tha Kryepeshkopi-këngëtar i komunitetit me një ton të lartë, të rreptë e solemn; ra heshtje e përgjithshme. Më lejo të të jap një këshillë. - Dhe i tundi gishtin Bernardit në fytyrë. Përpara se të jetë shumë vonë. Po të them një këshillë për mirë. (Zëri iu bë i zymtë.) - Merr rrugën e drejtë, djalosh. Rrugën e drejtë. - Bëri shenjën e T-së mbi kokën e tij dhe u nis të ikë. - Lenina thirri me një ton krejt tjetër, - eja me mua. e dashur,
Me bindje, por pa buzëqeshje dhe (krejtësisht e pandjeshme ndaj nderit që po i bëhej) pa ngazëllim, Lenina shkoi pas tij e doli nga dhoma. Të ftuarit e tjerë i ndoqën pas një intervali, sa për t'i respektuar. Të fundit që dolën e mbyllën portën me të përplasur. Bernardi mbeti krejt vetëm.
I dërrmuar, i shfryrë, ra në një karrige, mbuloi fytyrën me duar dhe nisi me të qara. Disa minuta më pas, gjithsesi, e mendoi më mirë këtë punë dhe mori katër tableta me soma.
Lart në dhomën e vet, egërsira po lexonte Romeo dhe Xhulieta.
Lenina dhe Kryepeshkopi-këngëtar i komunitetit shkelën në tarracë. "Nxito mikja ime, desha të them Lenina," tha peshkopi me padurim që prej kangjellave të ashensorit. Lenina, që u vonua për një moment sa për t'i hedhur një vështrim Hënës, hodhi vështrimin poshtë dhe erdhi duke rendur mes për mes tarracës për t'u bashkuar me të.
Një teori e re e biologjisë, - ishte titulli i kumtesës që sapo kishte mbaruar së lexuari Mustafa Mondi. Ai qëndroi ulur

për ca kohë, i ngrysur në mendime, pastaj mori penën dhe shkroi në anë të faqes përgjatë titullit. "Trajtimi matematik i autorit mbi konceptimin e qëllimit është risi dhe shumë gjenial, por heretik dhe, për sa i përket rregullit të sotëm shoqëror, i rrezikshëm dhe potencialisht armiqësor. Te mos botohet. - Ai i nënvizoi fjalët. - Autori të mbahet nën vëzhgim. Transferimi i tij tek Stacioni Biologjik i Marines në Shën Helenë mund të dalë domosdoshmëri." Sa keq, mendoi kur po nënshkruante. Një punim kryevepër. Por po fillove të pranosh shpjegime në terma të nisur nga qëllimi - afërmendsh, nuk ke si të dish se çfarë rezultatesh të presësh. Ishte ajo soj ideje, e cila mund të çkushtëzojë ata më të pavendosurit mes kastave të larta; bën që ata të humbin besimin te lumturia si Mirësia Sovrane dhe i shtyn të besojnë, në vend të saj, se synimi është diku përtej, diku jashtë sferave ekzistuese; se qëllimi i jetës nuk është mirëmbajtja e mirëqenies, por një farë rritjeje dhe rafinimi i ndërgjegjes, njëfarë zmadhimi i diturive. Çka ishte, arsyetonte Kontrollori, me gjasë, krejt e vërtetë. Veç jo e pranueshme në kushtet aktuale. Ai e mori përsëri në dorë penën dhe nën fjalët "Të mos botohet" hoqi dhe një vijë të dytë, më të trashë e më të nxirë se e para; pastaj psherëtiu. - Do të ishte bukur, - mendoi, sikur njeriu të mos mendonte për lumturinë! Me sytë e mbyllur e fytyrën që i shkëlqente prej dalldise, Xhoni po i recitonte n'ajër:

"Oh, ajo mëson pishtarët të digjen me dritë!
Ngjan sikur varur rri për faqe, natës

Si një xhevahir i çmuar në vesh' etiopiani,
Bukuri e pamasë ta përdorësh, tepër e shtrenjtë për tokën..."

T-ja e artë shkëlqente mbi gjoksin e Leninës. I shkathët, Kryepeshkopi-këngëtar i Komunitetit e zuri në dorë dhe, me shkathtësi e tërhoqi dhe e tërhoqi.. "Më mirë, - tha papritmas Lenina, duke thyer një heshtje të gjatë, – them të marr nja dy gramë soma."
Gjatë kësaj kohe, Bernardi kish rënë shpejt në gjumë dhe po i buzëqeshte parajsës private të ëndrrave të tij. Buzëqeshte, buzëqeshte. Por i pandalur, akrepi i sahatit elektrik mbi shtratin e tij hidhte një hap përpara çdo tridhjetë sekonda, me një tik-tak gati të pandjeshëm. Tik, tik, tik, tik, ... Dhe ja, u bë mëngjes. Bernardi u rikthye mes mjerimeve të hapësirës dhe kohës. Dhe kaloi deri në punë tek Qendra e Kushtëzimit në humorin më të ulët të mundshëm. Dehja prej suksesit avulloi; tashmë ishte prapë esëll vetja e tij e dikurshme; dhe për kontrast me ballonin e përkohshëm të javëve të fundit, vetvetja e vjetër ngjante në mënyrë të pashembullt më e rëndë se atmosfera që e rrethonte.
Me këtë Bernard të shfryrë, i egri u soll çuditërisht me përzemërsi.
- Ti ngjan si atëherë në Malpais, - i tha ai Bernadit, kur ky iu ankua për atë gjënë që i ndodhi. - Të kujtohet kur u takuam bashkë për herë të parë? Jashtë shtëpisë së vogël. Je njësoj siç ishe atëherë.
-Se jam prapë i brengosur, prandaj.
-Epo, unë do të pëlqeja më mirë të isha i brengosur, se atë farë lumturie false që kishe ti.

- E bukur kjo, më pëlqen, -i tha Bernardi gjithë vrer.- Për më tepër kur ti je ai që e shkaktove. Ngaqë nuk doje të vish në festë, prej teje m'u kthyen të gjithë kundër!-E dinte se ajo që po thoshte ishte absurde dhe e padrejtë; e pranoi me vete, e më në fund, edhe me plot gojën, vërtetësinë e asaj që i tha i egri për miqtë e kotë, të cilët kthehen aq lehtësisht, nga një provokim i vogël, në armiq të egër. Por megjithëse i dinte këto dhe i pranonte, me gjithë faktin se mbështetja e simpatia e mikut të vet ishte hë për hë i vetmi ngushëllim, Bernardi vazhdoi si pervers të ushqente, bashkë me dhembshurinë e çiltër, një hatërmbetje të fshehtë ndaj të egrit, sa të meditonte ca hakmarrje të vogla për t'ia lëshuar përsipër. Të ushqeje hatërmbetje ndaj Kryepeshkopit- këngëtar të Komunitetit ishte e kotë; nuk kishte asnjë mundësi të hakmerrej as ndaj Shefit të Shisheve apo Asistent Paracaktuesit. Si viktimë për Bernardin, i egri gëzonte mbi të tjerët një superioritet të pamasë: ai ishte i arritshëm. Një prej funksioneve më kryesore të një miku është (në një formë të butë e simbolike) të durojë ndëshkimet të cilat do të donim, por nuk kemi mundësi, t'ua japim armiqve tanë. Miku-viktimë tjetër për Bernardin ishte Helmholci. Kur, kokulur, ai erdhi edhe një herë tjetër dhe kërkoi miqësinë, të cilën, kur vetë ishte në majë, nuk e kishte menduar si të denjë për t'u ruajtur, Helmholci ia dha; dhe ia dha pa qortime, pa koment, si ta kishte harruar fare se kishte ngjarë ndonjëherë ndonjë sherr. I prekur, Bernardi e ndjeu veten thellësisht të poshtëruar nga shpirtmadhësia e tjetrit - shpirtmadhësi edhe më e jashtëzakonshme, prandaj edhe më poshtëruese, ajo nuk i detyrohej fare somas, por fund e krye karakterit të Helmholcit. Ishte Helmholci i përditshëm që harronte

dhe falte, jo Helmholci i gjysmëgramit që të shpinte në pushim. Bernardi ishte ashtu siç duhej mirënjohës (ishte një ngushëllim i jashtëzakonshëm ta kishte atë përsëri mik) dhe njëherësh i nxehur (do ishte kënaqësi të hakmerrej disi ndaj Helmholcit për shpirtmadhësinë e tij).
Në takimin e parë pas prishjes, Bernardi derdhi pa kursim një rrëfenjë të mjerimeve të veta dhe pranoi ngushëllimet. Dhe u deshën disa ditë për të mësuar, për habinë e tij dhe me një sëmbim prej turpit, se nuk kishte qenë i vetmi që kish pasur ngatërresa. Helmholci, po ashtu, kishte hyrë në konflikt me Autoritetet.
- E gjitha për ca vargje, - i shpjegoi ai. - Po jepja orën e zakonshme të Inxhinierisë së Avancuar të Ndjenjave për studentët e vitit të tretë. Dymbëdhjetë leksione, prej të cilave i shtati është për rimat. Për përdorimin e rimës në Propagandën e Moralit dhe Reklamë, thënë më saktë. Unë përherë i ilustroj leksionet me shumë shembuj teknikë. Këtë radhë u dhashë një që e kisha krijuar unë vetë. Budallallëk me brirë, sigurisht; por nuk e mbajta dot. - Dhe qeshi. - Isha kureshtar të shihja se si do të reagonin. Përveç kësaj, - shtoi ai më seriozisht, - doja të bëja pak propagandë; u përpoqa të sajoja diçka që ata të ndiejnë të njëjtën gjë që ndjeva dhe unë kur i shkrova vargjet. O, Ford! - Qeshi prapë. Çfarë sherri që plasi! Drejtori i shkollës më thirri dhe më kërcënoi se do më pushonte në çast nga puna. Më kanë futur në rreth.
- Po çfarë vargjesh bëre ti? - e pyeti Bernardi.
- Ishin për vetminë, - Bernadit i shkoi vetulla tek veshët. -T'i recitoj unë, po deshe, - dhe Helmholci ia nisi:

"Mbledhja e djeshme,
Veç një daulle shpon, Nata në qytet,
Në vakum noton,
Buzët mbyllur janë, fytyrat për gjumë,
Çdo makinë ka ndalur,
Në vende të qelbura llumë,
Ku turmat kanë qenë,
Heshtja të shijon,
Ngasherehesh ti (me zë a heshtur)
Flet-por a e shikon,
Me zë të kujt, flet ti
As unë nuk e di.
Suzana më mungon, Egera më mungon,
Për krahët edhe cicat,
Buzët dhe prapanicat, Ngadalë bëhen një pamje
Te kujt? pyes, për çfarë
Kaq absurd është thelbi
Se diçka, që s'është në jetë
Prapëseprapë duhet të mbesë
Më fort netëve të vetmisë Njëri-tjetri,
kur zë ta pallojë,
Pse kjo të na duket e fëlliqtë
Kur thuhet me gojë?"

Epo ja, këtë i dhashë si shembull dhe më denoncuan tekdrejtori i shkollës.
- Nuk më habit, - tha Bernardi. - Kjo bie ndesh me të gjithë atë që na kanë mësuar në leksionet e gjumit. Dhe

ki parasysh se ata kanë marrë të paktën një çerek milioni paralajmërime kundër vetmisë.
E di. Por mendova se do më pëlqente të shikoja efektin që do t'u shkaktonte.
E pra, ja tani e pe.
Helmholci thjesht qeshi.
-U ndjeva, - tha ai pasi heshti pak, - sikur sapo kisha nisur të kem diçka rreth së cilës të shkruaja. Sikur nisa të isha aq i aftë sa ta përdorja fuqinë që ndiej ta kem brenda meje - atë fuqi të fshehtë, të veçantë. - Pavarësisht gjithë problemeve, Bernardit tjetri iu duk thellësisht i lumtur.
Helmholci dhe i egri zunë miqësi aty për aty. Kaq me përzemërsi sa Bernardi ndjeu sëmbimin e mprehtë të xhelozisë. Gjithë këto javë ai nuk ia doli kurrë të familjarizohej me të të mos i kishte njohur kurrë me njëri- tjetrin. I erdhi turp prej xhelozisë së vet dhe u përpoq ta mposhtte këtë ndjenjë duke alternuar përpjekjet e vullnetit me kokrrat e somas. Por këto përpjekje nuk qenë shumë të suksesshme; dhe midis pushimeve soma kishte domosdo intervaleve. Ajo ndjenjë e urryer i kthehej pareshtur.
Në takimin e tretë me të egrin, Helmholci recitoi vargjet
e tij mbi vetminë.
- Si të duken? - e pyeti atë. I egri tundi kokën.
- Dëgjo këto, - i tha dhe duke hapur sirtarin që mbante mbyllur me çelës e nxori që aty librin e ngrënë minjsh, e hapi e lexoi:

"Lër zogun e ditës më të zhurmshme të rri' I vetmuar
mbi pemën arabike ai,
Lajmëtari i trishtuar dhe bori..."

Helmholci e dëgjonte përherë e më shumë i eksituar. Tek "i vetmuar në pemën arabike ai," u shkund; tek "prej britmes lajmëtare," buzëqeshi me kënaqësi të papritur; tek "çdo zog me krahë tiranë," gjaku i vërshoi nëpër mollëza; por tek "muzikë mortore" fytyra e tij u zbeh meit dhe dridhej prej një emocioni të paprecedent. I egri këndoi më tej:

"Prona ishte kaq e frikshme,
Se kush ishe më nuk je;
Dyfytyrësh, emër dy, Askush nuk të thirri ty.
Arsyeja e vetmallkuar
Ndarjen pa të rritet mbroth..."

- Orgji-derri!-tha Bernardi, duke i ndërprerë leximin me një të qeshur të shëmtuar dhe me zë të lartë. - Është thjesht himni i Shërbimit të Solidaritetit. - Po hakmerrej ndaj dy miqve të vet vetëm se ata po shkonin me njëri-tjetrin më mirë
se me të.
Në harkun e dy-tri takimeve të mëpasme, ai e përsëriti herë egrin, sa ç'arriti përnjëherë Helmholci. Duke i ndjekur me sy, i dëgjonte të bisedonin dhe u ndie i penduar, me dëshirën që pas here këtë akt të vogël hakmarrjeje. Ishte e thjeshtë dhe meqë, si Helmholci, si i egri ishin të lënduar për tmerr prej shkatërrimit e prishjes së kristalit poetik, tejmase të efektshëm. Më në fund, Helmholci e kërcënoi se do ta nxirrte me shqelma nga dhoma po të guxonte t'i ndërpriste përsëri. E megjithatë, ndërprerja e radhës, më e paturpshmja e të gjithave, erdhi prej Helmholcit dora vetë.
I egri po lexonte *Romeo dhe Xhulieta* me zë - duke lexuar (atiji dukej vetja Romeo, kurse Lenina ishte Xhulieta) me

pasion të madh e drithërues. Helmholci po dëgjonte skenën e takimit të parë mes të dashuruarve me njëfarë mëdyshjeje. Skena në kopsht e mrekulloi me poetikën e saj; por nga ndjenjat eshprehura i erdhi për të qeshur. Të shkosh deri në atë gjendje vetëm që ta bësh me një vajzë iu duk fare qesharake. Por, e marrë fjalë për fjalë, çfarë pjese madhështore e inxhinierisë emocionale! "Ky mik i vjetër, - tha ai, - bën që teknikët më të mirë të propagandës këtu tek ne të duken teveqelë." I egri- buzëqeshi gjithë triumf dhe vijoi leximin. E të gjitha shkuan pak a shumë mirë deri në skenën e fundit të aktit të tretë, Kapuleti dhe Zonja Kapulet nisën të shtyjnë me detyrim Xhulietën të martohet me Parisin. Helmholcin nuk e zinte vendi gjatë gjithë skenës; por kur, luajtur me aq patos nga i egri, Xhulieta briti:

"Nuk ka mëshirë që rri mes resh,
Që t'i shohë fundin hidhërimit tim?
Oh, e ëmbla nënë, mos më flakni tej!
Shtyje këtë martesë, për një muaj, a një javë;
Ose, po s'e bëre, shtro shtratin martesor,
Tek i ziu monument ku shtrirë rri Tibalti..."

Sapo Xhulieta tha kështu, Helmholci i plasi gazit sa nuk mbahej dot.
Nëna dhe babai (çfarë turpi i paparë) e detyrojnë vajzën të martohet me një njeri që ajo nuk e do! Dhe vajza idiote që nuk i thotë se është me një tjetër, për të cilin (për momentin, pas gjithë gjasave) ka preferencë! Në këtë absurditet vulgar, situata ishte krejt komike. Ai ia kishte dalë, me përpjekje heroike, të mbante ndrydhur brenda vetes shtysën për t'ia plasur gazit;

por "e ëmbla nënë" (thënë në tonin më të përvuajtur që bëri i egri) dhe përmendja e Tibaltit të vdekur, por dukshëm me trup të padjegur, duke harxhuar kështu gjithë atë fosfor për një monument të fishkur, kjo ishte e tepërt. Ai qeshi e qeshi, deri kur i ranë lotët faqeve rrëke - qeshi pa pushim ndërkohë që, i zbehur prej ndjesisë fyese, i egri e shihte përsipër librit të vet të hapur dhe pastaj, teksa e qeshura vazhdonte, e mbylli librin me indinjatë, u ngrit në këmbë, dhe, me gjestin e dikujt që s'di nga lidhet gomari, e kyçi atë në sirtarin e vet.
“E megjithatë, – tha Helmholci kur, pasi i ishte rregulluar frymëmarrja aq sa t'i kërkonte falje, e zbuti të egrin deri sa ta bënte të dëgjojë shpjegimet e duhura, - E kuptoj fare mirë se njeriu ka nevojë për situata të tilla qesharake dhe të çmendura; askush nuk shkruan dot kaq mirë për gjë tjetër. Përse ky miku ynë i vjetër ka qenë një teknik kaq i mrekullueshëm i propagandës? Sepse ai ka pasur kaq shumë gjëra të çmendura, tortura të vërteta, të cilat e kanë ngacmuar. Njeriu duhet të lëndohet e të mërzitet; përndryshe nuk mendon dot për fraza që hyjnë thellë në mendje, si rreze X. Por baballarë dhe nëna! - dhe tundi kokën. - Nuk ke si pret që unë të mos qesh me baballarët dhe nënat. Edhe kujt do t'i bënte përshtypje, nëse një djalë shkon me një vajzë apo jo? (I egri u mrrol, por Helmholci, i cili i kishte ngulur mendueshëm sytë në dysheme, nuk pa gjë.) - Jo, - tha me një psherëtimë, – nuk bën. Ne kemi nevojë për një lloj tjetër çmendurie e dhune. Por çfare? Çfarë? Ku mund t'i gjejmë? - heshti; pastaj duke tundur kokën si për të thënë jo, tha - nuk e di, - dhe e mbylli për fare me një Unë nuk e di."

KAPITULLI XIII

Henri Foster endej nëpër muzgun e Magazinës së Embrioneve.
Të pëlqen të shkojmë tek kinemaja e ndjenjave sonte? Lenina tha jo me kokë pa thënë një fjalë. Do shkosh me ndonjë tjetër? - Ai ishte i interesuar të dinte se kush prej miqve të tij po e bënte me kë. - Mos është gjë Benito? - e pyeti.
Ajo prapë tundi kokën.
Henri e dalloi lodhjen në sytë e saj ngjyrë vjollcë, zverdhjen përfund läbyrjes së lupusit, brengën në cepat e gojës së kuqërremtë pa buzëqeshje.
- Mos je gjë sëmurë, apo jo? - e pyeti, pak si me merak, i trembur se mos ajo po vuante prej një prej atyre pak sëmundjeve infektive që kishin ngelur ende.
Edhe një herë tjetër Lenina tundi kokën.
Gjithsesi, ti duhet të shkosh e të shihesh tek doktori, - tha Henri. - Një doktor në prag, t'i mban hallet larg, shtoi ai me gjithë zemër, duke e përmbyllur fjalën e urtë hipnopedike me një të rrahur të lehtë në sup. - Ndoshta ke nevojë për ndonjë Zëvendësim Shtatzënie, - propozoi ai. - Ose përndryshe një trajtim super të fortë Surrogat i Dhunshëm Pasioni. Se ndonjëherë, ti e di, surrogati standard i pasionit
nuk është tamam....

- Oh, për hir të Fordit, - i tha Lenina duke thyer heshtjen
e vet kokëfortë, - qepe! - dhe u kthye në anën tjetër të
merrej me embrionet e veta të lëna pas dore.
Një trajtim S.Dh.P, tamam ashtu! Ajo do kish qeshur, po të mos ishte gati për të qarë. Thua se nuk kishte mjaft S.Dh.P. metë sajën! Psherëtiu thellë e vazhdoi të mbushte një shiringë. "Xhoni, - murmuriti me vete, -Xhoni. Pastaj tha - O Ford! Ia dhashë këtij injeksionin e sëmundjes së gjumit apo jo?" - thjesht nuk po i kujtohej. Më në fund vendosi të mos rrezikonte me mbidozë dhe vazhdoi më tej në rresht me shishen e radhës.
Njëzet e dy vjet, tetë muaj e katër ditë nga ai çast, një i ri Alfa-minus administrator tek Muanza-Muanza do të vdiste nga tripanosomiasoza - rasti i parë prej më shumë se gjysmë shekulli. Me psherëtima, Lenina vazhdoi punën.
Një orë më vonë, në Dhomën e Zhveshjes, Fani po e kundërshtonte me forcë.
- Po është absurde të lësh veten në një gjendje të tillë. Thjesht absurde. - Përsëriti ajo. - Dhe për çfarë? Për një burrë, vetëm një burrë.
- Por ky është ai që dua.
- Thua se nuk ka me miliona burra të tjerë në këtë botë.
- Por unë nuk dua ata.
- E nga e di ti, kur nuk i ke provuar?
- I kam provuar.
- Po sa ke provuar? - e pyeti Fani duke ngritur supet me përçmim, - një, dy? Sa?
—Me dhjetra. Veç, - tundi kokën e shtoi, - nuk ishte ndonjë gjë.
- Duhet të këmbëngulësh, - tha Fani plot kuptim.

Në prag, veshur me një kostum të bardhë marinari prej surrogat-acetat sateni dhe me një kapele po të bardhë, të rrumbullakët, të kthyer mënjanë mbi veshin e majtë, qëndronte Lenina.
- Oh! - tha i egri, sikur ti kishte futur njeri ndonjë grusht të fortë.
Gjysmë grami kishte mjaftuar, që Lenina të harronte fare edhe frikën edhe turpin.
-Tung Xhon, - tha ajo duke i buzëqeshur dhe kaloi ngjitur pas tij për t'u futur brenda.
Automatikisht ai e mbylli portën dhe i ra pas. Lenina zuri vend. Ra një heshtje e gjatë. - Ti nuk dukesh shumë i gëzuar që po më sheh, Xhon, - tha ajo më në fund.
-Jo i gëzuar? - tha i egri duke vështruar Leninën me qortim; pastaj befas ra në gjunjë përpara saj, i mori dorën dhe ia puthi me admirim. - Jo i gëzuar? Oh, vetëm ta dish, - pëshpëriti duke u përpjekur të ngrejë sytë lart të shohë fytyrën e saj, - E çmueshmja Leninë, - vazhdoi ai, - më e mahnitshmja, gjëja mëe shtrenjtë në botë. - Ajo i buzëqeshi ëmbël e me butësi.
-Oh, ti je kaq e përkryer, - (ajo u zgjat drejt tij me buzët e hapura), - kaq e përkryer dhe e pashoqe je krijuar, (u afruan) ke më të mirën e çdo krijese. - Edhe më pranë. Kur befas, i egri kërceu drejt më këmbë. - Prandaj, - tha ai, duke folur me fytyrën e kthyer mënjanë, – dua të bëj më parë një gjë për ty... dua të them, të tregoj se unë ia vlej për ty. Jo se vërtet do vlej ndonjëherë aq sa duhet. Por gjithsesi, dua të tregoj me çdo kusht që nuk jam krejt i pavlerë. Dua të bëj diçka.
- Përse mendon se kjo është e nevojshme.. - nisi të thotë Lenina, por e preu fjalën në mes. Kishte një notë acarimi në zërin e saj. Kur dikush është zgjatur përpara me buzët e

hapura, të afrohet përherë e më pranë - vetëm që të gjendet pastaj papritur, ndërkohë që ky gdhe i shëmtuar ngrihej në këmbë, përpara asgjëje - epo, kishte arsye të mërzitej, edhe me gjysmë grami soma në qarkullimin e gjakut, një arsye të
qashtër për t'u mërzitur.
-Në Malpais, - murmurinte krejt pa lidhje i egri, - duhet t'i sjellësh asaj lëkurën e luanit të malit, dua të them, kur dëshiron të martohesh me një femër. Ose edhe lëkurë ujku.
- Nuk ka luanë në Angli, - Lenina gati sa nuk pëlciti. -Po edhe po të kishte, - shtoi i egri me përbuzje të papritur, - njerëzit do t'i vrisnin nga helikopterët, besoj, me gaz helmues apo ndonjë gjë të tillë. Unë këtë nuk do ta bëja kurrë, Lenina. - Drejtoi supet, i hodhi sytë drejt saj dhe hasi vështrimin e bezdisur të një njeriu që nuk ka kuptuar asgjë. I hutuar tha, - Do bëj çdo gjë, - dhe vazhdoi gjithnjë e më pa lidhje. - Çfarëdo që të thuash ti. Do nisma dihet, janë me dhimbje, e ke parasysh. Por mundi i ardhur prej tyre sjell gëzim. Kështu ndihem unë. Për ty do bëj gjithçka, do fshij dyshemenë, po të ma kërkosh ti.
- Po ne kemi fshesa me korrent këtej, - i tha Lenina
e shushatur. - Nuk është nevoja të fshish me fshesë.
-Jo, sigurisht që nuk është e nevojshme. Por disa prej gjërave më të ulëta, quhen edhe vuajtje fisnike. Dua të vuaj diçka fisnike. Më kupton ç'dua të them?
- Po meqë i kemi fshesat e korrentit...
- Nuk po më kupton ku dua të dal.
-Se ne kemi dhe Ypsiolonët gjysmëdebilë, që të punojnë me fshesë... - vijoi ajo fjalën, - ore, vërtet, përse kërkon të lash dysheme?

- Përse? Po për ty, për ty. Që të tregoj se unë...
- Dhe, aman ç'lidhje kanë fshesat e korrentin me luanët...
-Për të treguar se sa...
- Apo luanët me të qenët i gëzuar që po më takon mua.
- ajo po pezmatohej përherë e më tepër.
- Fort të dashuroj, Leninë, - i tha ai me gjithë zemër e gatime dëshpërim.
- Si shenjë e beftë e ngazëllimit të brendshëm, gjaku
vërshoi mollëzave të Leninës.
- E ke seriozisht, Xhoni?
- Nuk e kisha menduar ta them kështu, - iu ankua i egri dhe përplasi duart si në agoni. – Jo deri kur... Dëgjo Lenina, në Malpais njerëzit martohen.
- Çfarë bëjnë? - acarimi dukej se po kthej sërish në zërin esaj. Çfarë po thoshte?
- Përgjithmonë. I premtojnë njëri-tjetrit të jetojnë bashkë përgjithmonë.
- Ç'ide e llahtarshme! - Lenina u trondit thellë.
- Lëre pas bukurinë e jashtme, me mendjen që rinohet më shpejt, se gjaku kalbet.
- Çfare?
- Edhe Shekspiri kështu thotë. - Po e theve ti nyjën e virgjër, përpara gjithë të shenjtave ceremoni, bëje të plotë e të shenjtëruar ritin...
- Pash Fordin, Xhoni, eja në vete. Nuk po të kuptoj asnjë fjalë. Në fillim më the se do lash dyshemenë për mua; pastaj me nyjat. Po më çmend fare. - Ajo brofi në këmbë, thua se frikësohej se mos ai arratisej fizikisht, po aq sa edhe mendërisht, dhe e mbërtheu për kyçi. - M'u përgjigj: A të pëlqej apo nuk të pëlqej?

Ra një çast heshtja; pastaj, me një zë të dobët, ai tha:
- Të dua më shumë se çdo gjë në këtë botë.
- Po pse dreqin nuk ma ke thënë? - bërtiti ajo fort, dhe aq i vrullshëm ishte pezmi, sa ia nguli thonjtë e vet të mprehtë në lëkurën e kyçit. - Në vend që t'i biesh rrotull me larje dyshemeje, a me nyje e luanë e të më bësh të ndihem mjerane gjithë këto javë.
Ajo ia lëshoi dorën dhe e largoi e zemëruar.
- Po mos të të pëlqeja kaq shumë, - tha ajo, - tani do të tërbohesha nga inati me ty.
E papritur i hodhi krahët në qafë; ai ndjeu buzët e saj të buta pranë të tijave. Të buta aq lezetshëm, aq të ngrohta edrithëruese sa atij iu kujtuan përqafimet te filmi Tre javë në një helikopter. Oh! Oh! Biondja stereoskopike dhe ahsh! Zezaku, gati si të ishte aty. Tmerr, tmerr, tmerr... ai u përpoq të shkëputej; por Lenina e shtrëngoi më fort në krahët e saj.
- Përse nuk më the? - i pëshpëriti ajo duke tërhequr
kokën pas për ta shikuar Xhonin në sy. Sytë e saj e qortuan me ëmbëlsi.
- Strofulla më e thellë, vendi më i mirë (gjëmoi poetikisht zëri i tij i brendshëm), - gjithë çka gjenia jonë ju ofron, s'e
çon nderin tim në lakmi. Kurrë, kurrë! - e mbylli ai.
- Budalla i vogël! - i thoshte ajo. - Unë të dëshiroja kaq shumë. Po kur më dëshiroje edhe ti, përse...?
- Por, Lenina... - nisi ta kundërshtojë ai; dhe kur ajo i shpleksi duart nga qafa dhe u tërhoq pas, ai kujtoi për një çast se e kishte kuptuar atë shenjë të pathënë të tijën. Por kur ajo zbërtheu gjerdanin e bardhë të prezervativëve dhe
e vari me kujdes në shpinoren e karriges, atëherë ai nisi të dyshojë se ndoshta ishte gabuar.

- Lenina! - i thirri i shqetësuar.
Por, ajo i çoi duart tek qafa dhe me një lëvizje, bluza e bardhë u shkit deri në fund fare; dyshimi iu përmblodh në një siguri tepër, tepër të qëndrueshme; "Lenina, çfarë po bën kështu?" Zip, zip! Përgjigja që erdhi prej saj ishte e pafjalë. Dhe ajo i la përtokë pantallonat me fund si kambana; të brendshmet me zinxhir, i kishte në ngjyrë rozë të zbehtë si vashë deti. T-ja e artë e Kryepeshkopit-këngëtar të
Komunitetit kolovitej mbi gjinjtë e saj.
"Për ato sisa qumështi, që përmes hekurave të dritareve shpojnë sytë e gjithë burrave...” kënga, bubullima, fjalët magjike, bënë që ajo të dukej dy herë më e rrezikshme, dy herë më joshëse. Butë, butë, por sa thellë hynte! Shponte dhe çante mes arsyes, i bënte gropën qëndresës. "Betimet më të forta, janë fije kashte në zjarrin e gjakut. Bëhu më i përkorë përndryshe..."
Zip! Ajo butësi e rrumbullakët bojërozë u derdh e u nda si dy gjysmat e një molle. Një vërvitje të krahëve, një përdredhje, njëra këmbë u ngrit pak lart e pastaj tjetra, kilotat ranë në dysheme, të shfryra si një balonë e shpuar. Ende me këpucë e çorapë dhe me kapelën e bardhë të mënjanuar mbi veshin e majtë, ajo iu afrua. "I dashur! I dashur! Oh, sikur të më kishe treguar më parë!” – dhe hapi
krahët.
Por në vend që të thoshte "E dashur!" e të zgjaste edhe vetë krahët përpara, i egri u tërhoq prapa plot tmerr duke shtyrë duart e saj, thua se po mbrohej nga një kafshë e rrezikshme. Bëri katër hapa pas dhe u mbështet me shpatulla pas murit. "O ëmbëlsirë! - i tha Lenina dhe duke i hedhur duart mbi supe e mbështeti trupin e saj pas tij. - Në krahë më

shtrëngo, - i dha urdhër ajo. - Fort ti përqafo, aq sa më drogo, zemër! - Edha ajo zotëronte poezinë e saj; dinte fjalë që këndoheshin e ishin fjalë magjike dhe goditje daullesh. - Puthmë! - ajo mbylli sytë, e la zërin e saj të zhytej mes një mërmërime të përgjumur, - puthmë sa në koma të bie, zemër! Dhe fort më shtrëngo, zemër..."
I egri e kapi nga kyçet e duarve, i shkuli duart e saj prej supeve dhe e shtyu prapa deri aq sa i mbërrinin krahët e vet. "Oh, më vrave, po më ... - dhe ajo krejt papritur heshti. Tmerri e kish bërë të harronte dhimbjen. Kur hapi sytë, kishte parë fytyrën e tij - jo, jo, nuk ishte fytyra e tij kjo e këtij të panjohuri, meit, e shfytyruar, që dridhej në mënyrë të çmendur e të pakuptueshme nga tërbimi. E shtangur ajo i pëshpëriti, – Çfarë ke Xhoni? - Ai nuk i ktheu përgjigje. Vetëm sa e shikonte drejt në sy, me ata sytë e tij të çmendur. Duart e tij i shtrëngonin kyçet, dridheshin. Ai merrte frymë thellë dhe në mënyrë të çrregullt. Të dobët si shushurimë, por tmerruese, ajo befas dëgjoi kërcitjen e dhëmbëve të tij. - Çfarë ke kështu? - gati sa nuk ulëriu ajo.

Prej britmës së saj ai sikur u zgjua, e mbërtheu nga supet dhe e shkundi fort dhe i ulëriu në fytyrë: "Kurvë! Kurvë! Lavire e pacipë!".
- Oh, mooos, joooo, - protestoi ajo më zërin që vinte i dridhur prej të shkundurave.
- Kurvë!
- Të luuuuutem.
- Lavire e pacipë!
- Një graaaamë është më miiiirë se... - filloi të thotë ajo. I egri e shtyu pas me aq forcë, sa ajo u lëkund dhe pastaj
ra përtokë.

- Ik, - bërtiti ai duke iu hakërryer në fytyrë, - Ik që këtu, se do të të vras fare. - Dhe i tregonte grushtet e shtrënguar fort. Lenina ngriti duart të mbrohej në fytyrë.
- Jo, Xhon, të lutem mos...
- Ec, ik shpejt.
Me njërin krah të ngritur lart, duke ndjekur me sy të tmerruar çdo lëvizje që ai bënte, ajo mezi u ngrit në këmbë dhe ashtu e kruspullosur, duke mbuluar kokën, u turr drejt
banjës.
Zhurma e madhe e shpullës që mori para se të nisej u dëgjua si e shtënë revolveri.
- Ahhh! - klithi Lenina e shkoi përpara.
E mbyllur brenda në banjë, ajo pati ngenë t'u hidhte një sy plagëve. Me shpinë nga pasqyra, ajo ktheu kokën të shohë. Në anën e majtë të supit dukej fare qartë shenja e një pëllëmbe me pesë gishtat; dallohej e skuqura mbi mishin e saj ngjyrë perle të bardhë. Me shumë kujdes lëmoi vendin e vrarë.
Jashtë në dhomë, i egri ecte lart e poshtë, marshonte, marshonte me rrahjen e daulleve dhe muzikalitetin e fjalëve magjike. "Trumcaku shkon atje dhe një mizë e praruar përdridhet në syrin tim." Ato i rrapëllinin në veshë si të çmendura. "Qelbësi, jo kali i shalës, turret drejt tij plot uri. Bel e poshtë centaurë janë, femra vetëm bel e lart. Veç brezat e zotave trashëgojnë. Poshtë tyre të gjithë janë djaj. Ka ferr e ka errësirë, atje është dhe gropa e squfurit, digjet, përvëlon, qelbet, ka konsum; turp e faqja e zezë! Më jep një gram qelbësirë të mirë farmacie, që të ëmbëlsoj pak imagjinatën."

- Xhoni! - kuturisej zëri i vogël magjepsës prej banjës. -
Xhoni!
- O ti kërp, që kaq me mjeshtëri lëshon aromë kaq të ëmbël, sa arsyeja për ty vuan. Ishte ky libri më i mirë sa për t'i shkruar përsipër titullin 'kurvë? Qielli i mbylltë hundën...
Por parfumi ende sillej nëpër dhomë dhe xhaketa i ishte bërë me pudër të bardhë prej trupit të saj erë myshk dhe kadife. -Lavire e pacipë, lavire e pacipë, lavire e pacipë. - Ritmi i paepur godiste pa pushim. - Lavire... -Xhon, a mund të m'i japësh pak rrobat e mia?
Ai i mblodhi pantallonat e shkurtra, bluzën dhe kilotat
me zinxhir.
- Hape! - i bërtiti duke goditur portën me shqelm. - Jo nuk ta hap. – Zëri i saj dridhej e shkonte duke u
shuar.

– Epo, si pret të t'i jap atëherë?

- Futi përmes ventilatorit sipër derës.
Ai bëri si i tha ajo dhe i shqetësuar iu kthye ecejakut – tutje-tëhu nëpër dhomë.
- Lavire e pacipë, lavire e pacipë. Lukset e djallit, bythët
e trasha dhe gishtat si patate...
- Xhoni!
- Çfarë do? - ia ktheu noprani.
- Nuk e di a ma jep dot gjerdanin tim maltuzian? Lenina i vuri veshin hapave në dhomën ngjitur, duke pyetur veten se sa gjatë do të vazhdonte ai ashtu, duke ecur lart e poshtë; nëse duhej të priste aty derisa të dilte jashtë apartamentit, apo do të ishte më e sigurt të priste të kalonin ca orë sa t'i binte inati, apo të hapte derën e banjës dhe të turrej me vrap jashtë.

Hamendjet e sikletshme iu prenë në mes prej ziles se telefonit që ra në dhomën tjetër. Përplasja e këmbëve ndali në vend. Dhe pastaj dëgjoi zërin e egërsirës të flasë qetësisht,
"Alo."
"Po."
"Të mos e tejkaloj veten, si, si, po unë jam."
"Po, nuk më dëgjoni? Unë jam, egërsira vetë."
“Çfarë? Kush është sëmurë? Sigurisht që dua ta di,"
"Kaq serioze është gjendja? Kaq keq është? U nisa menjëherë..."
"Nuk është në dhomën e saj? Ku e kanë çuar?"
"O Zot! Cila është adresa?"
"Park Lein, tre, vetëm kaq? Tre? Faleminderit."
Lenina e dëgjoi kërcitjen e receptorit tek u vu në vend, pastaj hapat e tij kur doli me nxitim. Një derë u përplas. Ra heshtja. Vërtet të kishte ikur?
Me një pafundësi masash paraprake, ajo e hapi portën një gisht: përgjoi përmes të çarës; mori zemër nga pamja e zbrazët; e hapi edhe pak më shumë dhe e nxori krejt kokën jashtë portës; më në fund doli majë gishtave në dhomë; qëndroi një sekondë me veshët ngehur dhe zemra i rrahu fort, shumë fort; pastaj u lëshua drejt portës, e hapi, rrëshqiti përmes saj,

e përplasi dhe ia dha vrapit. Vetëm kur u fut në ashensor dhe po zbriste poshtë, e ndjeu veten më në fund në vend të sigurt.

KAPITULLI XIV

Spitali për të vdekurit në Park Lejn ishte një kullë gjashtëdhjetëkatëshe me pllaka të verdhëlleme. Kur i egri zbriti prej taksikopterit, një karvan ajror mjetesh varrimi me ngjyra të gëzueshme u ngrit prej tarracës me uturima dhe u lëshuan përmes Parkut drejt perëndimit, drejt Krematoriumit të Kalbësirave. Në hyrje të ashensorit, portieri i dha informacionin që i nevojitej dhe ai zbriti në pavijonin 81 (pavijoni i kapërcimit të pleqërisë, i shpjegoi portieri), në katin e shtatëmbëdhjetë. Dhoma, e ndriçuar mirë, plot dritë dielli dhe e lyer me bojë të verdhë, mbante njëzet shtretër, të gjithë të zënë. Linda po vdiste me shoqëri - me shoqëri dhe me gjithë lehtësirat e jetës moderne. Atmosfera ishte përherë e gjallë nga meloditë e gëzueshme sintetike. Në këmbët e çdo shtrati, përballë secilit prej njerëzve që po vdisnin, kishte një televizor, i cili rrinte i ndezur pa pushim, çezmë e hapur, nga mëngjesi deri në mesnatë. Çdo çerek ore, parfumi i dhomës ndryshohej automatikisht.

Ne përpiqemi, - po i shpjegonte infermierja, që kish marrë në dorëzim të egrin, - përpiqemi të krijojmë një atmosferë krejtësisht të këndshme - një gjë midis hotelit të klasit të parë dhe një pallati ndjesish, nëse më kupton se ç'dua të them.

- Ku ndodhet ajo? - e pyeti i egri, duke injoruar shpjegimet e saj plot mirësjellje.
Infermierja u ofendua.
E ke me nxitim? - e pyeti ajo.
- Ka ndonjë shpresë? – ia ktheu ai.
- Do të thuash, që ajo të mos vdesë? (Ai pohoi me kokë.) - Jo, sigurisht që nuk ka. Kur dikush vjen këtu, nuk ka më... - e trembur prej ngjyrës së zbehtë të fytyrës së tij, ajo befas ia plasi. - Përse, çfarë problemi keni? e pyeti. Ajo nuk qe mësuar me këtë sjellje të një vizitori. (Jo se kishin pasur shumë vizitorë gjithsesi: se nuk kishte as arsye të kishin vizitorë.) - Nuk je gjë sëmurë, apo jo? - i tha atij. Ai tundi kokën për t'i thënë jo.
Është nëna ime, - i tha me një zë që mezi dëgjohej. Infermierja ia nguli sytë e trembur për tmerr; pastaj shpejt e hodhi vështrimin matanë. Nga qafa deri në flokë ishte bërë e flakë e kuqe.
- Më ço tek ajo, - tha i egri, duke u përpjekur t'i flasë me një ton të zakonshëm.
Ende fytyrëzymtë, ajo çau përmes pavijonit. Fytyra ende të freskëta e pa rrudha (pleqëria kapërcente aq shpejt sa nuk kishin kohë as t'u dukej mosha mbi faqe me rrudha - vetëm në zemër e në tru) ktheheshin të shihnin se kush po kalonte. Lëvizja e tyre po ndiqej edhe prej syve të zbrazët dhe aspak kureshtarë të fëmijërisë së dytë. I egri u drodh kur i pa.
Linda ishte shtrirë në fund të një rreshti të gjatë shtretërish, ngjitur me murin. E mbështetur pas jastëkëve, ajo po ndiqte gjysmëfinalet e kampionatit të Tenisit Sipërfaqësor në Amerikën e Jugut, të cilat po luheshin si një riprodhim i heshtur dhe i zbehtë përmes ekranit të televizorit në këmbëtë

shtratit. Sa andej-këtej, përmes kornizës katrore të ndriçuar te xhamit, figurat e vogla kërcenin pa zhurmë, si peshqit në akuarium-banorë të heshtur e të lëvizur të një tjetër bote. Linda i shihte me një buzëqeshje të zbehtë e pa domethënie. Fytyra e mbufatur dhe e zbehtë mbante shprehinë e lumturisë së budallait. Herë pas herë, qepallat i mbylleshin dhe për pak sekonda dukej sikur e këputste gjumi. Pastaj lëvizte pak dhe zgjohej përsëri - zgjohej përballë xhamit të akuariumit me kampionatin e tenisit brenda, prej interpretimeve supervoks-vurliceriane të këngës "Fort ti përqafo, aq sa më drogo, zemër!", prej rrymës së ngrohtë të lulemines që frynte prej ventilatorit mbi kokën esaj - zgjohej prej kësi gjërash, ose prej ëndrrave, të cilat ishin transformimi e stolisja e këtyre gjërave prej somas në gjak; dhe buzëqeshte edhe një herë tjetër me buzagazin e saj të shpëlarë me gëzim foshnjor.
-Epo, tani më duhet të iki, - tha infermierja - Kam një ngarkesë me fëmijë që do vijnë tani. Dhe përveç atyre, është edhe numri tre. Dhe tregoi me gisht matanë pavijonit. -Mund të fiket nga çasti në çast, tashmë. Epo, rehatohu vetë. - i tha dhe iku prerë.
I egri u ul në anë të shtratit të saj.
- Linda, - pëshpëriti ai, duke i shtrënguar dorën. Kur dëgjoi emrin e vet, ajo ktheu kokën. Sytë e saj të mjegulluar ndritën se e njohu. Shtrëngoi dorën e tij, i buzëqeshi, buzët i lëvizën; pastaj papritur i ra koka përpara. Po flinte. Ai u ul ta ruante - duke rrëmuar nëpër atë copë të plakur mishi, duke rrëmuar aq sa të gjente fytyrën e re e të mençur, që i kishte qëndruar mbi kokë kur kishte qenë fëmijë në Malpais, kujtoi (dhe mbylli sytë) zërin e saj,

lëvizjet, të gjitha ngjarjet e jetës që kishin kaluar bashkë "Streptokok - Gë te Banburi-T, që të kesh tamam një VC." Sa bukur që këndonte ajo! Edhe ato ninullat me rimë, sa magjike, të çuditshme e të mistershme!

A, B, C, D, vitamina pi:
Dhjami është në mëlçi, merluci në det rri.

I ndjeu lotët e nxehtë të mblidheshin poshtë qepallave të mbyllura, teksa rikujtonte fjalët dhe zërin e Lindës që ia përsëriste. E pastaj kur i mësoi të lexojë: vogëlushi është si rrushi, macja nuk rri te prushi; dhe Instruksionet Elementare për punëtorët Beta të Magazinës së Embrioneve. Dhe netët e gjata pranë zjarrit, apo në tarracën e shtëpisë së vogël, ku ajo i tregonte historitë për Vendin Tjetër, jashtë rezervatit: sa vend i bukur, sa i mrekullueshëm ishte ai Vendi Tjetër, kujtimet e të cilit, si kupa qiellore, si parajsa e mirësisë dhe dashurisë, ai ende i mbante të plota e të pacenuara, të panjollosura madje edhe pas kontaktit me këtë Londrën reale dhe me këta burrat e gratë e qytetërimit.
Papritur dëgjoi disa britma të çjerra, hapi sytë dhe pasi fshiu me ngut lotët, pa rrotull. Një rrymë e pafund binjakësh identikë tetëvjeçarë vërshoi brenda në dhomë. Binjak pas binjaku, binjak pas binjaku, ata hynë një makth i vërtetë. Fytyrat e tyre që përsëriteshin, të gjithë kishin një tip fytyre hundështypur, të hutuar, me vrimat e hundës sa koka e vet, me sytë të zgurdulluar, rrobat ngjyrë kaki, gojëshqyer. Ata u shpërndanë me britma sapo futën këmbët brenda në pavijon. U përhapën mes shtretërve, u ngjitën sipër, u zvarritën përfund, u hodhën nga një sy televizorëve dhe përqeshën pacientët.

Linda i habiti dhe i alarmoi. Një grup u mblodh tok te këmbët e shtratit të saj, duke e vështruar të trembur me kureshtjen idiote të një kafshe që përballet papritur me të panjohurën. "Shikoni, shikoni, shikoni! - i thoshin me frikë njëri-tjetrit me zë të ulët. Si e ka hallin kjo këtu? Përse është kaq e trashë?"
Ara nuk kishin parë kurrë një fytyrë si të sajën - nuk kishin parë kurrë një fytyrë pa rini dhe lëkurën të patendosur, një trup që nuk ishte më i hollë dhe i drejtë. Të gjithë këto gjashtëdhjetëvjeçare në vdekje e sipër ngjanin si vajza të vogla. Kurse Linda, dyzet e katër vjeçe, për kontrast, ngjante si përbindësh, e flashkur e e shtrembëruar nga pleqëria.
tyre.
"Sa e tmerrshme! - i vinin me pëshpërima komentet e
-Shikoni si i ka dhëmbët!
Befas, një binjak hundështypur doli nga poshtë shtratit, hyri mes karriges së Xhonit dhe murit dhe ia nguli sytë fytyrës së Lindës që po flinte.
- Unë them... nisi të thotë ai, por fjalia u mbyll para kohe me një kuisje. I egri e kishte kapur nga kollarja, ngritur lart njësh me karrigen dhe me një grusht te veshi, e kishte shpënë tutje duke ulëritur.
Britmat sollën kryeinfermieren, që nxitoi t'i vijë në ndihmë fëmijës.
- Çfarë po i bën atij? - pyeti ajo me egërsi. - Nuk të lë unë të gjuash fëmijët.
- Epo mbaji larg nga ky shtrat, atëherë. - Zëri i të egrit po dridhej nga zemërimi. - Ç'duan këta kopilë të qelbur këtu? Ky është një turp!
- Turp? Çfarë do të thuash me këtë? Këta po kushtëzohen

ndaj vdekjes. Edhe ja ku po të them, - e paralajmëroi ajo vrazhdë, po ndërhyre edhe një herë të cenosh kushtëzimin,
do të sjell portierët edhe do të të flakin jashtë.
I egri u çua në këmbë dhe bëri disa hapa drejt saj. Lëvizjet dhe shprehja e fytyrës së tij ishin kaq kërcënuese, sa infermierja u tërhoq e tmerruar. Me përpjekje të mëdha ai e mblodhi veten dhe pa folur u kthye e u ul përsëri në shtrat. Pasi e mori veten, por me një dinjitet që ishte paksa i pasigurt, i tha me të çjerrë:
- Të paralajmërova, ruhu. - Megjithatë ajo i largoi tej dy binjakët kureshtarë, duke i detyruar t'i bashkoheshin lojës "kërko-zinxhirin", të cilën e kishte organizuar njëra prej kolegeve të saj në anën tjetër të dhomës.
- Vraponi tani kolopuçë dhe pini solucionin e kafeinës, - i tha ajo infermieres tjetër. Ushtrimi i autoritetit i ktheu besimin te vetja dhe e bëri të ndihet mirë. - Menjëherë fëmijë! - thirri ajo.
Linda kishte lëvizur pak e bezdisur, kishte hapur sytë për një çast, kishte parë vërdallë dhe pastaj ishte kthyer përsëri në gjumë. Ulur në anë të shtratit, përkrah saj, i egri u përpoq shumë të kthehej në gjendjen në të cilën ndodhej disa minuta më parë. "A, B, C, D, vitamina pi," - përsëriti me vete pa zë, thua se fjalët ishin magji që do ta kthente të vdekurin në jetë. Por magjia nuk pati efekt. Kujtimet e bukura me kokëfortësi nuk ktheheshin më; iu ringjallën vetëm urrejtjet, xhelozitë, shëmtia dhe mjerimi. Popi me gjakun që i pikonte nga shpatulla e çarë, Linda që flinte - sa gjë e shpifur - me mizat që gumëzhinin përreth meskallës së derdhur përdhe pranë shtratit të saj; djemtë që e shanin me ato fjalët sa herë ... Ah, jo, jo! Mbylli sytë, tundi fort

kokën të zhdukë kujtimet. "A, B, C, D, vitamina pi..." U përpoq të kujtojë ato kohë kur ulej në gjunjët e saj dhe ajo e mbështillte në krahë, i këndonte pareshtur, një herë, dy, tri, duke e përkundur për ta vënë në gjumë. "A, B, C, D, vitamina pi, vitamina pi, vitamina pi... Supervoks-vurliceriana shkoi drejt një kreshendoje vajtuese; papritur luleminia, në sistemin qarkullues të aromave, i la vendin erës së fortë të bimës indiane të paçulit. Linda u përmend me lëkundje, u zgjua, ia hodhi sytë e hutuar për disa sekonda gjysmëfinalistëve, pastaj, duke ngritur fytyrën, nuhati nja dy herë ajrin e parfumuar dhe krejt papritur buzëqeshi, me buzëqeshjen e një fëmije të ekzaltuar nga gëzimi.
"Popi!, - murmuriti dhe mbylli sytë. - Oh, sa më pëlqen, sa po më pëlqen... - psherëtiu, dhe u zhyt prapë në jastëkë. -Linda! - i tha i egri duke iu lutur. - Nuk më njeh? - ishte përpjekur kaq fort, sa nuk kishte ç't'i bënte më; pse nuk e linte ajo atë ta harrojë? Ia shtrëngoi krahun e mpirë gati me dhunë, sikur po kërkonte ta nxirrte jashtë këtyre ëndrrave të kënaqësive të ulëta, nga këto kujtime të poshtra e të urryera - ta kthente mbrapsht në të tashmen, në realitet; të tashmen e tmerrshme, realitetin e llahtarshëm - por sublim, domethënës, i rëndësishëm deri në dëshpërim, pikërisht për afërsinë e asaj që i bënte të dy ata kaq të frikësuar. - A s'po më njeh, Linda?" Ndjeu shtypjen e lehtë të dorës së saj si përgjigje për të gjitha. Lotët i rrodhën nga sytë. U përkul dhe e puthi. Buzët e saj lëvizën.
"Popi!" - pëshpëriti përsëri dhe atij iu bë sikur i hodhën një kovë me pleh mu në fytyrë.

Papritur, zemërimi e ndezi flakë. I zhgënjyer për herë të dytë, vrulli i brengës së tij gjeti një tjetër të çarë, u
transformua në agoni e tërbim.
"Por unë jam Xhoni! - i bërtiti asaj. - Unë jam Xhoni!" dhe mes zemërimit e dhimbjes e kapi nga supet dhe e
shkundi fort.
Sytë e Lindes vibruan dhe u hapën; ajo e pa, e njohu: "Xhon! - por fytyrën e vërtetë, duart e vërteta dhe të ashpra të tij i futi në botën imagjinare ku po jetonte vetë - mes ekuivalentëve ëndërruese të paçulit dhe Supervurlicerit, përzier nëpër kujtime të shtrembëruara dhe sensacione te zhvendosura ngatërrueshëm, të cilat përbënin universin e ëndrrave të saj. Ajo e njohu për Xhonin, djalin e saj, por e përfytyroi si një njeri të futur vjedhurazi në atë Malpaisin përrallor ku ajo dhe Popi po kalonin ca pushime soma. Ai iu zemërua se asaj i pëlqente Popi; po e shkundte se Popi ishte aty me të në shtrat - sikur ky të ishte në gabim, sikur njerëzit e qytetëruar nuk bënin njëlloj. - Çdokush i përket çdokujt..." - zëri i saj u shua mes frymëmarrjeve gati si kuakje; goja iu hap; bëri një përpjekje të madhe për të mbushur mushkëritë me ajër. U mat të bërtasë, por nuk i doli zë; vetëm tmerri në sy rrëfente vuajtjen. Çoi duart në fyt, pastaj gërvishti ajrin si me thonj - ajrin që nuk po e thithte dot më, ajrin që për të nuk ekzistonte më.
I egri u çua shpejt dhe u përkul mbi të. "Çfarë ke Linda? Çfarë ke?" - zëri i tij ishte lutës, thua se ai po kërkonte të sigurohej që ishte mirë.
Vështrimi që ajo i dha ishte i ngarkuar me tmerr të papërshkrueshëm, me terror dhe, siç iu duk atij, me qortim. Ajo u përpoq të ngrihej vetë nga shtrati, por ra

mbrapsht mbi jastëkë. Fytyra e saj ishte shtrembëruar llahtar,
buzët iu kthyen në blu.
I egri mori vrapin nëpër pavijon.
"Shpejt! Shpejt! - bërtiti. - Shpejt!"
Nga ku ndodhej, në qendër të rrethit të binjakëve, kryeinfermierja pa drejt tij. Momenti i parë i hutimit ia lëshoi gati menjëherë vendin mosmiratimit.
"Mos bërtit! Mendo pak për vogëlushët, - i tha me vetullat e ngrysura, - mund t'u prishet kushtëzimi... çfarë po bën? - Ai ishte futur brenda rrethit të fëmijëve. - Kujdes, çfarë bën!" Një fëmijë qau.
"Shpejt! Shpejt! - ai e kapi nga mënga dhe e tërhoqi pas vetes. - Shpejt! Nuk e di se çfarë ndodhi. E vrava, më duket." Sa u kthyen ata në fund të pavijonit, Linda vdiq. I egri mbeti një moment i ngrirë në heshtje, pastaj i ra në gjunjë anës së shtratit dhe duke mbuluar fytyrën me dorë, qau e ngashëreu aq sa s'plasi.
Infermierja qëndroi e pavendosur, duke parë herë nga figura e përgjunjur përpara shtratit (ç'shfaqje skandaloze!) dhe herë nga binjakët (fëmijët e gjorë!), që ndalën lojën dhe vështronin nga ana tjetër e pavijonit, me sytë e hundët e shtypura, skenën që po luhej në shtratin numër 20. A duhej t'i fliste ajo atij? Ta sillte në vete e në njerëzi? Ta kujtonte se ku ndodhej? Sa dëm fatal mund t'u bëhej këtyre të parriturve të gjorë? Të zhbëhej gjithë kushtëzimi ndaj vdekjes, prej kësaj të qare të qelbur - thua se vdekja është diçka aq e tmerrshme, thua se një njeri vlente sa gjithë kjo zhurmë! Mund t'u jepte atyre idetë më shkatërrimtare mbi këtë dukuri, mund t'i mërzisë sa të sillen krejtësisht gabim, e plotësisht në mënyrë antisociale.

Bëri hapa përpara dhe e preku në sup.
- Di të sillesh ti? - i tha me zë të ulët e gjithë inat. Por kur hodhi vështrimin rrotull, pa se një duzinë binjakësh ishin ngritur në këmbë e po afroheshin. Rrethi po prishej.
Edhe një minutë më shumë edhe... jo, rreziku ishte shumë i madh; i gjithë grupi mund të vonohej gjashtë apo shtatë muaj me kushtëzimin. Ajo nxitoi të kthehej në detyrë. - Tani, kush dëshiron biskotë me krem çokollate? - i pyeti ajo me zë të lartë e me një ton gazmor.
- Unë! - tha njëzëri i gjithë grupi Bokanovski dhe me kaq shtrati 20 u harrua.
O Zot, o Zot, o Zot... - përsëriste pa ndërprerë i egri me vete. Në kaosin e dhimbjes dhe brerjes së ndërgjegjes që i kish pushtuar mendjen, kjo ishte e vetmja fjalë që artikulonte. - Zot! - pëshpëriti me zë. - Zot...
"Çfarë po kërkon të thotë ky?" - dëgjoi ai një zë shumë pranë vetes, i qartë e çjerrës, zë që përshkonte ulje-ngritjet e Supervurlicerit.
I egri u çua në këmbë në çast, zbuloi fytyrën dhe pa rreth e rrotull. Pesë binjakë bojë kaki, secili me nga një biskotë me krem çokollate në dorë dhe me fytyrat përlyer në mënyrë identike, po qëndronin në rresht.
Ata u panë sy më sy dhe të gjithë njëherësh zbardhën dhëmbët. Njëri prej tyre i bëri shenjë që nga shtrati me copën e mbetur të biskotës në dorë..
- Ka vdekur ajo? - e pyeti.
I egri ia nguli sytë për një moment krejt i heshtur. Pastaj, po në heshtje u çua në këmbë dhe prapë i heshtur mori të dalë drejt portës.

- Ka vdekur ajo? - futi përsëri hundët ku s'i takonin
binjaku, duke u çapitur anës tij.
Iegri e pa nga lart poshtë dhe pa i thënë asnjë fjalë i dha një të shtyrë. Binjaku u rrëzua në dysheme dhe me të rënë, filloi të ulërijë. I egri as që nuk i hodhi më sytë të shohë përreth.

KAPITULLI XV

Stafi i shërbimit në spitalin për të vdekurit në Park Lejn, përbëhej prej njëqind e gjashtëdhjetë e dy Deltash të ndarë në dy grupe Bokanovski, një me tetëdhjetë e katër kokëkuqe dhe tjetri me shtatëdhjetë e tetë dolikocefalikë binjakë. Në orën gjashtë, kur dita e punës kishte mbaruar, të dy grupet mblidheshin në hollin e spitalit dhe u shërbehej racioni i somas prej Zëvendësnënadministratorit.

I egri doli nga ashensori dhe kaloi mespërmes tyre. Por mendjen e kishte gjetiu te vdekja, pikëllimi dhe pendesa; mekanikisht, pa pasur mendjen në veprimet e veta, nisi të çajë turmën duke shtyrë me shpatulla.

"Cilin shtyn ti? Ku shkon kështu?"

Të lartë apo të ulët, nga shumësia e fyteve vetëm dy lloj zërash angullinin ose hungërinin. Të përsëritur pafundësisht, nga flokët, me si një tren me pasqyra, dy fytyra, njëra tullë quka dhe ngjyrë si hënë portokalli; dhe tjetra e hollë, si kokë gjeli, me mjekër të shkurtër dy ditë pa rruar, iu kthyen gjithë inat. Fjalët e tyre dhe goditjet e mprehta me bërryla, ia shpuan tejpërtej përhumbjen. Ai u zgjua edhe një herë tjetër në realitetin e jashtëm, pa rrotull vetes, kuptoi se ç'pa - e kuptoi, me një ndjesi mbytëse tmerri dhe neverie, për

delirin e përsëritur aq shpesh të ditëve dhe netëve, anktheve e luzmës së shpifur të ngjashmërisë. Binjakë... binjakë... si krimba të qelbur u ishin zvarritur misterit të vdekjes së Lindës. Sërish krimba, por më të mëdhenj, të rritur plotësisht, tani zvarriteshin nëpër dhimbjen dhe i brenin vështroi
ndërgjegjen. Ndali, me sy të hutuar e plot tmerr turmën me veshjet kaki, në mes të së cilës ai qëndronte plot një kokë më lart. "Sa krijesa të bukura ka këtu!", fjalët e këngës u duk sikur e tallën. “Sa e bukur është raca njerëzore! O më e mira e botëve..."
"Shpërndahet soma! - thërriste dikush me zë të lartë. Me rregull, ju lutem. Nxitoni ju atje."
U hap një portë, prej saj nxorën dhe i lanë në sheshpushim një tavolinë me karrige. Zëri ishte i një Alfe shakaxhi, kish hyrë nga e njëjta derë me një arkë të zezë prej hekuri për mbajtjen e parave në dorë. Një murmurimë kënaqësie u ngrit lart prej binjakëve, që mezi po prisnin. Te egrin e harruan fare. Vëmendja tashmë ishte përqendruar te kutia e zezë prej hekuri, të cilën i riu e vendosi mbi tavolinë dhe ndërkohë po e hapte. Kapaku u ngrit lart.
"Oho, oh!" - thanë njëqind e gjashtëdhjetë e dy vetë njëzëri, thua se nga kutia shpërthyen fishekzjarrët.
I riu mori në dorë një grusht me kuti të vogla tabletash, "Tani, - tha ai rëndë-rëndë, - afrohuni, ju lutem. Një e nga një dhe mos u shtyni."
Një e nga një e pa të shtyra, binjakët bënë përpara. Dy të parët ishin meshkuj, më pas një femër, pastaj një mashkull, pas tij tre femra, më pas...
I egri ndaloi dhe po i vështronte. "O më mira e botëve, O më e mira e botëve..." në kokën e tij fjalët e këngës

iu duk sikur ndryshuan ton. Ata ishin tallur me të kur ai vuante, kur pendohej, tallur me të me ato nota aq të tmerrshme gjithë përbuzje! Me një qeshje djallëzore, ato vetë kishin këmbëngulur në atë qelbësirëllëk të ulët, në shëmtinë krupëndjellëse të atij makthi. Tani, papritur, trumbetonin përgatitjen për dyluftim.
"O më e mira e botëve!" Miranda po zbulonte mundësinë e dashurisë, mundësinë e transformimit të makthit në diçka të mirë dhe fisnike. "O më e mira e botëve!" Kjo ishte sfidë,
urdhër.
- Mos u shtyni ju atje! - bërtiti zëvendësnënadministratori i nxehur dhe mbylli me të përplasur kapakun e kutisë së zezë. - Do ta ndërpres shpërndarjen deri kur të silleni mirë. Deltat murmurinë, u ngjeshën pak pas njëri-tjetrit dhe qëndruan në vend. Kërcënimi dha efektin e pritur. Nuk ka më soma - ç'tmerr vetëm ta mendosh!
-Shumë më mirë, tani, - tha i riu dhe e rihapi kutinë. Linda kishte qenë skllave; Linda kishte vdekur; të tjerët duhet të jetojnë në liri dhe bota të bëhet më e bukur. Një ndreqje, një detyrë. Dhe befas egërsirës iu bë e qartë si drita se çfarë duhet të bëjë; iu duk sikur grilat e mbyllura u ngritën lart, perdet u hapën.
- Tani, - tha zëvendësnënadministratori.
Një femër tjetër e veshur me kaki bëri përpara.
- Ndal! - bërtiti i egri me zë të fortë e kumbues. - Ndal! Ai çau me të shtyra deri te tavolina; Deltat e vështruan me habi.
- O Ford! - tha zëvendësnënadministratori pa frymë. - Qenka egërsira. - Dhe ndjeu frikë.
- Më dëgjoni, ju lutem, - thirri i egri me seriozitet. -

Mbani vesh... - nuk kishte folur kurrë më parë në publik dhe iu duk shumë e vështirë të gjente mënyrën që të shprehte mendimet. - Mos e merrni më këtë gjë të qelbur.
Eshtë helm, është helm.
-Po sikur, zotni Egërsira,- tha zëvendësnenadministratori
duke i buzëqeshur. - Ju vjen keq të më lini mua të...
- Helm përshpirtin dhe për trupin.
- Po, por a ka mundësi të më lësh të qetë të mbaroj shpërndarjen, a ka mundësi? Hë djalë i mirë. - Dhe me kujdesin që ledhatohet një kafshë tmerrësisht e egër, ai e preku egërsirën në krah. - Vetëm më lër...
- Kurrë! - thirri i egri.
- Pa shiko këtu, plako...
- Flakeni tej këtë helm të tmerrshëm.
Fjalët "flakeni tej" përshkuan shtresat rrethuese të moskuptimit të Deltave dhe arritën të prekin vetëdijen e Deltave. Një murmuri zemërimi u ngrit nga turma. - Erdha t'ju sjell lirinë, – tha egërsira duke u kthyer me fytyrë nga binjakët. - Erdha...
Zëvendësnënadministratori nuk donte më të dëgjonte; doli nga sheshpushimi dhe po kërkonte për një numër në librin e telefonave.
- Nuk është në dhomat e veta, - konkludoi Bernardi. -Nuk është në dhomat e mia. Nuk është tek Afroditaumi; nuk është në Qendër, as te kolegji. Ku do të ketë shkuar?
Helmholci mblodhi supet. Ata ishin kthyer bashkë prej punës duke pritur ta takonin të egrin në një prej vendtakimeve të zakonshme, por nuk kishte asnjë gjurmë të tijën. Kjo gjë i shqetësoi, aq sa menduan të marrin

sportikopterin katërvendësh të Helmholcit dhe të silleshin një herë andej nga Biarrici. Do të bëheshin vonë për darkë nëse ai nuk do të vinte shpejt.
- E presim edhe pesë minuta, nuk erdhi deri atëherë, do...
tha Helmholci. - Po
Fjalën ia preu zilja e telefonit. E mori në dorë receptorin. -Alo. Po unë jam. - Një interval i gjatë pa thënë asnjë fjalë, pastaj ai shpërtheu:
-Pash Veturën e Fordit Tonë! - Bëri be. - Erdha menjëherë.
Çfarë ka ndodhur? - e pyeti Bernardi.
Një i njohuri im në spitalin e Park Lejn, - tha tjetri.
- I egri është atje. Me sa duket është çmendur. Nuk pret puna. Do të vish edhe ti me mua?
Ata nxituan të dy bashkë drejt ashensorëve.
"Por a doni ju të jeni skllevër? - po thoshte i egri kur ata hynë në spital. Fytyra i ishte bërë flakë e kuqe, sytë i ndrisnin nga zjarri e zemërimi. - Ju pëlqen të jeni bebe? Po, bebe. Që qajnë dhe vjellin, - shtoi i pezmatuar gjer në atë pikë prej budallallëkut të tyre kafshëror, saqë nisi të shajë pikërisht atë që kishte ardhur ta shpëtonte. Fyerjet bënin rikoshet mbi zhguallin e trashë të budallallëkut të tyre; ata e vështronin me një shprehi boshe, të mpirë dhe të zymtë e një zemërim të errët në sy. - Po, të villni! - bërtiti ai. Brenga dhe pendimi, dhembshuria dhe detyra - të gjitha i kishte harruar tashmë, përthithur nga kjo urrejtje e shfrenuar për këto monstra njerëzore. - Nuk doni ju të jeni të lirë dhe njerëz? Nuk e kuptoni se çfarë është njerëzillëku dhe liria? – Tërbimi e bëri të flasë rrjedhshëm; fjalët rridhnin, lirshëm, me ngut. - Nuk doni ju? - e përsëriti fjalën, por nuk mori

asnjë përgjigje. -Shumë mirë pra, - dhe u ngërdhesh. - Do t'ju mësoj unë; do t'ju bëj të lirë, në ju pëlqen ose jo." Dhe pasi hapi kanatën e dritares që shihte nga oborri i brendshëm i spitalit, ai nisi të hedhë me pakot me soma. grushte jashtë Për një moment turma kaki ngeli në heshtje, e shtangur nga ky spektakël sakrilegji të kotë, plot habi dhe tmerr. "Është çmendur, - pëshpëriti Bernardi, duke parë syshkëlyer. - Kanë për ta vrarë. Do ta vrasin... - një britmë e madhe u ngrit nga turma papritur; një valë lëvizjeje e drejtoi atë drejt të egrit. - Fordi e ndihmoftë!" tha Bernardi dhe ktheu sytë në anën tjetër.
"Fordi ndihmon ata që ndihmojnë veten." Dhe me të qeshur, tamam me një të qeshur triumfi, Helmhole Uatsoni çau përmes turmës.
"Të lirë, të lirë," bërtiste i egri dhe me njërën dorë vazhdonte të hidhte tej soman, kurse me tjetrën godiste me grusht fytyrat e padallueshme të atyre që po e sulmonin.- Të lirë! - dhe befas në krah i doli Helmholci. - Helmhole, mik i vjetër! - grushtonte dhe ai, - Njerëz më në fund! - dhe mes intervaleve, vazhdonte po ashtu të hidhte përjashta helmin me grushta nga dritarja. - Po, njerëz, njerëz! - dhe helmi kishte mbaruar. Ai e mori në dorë kutinë e zezë dhe ua tregoi atyre të zbrazët. - Tani jeni të lirë!"
Me ulërima, Deltat u vërsulën me dyfishin e furisë. I ndërdyshur në suazat e përleshjes, Bernardi tha: "E hëngrën," - dhe i nxitur nga një impuls i papritur, rendi t'u shkojë në ndihmë; por pastaj e mendoi më mirë dhe ndali; pastaj me turp eci prapë përpara, po përsëri e mendoi dhe ndali në agoni, i pavendosur, i turpëruar; mendoi se ata

mund të vriteshin, po të mos u shkonte në ndihmë - por mendoi se ai vetë mund të vritej po t'u shkonte në ndihmë - kur (Fordit falë!) me maskat kundragaz si turi derrash, policët vërshuan brenda.
Bernardi rendi t'u dalë përpara. Valëviti krahët për t'ua bërë me shenjë; dhe me këtë veprim ai vërtet që po bënte
diçka, po ndihmonte miqtë e vet. Bërtiti "Ndihmë!" disa herë, përherë e më fort si për t'i dhënë vetes iluzionin se po ndihmonte, "Ndihmë! Ndihmë! Ndihmë!".
Policët e shtynë mënjanë dhe vazhduan me punët e veta. Tre burra me makineri shfryrëse shtrydhën re të rënda me gaz soma. Dy të tjerë merreshin me Kutinë muzikore portative. Me armë uji të pajisura me qetësues të fuqishëm, katër të tjerë kishin hapur rrugën mes turmës dhe në mënyrë metodike po shtrinin përtokë duke u hedhur çurg pas çurgu soma, luftëtarët më të egër.
"Shpejt! Shpejt! - thirri Bernardi. - Do t'i vrasin po nuk nxituat. Do t'i... Oh!" - i bezdisur nga llafet e Bernardit, një polic e qëlloi me pistoletë uji. Ai qëndroi për një çast a dy duke iu dridhur këmbët, që iu duken sikur nuk kishin më kocka, tendina, muskuj, si të ishin kallama tuli, dhe më në fund, kur nuk ishin me as tul, ngjanin si ujë; ai ra mbi një pirg njerëzish të shtrirë në dysheme.
Papritur, prej Boksit të Muzikës Sintetike, nisi të flasë një zë. Zëri i Arsyes, Zëri i Ndjenjave të Mira. Kolona zanore po shpaloste Fjalimin e Antirebelimit numër 2 (i fuqisë së mesme).
Drejtpërdrejt nga thellësitë e një zemre të paqenë: "Miqtë e mi! Miqtë e mi! - tha zëri, kaq patetik, me një notë aq pafundësisht të butë qortimi, sa edhe sytë e policëve pas maskave kundërgaz u mbushën për një çast me

lot. - Ç'kuptim ka kjo që po bëni? Përse nuk jeni të gjithë bashkë të lumtur e të gëzuar? Të lumtur dhe të mirë? – tha zëri. – Në paqe, në paqe. - Dhe drithërima u zhyt në një pështpërimë dhe përkohësisht u shua. - Oh, unë dua që ju të jeni të lumtur, - nisi përsëri zëri me një zell të zjarrtë. "Dua të jeni mirë! Ju lutem bëhuni të mirë dhe..."
Dy minuta më pas, zëri dhe soma i dhanë efektet e veta. Të përlotur, Deltat po putheshin e përqafoheshin me njëri-tjetrin, gjysmë duzine binjakësh njëherësh, në një përqafim gjithëpërfshirës. Edhe Helmholci dhe i egri për pak sa nuk zunë të qajnë. Një furnizim i ri me tableta erdhi sërish prej zëvendësnënadministratorit; shpërndarja e re u bë me ngut dhe nën notat prekëse e lamtumirat baritone që lëshonte Zëri, binjakët u shpërndanë mes lotësh, duke belbëzuar, thua se do t'u çaheshin zemrat. "Mirupafshim miqtë e mi më të dashur, ju mbrojttë Fordi! Mirupafshim miqtë e mi më të dashur, ju mbrojttë Fordi! Mirupafshim miqtë e mi më të dashur, ju mbrojttë Fordi!..."
Kur Deltat e fundit u larguan, policët prenë korrentin. Zëri engjëllor ra në heshtje.
- Do vini me të mira? - pyeti togeri, - apo doni ta bëj me anestezi? - dhe i drejtoi pistoletën e ujit.
- Oh, do vijmë me të mira, - iu përgjigj i egri duke njomur me pështymë herë buzën e çarë, herë qafën e gërvishtur e herë dorën e majtë që ia kishin kafshuar.
Me shaminë mbi hundën që i rridhte akoma gjak, Helmholci pohoi me kokë.
I zgjuar nga gjumi dhe me këmbët e çliruara, Bernardi
e zgjodhi këtë moment të shkojë sa më tinëz drejt portës.
- Hej, ti atje, - thirri togeri, dhe njëri prej policëve me

maskat si turinjtë e derrave e kapi dhe e mbajti nga supet. Bernardi u kthye me shprehinë e një të pafajshmi të indinjuar thellë. Të arratisej? As nuk e kishte parë në ëndërr
një gjë të tillë.
—Për çfarë ju duhem unë, - i tha ai togerit, – nuk e
imagjinoj dot.
- Ti je mik me të burgosurit, apo jo?
- Epo... - ngurroi Bernardi. Jo, nuk e mohonte dot. - Pse të mos jem? - e pyeti.
- Hajde me ne, pra, - tha togeri dhe shkoi vetë i pari atje ku po i prisnin makinat e policisë.

KAPITULLI XVI

Dhoma në të cilën u shoqëruan të tre, ishte studioja e Kontrollorit.
"Lartësia e tij fordiane do jetë më ju për një moment." Shërbëtori Gama i la vetëm dhe doli. Helmholci qeshi me të madhe.
“Ngjan më shumë si një festë me solucion kafeine, sesa si gjyq," tha ai dhe e lëshoi veten rëndë mbi një prej kolltukëve pneumatikë më luksoze. "Mos u mërzit Bernard, qesh," i tha mikut të vet, kur vërejti fytyrën e tij ngjyrë jeshile nga mërzia. Por Bernardi nuk vinte dot në humor; pa u përgjigjur, madje edhe pa ia hedhur sytë Helmholcit, shkoi dhe u ul në karrigen më të parehatshme në të gjithë dhomën, e zgjodhi me kujdes, me shpresën e fshehtë se kështu do t'i kundërvihej disi zemëratës së fuqive të mëdha.
I egri ndërkohë endej pa pushim nëpër dhomë duke u hedhur herë pas here një vështrim të vagullt dhe të përciptë librave në rafte, rrolave me kolona muzikore, bobinave të makinës së leximit me letrën e saj të shpuar vrima-vrima. Mbi tavolinën nën dritare qëndronte shtrirë një vëllim i trashë lidhur me surrogat lëkure të zezë, mbi të cilin ishte stampuar një Te madhe floriri. E mori në dorë dhe e hapi. JETA DHE PUNA IME, nga FORDI YNË. Libri ishte botuar në Detroit

nga Shoqëria për Propagandimin e Diturisë Fordiane. Me përtesë i hapi faqet, lexoi një fjali aty, një paragraf atje, dhe erdhi në përfundimin se nuk kishte asnjë interes për të; në atë moment porta u hap dhe Kontrollori i Përhershëm për Kontrollin e Botës për Evropën Perëndimore hyri gjithë gjallëri në dhomë.
Mustafa Mondi u shtrëngoi dorën që të treve, por
komunikoi vetëm me egërsirën.
-Pra, ty nuk të pëlqen aq shumë qytetërimi, zotni egërsirë, tha ai.
I egri e pa me vërejtje. Ishte bërë gati të gënjente, të ulërinte, të sillej si i papërgjegjshëm, por, i ngushëlluar prej fytyrës inteligjente dhe me humor të mirë të Kontrollorit, vendosi të thotë të vërtetën troç fare.
- Jo, - tha ai dhe tundi kokën.
Bernardi shtangu dhe dukej i tmerruar. Çfarë do të mendonte Kontrollori? Të etiketohesh si një mik i dikujt të cilit nuk i pëlqen qytetërimi - që e tha hapur, edhe kujt, Kontrollorit - kjo ishte e tmerrshme.
- Por Xhoni, -tha Bernardi, por një vështrim i Mustafa Mondit e detyroi të heshtë si i mjerë.
- Sigurisht, - vazhdoi i egri, - ka disa gjëra shumë të mira. Gjithë ajo muzikë vërdallë, për shembull...
Ndonjëherë një mijë tingëllima instrumentesh, murmurinë në veshë dhe ndonjëherë janë zërat... Fytyra e të egrit u ndez nga kënaqësia.
- E keni lexuar dhe ju? - e pyeti. - Mendoja se askush nuk kishte dëgjuar kurrë për këtë libër në gjithë Anglinë. Pothuaj askush. Unë jam njëri prej të paktëve. Është
e ndaluar, e kupton. Por meqë ligjet këtu i bëj unë, edhe

mund t'i thyej, pa ndëshkim zotni Marks, - shtoi duke u kthyer nga Bernardi. - Gjë të cilën kam frikë se ju nuk e bëni dot.
Bernardi u zhyt edhe më thellë në mjerim të pashpresë. - Po pse është i ndaluar? - pyeti i egri.
Prej ngazëllimit se kishte takuar një njeri që kishte lexuar Shekspirin, ai i kish harruar përkohësisht të gjitha.
Kontrollori mblodhi supet.
- Sepse është i vjetër, kjo është arsyeja kryesore. Ne nuk na
hyjnë më në punë gjërat e vjetra këtu.
- Edhe po të jenë shumë të bukura?
- Veçanërisht kur janë shumë të bukura. Bukuria është tërheqëse dhe ne nuk duam që njerëzit tanë të tërhiqen pas gjërave të vjetra. Ne duam që ata të pëlqejnë gjërat e reja.
- Por të rejat janë kaq idiote dhe të shëmtuara. Ato shfaqjet, vetëm helikopterë që fluturojnë, edhe pastaj të ndjesh të tjerët që puthen. - Dhe u ngërdhesh. - Dhi e majmunë! - Vetëm me fjalët e Otellos mundi të gjejë mjetin e përshtatshëm për përbuzjen dhe urrejtjen që ndiente. - Kafshë të buta e të mira, duhet thënë, - murmuriti Kontrollori sa për ta nisur.
- Përse nuk i lejoni të shohin Otellon, atëherë?
- Të thashë, është vjetërsirë. E përveç kësaj, ata nuk do ta kuptonin.
Po, ishte e vërtetë. Atij iu kujtua si kishte qeshur Helmholci me Romeo dhe Xhulieta.
Këtë duam të shkruajmë ne, - tha Helmholci, duke thyer heshtjen e gjatë.
- Epo atëherë, - tha ai pas një pauze, - diçka të re që është si Otello dhe që ata të mund ta kuptojnë.

Këtë kemi dashur të gjithë të shkruajmë, - tha Helmholci, duke thyer heshtjen e gjatë.
- Dhe këtë kurrë nuk do ta shkruani, - tha Kontrollori. - Sepse, po të jetë vërtet si Otello, askush nuk ka për të kuptuar, sado e re të jetë. Dhe po të jetë e re, nuk mund të
jetë kurrë si Otello.
- Përse jo?
- E pra, përse jo? - përsëriti Helmholci. Edhe ai, gjithashtu, harronte të vërtetat e pakëndshme të situatës. I bërë jeshil në fytyrë prej ankthit dhe frikës, vetëm Bernardit i kujtoheshin, të tjerët nuk ia varnin. - Përse jo?
- Sepse bota jonë nuk është njëlloj me botën e Otellos. Nuk bën dot njeri makina pa çelik, dhe nuk mund të shkruash tragjedi pa destabilizim social. Bota tashmë është e stabilizuar. Njerëzit janë të lumtur; marrin atë që duan dhe nuk duan asnjëherë atë që s'mund ta kenë. Janë mirë, janë të sigurt, nuk sëmuren kurrë, nuk kanë frikë prej vdekjes, janë të paditur – të lumtur sa i takon pasionit dhe plakjes, nuk janë të ndëshkuar nga nëna dhe baballarë, nuk kanë gra, apo fëmijë, apo dashnorë ndaj të cilëve të ndihen të lidhur fort; janë kaq të kushtëzuar sa praktikisht nuk sillen dot ndryshe nga ç'duhet të sillen. Edhe nëse ndonjë gjë shkon keq, ja ku është soma. Të cilën ti shkon dhe e hedh nga dritarja në emër të lirisë, zotni egërsirë. Lirisë! - dhe qeshi. - Ti pret që të të kuptojnë Deltat se çfarë është liria! Dhe tani pret që të kuptojnë se çfarë është Otello! More djalë i mirë!
I egri qëndroi pak në heshtje.
-E prapëseprapë, këmbënguli ai me kokëfortësi, - Otello është i mirë, Otello është më i mirë se ato filmat me prekje.

- Sigurisht, - ra njëmendje me të Kontrollori. - Por ja që ky është çmimi që duhet të paguajmë për stabilitetin. Duhet të zgjedhim mes lumturisë dhe asaj që njerëzit quanin dikur art i madh. Ne në vend të artit kemi kinematë me prekje
dhe organon e aromave.
-Por ato s'kanë kurrfarë kuptimi.
- Ato kanë një kuptim të tyrin; janë plot sensacione të këndshme për publikun.
- Po ato... tregohen prej një idioti. Kontrollori qeshi.
- Nuk po silleni shumë mirë me mikun tuaj, zotni Uatsonin. Një nga më të spikaturit ndër Inxhinierët e Ndjenjave...
– Ama ka të drejtë, – tha Helmholci i mërzitur. - Sepse është idiote. Të shkruash kur nuk ke asgjë për të thënë.
Saktë. Por kjo kërkon pafajësinë më të madhe. Ju po prodhoni makina me minimumin absolut të çelikut - vepra arti të bëra fund e krye prej ndjesive.
- I egri tundi kokën.
- Mua më duket një tmerr.
- Sigurisht që ashtu duket. Lumturia aktuale duket shumë e pistë në krahasim me shpërblimin që sjell kapërcimi i mjerimit. Dhe, sigurisht, stabiliteti as nuk i afrohet fare spektaklit të destabilizimit. Dhe të qenët i kënaqur nuk ngjan fare me magjinë që sjell lufta me fatkeqësinë, nuk i afrohet betejave piktoreske ndaj tundimit, apo mposhtjes fatale prej pasionit a dyshimit. Lumturia nuk është kurrë madhështore.
-Me sa duket jo, - tha egërsira duke thyer heshtjen. Por duhet medoemos të bëhet çdo gjë aq keq sa me ata binjakët? – dhe kaloi dorën mbi sy, sikur po kërkonte të

fshijë prej tyre kujtimin e imazheve të rreshtave të gjatë të xhuxhëve identikë te tavolinat e montimit, apo të kopeve të binjakëve të vënë në radhë në stacionin hekurudhor të Brentfordit, ata krimbat njerëzorë që i kacavirreshin Lindës në shtratin e vdekjes, fytyrat e përsëritura pafund të atyre që e sulmuan. Pa nga fasha që i mbështillte dorën e majtë dhe tha: – E tmerrshme!
– Por sa e dobishme! E shoh që ty nuk të pëlqejnë grupet tona Bokanovski, por të garantoj se ata janë themeli mbi të cilin ngrihet gjithçka. Ata janë xhiroskopi që stabilizon avionin raketë të shtetit në rrugën e tij pa dredha. – Zëri i thellë u drodh prej emocionit; duart bënë me gjeste sikur po tregonin pafundësinë dhe vrullin e papërmbajtshëm të makinerisë. Oratoria e Mustafa Mondit gati arrinte standardet e muzikës sintetike.
– Po vrisja mendjen, – tha i egri, – përse i bëni ashtu në fund të fundit, duke qenë që ju mund të nxirrni çfarë ju do zemra prej atyre shisheve. Përse nuk i bëni të gjithë Alfa Dopio Plus, jeni që jeni?
Mustafa Mondi qeshi.
– Sepse ne nuk duam që të na presin fytin, – iu përgjigj. – Ne besojmë te lumturia dhe stabiliteti. Një shoqëri Alfash nuk dështon, nuk bëhet e paqëndrueshme dhe mjerane. Imagjino një fabrikë e mbushur me Alfa – kjo do të thotë me individë të veçantë e pa lidhje me njëri-tjetrin, të kushtëzuar në mënyrë të atillë që (brenda kufijve) të zgjedhin lirisht e të marrin përsipër përgjegjësi. E imagjinon! – përsëriti ai.
I egri u përpoq ta imagjonojë, por pa sukses.
– Është absurditet. Një Alfa i kulluar, Alfa i kushtëzuar, do të çmendej po t'i duhej të bënte punën e një Ypsilon

gjysmëdebili; do të çmendej dhe do t'i bënte gjërat copë-copë. Alfai mund të socializohet plotësisht, por vetëm përmes kushtëzimit mund të bësh që Alfa të bëjë punën e një Alfe. Vetëm prej një Ypsiloni mund të pritet të bëjë sakrificat e një Ypsiloni, për arsyen e thjeshtë se për të këto nuk janë sakrifica, janë thjesht gjendja e rezistencës më të ulët. Kushtëzimi i ka shtruar shinat mbi të cilat ai duhet të ecë. Nuk ka ç'i bën, është i mallkuar që në fillim. Edhe që përpara filtrimit, që në shishe, ai është vetë një shishe imagjinare e mbushur me fiksime embrionale foshnjore. Secili prej nesh, sigurisht, – vazhdoi Kontrollori mendueshëm, – shkon gjithë jetën pa dalë nga shishja. Po nëse ndodh të jemi Alfa, shishet tona janë, relativisht të themi, gjigante. Do të vuanim shumë nëse do të na rrasnin brenda një hapësire të ngushtë. Nuk mund të hedhësh surrogat shampanje për kastën e lartë në shishet e kastës së ulët. Është e qartë teorikisht. Por është provuar, gjithashtu, në praktikën aktuale. Rezultati i eksperimentit të Qipros ishte shumë bindës.

– Çfarë është ky? – pyeti i egri. Mustafa Mondi buzëqeshi.

– Epo, mund ta quajmë eksperimenti i rifutjes në shishe, potë doni. Ka nisur 473. P. F. Kontrollorët e pastruan gjithë ishullin prej banorëve ekzistues dhe e rikolonizuan me një ngarkesë speciale prej njëzet e dy mijë Alfash. Iu dhanë gjithë pajisjet për bujqësinë dhe industrinë dhe u lanë t'i menaxhonin vetë punët. Rezultati përmbushi të gjitha parashikimet. Toka nuk u punua siç duhet, u zhvilluan greva në të gjitha fabrikat, ligjet u hodhën tej dhe urdhrat nuk zbatoheshin; të gjithë njerëzit që ishin të detyruar të punonin punë të gradës së ulët thurnin vazhdimisht intriga për të kapur punë të gradave të larta; dhe gjithë njerëzit që kishin punë në grada të larta

thurnin intriga për të ruajtur me çdo çmim pozitat e veta. Brenda gjashtë viteve, patën luftën e parë civile të kategorisë së parë. Kur nëntëmbëdhjetë prej njëzet e dy mijëve u vranë, të mbijetuarit i kërkuan Kontrollorëve të Botës të merrnin në dorë qeverisjen e ishullit. Dhe ata ashtu bënë. Dhe ky ishte fundi i së vetmes shoqëri Alfash që bota ka parë ndonjëherë.
Njeriu i egër lëshoi një psherëtimë të thellë.
– Popullata optimale, – tha Mustafa Mondi, – është modeluar si ajsbergu, – tetë të nëntat nën nivelin e ujit, një e nënta mbi të.
– Dhe janë të lumtur nën nivelin e ujit?
– Më të lumtur se po të jenë mbi nivel. Më të lumtur se miku yt këtu, për shembull. – Dhe tregoi me gisht.
– Me gjithë punën e llahtarshme?
– E llahtarshme? Atyre nuk u duket ashtu. Përkundrazi, u pëlqen. Është e lehtë, e thjeshtë, si lojë fëmijësh. Pa sforcim të mendjes apo të muskujve. Shtatë orë e gjysmë punë e lehtë e pa lodhje, dhe pastaj racionin e somas, pastaj lojëra, ndërrim pa kufi, kinema me prekje. Çfarë mund të kërkojnë më shumë se kaq? Dakord, – shtoi ai, – mund të kërkojnë shkurtim të orëve të punës. Dhe natyrisht që ne mund t'ua shkurtojmë orët e punës. Teknikisht, do të qe e mundur që shkurtoheshin orët e punës së të gjithë kastave të ulëta deri në tre-katër orë në ditë. Por a do të jenë më të lumtur? Jo, nuk do të jenë. Eksperimenti është provuar para më shumë se një shekulli e gjysmë. Gjithë Irlanda u vendos në sistemin me katër orë punë në ditë. Dhe çfarë erdhi si rezultat? Trazira dhe përdorim me doza të mëdha të somas, kaq. Ato tre orë e gjysmë të kohës së lirë ishin kaq larg të qenit burim lumturie, sa njerëzit u ndien të detyruar të merrnin pushim edhe prej tyre. Zyra e Shpikjeve është e

mbushur me plane për kursimin e orëve të punës. Me mijëra të tilla, – dhe Mustafa Mondi tregoi me duar sa të trasha ishin dosjet. – Dhe përse nuk i vëmë në zbatim? Për hir të punëtorëve; do të ishte mizori t'i ndëshkonim njerëzit me orë të tepërta për kohën e lirë. E njëjta gjë me bujqësinë. Ne kemi mundësi të sintetizojmë çdo kafshatë ushqimi, po të duam. Por nuk e bëjmë. Ne parapëlqejmë të mbajmë një të tretën e popullsisë tek toka. Për të mirën e tyre, sepse kërkon më shumë kohë të nxjerrësh ushqimin nga toka, sesa nga fabrika. Dhe përveç kësaj, na bën të mendojmë edhe për stabilitetin. Ne nuk duam të ndryshojmë. Çdo ndryshim është kërcënim ndaj stabilitetit. Kjo është edhe një tjetër arsye pse jemi kaq të rreptë në zbatimin e shpikjeve të reja. Çdo zbulim i shkencës së pastër është potencialisht subversiv; edhe vetë shkenca duhet trajtuar ndonjëherë si armik i mundshëm. Po, edhe vetë shkenca.

Shkenca? Njeriu i egër u vrenjt. E njohte atë fjalë. Por se ç'kuptim kishte, nuk mund ta thoshte dot saktë. Shekspiri dhe pleqtë e fshatit nuk e kishin përmendur kurrë fjalën shkencë dhe vetëm prej Lindës ai kishte arritur të mësonte ca grimca të vagullta: shkenca ishte një gjë, me të cilën bënin helikopterët, një gjë që të bënte të qeshësh me ato Vallet e Misrit, një gjë që të mësonte nga rrudhat dhe rënia e dhëmbëve. Bëri përpjekje të dëshpëruar për të kuptuar çfarë po thoshte Kontrollori.

– Po, – po thoshte Mustafa Mondi, – kjo është një çështje mbi koston e stabilitetit. Nuk është veç aty që nuk përputhet me lumturinë; shkenca, gjithashtu. Shkenca është e rrezikshme, ne na duhet ta mbajmë me kujdesin më të madh, të lidhur me zinxhirë e me gojëz.

– Çfarë? – tha Helmholci i hutuar. – Po ne themi përherë se shkenca është gjithçka. Është abeceja e hipnopedisë.

– Tri herë në javë, prej moshës trembëdhjetë gjer në shtatëmbëdhjetë, – ndërhyri Bernardi.
– Dhe gjithë kjo propagandë për shkencën që bëjnë në kolegji...
– Por për ç'lloj shkence po flisni? – pyeti Mustafa Mondi me sarkazëm. – Nuk keni pasur përgatitje shkencëtari, kështu që nuk mund të gjykoni. Unë kam qenë fizikan i mirë në kohën time. Tepër i mirë, aq i mirë sa rë kuptoja se e gjithë shkenca jonë ishte thjesht libër gatimi, me një teori ortodokse gatimi, të cilën nuk kishte askush të drejtë ta vinte në diskutim; dhe me një listë recetash, të cilat nuk duhej të shtoheshin përveçse me një leje speciale prej vetë kryeshefit të kuzhinës. Dhe tani shefi i kuzhinës jam unë. Por edhe unë dikur isha thjesht një çirak i vogël kureshtar, nisa të bëja pak gatime më vete. Gatim jotradicional. Gatim të ndaluar. Pak si shkencë e vërtetë, në fakt. – Dhe heshti.
– Çfarë ndodhi? – pyeti Helmholc Uatsoni. Kontrollori psherëtiu.
– Pak a shumë e njëjta gjë që do të ndodhte edhe me ju, djelmosha. Shkova deri në atë pikë, sa për pak nuk më çuan në ndonjë ishull.
Fjalët e elektrizuan Bernardin, sa u hodh përpjetë duke bërë me duar gjeste krejt të pafrenueshme.
– Të më çoni mua në ishull? – dhe u lëshua me vrap e qëndroi përpara Kontrollorit duke bërë gjeste me duar. – Nuk mund të më çoni mua. S'kam bërë asgjë. Të tjerët bënë. Ju betohem se ishin të tjerët. – Dhe tregoi me gisht Helmholcin dhe njeriun e egër.
– Oh, ju lutem, mos më çoni në Islandë. Ju premtoj se do të bëj çfarëdolloj gjëje që kërkohet prej meje. Më

jepni edhe një shans. Ju lutem, edhe një shans, – dhe lotët nisën t'i shkojnë çurg. – Po jua them, është krejt faji i tyre, – ngashërehej ai. – Jo në Islandë, ju lutem Fordlartësia juaj... – dhe prej dalldisë së mjerimit u hodh përtokë e ra në gjunjë para tij. Mustafa Mondi u përpoq ta çojë në këmbë, por Bernardi këmbëngulte dhe rrjedha e fjalëve vazhdoi panënshur. Më në fund, Kontrollorit iu desh t'i bënte një zile sekretares së vet numër katër.
– Silli tre vetë me rraha, – i dha urdhër, – dhe çojeni zotniun në një dhomë gjumi. Jepi një avull të mirë soma, vëre në gjumë e lëre aty.
Sekretarja e katërt doli dhe u kthye me tri këmbësorë binjakë të veshur me uniforma jeshile. Ende duke qarë me dënesë, Bernardin e morën në krahë dhe e nxorën jashtë.
– A thua se po e çojnë t'i presin kokën, – tha Kontrollori sapo u mbyll porta. – Ndërkohë që po të kishte dy para mend në kokë, do ta kuptonte vetë se ky në të vërtetë nuk është dënim, por shpërblim. Atë po e çojnë në një ishull. Kjo është si të thuash se po e çojnë në një vend ku do të takojë burrat dhe gratë më interesantë në gjithë botën. Të gjithë njerëzit që, për një arsye apo një tjetër, kanë individualitet e vetëdije të tepërt për t'u përshtatur në jetën komunitare. Të gjithë njerëzit të cilët nuk janë të kënaqur me traditën, që kanë idetë e veta të pavarura. Me një fjalë, të gjithë ata që janë dikush. Gati ju kam zili, zotni Uatson.
Helmholci qeshi.
– Atëherë përse nuk jeni edhe vetë në atë ishull?
– Sepse, në fund, unë preferova këtë këtu, – iu përgjigj Kontrollori. M'u dha e drejta të zgjedh: të më nisnin në një ishull, ku kisha rast të merresha me shkencën time, apo të më

merrnin te Këshilli i Kontrollorëve me përgatitjen që përgjatë rrugës të isha, siç jam aktualisht, Kontrollor. Unë zgjodha këtë dhe e lashë shkencën. – Pas një heshtjeje të shkurtër tha: – Ndonjëherë pendohem për shkencën. Lumturia është zanat i vështirë, veçanërisht lumturia e të tjerëve. Dhe bëhet zanat edhe më i vështirë se e vërteta, nëse dikush nuk është i kushtëzuar ta pranojë pa fjalë. – Psherëtiu, ndenji pak në heshtje dhe vijoi me një ton më të rreptësi: – Apo detyra është detyrë. Njeriu nuk merr dot për këshillë shijet e veta. Unë kam interes për të vërtetën, më pëlqen shkenca. Mirëpo e vërteta është kërcënim, shkenca është rrezik publik. Aq e rrezikshme, sa ka qenë e dobishme. Na ka dhënë civilizim më të qëndrueshëm në histori. Ai i Kinës ishte i pashpirt, po t'i krahasojmë; deri edhe matriarkati më primitiv nuk ka qenë kurrë më i qëndrueshëm sa ç'jemi ne. Dhe kjo falë shkencës, po e përsëris. Por ne nuk mund ta lejojmë shkencën të zhbëjë punët e saj të mira. Ja përse, me aq përgjegjësi, ne i vëmë kufij sferës së kërkimit; ja përse mua për pak nuk më dërguan në ishull. Ne nuk e lejojmë shkencën të merret me gjë tjetër, përveçse me problemet më imediate. Të gjitha përpjekjet e tjera janë dekurajuar me zellin më të madh. Është interesante, – dhe heshti pak, – të lexosh se çfarë kanë shkruar njerëzit në kohën e Fordit Tonë për zhvillimin shkencor. Me ç'duket, ata përfytyronin se do të përparonte pafundësisht, pavarësisht çdo gjëje tjetër. Gja ishte e mira më e madhe, e vërteta – vlera më e lartësuar; gjithë çfarë mbetet ishte e dorës së dytë dhe e nënrenditur. Është e vërtetë, idetë kishin nisur të ndryshonin edhe në ato kohë. Vetë Fordi Ynë bëri shumë që të zhvendosej theksi nga e vërteta dhe e bukura, tek rehatia dhe lumturia. Prodhimi në masë të gjerë e kërkonte

këtë zhvendosje. Lumturia universale e mban rrotën në lëvizje të pandërprerë, e vërteta dhe e bukura nuk mundem. Dhe, sigurisht, si herë që masat merrnin në dorë pushtetin politik, atëherë ishte lumturia që kishte vlerë më shumë se sa e vërteta dhe bukura. E megjithatë, paçka të gjithave, kërkimi shkencor i pakufizuar njihej akoma. Njerëzit prapë vazhdonin të flisnin për të vërtetën dhe bukurinë si të ishin gjëra të plotfuqishëm. Derisa i erdhi dita Luftës së Nëntë Viteve. Ajo pa se i bëri të ndryshojnë mendim, po ta them unë. Ç'kuptim ka bukuria, e vërteta apo dituria, kur po të shpërthejnë rrethë bombat e antrazit? Atëherë, Luftës së Nëntë Viteve, nisi edhe shkenca të kontrollohej. Njerëzit atëherë ishin gati që t'i kontrollohej edhe orët; ishin të gatshëm të bënin gjithçka për një jetë të qetë. Dhe ne kemi vazhduar t'i kontrollojmë që atëherë e tutje. Për të vërtetën, kjo nuk ka qenë një gjë edhe aq e mirë, sigurisht. Por ka qenë shumë e mirë për lumturinë. Nuk mund të përfitohet diçka në këmbim të asgjëje. Për lumturinë duhet paguar. Dhe ju po paguani, zotni Uatson; po paguani sepse ka qëlluar që të jeni tepër i interesuar për të bukurën. Unë isha tepër i interesuar për të vërtetën, kam paguar edhe unë.

Veçse ty nuk t'i ra të shkosh në ishull, – tha njeriu i egër, duke thyer heshtjen e gjatë.

Kontrollori buzëqeshi.

– Dhe ja si e pagova: Duke zgjedhur t'i shërbej lumturisë. Lumturisë të të tjerëve, jo simes. Fat i madh, – shtoi pas një pauze, – që ka kaq shumë ishuj në botë. Nuk di si do t'ia bënim pa to. Do t'ju fusnim të gjithëve në dhomën e vdekjes, ma do mendja. Me që ra fjala, zotni Uatson, a ju pëlqen klima tropikale? Ishujt Markez, për shembull; apo Samoa? Apo diçka më të gjallë?

Helmholci u çua prej karriges pneumatike.
– Mua do më pëlqente të shkoja në një klimë tërësisht të keqe, – iu përgjigj. – Besoj se njeriu shkruan më mirë nëse klima është e keqe. Nëse ka shumë erë, stuhi, gjëra të tilla...
Kontrollori tundi kokën në shenjë aprovimi.
– Më pëlqen guximi juaj, zotni Uatson. Më pëlqen shumë, pa dyshim. Sado që zyrtarisht nuk jam dakord. – Buzëqeshi. – Si thoni për Ishujt Folkland?
– Po, them se janë mirë, – iu përgjigji Helmholci. – Dhe tani, nëse nuk e keni problem, do të shkoj të shoh se si po e kalon i shkreti Bernard.

KAPITULLI XVII

– Art, shkencë – duket se e paskeni paguar lumturinë shumë shtrenjtë, – tha njeriu i egër kur mbetën vetëm. – Tjetër gjë?
– Epo,feja sigurisht, – ia ktheu Kontrollori. – Ka qenë dikurnjë gjë që quhej Zot, përpara Luftës së Nëntë Viteve. Por harrova, ti i di të gjitha këto gjërat me Zot, besoj.
– Epo... – ngurroi njeriu i egër. Ai do të kishte dashur të fliste për vetminë, për natën, për sheshin e zbehtë nën dritën e hënës, për humnerën, zhytjen drejt errësirës hije-rëndë, për vdekjen. Do të kishte dashur të fliste, por nuk kishte fjalë. Ashtu si të Shekspirit.
Kontrollori, ndërkohë, shkoi deri në qoshen tjetër të dhomës dhe po hapte një kasafortë të madhe, të vendosur në murin mes rafteve të librave. Porta e rëndë u hap njesh. Duke rrëmuar brenda errësirës ai tha:
– Është një subjekt që më ka ngjallur përherë interes. – Dhe nxori që aty një vëllim të trashë të zi.
– Ti nuk e ke lexuar kurrë këtë, për shembull.
Njeriu i egër e mori në dorë.
– *Bibla e shenjtë*, përmban *Testamentin e Ri dhe të Vjetër*, – lexoi ai me zë në faqen e parë.

– As këtë. – Ishte një libër i vogël, të cilit i kishte humbur kapaku.
– *Imitimi i Krishtit*.
– As këtë, – dhe i dha në dorë një vëllim tjetër.
– *Varietete të përvojës fetare*. Nga Uilliam James.
– Edhe kam plot të tjera, – vijoi fjalën Mustafa Mondi duke u kthyer në karrigen e vet. – Një koleksion të plotë me libra të vjetër pornografikë. Zonit në kasafortë dhe Fordit në rafte. – Ai tregoi duke qeshur librarinë e madhe, me raftet e mbytur nga librat, raftet plot me bobina të makinës së leximit dhe me rrakelet e kolorave muzikore.
– Por kur e di për Zotin, pse nuk ua tregon të gjithëve? – pyeti njeriu i egër shumë i prekur. – Përse nuk u jepni këto libra që flasin për Zotin?
– Për të njëjtën arsye që nuk u japim *Otellon*: se janë vjetërsira. Janë për Zotin qindra vite më parë. Nuk janë për Zotin tani.
– Por Zoti nuk ndryshon.
– Njerëzit po, ama.
– Edhe çfarë ndryshon kjo?
– Kjo ndryshon gjithçka, – tha Mustafa Mondi. Dhe u çua edhe një herë dhe shkoi te kasaforta. – Ka qenë njëherë një njeri që quhej Kardinali Njuman, – tha ai. – Kardinali,... tha ai me një ton prindëror, – ka qenë një si punë Kryepeshkopi-këngëtar i Komunitetit.
– Unë Pandulfi, kardinali i drejtë i Milanos. Kam lexuar rreth tyre tek Shekspiri.
– Patjetër që ke lexuar, Epo, siç po ju thosha, ka qenë dikur një njeri që quhej Kardinal Njuman. Ah, ja tek është libri. – Dhe ai e nxori librin jashtë. – Dhe meqë jam këtu

po e nxjerr edhe këtë tjetrin. Është shkruar nga një që quhej Majn dë Biran. Ka qenë filozof, nëse e di se çfarë ka qenë filozofi.
– Një njeri që ëndërron disa gjëra të tjera, më shumë se sa ato që janë në parajsë dhe në tokë, – ia ktheu njeriu i egër.
– Tanimë ashtu. Do të lexoj një prej gjërave që ai rëndom thoshte. Ndërkohë, dëgjo se çfarë ka thënë ky Kryepeshkop-këngëtar i Komunitetit. – Dhe ai e hapi librin në një faqe të shënuar nga një fije letre dhe nisi të lexojë. "Ne nuk kemi zotërim mbi veten, më shumë se ç'mund të kemi mbi sendet që na përkasin. Nuk mundemi ta bëjmë veten, nuk mund të kemi epërsi mbi veten. Ne nuk jemi të zotët e vete. Ne jemi pronë e Zotit. A nuk është kësodore lumturi rehati të pohojmë se i *përkasim vetes*? Mund ta mendojnë kështu të rinjtë dhe të fuqishmit. Këtyre mund t'u duket gjë e madhe të bëjnë gjithçka sipas dëshirës së vet, siç pandehin; të mos varen prej askujt; të mos jenë të detyruar të mendojnë mbi asgjë përtej asaj që shohin me sy, të mos jenë të ngarkuar me bezdinë e përkushtimit të vazhdueshëm, lutjes së vazhdueshme, pa iu referuar për atë çka i bëjnë vullnetit të tjetërkujt. Por teksa kalon koha, ata, si gjithë njerëzit, do të kuptojnë se pavarësia nuk është bërë për njerëzit – se kjo është një gjendje e panatyrshme, ajo do t'i çojë përpara për ca kohë, por kurrë nuk do t'i mbarte deri në fund... Mustafa Mondi heshti, la njërin libër dhe mori në dorë tjetrin, kaloi disa faqe. – Ja, merr këtë si shembull, tha ai dhe zëri i tij i thellë ia nisi sërish leximit: – Njeriu plaket; ai e ndien te vetja ndjesinë radikale të dobësisë, apatisë, sfilitjes, të cilat shoqërojnë kalimin e moshës; dhe duke u

ndier kështu, përfytyron veten thjesht të sëmurë, ndrysh frikën e vet me idenë se kjo gjendje shqetësuese ka ndodhur për një shkak të caktuar, prej të cilit, si prej sëmundjes, ka shpresë të shërohet. Përfytyrime të kota! Kjo sëmundje është pleqëria, dhe është sëmundje e tmerrshme. Thonë që është frika prej vdekjes dhe asaj që vjen pas vdekjes, ajo që i kthen njerëzit dhe i bën religjiozë me kalimin e viteve. Po përvoja ime më jep bindjen se, veçan merzit apo përfytyrimit, ndjenjat religjioze kanë prirje të zhvillohen brenda nesh, sa më tepër që plakemi, të zhvillohen sepse, ndërkohë që pasionet qetësohen, ndërsa fantazitë dhe ndjenjat janë përherë e më pak ngacmuese dhe të ngacmueshme, arsyeja jonë vjen e bëhet më pak e trazuar në funksionet e saj, më pak e errësuar prej imazheve, dëshirave dhe burimeve me të cilat merret zakonisht; e këtu Zoti shfaqet si pas një reje, shpirtat tanë shohin, ndiejnë, kthehen nga burimi i dritës, kthehen natyrshëm dhe pashmangshmërisht, ngase ajo që deri tani i kish dhënë botës së shqisave jetën dhe hijeshinë, ka nisur të rrjedhë larg prej nesh, tani që kjo ekzistencë fenomenale nuk përkrahet më nga përshtatjet e brendshme apo të jashtme, ne ndiejmë nevojën të mbështetemi pas diçkaje të qëndrueshme, diçkaje që nuk do të na lëjë në baltë – një realitet, një e vërtetë absolute dhe e përhershme. Po, në mënyrë të pashmangshme ne i drejtohemi Zotit; ngase kjo ndjenjë fetare ka natyrë kaq të kulluar, kaq ngushëlluese për shpirtin, saqë na kompenson të gjitha humbjet. – Mustafa Mondi e mbylli librin dhe u mbështet prapa në karrige. – Një prej gjërave të panumërta në qiej dhe në tokë, të cilën filozofët nuk e panë as në ëndërr, është kjo, (ai hapi duart) – ishim ne, bota moderne. – Mund të jesh i pavarur prej

Zotit vetëm në kohën kur ke rini dhe mirëqenie; pavarësia nuk të çon shëndoshë deri në fund të rrugës. – Epo, ne tani kemi edhe rini, edhe mirëqenie, deri në fund të jetës. Çfarë ndodh? Po duket sheshit se tani kemi mundësi të jemi të pavarur prej Zotit. – Ndjenja fetare do të na ngushëllojë për të gjitha humbjet. – Por ne nuk kemi humbur gjë, që të shpaguhemi; ndjenja fetare është e tepërt. Dhe përse na duhet të kërkojmë një zëvendësues për dëshirat rinore, kur dëshirat rinore nuk dështojnë kurrë? Një zëvendësues argëtimesh, kur po ne i shijojmë gjithë budallallëqet e vjetra deri në një? Çfarë nevoje kemi për çlodhje, kur mendjet dhe trupat tanë vazhdojnë të kënaqen me veprimtari? Ç'e duam ngushëllimin, kur kemi soma? Ç'na duhet një themel i patundshëm, kur kemi rregullin shoqëror?
– Atëherë, ti mendon se nuk ka Zot?
– Jo, mendoj se ka shumë mundësi të ketë.
– Atëherë përse...
Mustafa Mondi e ndërpreu.
– Por ai u shfaqet në rrugë të ndryshme njerëzve të ndryshëm. Në kohët paramoderne e shfaqi veten si qenia e përshkruar në këta libra. Tani...
– Siç shfaqet ai vetëm sot? – e pyeti njeriu i egër.
– Epo, ai e shfaq veten si mungesë; si të mos ishte fare.
– Ky është faji juaj.
– Quaje faj të qytetërimit. Zoti nuk përshtatet me makineritë, mjekësinë shkencore dhe lumturinë universale. Duhet të bësh zgjedhjen tënde. Qytetërimi ynë ka zgjedhur makineritë, mjekësinë dhe lumturinë. Prandaj dhe më duhet t'i mbaj këto libra të mbyllur me çelës. Janë sëmundje. Njerëzit do të tronditeshin nëse...

Njeriu i egër e ndërpreu.
– Po a nuk është e natyrshme të besosh se ka Zot?
– Ti mund fare mirë të pyesësh a është e natyrshme që t'i bësh pantallonat e shkurtra me zinxhir, – tha Kontrollori me sarkazëm. – Ti më kujton një tjetër prej atyre tipave të vjetër, të quajtur Bradlej. Ai e përcaktonte filozofinë si gjetjen e arsyeve të gabuara për atë që njeriu beson nga instinkti. Sikur ta besuarit njeri i shtyrë prej instinktit! Njeriu i beson gjërat se është i kushtëzuar t'i besojë. Të gjeturit e arsyeve të gabuara për atë çka beson, për shkak arsyesh të tjera të gabuara – ja ç'është filozofia. Njerëzit e besojnë Zotin, sepse janë të kushtëzuar që ta besojnë.
– Por, prapëseprapë, – këmbënguli njeriu i egër, – është e natyrshme të besosh në Zot kur je i vetmuar, krejt i vetmuar natën, kur mendon për vdekjen...
– Por njerëzit sot nuk janë kurrë të vetmuar, – tha Mustafa Mondi. – Ne i bëjmë që ta urrejnë vetminë, dhe i rregullojmë jetët e tyre asisoj, që ta kenë gati të pamundur të jenë vetëm.
Njeriu i egër pohoi i dëshpëruar me kokë. Në Malpais, ai kishte vuajtur, sepse e kishin përjashtuar nga aktivitetet e përbashkëta të fshatit; në Landën e qytetëruar vuante se nuk shpëtonte dot prej aktiviteteve të përbashkëta. Këtu nuk i binte kurrë të ishte i vetëm.
– A të kujtohet ajo pjesa tek *Mbreti Lir*? – tha njeriu i egër më në fund: "Zotat janë të drejtë, me veset tona kënaqësindjellëse farkëtojnë instrumente për të na ndëshkuar; vendin i errët dhe i mbrapshtë ku ai të ngjizi i kushtoi të parët, – dhe Edmondi i përgjigjet (të kujtohet, ai është plagosur, po vdes) – Ti fole drejt, është e vërtetë. Rrota

u soll një qark të plotë; unë jam këtu. Po kësaj ç'i thua? A nuk paska njëfarë njeriu një Zot, që sajdis, ndëshkon, shpërblen?
– Pra, a ka? – pyeti Kontrollori kur i erdhi radha të flasë. – Sot ti mund t'i lejosh vetes gjithfarë vesesh me shpirtpër, pa pasur kurrë rrezikun që i biri i dashnores do të vijë të të nxjerrë sytë. "Rrota u soll një qark plot; unë jam këtu." Po ku do të ishte Edmondi në ditët e sotme? I ulur në një karrige pneumatike, me dorën pas belit të një vajze, duke i thithur lëngun çamçakëzit me hormone seksi, duke parë filma në kinematë me prekje. Zotat janë të drejtë. Pa dyshim. Por kodi i ligjeve të tyre diktohet, në fund të fundit, nga njerëzit që organizojnë shoqërinë; Provania zë fill tek njerëzit.
– Je i sigurt? – e pyeti njeriu i egër. – Je krejtësisht i sigurt se Edmondi në karrigen pneumatike nuk është i ndëshkuar po aq shumë sa edhe Edmondi i përgjakur e i plagosur për vdekje? Zotat janë të drejtë. A nuk i kanë përdorur ata veset e kënaqësive të tua për ta shkatërruar atë?
– Sakrificat prej cilit pozicion? Si qytetar i lumtur, punëtor i madh, konsumator i mirë, ai është i përkryer. Sigurisht, po t'i zgjedhësh ndonjë standard tjetër nga ky i joni, atëherë mbase mund të thuash që e degraduan. Por ti duhet t'i përmbahesh një takëmi postulatesh. Nuk mund të luash golf elektromagnetik sipas rregullave të lojës Qenushi Centrifugal.
– Por vlera nuk qëndron te vullneti i veçantë, – tha njeriu i egër. – Ajo e ruan vlerën dhe dinjitetin po aq mirë, edhe nëse mbajtësi i tyre nuk është aq i vyer.
– Prit, prit, – kundërshtoi Mustafa Mondi, – se po shkon pak si larg, apo jo?

– Nëse ti i lejon vetes të mendosh për Zotin, ti nuk i lejon dot vetes të degradohesh nga veset e kënaqësisë. Sepse ke një arsye që t'i përballosh gjërat me dinjitet, t'i bësh ato me kurajë. Unë këtë e kam parë tek indianët.
– Jam krejt i bindur për këtë që ke parë, – pohoi Mustafa Mondi. – Por ne nuk jemi indianë. Nuk ka asnjë nevojë që njeriu i qytetëruar të durojë gjëra të papëlqyeshme. Dhe sa për të bërë gjëra – Fordi na ndihmoftë nëse dikujt i shkon ndër mend të bëjë një gjë të tillë. Do të çrregullohej i gjithë rregulli shoqëror sikur të gjithë njerëzit që nisin e t'i bëjnë gjërat me kokë të tyre.
– Ç'më thua atëherë për vetëmohimin? Pa të kishit Zot, do të kishit dhe arsye për vetëmohim.
– Por, qytetërimi industrial është i mundur vetëm kur nuk ekziston vetëmohimi. Vetëkënaqësia po, deri në limitet e vendosura prej higjienës dhe ekonomisë. Përndryshe rrota e zhvillimit nuk ecën më.
– Do të kishit një arsye edhe për dëlirësinë! – tha njeriu i egër duke u skuqur lehtë në faqe kur nxori fjalët nga goja.
– Po dëlirësia do të thotë pasion, dëlirësia do të thotë nevrasteni. Dhe pasioni dhe nevrastenia do të thonë destabilizim. Dhe destabilizim do të thotë fundi i qytetërimit. Nuk ka si të mbash jetëgjatë një qytetërim pa i pasur me shumicë veset e kënaqësisë.
– Po Zoti është arsyeja për gjithë gjërat fisnike, të mira dhe heroike, Po të kishit një Zot...
– Mik i dashur e i ri, – tha Mustafa Mondi, – qytetërimi nuk ka absolutisht nevojë për fisnikëri apo heroizëm. Këto gjëra janë simptoma të paefektshmërisë politike. Në një shoqëri të organizuar mirë, si kjo e jona, askujt s'i jepet rasti

të jetë fisnik dhe heroik. Kushtet duhet të jenë tërësisht të paqëndrueshme që t'u jepet rasti. Kur ka luftëra, kur ka bashkësi që ndahen me të tjerët, kur ka tundime të cilave duhet t'u bësh ballë, objekte të dashurisë sonë për të cilat duhet luftuar apo të duhen mbrojtur – atëherë, natyrisht, ka njëfarë kuptimi fisnikëria dhe heroizmi. Mirëpo sot nuk ka më luftëra. Tregohet përkujdesja maksimale për të parandaluar të dashuruarit njeri me tjetrin. Të ndash bashkësinë me të tjerët, është një gjë që nuk ekziston; njeriu është aq i kushtëzuar, sa nuk bën dot ndryshe nga ajo që i kanë mësuar. Dhe ajo që ti duhet të bësh është aq e kënaqshme, ka kaq shumë impulse të natyrshme që janë lënë të lira të lëvizin, sa nuk ka ndonjë tundim ndaj të cilit të të duhet të rezistosh. Por edhe nëse, ndonjëherë, prej fatit të keq, të rëndonte ndonjë gjë e papëlqyeshme, ja përse kemi soma, e cilat çon me pushime larg fakteve. Dhe ka gjithmonë soma për të qetësuar zemërimin, për t'u pajtuar me armiqtë, për t'u bërë i durueshëm dhe kofekfortë. Në të shkuarën mund t'i arrije këto vetëm mes përpjekjesh të mëdha dhe pas disa vitesh të rënda të formimit të parimeve morale. Sot kapërdin dy a tri tableta soma gjysmëgramëshe dhe ia ke dalë mbanë. Çdokush sot mund të bëhet i virtytshëm. Mund të mbash me vete gjysmën e parimeve morale brenda një shisheje të vogël. Krishterimi pa lot – ja kjo është soma.

– Po lojërat janë të domosdoshëm. Nuk ta kujtohet si e thotë *Otello*? "Nëse pas çdo stuhie vjen kështu qetësia, era le të fryjë deri sa vdekjen të zgjojë." Është një histori, të cilën na e kanë pasur treguar indianët pleq, për një vajzë nga Mataski. Djaloshi që donte të martohej me të, duhej të prashiste në mëngjes kopshtin e saj. Dukej e lehtë, por

kishte miza e mushkonja, nga ato magjikes. Shpirtat e djemve të rinj nuk i duronin dot pickimet dhe ktheheshin. Por ai që duronte, fitonte vajzën.
– E mrekullueshme! Por në botën e qytetëruar, – tha Kontrollori, – mund t'i marrësh vajzat edhe pa prashitur dhe nuk ka as miza, as mushkonja që të të pickojnë. I kemi hequr qafe shekuj më parë.
Njeriu i egër pohoi me kokë vetëllëngonjës.
– I hoqët qafe. Po, tipike e juaja. Hiqni qafe çdo gjë të pakëndshme, në vend që të mësoni të përballeni me to. Është më fisnike të vuash goditjet dhe shigjetat e fatit mizor, apo t'i ngresh krahët ditët e andrallave e t'u dalësh kundër... Por ju nuk e bëni as njërën, as tjetrën. As vuani, as ngriheni kundër. Ju i zhdukni kohëtë dhe shigjetat dhe goditjet. Është shumë kollaj ashtu.
Ai papritur heshti, po mendonte për vdekjen e nënës. Në dhomën e saj në katin e tridhjetë e shtatë, Linda kish piskatur në detin e këngës së dritave dhe parfumeve përkëdhelëse; kishte pluskuar atje përtej hapësirës, jashtë kohës, jashtë burgut të kujtimeve, zakoneve të veta, jashtë trupit të saj të mbufatur e të plakur. Dhe Tomakini, ish-drejtori i Rezervatit të Rritjes dhe Kushtëzimit të embrioneve ishte ende me pushime me pushime prej turpit dhe prej dhimbjes, në një botë ku nuk do t'i dëgjonte këto fjalë, në qeshjen tallëse, nuk mund ta shihte atë fytyrën e shëmtuar të ndiente ato krahët e lagësht e të lëshuar përrreth qafës, si ishte në një botë të bukur...
– Ajo për të cilën keni nevojë, – vijoi të flasë njeriu i egër, – është të qani me lot, sa për të ndërruar një herë. Asgjë këtu nuk kushton aq sa ç'duhet të kushtojë.

"Dymbëdhjetë milionë e gjysmë dollarë," – ishte lënduar zëri Fani Foster kur i egri i kish thënë të njëjtën gjë.
Dymbëdhjetë milionë e gjysmë dollarë – kaq ka kushtuar Qendra e Kushtëzimit. Asnjë cent më pak.")
Të tregosh se je është e vdekshme dhe e pasigurt përrallë fat-, vdekjes dhe rrezikut që guxon ta marrë mbi vete, qoftë edhe një lëvizje veze. A nuk ka këtë diçka! – e pyeti ai, duke parë në sy Mustafa Mondin. – Krejt veçan Zoti – përkase patjetër Zodi është arsyeja që ajo ekziston. A nuk ka diçka edhe në të jetuarit rrezikshëm?
– Po, ka dhe ka shumë, – ia ktheu Kontrollori. – Burrave dhe grave u duhet t'u stimulohet mbiveshkoret herë pas here.
– Çfarë? – pyeti njeriu i egër me moskuptim.
– Është një prej kushteve për shëndet të përkryer. Prandaj dhe kemi trajtimin S. P. DH të detyrueshëm.
– S. P. DH-ne?
– Surrogatin për pasionet e dhunshme. Rregullisht, një herë çdo muaj. Ua përmbytim gjithë sistemin me adreninë. Është ekuivalenti i plotë fiziologjik i frikës dhe zemërimit. Të gjitha efektet gjallëruese e të vrarit të Desdemonës e të të qenit i vrarë prej Otellos, vetëm pa pjesën e dëmit.
– Por mua më pëlqen pjesa e dëmit.
– Neve jo, – tha Kontrollori. – Neve na pëlqen që t'i bëjmë gjërat me rehati.
– Por unë nuk dua rehatinë. Unë dua Zotin, dua poezinë, dua rrezikun e vërtetë, dua lirinë, dua mirësinë. Dua mëkatin. Në fakt, – tha Mustafa Mondi, – ti po pretendon të drejtën për të qenë i mërzitur.

– Epo mirë pra, – tha njeriu i egër, – unë po pretendoj të drejtën të jem i mërzitur.
– Pa përmendur këtu të drejtën për t'u plakur, për t'u shëmtuar dhe për t'u bërë impotent, të drejtën për të marrë sifilizin dhe për të vuajtur prej kancerit, të drejtën për të pasur shumë pak për të ngrënë, të drejtën të jesh miunxhi, të drejtën për të jetuar me frikën e përhershme për çka do të ndodhë nesër, të drejtën të marrësh tifon, të drejtën për t'u torturuar nga dhimbje të të gjitha llojeve.
Ra heshtje e gjatë.
– I pretendoj të gjitha, – tha më në fund njeriu i egër.
Mustafa Mondi ngriti supet.
– Jeni të mirëseardhur – tha ai.

KAPITULLI XVIII

Porta ishte pak e hapur kanat; ata hynë brenda.
– Xhon!
Nga banjo erdhi një zhurmë e pakëndshme dhe karakteristike.
– Ke ndonjë problem? – thirri Helmholci.
Nuk i ktheu njeri përgjigje. Zhurma e pakëndshme u përsërit edhe një herë tjetër, dy herë të tjera; pastaj ra heshtje. Pastaj një kërcitje, porta e banjës u hap dhe, shumë i zbehtë, prej saj u shfaq njeriu i egër.
– Do të thosha, – tha Helmholci i merakosur, – se më dukesh pa qejf, Xhon!
– Mos hëngre ndonjë gjë që nuk të shkoi për shtat? – e pyeti Bernardi.
Njeriu i egër pohoi me kokë.
– Hëngra qytetërimin.
– Çfarë?
– Më helmoi, u ndota. Dhe më pas, – shtoi ai duke e ulur tonin e zërit, – bëra gra lëpisinë time.
– Po mirë, por çfarë tamam-tamam? Desha të them se pak më parë ishe...
– Tani jam i pastër, – tha Xhoni. – Piva ca mustardë me ujë të ngrohtë.

Të tjerët e panë të habitur.
– Mos po thua se e bëre me qëllim? – e pyeti Bernardi. – Kështu e pastrojnë veten indianët. – Ai u ul përdhe dhe pasi psherëtiu, kaloi dorën mbi ballë. – Duhet të çlodhem pak, tha ai. – Jam shumë i lodhur.
– Epo, nuk më habit, – tha Helmholci. Dhe pas heshtjes, me një ton krejt të ndryshëm, tha: – Ne erdhëm të të thoni lamtumirë. Nesër në mëngjes nisemi.
– Po, nisemi nesër, – i tha Bernardi, në fytyrën e të cilit njeriu i egër dalloi shprehinë e një dorëheqjeje të pakthyeshme. – Dhe meqë ra fjala Xhon, dua të të kërkoj falje, – vijoi ai duke mbështetur dorën mbi gjurin e njeriut të egër. – dua të të kërkoj falje për gjithë atë që ndodhi dje.
– Edhe u skuq. – Tani më vjen turp, – dhe vazhdoi më të flasë, megjithëse zëri iu drodh, – shumë turp...
Njeriu i egër ia preu fjalën me një shtrëngim dore të përzemërt.
– Helmholci u soll me mua mrekullisht, – ia ktheu fjalëve Bernardi pas pauzës. – Sikur të mos ishte për të, unë do të...
– Mirë, mirë, hajde tani, – kundërshtoi Helmholci.
Ra heshtja. Pavarësisht mërzisë – edhe ndoshta për shkak të saj, se mërzitë ishin për ta simptomë e dashurisë për njëri tjetrin – tre djelmoshat ndiheshin të lumtur.
– Shkova sot në mëngjes të takoj Kontrollorin, – tha më në fund njeriu i egër.
– Për çfarë?
– Ta pyesja nëse mund të vija me ju në ishull.
– Dhe çfarë të tha ai? – e pyeti Helmholci gjithë zell.
Njeriu i egër tundi kokën.
– Nuk më la.

– Përse jo?
– Më tha se donte të vazhdonte eksperimentin. Po mallkuar qofsha, – tha njeriu i egër krejt papritur me tërbim. – Mallkuar qofsha po lejova që të eksperimentojnë më me mua. As gjithë Kontrollorët e botës bashkë nuk e bëjnë dot. Edhe unë do të iki nesër.
– Po ku? – e pyetën ata njëzëri. Njeriu i egër ngriti supet.
– Ku të jetë. Nuk dua t'ia di. Mjafton të jem vetëm.
Prej Gjillfordit, linja për poshtë ndjek luginën Usi deri në Godalming, pastaj, mbi Milford dhe Uitlej e vazhdonte në Haslemere përmes Petersfildit, drejt në Portsmouth. Pak a shumë paralele me të, linja që shkonte lart kalonte mbi Vorplesden, Tongham, Patenham, Elsted dhe Grejshot. Mes shpatit e qafës së Derrit, kishte pika ku të dy linjat nuk ishin më larg se gjashtë a shtatë kilometra mes tyre. Distanca ishte tepër e ngushtë për pilotët e pakujdesshëm – veçanërisht netëve dhe sidomos kur kishin kapërcyer ndonjë gjysmë grami më tepër. Kish pasur edhe aksidente. Nga ato të rëndat. Ishte vendosur që të shmanguan linjat që shkonin lart disa kilometra nga perëndimi. Mes Grejshotit dhe Tonghamit katër fanarë për paralajmërues për ajrin të braktisur shënonin drejtimin e rrugës së vjetër Portsmouth-Londër. Qiejt përmbi ishin të heshtur dhe të braktisur. Helikopterët gumëzhinin pa pushim vetëm mbi Selbornë, Bordon dhe Farnham. Njeriu i egër e kishte zgjedhur si vendin ku do të jetonte vetëm fanarin e vjetër që ngrihej mbi kreshtën e një kodre mes Puttenhamit dhe Elstedit. Ndërtesa ishte prej ferrobetoni dhe në gjendje të shkëlqyer – gati tepër e rehatshme, pati

menduar njeriu i egër kur kishte eksploruar vendin për herë të parë; gati-gati tepër e qytetëruar e luksoze. Por e paqëtoi ndërgjegjen duke i bërë premtim vetes një vetëdisiplinim edhe më të fortë si kompensim, pastrime edhe më të shpeshta, edhe më të thella. Nata e parë në vendin e vetmisë ishte qëllimisht një natë e pagjumë. Ai i kaloi orët në gjunjë duke iu falur herë asaj Parajse prej së cilës fajtori Klaudius kërkonte falje, herë Auonauilonës në Zuñi, herë Krishtit dhe Pukongut, herë shpendit të tij mbrojtës: shqiponjës. Me raste hapte krahët si të ishte kryëzuar dhe i mbante ashtu për minuta që zgjasnin shumë mes dhimbjesh, të cilat gradualisht shtoheshin derisa ktheheshin në tortura e përpëlitje deri në agoni; i mbante në një kryqëzim të vullnetshëm, ndërsa përsëriste mes dhëmbëve të shtrënguar që sa nuk thyheshin (djersa ndërkohë i shkonte valëfaqeve), "Oh, më fal! Më bëj të pastër! Oh, më ndihmo të jem i mirë!" – pa pushuar një herë, derisa ishte gati t'i binte të fikët.

Kur erdhi mëngjesi, atij iu duk se e kishte fituar të drejtën që të banonte në ndërtesën e farit; edhe pse kishte prapë xhama në shumicën e dritareve, edhe pse pamja prej platformës së saj ishte kaq e bukur. Ngase arsyeja që kishte zgjedhur farin, qe bërë pothuaj menjëherë arsyeja për të ikur prapë diku tjetër. Kish vendosur të jetonte aty sepse pamja ishte kaq e bukur, sepse prej kësaj pike të epërme, atij i ngjante sikur po shihte në brendësi mishërimin e një qenieje hyjnore. Por kush ishte ai që të llastohej me pamjen e përditshme dhe të përorshme të dashurisë? Kush ishte ai që të jetonte në praninë e dukshme të Zotit? Ai meritonte të jetonte vetëm në një thark të qelbur, në ndonjë vrimë qorre poshtë nën dhe. I mpirë, me vuajtje prej netëve të

gjata plot dhimbje, por tamam për këtë arsye i bindur se brendshmi, ai ngjitej lart në platformën e kullës së tij, pa përtej në dritën e shkëlqyeshme të diellit të asaj bote ku ai kishte rifituar të drejtën të jetonte. Në veri, pamja bëhej bashkë e zgjatej tej kreshtës së bardhë të gëlqeres të shpatit të Derrit, pas të cilit, në skajin më të largët në lindje ngriheshin kullat e shtatë qiellgërvishtësve që formonin Gildfordin. Duke vështruar andej, njeriu i egër ngërdheshej; veç, me kalimin e kohës do të pajtohej me atë pamje, ngase natën ata xixëllonin gëzueshëm me yjesi gjeometrike, ose përndryshe, të larë në dritë drejtonin gishtat e vet të shndritshëm (me një gjest të cilin askush në gjithë Anglinë nuk e kuptonte përveç njeriut të egër) solemnisht përkundër thellësive të mistershme të qiejve.

Në luginën e cila ndante shpatin e Derrit nga kodrat e shtufit ku qëndronte fari, Patenhami ishte veçse një fshat i vogël me ndërtesa nëntëkatëshe, me kulla-silose, ferma pulash dhe një fabrikë të vogël që prodhonte vitaminë D. Në anën tjetër të farit, nga jugu, terreni binte teposhtë në rrepira të gjata, deri te një varg hauzesh.

Përtej atyre, mbi pyjet që ndërthureshin, ngrihej ndërtesa katërmbëdhjetëkatëshe e kullës së Elstedit. Të zbehtë në ajrin e mjegullt të Londrës, Qafa dhe Selborni e ftonin vështrimin në blunë romantike të largësisë. Por nuk ishte vetëm largësia ajo që tërheqte njeriun e egër ty far, ato që kishte afër ishin po aq ndjellëse sa ato që ishin larg. Pyjet, zgjatimet e shqopave dhe gjineshtrës së verdhë, grumbujt e bredhave skocezë, hauzet që shkëlqenin mes mështeknave që u vareshin përsipër, zambakët e ujit brenda tyre, shtretërit e xunkthit – këto ishin të mrekullueshme dhe për syrin e

një njeriu të mësuar me thatësirën e shkretëtirës amerikane, thjesht mahnitëse. E për më tepër vetmia! Kalonin ditë të tëra pa parë me sy qenie njerëzore. Fari ishte vetëm një çerek ore fluturim larg Kullës së Kujdesit-T; por kodrat e Malpaisit vështirë se ishin më të shkreta e pa njerëzi se kjo shqopishtë. Turmat që përditë linin Londrën dilnin jashtë qytetit të luanin Golf Elektro-Magnetik ose tenis. Patenhami nuk kishte asnjë lidhje; sipërfaqet-Rieman më të afërta ishin në Guildford. Lulet dhe peizazhet ishin të vetmet argëtime këtu. Dhe meqë nuk kishte asnjë arsye për të shkuar aty, askush nuk vinte. Gjatë ditëve të para njeriu i egër jetoi vetëm, i pashqetësuar.

Prej parave që Xhoni kishte marrë për shpenzime personale kur kish mbërritur, shumica ishin shpenzuar në pajisje. Përpara se të linte Londrën, kishte blerë katër batanije prej viskoze leshi, litar dhe spango, gozhdë, ngjitës, pak vegla, shkrepëse (megjithëse kishte ndërmend të bënte pak stërvitje për ndezje zjarri), tenxhere e tiganë, duzina me kuti me fara dhe dhjetë kilogramë miell gruri. "Jo, nuk dua niseshte sintetike dhe mbetjet e pambukut zëvendësuese të miellit të grurit, – kishte ngulur këmbë. – Edhe pse janë më të ushqyeshme." Por kur i erdhi radha biskotave me gjëndra të fërguara dhe surrogatit të vitaminizuar të viçit, nuk ia kishte dalë dot t'i rezistonte këmbënguljes së shitësit. Kur shihte tani kanoçet, sahante veten me hidhërim pse ishte treguar i dobët. Gjëra të neveritshme qytetërimi! E kishte ndarë mendjen se nuk do t'i hante kurrë edhe sikur të vdiste urie. "Ua tregoj unë atyre," mendonte me hakmarrje. Por donte t'ia tregonte edhe vetes. Numëroi paratë. Shpresonte se mund ta kalonte dimrin me aq pak sa i kishin mbetur.

Kur të vinte pranvera, kopshti i tij do të prodhonte aq sa ta bënte të pavarur prej botës së jashtme. Ndërkohë, ishte përherë rasti të gjuante.
Kishte parë plot lepuj dhe në hauze kishte pula uji. Ndaj edhe ai iu vu punës menjëherë të bënte harkun dhe shigjetat. Kishte disa pemë frashëri pranë farit dhe një grumbull të madh fidanësh të drejtë lajthish për shtizat e shigjetave. Dhe ia nisi duke rrëzuar përrdhe një frashër të vogël, preu një copë kërcelli të gjatë gati dy metra, pa asnjë degë, i hoqi lëkurën copa-copa, e kroi mirë e mirë derisa i doli druri i bardhë – siç e kishte mësuar plaku i moçëm Micima – derisa e bëri dërrasë në gjatësinë e trupit të vet, të ngjeshur në qendër, të hollë në maja. Puna i dha kënaqësi të thellë. Pas atyre javëve plogështie në Londër, kur nuk kishte se ç'bënte më shumë, sepse sa herë që i duhej diçka i binte ose të shtypte ndonjë buton, ose të lëvizte ndonjë levë. Ishte qejf të bënte diçka që kërkonte aftësi dhe durim.
Ai gati po mbaronte së latuari harkun, kur kuptoi se pa mendje po këndonte – po, po, po këndonte! Ishte sikur të kishte takuar rastësisht vetveten e ta kishte zënë në befasi duke bërë një gabim flagrant. U skuq flakë nga faji. Në fund të fundit, nuk kishte ardhur të këndonte e të kënaqej këtu. Kishte ardhur të arratisej sa më larg nga ndotja e mëtejshme prej jetës së qytetëruar; që të pastrohej e të bëhej më i mirë. E kuptoi për llahtarin e vet se, duke humbur mendjen pas gdhendjes së harkut, ai kishte harruar betimin që kishte bërë me veten se përherë e çdo kohë do ta kujtonte të shkretën Lindë dhe sjelljet e veta mizore, binjakët e neveritshëm që iu qepën asaj si morrat rreth misterit të vdekjes; fyes, me praninë e tyre, jo vetëm pikëllimin e pendimin e tij, por

zotat vetë. Ish betuar të mos harronte kurrë, ish betuar pareshtur se do të ndreqte gabimet. Dhe ja ku ishte aty, ulur në bythë me harkun në dorë duke kënduar, duke kënduar me gojën plot...
U fut brenda farit dhe shkoi të hapte një kuti me mustardë, vuri në zjarr pak ujë që të ziejë. Gjysmë ore më vonë, tri kopshtarë Delta-minus nga njëri prej Grupeve Bokanovski të Patenhamit, qëlloi të kalonin me makinë për në Elsted dhe, majë kodrës, të habitur, panë një djalosh që rrinte përjashta farit të braktisur, i zhveshur deri në bel e që godiste veten me kamxhik me fije të lidhura nyje. Shpina i qe vijëzuar horizontalisht me rrëke të kuqe, edhe pas çdo fshikullime vërshonin valë të trasha gjaku. Shoferi i kamionit ndali në anë të rrugës dhe me dy shoqëruesit e vet vështroi gojëhapur spektaklin e jashtëzakonshëm. Një, dy, tre – numëruan goditjet. Pas së tetës, djaloshi ndali sa për të shkuar në një qoshe, ku zuri të vjellë shumë rëndë. Sapo mbaroi të vjellën, mori në dorë kamxhikun dhe nisi të godasë sërish veten. Nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë...
– O Ford! – pëshpëriti shoferi. Dhe dy binjakët me të ishin të një mendjeje.
– O Ford i madh! – thanë ata.
Tri ditë më vonë, si zogj grabitqarë që çukitin një cofëtinë, erdhën reporterët.
Tharë e forcuar mbi flakët e lehta të zjarrit të druve të njomë, harku i shigjetave ishte bërë gati. Njeriu i egër ishte shumë i zënë me shigjetat. Tridhjetë shtiza shkarpash të drejta prej lajthije ishin tharë, mprehur dhe pajisur me gozhdë në majë. Ai kishte bërë një mësymje një natë tek

ferma e pulave të Patenhamit dhe kishte marrë aq pupla sa për të pajisur një kazermë. Po merrej me kanalit e puplave në bisht të shtizave, kur e gjeti një prej reporterëve. Krejt pa zhurmë prej këpucëve të veta pneumatike, njeriu u ngjit lart dhe i doli nga prapa.
– Mirëmëngjesi, zotni njeri i egër, – tha ai. – Unë jam përfaqësuesi i *Radio Orës*.
I trembur si prej gjarprit, i egri kërceu në këmbë dhe shigjetat, puplat dhe gjithësia fluturuan në të gjitha drejtimet.
– Ju kërkoj ndjesë, – tha reporteri i vënë në siklet. – Nuk kisha për qëllim... – ai preku me dorë kapelën e vet, atë kapelën prej alumini si tub sobe ku mbante transmetuesin dhe marrësin pa tel.
– Më falni që nuk po e heq kapelën, – tha ai. – Është pak e rëndë. Pra, siç po thosha, jam përfaqësuesi i *Radios*...
– Çfarë do? – e pyeti njeriu i egër krejt i ngrysur. Reporteri ia ktheu me buzëqeshjen më magjepsëse.
– Epo, si të them, dëgjuesit tanë do ishin thjesht të interesuar... – ai ktheu kokën mënjanë dhe buzëqeshja iu bë gati joshëse. – Vetëm dy fjalë, zotni njeri i egër. – Dhe shpejt e shpejt, me një sërë gjestesh që dukej se i dinte përmendësh, ai zgjidhi dy tela dhe i lidhi me baterinë që mbante si rrip në brez; i lidhi njëkohësisht me baterinë dhe në anë të kapelës së vet prej alumini preku një sustë në kurorën e kapës dhe antena u zgjat lart, preku një sustë tjetër në qoshe të rrethit dhe mikrofoni kërceu si akrobat dhe u var përjashta duke u tundur një pëllëmbë larg hundës së vet; nxori një palë marrësa mbi veshë; shtypi një sutë tjetër në anën e majtë të kapelës dhe nga brenda kapës erdhi një gumëzhitje e dobët si e grerëzave; ktheu një çelës në të djathtë dhe gumëzhima

u ndërpre prej gulçimave, kërcitjeve, lemzave dhe kollitjeve stetoskopike. – Alo, – tha ai në mikrofon, – alo, alo... – papritur një zile filloi të bjerë brenda kapës së tij. – Ti je Edzel? Primo Melloni po të flet. Po e kam këtu. Zotni njeriu i egër do të na thotë ca fjalë tani. Apo jo? – dhe pa nga egërsira me një prej atyre buzëqeshjeve të veta. – Thjesht trego për dëgjuesit tanë përse erdhe këtu. Çfarë të bëri të lësh Londrën (prit pak, Edzel!) kaq papritur. Edhe patjetër, edhe për kamxhikun...
(I egri mbeti. Nga e dinin ata për kamxhikun?) – Mezi po presim të dimë përse është kamxhiku. Edhe ndonjë fjalë për qytetërimin. Më kupton, gjëra të tilla. "Çfarë mendoj unë për një vajzë e qytetëruar." Nja dy fjalë, nja dy...
Njeriu i egër u bind i turbulluar e në mënyrë të përpiktë. Pesë fjalë nxori dhe asnjë më shumë – pesë fjalë si ato që i tha Bernardit për Kryepeshkopin-këngëtar të Komunitetit të Kanterburit. *"Háni! Sons éso tse-ná!"* dhe duke e mbërthyer reporterin nga supi e ktheu rrumbullak dhe (djaloshi e tregoi veten të formuar mirë), u mat dhe, me forcën e saktësinë e një futbollisti kampion ia lëshoi me një shqelm të rrufeshëm.
Tetë minuta më vonë, një edicion i ri i *Radio Orës* doli për shitje në rrugët e Londrës. "Reporteri i *Radio Orës* goditet me shqelm në kërbisht nga njeriu i egër misterioz, – hapej faqja e parë. – Sensacionale."
"Sensacionale edhe në Londër," – mendoi reporteri kur, gjatë kthimit, lexoi ato fjalë. Një sensacion që për më tepër edhe i dhembi fort. U ul me shumë kujdes kur do të hante drekën. Të pashqetësuar prej plagës paralajmëruese në kërbishtin

e kolegut, katër reporterë të tjerë, që përfaqësonin *New York Times-in, Kontinuumin Katërdimensional të Frankfurtit, Monitorin e Shkencës Fordijane* dhe *Delta Mirror-in,* u paraqitën atë pasdite tek fari dhe hasën një pritje përherë e më të dhunshme.
Prej një distance të sigurt dhe duke fërkuar ende me dorë prapanicat, i dërguari i *Monitorit të Shkencës Fordijane* bërtiti:
– Budalla i trashë! Përse nuk merr edhe ti *soma*?
– Zhduku! – i tha njeriu i egër duke i treguar grushtet. Tjetri u tërhoq disa hapa dhe u kthye përsëri.
– Djalli zhduket nga dhoma, nëse merr nja dy gramë *soma*.
– *Kohakua iyathtokyai!* – toni i tij ishte kërcënues e përqeshës.
– Dhimbja është iluzion.
– Ou, kështu? – tha i egri dhe mori në dorë fshikullin me bisht të trashë me dru frashëri e bëri përpara.
I dërguari i *Monitorit të Shkencës Fordijane* ia dha vrapit të ngjitej në helikopterin e vet.
Pas kësaj, njeriun e egër e lanë të qetë për pak kohë. Disa helikopterë erdhën e qëndruan pezull duke hetuar rrotull kullës. Ai i lëshoi një shigjetë atij që iu afrua më pranë. Shigjeta e shpoi dyshemenë prej alumini të kabinës; u dëgjua një britmë e mprehtë dhe helikopteri u ngjit vertik lart me të gjithë fuqinë që i jepnin motorët. Të tjerët, ditët në vijim, mbajtën një distancë të mjaftueshme, si për respekt. Pa i vënë veshin zhurmës kapitëse të motorëve (ai në përfytyrimin e tij e përqasi veten me një prej neshënotësve të vajzës së Mátsakit, i palëkundur dhe këmbëngulës mes insekteve që i fluturonin rrotull), njeriu i egër gërmoi gjatë

atë që, më në fund, u bë kopshti i tij. Pas ca kohësh parazitët fluturues u mërzitën dhe ikën; për orë të tëra një ngastër qielli mbi kokën e tij ishte e zbrazët dhe përveç laureshave, çdo gjë ra në heshtje.
Moti ishte i nxehtë sa të merrej fryma, një vetëtimë i ra pash qiellit. Ai kishte gërmuar gjithë mëngjesin dhe po çlodhej, shtrirë përdhe sa gjatë-gjerë. Dhe papritur kujtimi i Leninës iu bë si i gjallë e prej mishi, lakuriq dhe e prekshme, duke i thënë "Zemër! Përqafomë! – me këpucë e çorapët gjithë parfum. Lavire e pafytyrë! Por, oh, oh, oh, krahët e saj rreth qafës së tij, gjokset e ngritura, përjetësia vetë binte mbi buzët e sytë. Lenina... Jo, jo, jo, jo! Ai kërceu në këmbë dhe ashtu, gjysmë i zhveshur siishte, doli jashtë shtëpisë. Në skaj të shqopishtës qëndronte një grumbull dëllinjash të vjetra. Ai u hodh mbi to, u përqafua, jo me trupin e lëmuar të dëshirës së vet, por me një grusht gjembash të gjelbër. Të mprehtë me një mijë majuca ato e shpuan. U përpoq të sillte ndërmend Lindën e gjorë, pa frymë dhe pa gojë, me duart si kthetra në ajër dhe terrorin e pashqiptuar në sy. Lindën e gjorë, të cilën ishte betuar se do ta kujtonte. Por ishte përsëri prania e Leninës që e përndiqte. Lenina, të cilën ishte betuar se do ta harronte. Edhe me sëmbimet e shpimet e dëllinjës, mishi i tij fërgëllues ishte i vetëdijshëm për praninë e saj plotësisht reale. – Zemër, zemër... Kur doje dhe vetë, përse nuk..."
Kamxhiku ishte varur në një gozhdë pas dere, gati të fshikullojë mbi reporterët. Prej dallgës, njeriu i egër u kthye me vrap në shtëpi, e rrëmbeu dhe e vërtiti. Nyjat e litarit i kafshuan mishin. "Lavire! Lavire! – ulërinte pas çdo goditjeje, thua se nën

kamxhik ishte Lenina (dhe me çfarë tërbimi, pa e ditur as vetë, kishte dëshirë që ajo të ishte aty!); e bardhë, e ngrohtë, erëmirë, Lenina e poshtër, atë po rrihte paq me kamxhik. – Lavire! – dhe pastaj me zë të dëshpëruar, – Oh, Linda, më fal. Më fal, o Zot! Jam i keq. Jam i lig. Jam... jo, jo, jo, ti lavire, lavire!" Nga vendi i fshehtë dhe i mirëndërtuar brenda në pyll, mes pemëve, njëqind metra larg, Darvin Bonaparti, fotografi më i mirë i lodrave të mëdha, i Korporatës Kinematografike, e kishte ndjekur të gjithë procedurën. Durimi dhe aftësia më në fund ishin shpërblyer. Ai kishte qëndruar tre ditë ulur brenda një zgavre të një lisi artificial; tri netë ishte tërhequr zvarrë mes shqopave, duke fshehur kamera mikroskopike nëpër shkurret e gjineshtrave, duke mbuluar telat e tyre në rërën e butë poshtë tyre. Shtatëdhjetë e dy orë sikleti të thellë. Por tani kish ardhur çasti i madh – më i madhi, pati kohë të mendonte Darvin Bonaparti, ndërsa lëvizte mes instrumenteve; më i madhi prej kohës kur kishte marrë imazhet e famshme stereoskopike të ulërimave të gorillave që po martoheshin. – Shkëlqyeshëm! – i tha vetes, në kohën kur njeriu i egër nisi performancën e çuditshme. – Shkëlqyeshëm!" – ai i mbajti kamerat e veta teleskopike të drejtuara plot kujdes, ngjitur me objektin e lëvizshëm; shkrepi me fuqinë më të madhe, për të marrë pamje të mira nga afër të fytyrës së xhindosur dhe të shtrembëruar (e admirueshme!); kaloi për një gjysmë minute në slow motion (një efekt jashtëzakonisht komik!), duke dëgjuar ndërkohë goditjet, rënkimet, fjalët e egra në jerm që po regjistroheshin në kolonën zanore në anë të filmit; provoi efektin e amplifikimit, (po, ishte shumë më mirë ashtu); u mrekullua, në një moment qetësie, prej këngës së mprehtë të

laureshës; do të donte që njeriu i egër të kthehej në anën tjetër, që ai të merrte një pamje më të mirë të gjakut mbi kurriz; dhe gati në çast (ç'fat i hatashëm!) njeriu atje tutje u kthye dhe ai ia doli të marrë një plan nga afër të përkryer.
"Epo kjo ishte e madhe! – tha me vete kur çdo gjë mbaroi. – Vërtet e madhe! – dhe fshiu fytyrën me një leckë. Kur t'i futnin edhe efektin e ndjenjave në studio, do të dilte një film i mrekullueshëm. Gati po aq i mirë, mendoi Darvin Bonaparti, sa edhe *Jeta dashurore e balenës ndërzyese*. Dhe po the këtë, për Fordin, ke thënë mjaft!"
Dymbëdhjetë ditë më vonë doli i egri i Surejt, që mund të dëgjohej, shikohej dhe ndihej në të gjitha kinematë e ndjenjave të klasit të parë në Evropën Perëndimore.
Ndikimi i filmit të Darvin Bonapartit ishte i menjëhershëm dhe i jashtëzakonshëm. Pasditen e nesërme të shfaqjes së parë, vetmia fshatarake e Xhonit u thye prej luzmës gumëzhitëse të helikopterëve.
Ai po gërmonte kopshtin – po gërmonte edhe brenda mendjes së vet, me punë po kthente si plis substancën e mendimit. Vdekja – dhe e ktheu lopatën një herë, dy, e prapë e prapë. Dhe gjithë të djeshmet tona u kanë ndriçuar budallenjve rrugën drejt pluhurit të vdekjes. Një vetëtimë bindjeje gjëmoi mes fjalëve. Ai ngriti një tjetër lopatë plot me dhe. Pse vdiq Linda? Përse u la gradualisht të bëhej më pak se njeri dhe më në fund... I shkuan të ngjethura. Një kërmë aq e mirë, sa ta puthje. Vuri këmbën mbi lopatë dhe e shtyu fort në dhe. Siç janë mizat për djemtë mistrecë, ashtu jemi ne për zotat; na vrasin për sport. Prapë vetëtiu; fjalë që vetëshpallen si të vërteta – më të vërteta se vetë e vërteta. E megjithatë, i njëjti Glosster i kish quajtur zotat ndonjëherë të sjellshëm. Përveç

kësaj, çlodhja më e mirë është gjumi, të cilin vetë e shkakton; e prapë vdekja, që s'është asgjë më shumë, të tmerron. Asgjë më tepër se gjumi. Gjumi. Për të ëndërruar. Lopata i hasi në gur; ndali dhe u ul ta marrë. Për atë që fle gjumin e vdekjes, çfarë ëndrrash...?
Gumëzhima mbi kokë u bë gjëmim, dhe krejt papritur u gjend brenda një hijeje, kishte diçka mes tij dhe diellit. Ngriti vështrim lart, i trembur, la gërmimin dhe mendimet; pa lart i verbuar dhe i trembur, me mendjen që akoma endej në atë botë më të vërtetë se e vërteta, ende e fokusuar në pafundësitë e vdekjes dhe hyjnisë; vështroi lart dhe pa, fare pranë me të, një luzmë makinerish fluturuese. Si karkalecat erdhën, qëndruan varur dhe u ulën rreth e rrotull tij mbi shqopa. Dhe prej barqeve të këtyre barngrënëseve, zbritën disa burra të veshur me rroba prej fanellate viskoze të bardhë, gra (ngase bënte vapë) në pizhame acetat pambuku, pantallona të shkurtra kadifeje dhe kanotiere pa mëngë me zinxhirët zbërthyer – një çift për çdo sërë. Për pak minuta u bënë duzina me njerëz, të cilët krijuan një qark të gjerë rrotull farit. Ata e vështronin, qeshnin, shkrepnin aparatet fotografike, i hidhnin (siç bëhej me majmunin) kikirikë, paketa me çamçakëzë me hormone seksi, gjëndra të tiganit petit beurre. Në pak minuta, që përtej shpatit të Derrit, rrjedha e trafikut tani vazhdonte pandërprerë, numri i tyre u rrit. Si nëpër ëndrra të këqija, duzinat u bënë tog, togjet numëroheshin me qindra.
Njeriu i egër u tërhoq pas në mbrojtje dhe tani, me sjelljen e kafshës së zënë në grackë, qëndronte me shpinë pas murit të farit, duke i vështruar fytyrat e tyre një për një, me tmerr të papërshkrueshëm, si njeri që s'është në vete.

Prej shtangies u kthye në realitet prej një pakoje me çamçakëz, që ia kishin matur mirë dhe që i ra në faqe. Prej goditjes dhe dhimbjes që po i përhapej, u përmend, sikur i doli krejt gjumi, u përmend i tërbuar nga zemërimi.
"Ikni!" – u bërtiti.
Majmuni foli me gojë; plasi gazi dhe duartrokitjet. "I madhi njeri i egër! Urra! Urra!" Nëpër babelin e zërave dhe lëvizjeve dëgjoi thirrjen: "Fshikullo, fshikullo, me kamxhikun fshikullo!" Pas këshillës së turmës, ai shkuli prej gozhdës pas derës tufën e litarëve me nyje dhe e tundi në sy të persekutorëve të vet.
U dëgjua një britmë ironie e më pas duartrokitjet. Kërcënues, ai bëri përpara drejt tyre. Një grua ulëriti nga frika. Vargu u lëkund në pikën më të afërt me kërcënimin, bëri prapas, pastaj u ngurtësua sërish dhe ndenji në vend. Vetëdija se ishin më të shumtë në numër u kishte dhënë sehirxhinjve një guxim, të cilin njeriu i egër nuk e priste. U shty pas, ndali dhe vështroi përqark.
"Përse nuk më lini të qetë?" – kishte një notë gati të përvajshme brenda zemërimit të tij.
"Ha ca bajame të kripura me magnez!" i tha një burrë, i cili, po të gjuante i egri, do të goditej i pari. Ai i zgjati një pako. "Janë shumë të mira, provoi, – shtoi ai me një buzagaz, si për ta marrë me të mirë, – dhe kripa e magnezit të ndihmon të mos plakesh."
Njeriu i egër e injoroi. "Çfarë doni nga unë?" pyeti, me sytë sa nga njëra fytyrë e shtrembëruar tek tjetra. "Çfarë doni nga unë?"
"Kamxhikun, – iu përgjigjën qindra zëra, – bëj numrin me kamxhik. Dua të shohim numrin e kamxhikut."

Pastaj, njëzëri dhe me një ritëm të ngadaltë e të rëndë: “Duam kamxhikun, – filloi të bërtasë një grup andej nga fundi. – Duam kamxhikun!”
Të tjerë iu bashkuan thirrjes menjëherë dhe fraza u përsërit, papagallçe, prapë e prapë, me zë përherë e më të lartë, derisa, pas përsëritjes së shtatë a të tetë, nuk dëgjohej fjalë tjetër anekënd. Bërtitnin të gjithë së bashku; dhe, helmuar prej zhurmës, njëzëshmërisë, atij shëlbimi ritmik, dukej se të gjithë mund të vazhdonin ashtu pothuaj pa pushim. Por aty nga përsëritja e njëzet e pestë, ceremonia u ndërpre. Një tjetër helikopter kish mbërritur nga shpati i Derrit. Ai qëndroi pezull mbi turmë, pastaj u ul pak metra larg vendit ku po rrinte njeriu i egër, në hapësirën mes vargut të njerëzve dhe farit. Gjëmimi i helikave për pak i mbyti thirrjet; pastaj, kur makineria preku në tokë dhe motorët u shuan: “Duam kamxhikun, duam kamxhikun,” – shpërtheu përsëri me të njëjtin zë monoton e këmbëngulës.
Porta e helikopterit u hap dhe doli në fillim njëri me fytyrë të kuqe e të re dhe, pas tij, e veshur me pantallona të shkurtra kadifeje ngjyrë jeshile, bluzë të bardhë dhe kapele hipizmi, një vajzë e re.
Sapo pa me sy vajzën e re, njeriu i egër ngriu, u tërhoq pas, u zbeh.
Vajza e re qëndroi, duke i buzëqeshur atij – një buzëqeshje lutëse e paqartë, gati e ndyrë. Sekondat kalonin. Buzët e saj po lëviznin, ajo po thoshte një gjë; por zëri i saj u mbulua nga refreni i përsëritur i sehirxhinjve.
“Duam kamxhikun! Duam kamxhikun!”
Vajza e re vendosi të dyja duart në anën e majtë dhe në atë fytyrë ngjyrë pjeshke, si prej kukulle, u shfaq një shprehi

shqetësimi të mallëngjyer. Sytë e saj blu u duk sikur u zmadhuan, u përndritën; e befas dy pika lot i rrodhën teposhtë faqeve. Pa u dëgjuar, ajo foli sërish; pastaj, me një gjest të shpejtë e të pasionuar, ajo i shpërndau duart drejt të egrit dhe eci para.
"Duam kamxhikun! Duam..."
Dhe krejt kur nuk e prisnin, ata morën atë që deshën.
"Lavire! – njeriu i egër u vërsul si i çmendur. – Qelbësirë!" si i çmendur, ai po fshikullonte me kamxhikun me fije të holla.
E tmerruar, ajo ishte kthyer mbrapsht të ikte me vrap, por ishte rrëzuar ngatërruar nga shqopat.
"Henri! Henri!" – bërtiste ajo. Por shoqëruesi i saj fytyrëkuq ishte turrur larg rrezikut, duke u fshehur prapa helikopterit.
Me një gulç ngazëllimi, vargu u ndërpre; u bë një rrëmujë konvergjente, që shtynte si me magnet drejt qendrës së rëndësisë. Dhimbja ishte një tmerr tepër tërheqës.
"Zhduku, lapërdhi, zhduku!" – klithte njeriu i egër dhe fshikullonte përsëri.
Me lakmi ata iu mblodhën rrotull, duke shtyrë e sharë, si derrat në thark.
"Ah, mishi! – njeriu i egër kërcëlliu dhëmbët. Këtë radhë kamxhiku zuri vend në shpatullat e tij. – Vrite! Vrite!"
Të tërhequr prej magjepsjes së tmerrit të dhimbjes dhe, nga përbrenda, të shtyrë nga zakoni i bashkëpunimit, nga dëshira për unanimitet dhe shëlbim, të cilën kushtëzimi ia kishte ngulitur gjer në thelb, turma nisi të imitojë furinë e gjesteve, duke goditur njëri-tjetrin sa herë që njeriu i egër godiste mishin e vet kryengritës, ose vetë mishërimin e turpit të kolmë që dridhej mbi shqopa aty nën këmbët e tij.

"Vrite, vrite, vrite..." – vazhdonte të bërtiturat i egri.
Befas dikush nisi të këndojë "Orgji-derri" dhe për një çast të vetëm, të gjithë i mbajtën refrenin dhe duke kënduar, nisën të vallëzojnë. Orgji-derri, rrotullohu, rrotullohu, duke goditur njëri-tjetrin me kohën gjashtë të tetat. Orgji-derri...
Mesnata kishte mbërritur kur helikopteri i fundit u ngrit e iku. I trullosur prej somas dhe i rraskapitur prej ditës së tejzgjatur me furinë e ndjeshmërisë, njeriu i egër i shtrirë për të fjetur mbi shqopa. Kur u zgjua, dielli tashmë qe ngritur në kupë të qiellit. Qëndroi shtrirë për një moment, duke picërruar sytë si kukuvajka në dritë; pastaj befas iu kujtuan të gjitha.
"O Zot, o Zot!" – mbuloi sytë me pëllëmbë.
Atë mbrëmje, luzma tjetër e helikopterëve të ardhur me gumëzhima përmes shpatit të Derrit ishte si një re e zezë dhjetë kilometra e gjatë. Përshkrimi i orgjisë së shëlbimit të një nate më parë kishte dalë në të gjitha gazetat.
"Njeri i egër!" – thirrën ata që mbërritën të parët sapo zbritën prej makinerive të veta.
"Zotni njeri i egër!"
Asnjë përgjigje.
Porta e farit ishte kanat e hapur. Ata e shtynë dhe u futën brenda në muzgun e dritareve me grila. Përmes harkut matanë dhomës, ata mundën të shohin fundin e kafazit të shkallëve, të cilat ngjiteshin në katet e sipërme. Tamam në kurorën e harkut tundeshin një palë këmbë.
"Zotni egërsira!"
Ngadalë, shumë ngadalë, si dy gjilpërat e busullës, këmbët u sollën nga e djathta; veri, verilindje, lindje, juglindje, jug,

jug-jugperëndim; pastaj reshtën dhe, pas disa sekondash, u sollën me po aq plogëti në anën e majtë. Jug, jugperëndim, jug, juglindje, lindje...

FUND


MË E MIRA
E BOTËVE
NJË ROMAN PËR TË ARDHMEN
Në një të ardhme të largët, njerëzimi
jeton në një botë të përsosur.
Pa varfëri, pa dhimbje, pa luftë.
Lumturia është e garantuar.
Por çmimi i saj është liria.
Përmes vizionit të tij të fuqishëm dhe
paralajmërues, Aldous Huxley na çon
në një shoqëri ku teknologjia,
konsumizmi dhe kontrolli i mendjes
krijojnë një rend të ri –
ku njerëzit janë të lirë
të zgjedhin gjithçka,
përveç së vërtetës.
"Një nga romanet më të rëndësishme
të shekullit XX."
– George Orwell